

Издавач:

Биро за развој на образованието

За издавачот:

Весна Хорватовиќ, директор

Уредници:

Жанета Чонтева

Митко Чешларов

Печати:

Винсент - Графика

Тираж:

5.500 примероци

CIP – Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

373.3.091.3 : 316.61 (035)
316.61 (035)

ПРИРАЧНИК за образование за животни вештини : од IV до VI одделение-основно училиште / [прирачникот го подготвија Филипина Негриевска... (и др.) ; под раководство на Виолета Петровска-Бешка ; уредници Жанета Чонтева, Митко Чешларов]. - Скопје : Биро за развој на образованието, 2009. – 326 стр. : илустр. ; 30 см

ИСБН 978-608-206-009-5

а) Животни вештини – Основно образование – Наставни методи – Прирачници
ЦОБИСС.МК-ИД 78957322

Përmbajtja

Tema I: UNË – ZHVILLIMI PERSONAL	16
Përmbajtja I-1: KRIJIMI I VETËBESIMIT	17
<i>Punëtorja I-1.3: Dollia.....</i>	<i>18</i>
<i>Punëtorja I-1.2: Pasqyra ime, pasqyra ime... ..</i>	<i>22</i>
<i>Punëtorja I-1.3: Unë mundem</i>	<i>23</i>
Përmbajtja I-2: KRIJIMI I IMAZHIT PËR VETVETEN SI ANËTAR I FAMILJES DHE SI NXËNËS.....	25
<i>Punëtorja I-2.1: Familje të ndryshme – dashuri e njëjtë</i>	<i>26</i>
<i>Punëtorja I-2.2: Përgjegjësitë e mia</i>	<i>29</i>
<i>Punëtorja I-2.3: Secili bën diçka</i>	<i>30</i>
Përmbajtja I-3: NJOHJA DHE SHPREHJA E EMOCIONEVE PERSONALE.....	31
<i>Punëtorja I-3.1: Edhe këndshëm edhe jo këndshëm.....</i>	<i>32</i>
<i>Punëtorja I-3.2: Ndjenjat e fuqishme</i>	<i>35</i>
<i>Punëtorja I-3.3: Njohja e ndjenjave</i>	<i>37</i>
Përmbajtja I-4: BALLAFAQIMI ME HUMBjen DHE PIKËLLIMIN.....	39
<i>Punëtorja I-4.1: Barometri i emocioneve.....</i>	<i>40</i>
<i>Punëtorja I-4.2: Humbja e lepurit Zozo.....</i>	<i>42</i>
Përmbajtja I-5: BALLAFAQIMI MË SUKSESIN/MOSSUKSESIN.....	45
<i>Punëtorja I-5.1: Asgjë nuk shkon aq mirë sa suksesi!... ..</i>	<i>46</i>
<i>Punëtorja I-5.2: Proverba për suksesin dhe mossuksesin.....</i>	<i>48</i>
Përmbajtja I-6: SHPREHJA MENDIMIT	50
<i>Punëtorja I-6.1: Unë mendoj kështu dhe dëshiroj ta dinë të gjithë!... ..</i>	<i>51</i>
<i>Punëtorja I-6.2: Debat.....</i>	<i>53</i>
<i>Punëtorja I-6.3: Më thuaj çka mendon, se dua të të dëgjoj</i>	<i>55</i>
Përmbajtja I-7: MENAXHIMI I KOHËS SË LIRË	57
<i>Punëtorja I-7.1: Koha e lirë.....</i>	<i>58</i>
 Tema II: UNË DHE TI – RAPORTET NDËRPERSONALE.....	 60
Përmbajtja II-1: PRANIMI I NGJASHMËRIVE DHE DALLIMEVE.....	61
<i>Punëtorja II-1.1: Pjesë-pjesë - radhitëse</i>	<i>62</i>
<i>Punëtorja II-1.2: Ose sirtar ose kolltuk</i>	<i>65</i>
<i>Punëtorja II-1.3: Ushqim, veshje ose libra.....</i>	<i>67</i>
<i>Punëtorja II-1.4: E rëndësishme, më e rëndësishme</i>	<i>69</i>
<i>Punëtorja II-1.5: Mundem, nuk mundem/di, nuk di</i>	<i>70</i>
Përmbajtja II-2: FORMIMI, MIRËMBAJTJA DHE NDËRPRERJA E LIDHJEVE.....	71
<i>Punëtorja II-2.1: Lulja e miqësisë.....</i>	<i>72</i>
Përmbajtja II-3: RUAJTJA E SEKRETIT	74
<i>Punëtorja II-3.1: Ruajtja e sekretit</i>	<i>75</i>
Përmbajtja II-4: TREGIMI I GËNJESHTRAVE/TË VËRTETAVE	76
<i>Punëtorja II-4.1: Pse gënjejmë?.....</i>	<i>77</i>
Përmbajtja II-5: DHËNIA DHE PRANIMI I NDIHMËS.....	78
<i>Punëtorja II-5.1: Ndhmo këtu, ndhmo aty... ..</i>	<i>79</i>
<i>Punëtorja II-5.2: Luani dhe miu... ..</i>	<i>81</i>
<i>Punëtorja II-5.3: Fëmijë me nevoja të veçanta</i>	<i>83</i>
Përmbajtja II-6: PAJTIMI DHE PRANIMI I GABIMEVE.....	86
<i>Punëtorja II-6.1: Gabimi dhe falja</i>	<i>87</i>

Përmbajtja II-7: BALLAFAQIMI ME EMOCIONET	88
<i>Punëtorja II-7.1: Sjellja gjatë hidhërimit</i>	<i>89</i>
<i>Punëtorja II-7.2: Sjellja sulmuese.....</i>	<i>91</i>
<i>Punëtorja II-7.3: Kontrollimi i hidhërimit personal.....</i>	<i>94</i>
<i>Punëtorja II-7.4: Simpa, simpa, ti dhe unë... ..</i>	<i>96</i>
Përmbajtja II-8: KOMUNIKIMI.....	97
<i>Punëtorja II-8.1: Të folurit e fytyrës sime</i>	<i>98</i>
<i>Punëtorja II-8.2: Pyetje për ta qëlluar.....</i>	<i>100</i>
<i>Punëtorja II-8.3: Dëgjim dhe kuptim.....</i>	<i>102</i>
<i>Punëtorja II-8.4: Dëgjim aktiv</i>	<i>104</i>
<i>Punëtorja II-8.5: Nëse të kuptova si duhet... ..</i>	<i>105</i>
Përmbajtja II-9: BALLAFAQIMI ME SJELLJE TË DHUNSHME	107
<i>Punëtorja II-9.1: Lea e përqeshur.....</i>	<i>108</i>
Përmbajtja II-10: ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE	111
<i>Punëtorja II-10.1: E shikojmë të njëjtën, shohim gjëra të tjera</i>	<i>112</i>
<i>Punëtorja II-10.2: Konfliktet janë shkallë-shkallë</i>	<i>116</i>
<i>Punëtorja II-10.3: Nevoja</i>	<i>128</i>
<i>Punëtorja II-10.4: Burimet e konflikteve.....</i>	<i>130</i>
<i>Punëtorja II-10.5: Shmangia, kundërshtimi ose.....</i>	<i>132</i>
<i>Punëtorja II-10.6: “Unë” mesazhe.....</i>	<i>134</i>

Tema III: UNË DHE TË TJERËT – RAPORTET SHOQËRORE 136

Përmbajtja III-1: NJOHJA E TË DREJTAVE ELEMENTARE TË NJERIUT (TË DREJTAT E FËMIJËVE)	137
<i>Punëtorja III-1.1: Të drejtat dhe rregullat.....</i>	<i>138</i>
<i>Punëtorja III-1.2: Të drejtat dhe përgjegjësitë</i>	<i>140</i>
<i>Punëtorja III-1.3: Sa i njeh të drejtat tuaja?.....</i>	<i>141</i>
PËRMBAJTJA III-2: RESPEKTIMI I TË TJERËVE (MOSDISKRIMINIMI)	146
<i>Punëtorja III-2.1: Biznesmenë dhe fotomodelë</i>	<i>147</i>
<i>Punëtorja III-2.1: Me sy bojë kafe ose pa to.....</i>	<i>149</i>
Përmbajtja III-3: MBËSHTETJA DHE BASHKËPUNIMI I NDËRSJELLË	151
<i>Punëtorja III-3.1: Tre në një</i>	<i>152</i>
<i>Punëtorja III-3.2: Nga fjalët deri te fjalitë.....</i>	<i>154</i>
<i>Punëtorja III-3.3: NDIHMË!.....</i>	<i>157</i>
Përmbajtja III-4: NJOHJA E STRUKTURËS SË GRUPIT	159
<i>Punëtorja III-4.1: Sa shumë grupe!?.....</i>	<i>160</i>
Përmbajtja III-5: MARRJA E VENDIMEVE NË GRUP.....	162
<i>Punëtorja III-5.1: Stuhi idesh</i>	<i>163</i>
<i>Punëtorja III-5.2: Lider i mirë, klasë e mirë.....</i>	<i>165</i>
<i>Punëtorja III-5.3: Të hedhim një monedhë ose të votojmë?.....</i>	<i>166</i>
<i>Punëtorja III-5.4: Të kundërshtoj apo jo?</i>	<i>167</i>
<i>Punëtorja III-5.5: Vendimi im, vendimi yt.....</i>	<i>169</i>
Përmbajtja III-6: BALLAFAQIMI ME TRYSNINË SOCIALE.....	170
<i>Punëtorja III-6.1: Sjellje e pranueshme dhe e papranueshme.....</i>	<i>171</i>
<i>Punëtorja III-6.2: Të grithim vetura!.....</i>	<i>175</i>
<i>Punëtorja III-6.3: Djemtë nuk qajnë... ..</i>	<i>177</i>
<i>Punëtorja III-6.4: Hirushi</i>	<i>179</i>
Përmbajtja III-7: MARRJA E PËRGJEGJËSISË PËR VEPRIMET	183
<i>Punëtorja III-7.1: Ngjarjet e Ogit</i>	<i>184</i>

<i>Punëtorja III-7.2: Rregulla, rregulla, rregulla!</i>	186
Përmbajtja III-8: NDËRTIMI I RAPORTIT POZITIV PËR VENDIN TËND	188
<i>Punëtorja III-8.1: Në pajtim me kushtetutën ose jo?</i>	189
<i>Punëtorja III-8.2: Përfaqësoje Maqedoninë</i>	190
Përmbajtja III-9: NDËRTIMI I NDJENJËS PËR PËRKATËSINË E PËRGJITHSHME CIVILIZUESE	192
<i>Punëtorja III-9.1: Bota pas 20 viteve</i>	193
<i>Punëtorja III-9.2: Ne jemi ylber</i>	194
Përmbajtja III-10: PERCEPTIMI I MODELEVE POZITIVE TË IDENTIFIKIMIT	197
<i>Punëtorja III-10.1: Dëshiroj të bëhem</i>	198
<i>Punëtorja III-10.2: Intervista</i>	200
<i>Punëtorja III-10.3: Heronjtë</i>	201
Përmbajtja III-11: ZHVILLIMI I QASJES KRITIKE NDAJ MEDIAVE	202
<i>Punëtorja III-11.1: Përralla e “tjetrit”</i>	203
<i>Punëtorja III-11.2: Programi për fëmijë?!</i>	207
Përmbajtja III-12: PËRDORIMI I INSTITUCIONEVE PËR MBROJTJE DHE SIGURI	209
<i>Punëtorja III-12.1: Institucionet e mbrojtjes</i>	210
<i>Punëtorja III-12.2: Kur je në fatkeqësi, paraqitu në</i>	213
 Tema IV: UNË DHE SHËNDETI – JETA E SHËNDETSHME	215
Përmbajtja IV-1: PËRVETËSIMI I SHPREHIVE PËR USHQIM TË SHËNDETSHËM	216
<i>Punëtorja IV-1.1 Barometri që harxhon kalori</i>	217
<i>Punëtorja IV-1.2 Piramida e të ushqyerit</i>	219
<i>Punëtorja IV-1.3 Patatja e nxehtë</i>	222
<i>Punëtorja IV-1.4: Sallatë ose sandviç?</i>	224
<i>Punëtorja IV-1.5 Ushqime të thjeshta</i>	226
<i>Punëtorja IV-1.6 Lënda djegëse organike</i>	227
<i>Punëtorja IV-1.7: Shprehitë e shëndosha</i>	230
Përmbajtja IV-2: KUJDESI PËR HIGJIENËN PERSONALE	233
<i>Punëtorja IV-2.1: Ndërlidhëse</i>	234
<i>Punëtorja IV-2.2: E imja – e jona</i>	236
<i>Punëtorja IV-2.3 Përralla për Kalën</i>	237
<i>Punëtorja IV-2.4: Veshja adekuate</i>	240
<i>Punëtorja IV-2.5: Veshja ime – brenga ime</i>	242
<i>Punëtorja IV-2.6: Përralla e varësës</i>	244
<i>Përmbajtja IV-3: PREVENTIVA NDAJ SËMUNDJEVE DHE SËMURJEVE</i>	246
<i>Punëtorja IV-3.1: Sëmundjet</i>	247
<i>Punëtorja IV-3.2: Visheni Zdravkën</i>	250
<i>Punëtorja IV-3.3: Lëndimet</i>	252
Përmbajtja IV-4: ZHVILLIMI I VETËDIJES PËR SHËNDETI SEKSUAL	254
<i>Punëtorja IV-4.1 Përralla për Ingën</i>	255
<i>Punëtorja IV-4.2: Ndryshimet</i>	258
<i>Punëtorja IV-4.3: Puberteti – kuiz</i>	259
<i>Punëtorja IV-4.4 Mbrojtja nga keqpërdorimi seksual</i>	262
<i>Punëtorja IV-4.5: Shqetësimi seksual</i>	264
<i>Punëtorja IV-4.6: Situatat</i>	267
Përmbajtja IV-5: PARANDALIMI I ALKOOLIT DHE DUHANIT	270
<i>Punëtorja IV-5.1: Mbrojtja nga pirja e duhanit</i>	271
<i>Punëtorja IV-5.2: Shëndet apo jo?</i>	273
<i>Punëtorja IV-5.3: Anti-reklamat</i>	275

Tema V: UNË DHE MJEDISI – RAPORTI ME MJEDISIN E JASHTËM	276
<i>Përmbajtja V-1: SJELLJA E SIGURT NË MJEDIS</i>	<i>277</i>
<i>Punëtorja V-1.1: Rreziqet.....</i>	<i>278</i>
<i>Punëtorja V-1.2: Rruga ime deri në shkollë.....</i>	<i>281</i>
<i>Punëtorja V-1.3: Siguria në komunikacion</i>	<i>283</i>
<i>Punëtorja V-1.4: Siguria në komunikacion II.....</i>	<i>284</i>
<i>Punëtorja V-1.5: Është me rëndësi të dihet.....</i>	<i>285</i>
<i>Punëtorja V-1.6: Labirinti.....</i>	<i>287</i>
<i>Punëtorja V-1.7: Armët.....</i>	<i>289</i>
<i>Përmbajtja V-2: KRIJIMI I RAPORTI POZITIV NDAJ MJEDISIT.....</i>	<i>290</i>
<i>Punëtorja V-2.1: Ngremë.....</i>	<i>291</i>
<i>Punëtorja V-2.2: KLASA JONË.....</i>	<i>292</i>
<i>Punëtorja V-2.3: Mbeturina? Ndotja? Stolia?</i>	<i>293</i>
<i>Punëtorja V-2.4: Dita e planetit Tokë</i>	<i>294</i>
<i>Punëtorja V-2.5: Në klasë.....</i>	<i>295</i>
<i>Përmbajtja V-3: KRIJIMI I RAPORTIT POZITIV NDAJ KAFSHËVE DHE BIMËVE.....</i>	<i>297</i>
<i>Punëtorja V-3.1: Origamet.....</i>	<i>298</i>
<i>Punëtorja V-3.2: Fjalëkryqi.....</i>	<i>301</i>
<i>Punëtorja V-3.3: Vesna e madhe e vogël</i>	<i>303</i>
<i>Punëtorja V-3.4: Bondrithja dhe Barishti.....</i>	<i>306</i>
<i>Punëtorja V-3.5: Ushqimoret e fluturave</i>	<i>309</i>
<i>Punëtorja V-3.6: Ushqimore për shpezë.....</i>	<i>311</i>
<i>Përmbajtja V-4: PËRMIRËSIMI, MIRËMBAJTJA DHE STOLISJA E MJEDISIT</i>	<i>313</i>
<i>Punëtorja V-4.1: Klasa jonë.....</i>	<i>314</i>
<i>Përmbajtja V-5: MBROJTJA E PLANETIT TOKË</i>	<i>316</i>
<i>Punëtorja V-5.1: Shëtitja e gjelbër-ndotësmetri</i>	<i>317</i>
<i>Punëtorja V-5.2: Teknologjia = ndotja?.....</i>	<i>320</i>
<i>Punëtorja V-5.3: Uji.....</i>	<i>322</i>

Doracakun e përgatitën:
Filipina Negrievska
Safet Ballazhi
Sasho Nikollovski-Alushevski
Renata Dedova
nën mbikëqyrje të
Prof. Dr. Violeta Petroska – Beshka

Në doracak janë përdorë materiale që janë përgatitur për nevojat e programeve të ndryshme arsimore që janë krijuar nga ekipi i ekspertëve të Qendrës së të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve:

- » Дедова, Р. Негриевска, Ф. dhe Цветаноска, М. (2003). *Исти, слични, различни: работилници за интеретничка толеранција (Тë njëjtë, të ngjashëm, të ndryshëm: punëtori për tolerancë ndëretnike)* (doracak për përdorim intern). Qendra e të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve dhe UNICEF.
- » Naj~evska, M.(udhëheqëse e projektit) (2000). *Imam pravo: Proekt za implementacija za pravata na deteto vo IV oddelenie od osnovното obrazovanie (Kam të drejtë: Projekt për implementimin e të drejtave të fëmijës në klasën IV të shkollës fillore)* (doracak për arsimtarë). Qendra e të Drejtave të Njeriut – Instituti i Gjurmimeve Sociologjike dhe Politike-Juridike dhe UNICEF.
- » Петроска-Бешка, В. (1996). *Итри за разрешување конфликти за деца од 9-11 години (Lojëra për zgjidhjen e konflikteve të moshës 9-11 vjeçare)* (doracak për stërvitës). Projekt për zgjidhjen e konflikteve etnike – Fakulteti Filozofik, Shkup.
- » Петроска-Бешка, В., Поповски, М. dhe Абдулаи, Ј. (1997). *Разбирање на конфликтише (Kuptimi i konflikteve)* (doracak për stërvitës). Projekt për zgjidhjen e konflikteve etnike – Fakulteti Filozofik, Shkup.
- » Петроска-Бешка, В. (2002). *Абра-мир-добра, Образование за мир - 1. и 2. дел (Абра-паке-добра, Arsimi për paqe – pjesa 1 dhe 2)* (doracak për përdorim intern). Qendra e të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve dhe UNICEF.
- » Петроска-Бешка, В. (2005). *Едукација за разрешување конфликти за VII одделение (Edukimi për zgjidhjen e konflikteve për klasën VII)* (doracak për arsimtarë). Qendra e të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve dhe UNICEF.
- » Цветаноска, М., Балажи, С. dhe Негриевска, Ф. (1999). *Пошрага по скриеношо болаштво: Работилници за психо-социјална поддршка на деца. (Kërkimi i thesarit të fshehur: Punëtori për përkrahje psiko-sociale të fëmijëve),* Projekt për zgjidhjen e konflikteve etnike – Fakulteti Filozofik, Shkup.

HYRJE

ÇKA ËSHTË ARSIMIMI PËR SHKATHTËSITË JETËSORE?

Të gjithë fëmijët, pavarësisht nga prejardhja dhe aftësitë, kanë nevojë për shkathtësi të cilat do t'u mundësojnë t'i shfrytëzojnë dituritë e tyre që të praktikojnë forma të shëndosha të sjelljes dhe t'u shmangen atyre formave që paraqesin kanosje ndaj shëndetit të tyre personal, emocional dhe social. Ato shkathtësi do të ndihmojnë që ata të jenë të pjekur, aktivë dhe persona të përgjegjshëm në një shoqëri qytetare dhe multikulturore.

Me çka dallohet arsimimi për shkathtësi jetësore nga qasjet e tjera të cilat orvaten të ndikojnë në sjelljen e fëmijëve?

- » Arsimimi për shkathtësi jetësore është i orientuar drejt futjes së ndryshimeve të sjelljes përmes përvetësimit të diturive, qëndrimeve dhe shkathtësive të caktuara, të cilat u ndihmojnë fëmijëve të zgjedhin dhe praktikojnë sjellje të shëndoshë në vend të mësimin të thatë me shpjegimin se çka do të thotë ajo sjellje në teori.
- » Detyra themelore e arsimimit për shkathtësi jetësore është ta transformojë diturinë në sjellje; andaj secili program për shkathtësi jetësore duhet të ofrojë raport të balancuar ndërmjet: (1) diturive dhe informacioneve; (2) qëndrimeve dhe vlerave dhe (3) shkathtësive.
- » Arsimimi për shkathtësi jetësore bazohet në metodat participuese të mësimin dhe mësimdhënies, që i bën fëmijët pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimin, në vend që t'i trajtojnë ata si pranues pasiv të informacioneve.

Arsimimi për shkathtësi jetësore nisët nga premisa themelore se përvetësimi i shkathtësive jetësore është e drejtë e secilit fëmijë. Kjo e bën të jetë relevant për nevojat e fëmijëve të secilës moshë dhe në mënyrë fleksibile t'u përgjigjet sfidave reale të jetës së përditshme të fëmijëve.

Arsimimi për shkathtësi jetësore e merr parasysh faktin se sjellja e individit varet nga faktorë të ndryshëm, të cilët burojnë nga familja, shkolla dhe bashkësia më e gjerë, po edhe nga faktorët individualë në të cilët bëjnë pjesë dituritë, qëndrimet, shkathtësitë dhe veçoritë e individit. Prandaj, arsimimi për shkathtësi jetësore nuk zbatohet në mënyrë të izoluar nga burimet e tjera të ndikimit, por përkundrazi, synon që ta fuqizojë individin si pjesë të bashkësisë që ai të mund të ballafaqohet me sfidat të cilat burojnë nga ndikimet e mjedisit në të cilin ai ekziston.

ÇKA JANË SHKATHTËSITË JETËSORE?

Termi shkathtësi jetësore i referohet një grupi të madh të shkathtësive psiko-sociale, qëllimi i të cilave është të kontribuojnë për zhvillimin personal, emocional dhe social të fëmijëve, si dhe të sigurojnë mirëqenie fizike, mentale dhe sociale për fëmijët.

Është vështirë të bëhet një listë e të gjitha shkathtësive të mundshme jetësore, por zakonisht si më të rëndësishëm mund të konsiderohen ato që janë dhënë në tabelën që vijon (Tabela 1).

Se cilat shkathtësi jetësore do të theksohen dhe cilave do t'u kushtohet vëmendje më e madhe në procesin e arsimimit, kjo varet nga tema dhe përmbajtja që përcillet, nga situata reale jetësore në shkollë dhe në mjedisin më të gjerë dhe, më e rëndësishmja, nga nevojat e vetë nxënësve. Pa e marrë në konsideratë kontekstin në të cilin është vënë, arsimimi për shkathtësi jetësore duhet të promovojë vlera pozitive dhe t'i zbatojë shkathtësitë e përmbushjes së nevojave konkrete të fëmijëve.

*Tabela 1. Shkathtësitë më të rëndësishme jetësore.
(sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë)*

Vetëdija për veten » vetëdija për vlerat personale (vetëbesimi, imazhi pozitiv për veten) » vetëdija për dobësitë personale (të priturat reale, imazhi real për veten) » vetëdija për të drejtat dhe përgjegjësitë » pasqyra e qartë për vlerat » motivimi dhe kujdesi për vetveten	Empatia » kujdesi për të tjerët » toleranca ndaj dallimeve » respektimi i të tjerëve » të qenët i shoqërueshëm
Shkathtësitë e komunikimit » komunikimi efektiv dhe adekuat verbal dhe joverbal » aftësia për t'u shprehur » asertiviteti » dëgjimi aktiv » aftësia për bisedime	Shkathtësitë interpersonale » bashkëpunimi » përgatitja për punë ekipore » formimi dhe ndërprerja e miqësive » njohja e kufijve të sjelljes adekuate interpersonale
Shkathtësitë e marrjes së vendimeve » marrja e vendimeve me vetëdije të plotë për faktorët që ndikojnë në mendimin dhe zgjedhjen » marrja e vendimeve që janë të bazuara në vlerësim të saktë të situatës » parashtrimi i qëllimeve reale » planifikimi i procedurave personale duke i marrë parasysh pasojat e mundshme » marrja e përgjegjësisë për procedurat personale » përgatitja për ndryshimin e vendimeve me qëllim të përshtatjes ndaj situatave të reja	Shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve » identifikimi i problemeve dhe shkaqeve të paraqitjes së tyre » vlerësimi i saktë i aktiviteteve që mund të ndërmerren për zgjidhjen e problemeve » identifikimi se ku mund të kërkohet ndihmë kur ka ndonjë problem dhe kërkimi i ndihmës. » përgatitja për kompromis » përgatitja për pjesëmarrje në zgjidhjen grupe të problemeve
Të menduarit kreativ » të menduarit pozitiv » mësimi aktiv (nevoja për të kërkuar njohuri të reja) » aftësia për ta shprehur vetveten » identifikimi i mundësive alternative » zbulimi i zgjidhjeve origjinale të problemeve	Të menduarit kritik » njohja e ndikimeve sociale dhe kulturore ndaj qëndrimeve, vlerave dhe sjelljes (përfshirë edhe presionin e moshatarëve dhe ndikimin e mediave) » vetëdija për pabarazinë, padrejtësinë dhe paragjykimet » vetëdija për rolin e qytetarit të përgjegjshëm
Ballafaqimi me emocionet » njohja e emocioneve personale dhe e emocioneve të të tjerëve » ndërlidhja e emocioneve me përjetimet, të menduarit dhe sjelljen » ballafaqimi me frustracione, hidhërim, pikëllim, frikë dhe ankth » ballafaqimi me emocione të fuqishme të të tjerët	Ballafaqimi me stresin » ballafaqimi me situata në të cilat nuk mund të ndikohet » zhvillimi i strategjive për t'u ballafaquar me humbjen, refuzimin dhe kritikën » ballafaqimi me përdorimin e substancave psikotropike » rezistenca ndaj trysnive » ballafaqimi me situata të stresit » menaxhimi i kohës

ÇFARË MËSIMDHËNIE PËR SHKATHTËSITË JETËSORE?

Kur bëhet fjalë për arsimimin e shkathtësive jetësore, nuk mjafton vetëm të përcaktohet se cilat janë shkathtësitë që duhet t'i përvetësojnë fëmijët, por edhe se cilat metoda mësimore do të përdoren në atë rast. Si do të jepet ai mësim është njësoj me rëndësi me atë se çka do të mësohet. Kjo do të thotë se mësimi që është i orientuar drejt përvetësimit të shkathtësive jetësore duhet të bazohet në metodat dhe qasjet aktive që u mundësojnë fëmijëve të mësojnë përmes përvojës, duke i zbatuar këto shkathtësi. Në këtë mësim rolin më themelor e ka arsimtari – nga ai varet se a do të thjeshtësohet arsimimi për shkathtësi jetësore vetëm në përcjelljen e diturive për atë se si duhet të veprohet në situata të caktuara ose do të përfshihet edhe përvetësimi i shkathtësive që do t'u mundësojnë fëmijëve të veprojnë në mënyrë adekuate kur gjendet në një situatë konkrete.

Në tabelën që vijon (Tabela 2) janë dhënë metodat më shpesh të përdorura të mësimit aktiv që përdoren në mësimdhënien e shkathtësive jetësore. Përveç se janë përcaktuar dobittë kryesore nga zbatimi i secilës metodë, në këtë tabelë janë dhënë edhe këshilla konkrete për zbatim të suksesshëm të secilës metodë.

Tabela 2. Metodatat më shpesh të përdorura në arsimimin për shkathtësi jetësore

Metoda	Dobitë	Këshilla për arsimtarin / arsimtaren
Diskutimi me tërë grupin	1. Nxiti këmbimin e mendimeve 2. Ndihmon në arritjen e përbashkët të përfundimeve dhe nxjerrjen e porosit nga aktivitetet 3. Ndihmon në përvetësimin e komunikimit dhe respektit të ndërsjellë	» Arsimtari duhet t'u mundësojë nxënësve që ta nxjerrin porosinë dhe të arrijnë në përfundim » Arsimtari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të sjelljes për të cilat janë marrë vesh më parë – në rast të thyerjes së rregullave, identifikohet dhe jepet rregulla e thyerjes, pa i përmendur fëmijët që e kanë thyer atë. » Arsimtari duhet t'i respektojë denjësisht rregullat për të cilat janë marrë vesh dhe me sjelljen e tij të bëhet model i nxënësve » Secili fëmijë duhet të nxitet të marrë pjesë në diskutim – përparësi u jepet përgjigjeve të pyetjeve në të cilat nxënësit më rrallë paraqiten për fjalë. » Asnjë fëmijë nuk detyrohet të përgjigjet në pyetje gjatë diskutimit – duhet të gjendet mënyra që të gjithë fëmijët të nxiten të marrin pjesë në mënyrë vullnetare » Asnjë përgjigje e nxënësve nuk duhet të trajtohet si e gabuar, e as të reagohej në të (verbalisht ose joverbalisht) sikur është e gabuar

Grupet punuese	1. Ndhimjnë në aktivizimin e secilit fëmijë, përmes këmbimit të përvojës personale dhe shprehjes së mendimit të tyre 2. U ndihmojnë fëmijëve që të mësojnë të komunikojnë me njëri-tjetrin, të bashkëpunojnë dhe të respektohen me njëri-tjetrin.	» Më së miri është që grupet të numërojnë 4-5 fëmijë, pos nëse nuk është caktuar më shumë » Nuk lejohet që fëmijët e njëjtë vazhdimisht ta paraqesin punën e tyre në grup – kujdes që në këtë të ndërrohen rolet mes djemve dhe vajzave » Më së miri është që grupet të formohen me zgjedhje të rastësishme (me përdorimin e kartelave të lojës, numërimit etj.) që kështu të pamundësohet formimi i klikave » Udhëzimet për punën në grup duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme nga të gjithë » Arsimitarja duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët e grupit të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në punë
Analiza e përrallave	1. I prezantojnë informacionet në mënyrë interesante që kështu t'u ndihmojnë fëmijëve që më lehtë të kuptojnë dhe të mbajnë mend 2. Mundësojnë të inkuadrohen edhe tema më të ndjeshme dhe më të vështira 3. Kontribuojnë për zhvillimin e fantazisë së fëmijës 4. Kontribuojnë për zhvillimin e shkathtësive komunikuese (dëgjim, ligjërim, shkrim)	» Përrallat duhet të jenë interesante dhe të lexohen ose rrëfohen në mënyrë dramatike » Përrallat duhet të jenë të kuptueshme për fëmijët – që fëmijët të mund ta zbulojnë dhe kuptojnë mesazhin e përrallës dhe t'i identifikojnë ndjenjat e personazheve kryesorë. » Përrallat duhet të përdoren si nxitje për vizatim, aktrim ose ndonjë aktivitet tjetër. » Përrallat duhet të nxisin ndërlidhje me jetën e përditshme të fëmijëve
Vizatimi	1. Paraqet mjet për ta shprehur mendimin e fëmijëve 2. Nxit të menduarit kreativ 3. Ndhmon që të përcillen dhe mbahen mend informacionet	» Nuk është me rëndësi të jetë shumë artistike – më e rëndësishme është përmbajtja e asaj që është vizatuar. » Mund të përdoret si zëvendësim për shkrim të fëmijët më të vegjël, të cilët akoma nuk i kanë përvetësuar shkathtësitë e shkrim-leximit » Duhet të jetë e kufizuar në kohë dhe e njohur për nxënësit » Mund të vizatohet në mënyrë individuale ose grupe
Analiza e situatave / rasteve	1. Mundëson që, përmes analizës së sjelljes së dhënë, të nxitet sjellja alternative 2. Nxit të menduarin kritik dhe kreativ	» Situatat duhet të jenë më të shkurtra, më të thjeshta dhe më të kuptueshme » Situatat duhet të burojnë nga realiteti dhe ta shprehin atë realitet
Demonstrime dhe simulime	1. Ndhimjnë që të ndërlidhet dituria abstrakte me situatat konkrete të realitetit 2. Kontribuojnë për zhvillimin e shkathtësive praktike dhe të shkathtësive të vëzhgimit 3. E stimulojnë të menduarit logjik	» Më së miri është të përdoren sende të vërteta (ushqim, top ose gjëra të tjera) në vend të fotografive të tyre » Fëmijët duhet të inkurajohen që në mënyrë të pavarur të inkuadrohen në demonstrimet dhe simulimet praktike, me ndihmë minimale nga arsimtari

Akrimi dhe luajtja e roleve	1. Kontribuojnë që të zhvillohen të gjitha llojet e shkathtësive komunikuese 2. U mundësojnë fëmijëve që t'i analizojnë qëndrimet dhe emocionet, madje edhe atëherë kur bëhet fjalë për tema të ndjeshme, siç është seksualiteti ose pengesat në zhvillim 3. Kontribuojnë për zhvillimin e vetëbesimit të fëmijët 4. Nxisin aktivitete që kërkojnë nga fëmijët të mendojnë dhe të vendosin.	» Fëmijët duhet që vetë t'i mendojnë dramatizimet në të cilat do të aktrojnë dhe rolet që do t'i kenë ata. » Si rekuizita mund të përdoren kukullat e vërteta, por edhe gjërat e thjeshta të bëra nga çorape, qese të letres ose sende të ngjashme që mund të përshtaten për këtë qëllim » Secili dramatizim duhet të jetë ilustrim i ndonjë mesazhi të caktuar ose të shpijë drejt një mesazhi të caktuar » Dramatizimet mund të përdoren çdoherë kur paraqitet sjellje "problemore" jashtë orës së mësimi të shkathtësive jetësore.
Aktivitete loje	1. Ndihmojnë që tema të realizohet përmes argëtimit 2. Kontribuojnë që më lehtë të mbahet mend porosia 3. Mundësojnë që të gjithë fëmijët të marrin pjesë dhe të kontribuojnë për zhvillimin e vetëbesimit të fëmijët	» Për luajtjet e lojërave më shpesh duhet një hapësirë e zbrahtë (më rrallë edhe ndonjë organizim i veçantë i hapësirës), e cila mund të sigurohet me zhvendosjen e bankave dhe karrigeve nga nxënësit (njësoj edhe djemtë edhe vajzat) » Në lojëra duhet të marrë pjesë edhe arsimtari – në fillim, kur përmes shembullit të tij do të ndihmojë në kuptimin e udhëzimeve dhe/ose përmes pjesëmarrjes në aktivitete ashtu si kërkon nga nxënësit

SI PËRDORET DORACAKU

Në doracak janë dhënë të gjitha pesë temat e përfshira në programin e shkathtësive jetësore:

1. UNË: Identiteti personal
2. UNË dhe TI: Raportet interpersonale
3. UNË dhe TË TJERËT: Raportet shoqërore
4. UNË dhe SHËNDETI: Jeta e shëndoshë
5. UNË dhe MJEDISI: Raporti me mjedisin e jashtëm

Për secilën temë programi mësimor i parashikon nga disa përmbajtje që përpunohen nëpër aktivitete të ndryshme. Në doracak janë dhënë përmbajtjet e secilës temë bashkë, ndërsa pritet nxënësi që t'i përvetësojë ato si dituri, shkathtësi dhe qëndrime/vlera pas përvetësimit të secilës përmbajtje veçmas. Rezultatet e pritura për secilën përmbajtje burojnë drejtpërdrejt nga qëllimet mësimore të vizatuara në program. Nga arsimtari/arsimtarja pritet që derisa e udhëheqë punëtorinë të udhëhiqet nga qëllimet drejt të cilave synon tema dhe përmbajtja konkrete.

Doracaku përmban numër të ndryshëm të punëtorive për secilën temë të programit mësimor, gjegjësisht për secilën përmbajtje në kuadër të temës. Numri i punëtorive luhet varësisht nga përmbajtja e temës, por edhe nga ndërlikueshmëria e qëllimeve të parashtruara mësimore, gjegjësisht nga rezultatet e mësimi të inkuadruar në vetë temën/përmbajtjen. Me realizimin e secilës përmbajtje veçmas, arrihen disa qëllime mësimore njëherazi, që nuk do të thotë se një punëtori mund të zëvendësojë më shumë të tilla, as se punëtoritë e ofruara konkrete mund të kombinohen, të modifikohen dhe të ridedikohen.

Secila punëtori është e strukturuar ashtu që të përfshijë disa komponentë që realizohen njëri pas tjetrit dhe shpesh burojnë nga njëri-tjetri. Qëllimi i secilit komponent dhe i karakteristikave të tij kryesore është përshkruar në Tabelën 3

Tabela 3. Përshkrimi i komponentëve që e përbëjnë strukturën e punëtorive

KOMPO-NENTI	DEDIKIMI	KARAKTERISTIKAT
Aktiviteti hyrës	- I inkuadron nxënësit në temën e punëtorisë dhe/ose i jep punëtorisë ton argëtues	» Paraqet aktivitet lojë » Duhet të zgjasë 5-10 minuta » Mundet, por nuk është patjetër, të ketë lidhje të dukshme me temën » Mund të kryhet me pyetje që e sigurojnë lidhjen me aktivitetin kryesor
Aktiviteti kryesor	- Siguron arritjen e qëllimeve të parashtruara dhe të rezultateve të pritura (nxënësit t'i përvetësojnë dituritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e kërkuara) përmes mësimi nga përvoja	» I përmbajnë aktivitetet bartëse të punëtorisë të organizuara në formë të aktrimit/roleve, vizatimit, analizës së përrallave, analizës së situatave/rasteve ose të llojeve të ndryshme të aktiviteteve të lojës » Shumica e punëtorive kanë një aktivitet kryesor, por disa kanë mund të kenë edhe nga dy, që burojnë nga njëri-tjetri » Aktiviteti (ose aktivitetet) kryesor/e duhet të zgjat/zgjasin 20-30 minuta
Diskutimi	- Nxit këmbimin e përsh-typeve dhe mendimeve nga aktiviteti kryesor - Siguron arritjen e përfundimeve drejt të cilave synon punëtorja (deri në arritjen e qëllimeve dhe rezultateve)	» Vijon pas aktivitetit kryesor (ose pas secilit aktivitet kryesor, nëse ka më shumë) » Mbahen në bazë të serisë së pyetjeve të strukturuar që lidhen me përvojat e aktivitetit kryesor » E udhëheq arsimtari në rolin e facilituesit – nuk i ofron përfundimet, por i udhëheq nxënësit që ata vetë të arrijnë në përgjithësimin e përvojave dhe njohurive paraprake.
Përfundimi	- U jep arsimtarëve orientime për atë që duhet të burojë nga diskutimi me nxënësit	» I rezymon dituritë, shkathtësitë dhe qëndrimet që duhet t'i arrijnë nxënësit në kontekst të punëtorisë konkrete » Nuk u tregohen nxënësve – arsimtari i ka në mendje përgjigjet kur parashtron pyetje (dhe nënpyetje) për diskutim
Aktiviteti përmb-yllës	- I lëviz nxënësit pas diskutimit dhe/ose siguron përfundim të punëtorisë me ndjenjën pozitive	» Paraqet aktivitet lojë » Mund të zgjasë më së shumti 5 minuta » Nuk është i patjetërsueshëm kur aktiviteti kryesor është më i vëllimshëm dhe përmban metoda të ndryshme të punës » Mund të zbatohet para ose pas reflektimit – nëse del nga aktiviteti kryesor ose ka pikëtakime me të, rekomandohet t'i paraprijë reflektimit, por nëse është i pavarur nga aktiviteti kryesor mund ta ndjekë reflektimin
Reflektim	- E rezymon atë që e ka mësuar dhe e ndërlidh me jetën e përditshme – i nxit nxënësit të mendojnë për atë që e kanë përjetuar, që e kanë kuptuar dhe si mund ta zbatojnë atë që e kanë mësuar	» Vijon pas aktivitetit përfundimtar ose pas aktivitetit kryesor, varësisht nga lidhja ndërmjet aktivitetit përfundimtar dhe aktivitetit kryesor » Çdoherë zhvillohet në bazë të katër pyetjeve të njëjta » E udhëheq arsimtari në rol të facilituesit – nuk imponon pikëpamje dhe përjetim të tij, por vetëm siguron atmosferë që nxënësit t'i shprehin përjetimet e tyre dhe të ofrojnë zbatim të asaj që e kanë mësuar në jetën e përditshme.

Doracaku përmban punëtori që janë të dedikuara për fëmijë të moshës 9-11 vjeçare, gjegjësisht për fëmijë të klasave IV-VI. Me këtë rast duhet të thuhet se punëtoritë nuk janë të grupuara sipas moshës, me qëllim që të kështu t'i jepet mjaft liri realizuesit të programit që vetë ai të zgjedhë se cilat punëtori i konsideron për më themelore dhe/ose më adekuate për moshën, pjekurinë dhe nevojat e nxënësve të tij. Kjo do të thotë edhe se realizuesi mund t'i përshtatë punëtoritë e paraqitura të moshës, pjekurisë dhe nevojave të nxënësve, nëse gjatë kësaj i përmbahet strukturës së përgjithshme të punëtorisë.

Punëtoritë e ofruara në doracak mund edhe të mos i mbulojnë të gjitha orët e parashikuara për përmbajtjet që i kushtohen arsimimit për shkathtësi jetësore të klasave IV-VI. Nga arsimtari/arsimtarja që e realizon programin për shkathtësi jetësore pritet që ai të jetë kreatori i punëtorive me të cilat do të përmbushet numri i mbetur i orëve të parashikuara me programin mësimor. Realizuesit të programit i jepet liri që të krijojnë punëtori të reja, që nga njëra anë do të burojnë nga qëllimet e programit, ndërsa nga ana tjetër do t'i respektojnë nevojat e grupit të nxënësve të tij/të saj ose nevojat që i imponon një situatë e caktuar në paralele, në shkollë ose në komunitetin më të gjerë. Në atë rast pritet që modeli i punëtorive të paraqitura në doracak dhe përvoja e arritur përmes zbatimit të tyre të përdoret si bazë e krijimit të punëtorive plotësuese.

Punëtoritë e dhëna në doracak janë grupuar rreth pesë temave të përfaqësuara në programin e arsimimit për shkathtësi jetësore. Gjatë realizimit të punëtorisë në punën me nxënës nuk pritet të respektohet rendi i paraqitjes së tyre si në doracak, por përkundrazi, realizuesit të programit i jepet liri e plotë që ta lëvizë rendin e punëtorive, duke e ndryshuar temën nga njëra orë në tjetrën, por duke i respektuar edhe nevojat e nxënësve dhe të vetë rrethanave.

Disa nga punëtoritë për nga vetë përmbajtja e tyre ose për nga qëllimet e tyre mund të duken të afërta për përmbajtjet/qëllimet mësimore të përfaqësuara në lëndët e tjera. Kjo nuk do të thotë se ato punëtori duhet të shmangen, por përkundrazi, mund të përdoren si nxitje, e ndonjëherë edhe si zëvendësim për orët e parashikuara në përmbajtje të tilla më akademike. Ndonjëherë duhet të kihet parasysh qasja që e imponojnë punëtoritë, e cila shpie drejt rezultateve më të qëndrueshme të mësimit dhe, përveç që ofron dituri, nxit edhe përvetësimin e shkathtësive dhe pranimin e qëndrimeve dhe vlerave pozitive.



Tema I: UNË – ZHVILLIMI PERSONAL

Përmbajtja I-1: KIRIJIMI I VETËBESIMIT

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se secili njeri i ka anët e tij të fuqishme dhe të dobëta » të dijë për skeptrin e gjerë të gjërave që ndikojnë në te të rinjtë që ata ta pranojnë vetveten » ta dijë rëndësinë e vetëbesimit në jetën e njerëzve » t'i dijë teknikat e ndryshme të vetëshprehjes me qëllim të përcjelljes së qëndrimeve personale
Shkathtësi	» të mund ta dallojë atë që është unike në vetvete » të mund t'i identifikojë potencialet e veta dhe të parashtrojë qëllime për t'i arritur ato » të mundet t'i paraqesë/shprehë me siguri dituritë, mundësitë dhe nevojat e tij » të mund të flasë hapur dhe t'i mbrojë pikëpamjet dhe mendimet e tij
Qëndrime/vlera	» ta kuptojë se vetëbesimi dhe siguria në vetvete janë shumë të rëndësishme për sukseset në jetë » të pranojë përvoja të reja me plot siguri » ta pranojë rëndësinë e shprehjes së vetvetes

Punëtorja I-1.3: Dollia



Materialet:

- » fleta të letrës (është mirë të jenë me ngjyra të ndryshme)
- » pajisje për të vizatuar
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Udhëzimi për të bërë gota letre

Aktiviteti hyrës

Impuls 1.

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe duhet të përcjellin impuls nga emrat. Impulsi përcillet në atë mënyrë që secili do ta thotë emrin e tij pasi ta dëgjojnë emrin e nxënësit që është para tij në rreth.

Lojë e fillon arsimtari, duke e thënë emrin e tij dhe duke e shikuar nxënësin që gjendet në anën e tij të djathtë, duke i dhënë kështu shenjë që ta marrë impulsin. Aktiviteti kryhet me duartrokitje nga të gjithë, kur impulsi përsëri të kthehet te arsimtari, pasi që ai ta përsëritë emrin e tij.

Impuls 2.

Në rrethin e ardhshëm përsëri përcillet impuls, por kësaj radhe që të përcillet impulsi, secili nxënës, përveç emrit të tij, duhet t'i thotë edhe emrat e atyre që gjenden në anën e tij të majtë dhe të djathtë.

Përsëri lojën e fillon arsimtari duke e thënë:

1. emrin e tij,
2. emrin e atij që është majtas, duke shikuar në të dhe
3. emrin e atij që është djathtas, duke shikuar në të

Kështu vazhdon ai që është në të djathtë e ti, duke filluar me emrin e tij dhe duke përfunduar me emrin e personit që është në djathtë e tij, të cilit i jepet impulsi.

Aktiviteti përfundon me një duartrokitje te përgjithshme, atëherë kur impulsi do të arrijë te arsimtari dhe ai t'i përsërisë emrat e me të cilët ka filluar.

Impuls 3.

Procedura e përcjelljes së impulsit është identike si në rastet e kaluara (për impulsin 2), por këtu para se të fillohet, nxënësit patjetër duhet t'i ndërrojnë vendet në rreth – secili të ulet ndërmjet dy nxënësve të tjerë.

Në këtë mënyrë mund të rrotullohen më shumë rrathë, ndërsa para secilit rreth nxënësit duhet t'i ndërrojnë vendet e tyre. Me këtë rast impulsi mund edhe ta ndryshojë kahun – në vend vetëm djathtas, në disa raste impulsi mund të kthehet edhe majtas.

Aktiviteti kryesor

Aktivitetet zhvillohen ashtu që nxënësit, përfshirë edhe arsimtarin, ulen në rreth, duke paramenduar se gjenden në një drekë ose darkë të përbashkët.

Kështu secili nxënës e merr një fletë letre me të cilën duhet ta bëjë një gote letre, natyrisht duke i ndjekur udhëzimet e fletës së punës së arsimtarit/arsimtares "Udhëzimi për të bërë gota letre", e pastaj atë duhet ta zbukurojnë me vizatime dhe ngjyrosje.

Dollia 1.

Pastaj nga secili fëmijë, përfshirë edhe arsimtarin, kërkohet të thotë diçka të jashtëzakonshme për veten e tij, me çka mund të lavdërohet para të tjerëve. Për këtë qëllim, së pari duhet të ngrihet nga karrigia, e pastaj ta thotë këtë frazë:

"Jo se lavdërohem, po....." (diçka të jashtëzakonshme)

Me atë të "diçka të jashtëzakonshme" nënkuptohet

Ose diçka që e ka bërë ose diçka që ka ndodhur në të kaluarën (për shembull: "... si fëmijë rashë në hendek 3 m të thellë dhe u lëndova"; "... njëherë hëngra 20 sarma") ose diçka që rrallëkush mund ta bëjë ose të dëshirojë ta bëjë (për shembull: "...vdes për marmelatë dhe djathtë bashkë").

Fëmija tjetër në rreth ngrihet, e ngre "gotën" dhe e përsërit atë që e ka dëgjuar, duke kërkuar të ngrihet dolli në këtë mënyrë:

"Të pimë për ... (emrin e fëmijës paraprak), sepse (diçka të jashtëzakonshme me të cilën ai është lavdëruar)

Me këtë rast ngrihen të gjithë, i ngrenë gotat dhe njëzëri përgjigjen me fjalët "Gëzuar!" e pastaj "pinë" nga gotat.

Aktivitetin e fillon arsimtari, ndërsa pastaj renditen të gjithë nxënësit me radhë ashtu siç janë ulur në rreth. Aktiviteti mbaron me duartrokitje pasi të jetë ngritur dolli për të gjithë nxënësit.

Dollia 2.

Para se të filloj ky aktivitet, nxënësit duhet t'i ndërrojnë vendet e tyre në rreth – secili të vendoset ndërmjet dy nxënësve të tjerë.

Për dallim nga rrethi paraprak, në të cilin secili nxënës e krijonte shkakun e dollisë për të, në këtë rreth secili nxënës duhet të mendojë se për çfarë arsye do të ngrinte dolli për personin që është afër tij. Shkak për dolli mund të jetë vetëm ndonjë karakteristikë pozitive që do të dëshironim t'ia përshkruanim (p.sh.: e guximshme, argëtues, i mençur, i shqetësuar). Me këtë karakteristika që është përdorë një herë nuk guxon të përsëritet (konsiderohet "e harxhuar").

Personi që e ngre dollinë duhet të qëndrojë me "gotë" në dorë, i kthyer me fytyrë nga personi për të cilin e ngre dollinë. Dollia duhet t'i përmbajë këtë fjalë:

"të pimë për (emrin e personit afër tij), sepse ai është (karakteristika pozitive).

Dollisë së tij i përgjigjen të gjithë, ashtu që ngrihen në këmbë, i ngrenë "gotat" dhe me zë thonë "Për shëndetit e (emrin e personit)" dhe "pinë" nga gotat.

Nxënësi për të cilin është ngritur dollia së pari duhet të falënderohet, e pastaj duhet të vazhdojë me dolli për nxënësin e ardhshëm në rreth.

Edhe këtë aktivitet së pari e fillon arsimtari, duke ngritur dolli për personin që është djathtas ose majtas tij, sipas drejtimit të rrethit. Aktiviteti përmbyllet me duartrokitje kur të gjithë nxënësit ta kalojnë rrethin.



Diskutim

1. A ndjeheshit mirë kur ju përshkruhej karakteristikë pozitive? A e "qëlluan" karakteristikën tuaj?
2. Kur ndjeheshit më mirë – kur vetë lavdëroheshit apo kur të tjerët ju lavdëronin? Pse?
3. Si ndjeheshit kur ngrihej dolli për ju? Si ndjeheshit në rastin e parë dhe si në të dytin?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?


Përfundim

Është ndjenjë e këndshme kur mund të lavdërohemi para të tjerëve, por edhe më mirë është kur të tjerët na lavdërojnë neve. Është shumë me rëndësi të jemi të vetëdijshëm se secili nga ne është i veçantë dhe i papërsëritshëm me diçka. Secili nga ne ka anë të mira – pozitive dhe është mirë ta dijë këtë, t'i respektoje ato tipare dhe t'i pranojë si të tilla. Ato janë mjetet e tij më të vlefshme për jetë.


Fletë punë për arsimtarin/arsimtare: Udhëzimi për të bërë gota letre




Nga një copëz letre në formë të katrorit mbështilleni këndin A dhe bashkojeni me këndin B. Tehun CD barazojeni me gishta.



Mbështilleni këndin C kah pika e mesit të anës AD dhe tehun barazojeni me gishta.



Mbështilleni këndin D kah pika E dhe këndin barazojeni me gishta.



Mbështilleni këndin A teposhtë, sa më shumë që mundeni.



Mbështilleni këndin B në anën e kundërt sa më shumë që mundeni. Gota është gati dhe prej saj mund të pihet.



Punëtorja I-1.2: Pasqyra ime, pasqyra ime...



Materialet:

- » top i vogël
- » fletë pune për nxënësit I-1.2: Pasqyra ime
- » pajisje për të vizatuar

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çifte dhe secili prej tyre duhet t'ia thotë tjetrit dy gjëra që i bën me sukses dhe mirë dhe një gjë që nuk di ta bëjë, por që do të dëshironte ta bëjë ose të mund ta bëjë.

Pastaj nxënësit formojnë rreth dhe arsimtari e mban një top të vogël në dorë. Atij nxënësi që do t'ia japë topin, ai duhet ta thotë atë që e ka dëgjuar nga partneri i tij. Për shembull: "Jovana është mjeshtër për lojëra në kompjuter dhe për matematikë, ndërsa do të dëshironte të luajë basketboll". Pastaj fëmija ia jep topin ndonjë fëmije tjetër dhe aktiviteti përsëritet derisa ta kalojnë të gjithë fëmijët.

Aktiviteti kryesor

Secili fëmijë e merr nga një kopje të fletës së punës për nxënësit "Pasqyra ime", në të cilën do të duhet ta vizatojë vetveten, ndërsa kornizën duhet ta stolisë me fjalë që e përshkruajnë në mënyrë pozitive (simpatik/e, i/e disponuar, i/e bukur, i guximshëm/e guximshme, i/e butë...), e pastaj në vizat adekuate duhet ta shkruajë:

- » këngën e dashur;
- » filmin e dashur;
- » kafshën e dashur;
- » sportin e dashur dhe
- » ushqimin e dashur.

Pasi të përfundojnë të gjithë, secili duhet të zgjedhë se si do ta prezantojë vetveten para të tjerëve. Ai duhet të zgjedhë një ose më shumë gjëra për veten e tij, të cilat mund t'i prezantojë gojarisht; përmes ndonjë kënge që do ta këndojë, përmes ndonjë vizatimi, përmes ndonjë grafiti/stripi, përmes pantomimës etj. Pasi të mendojnë se çka do të prezantojnë, përgatiten dhe qëndrojnë në rreth dhe një nga një prezantohen. Secilin prezantim grupi e shpërblen me duartrokitje frenetike.



Diskutim

1. Si ndjeheshit derisa shkruanit, vizatonit dhe e prezantonit vetveten?
2. Si ndjeheshit kur duhej ta përshkruani vetveten me fjalë pozitive?
3. A ka secili nga ne anë pozitive? Por, a ka edhe anë të dobëta – gjëra që do të dëshironte t'i përmirësojë?
4. Në çfarë mënyrash mund ta shprehni vetveten? A mund t'i prezantoni qëndrimet dhe mendimet tuaja për çështje të caktuara përmes përshkrimit të interesave tuaja?
5. A është me rëndësi ta shprehni vetveten? Pse?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim !

Secili njeri i ka anët e tij të forta dhe të dobëta. Është mirë për ne që t'i njohim dhe t'i pranojmë edhe ato edhe ato që kështu të kemi siguri dhe vetëbesim dhe të dimë se në cilin drejtim duhet të punojmë që të përmirësohemi. Ne mund ta shprehim vetveten sepse në atë mënyrë vetërealizohemi, e pasurojmë botën me veçantinë dhe papërsëritshmërinë tonë dhe u japim mundësi të tjerëve që të realizojnë relacione me ne në bazë të asaj që ne konsiderojmë se është e rëndësishme.

Punëtorja I-1.3: Unë mundem ...



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit I-1.3: Unë mundem ...
- » pajisje për të shkruar
- » top nga fleta e mbledhur

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çifte, ndalen përballë njëri-tjetrit dhe secili nga çifti duhet ta shikojë me kujdes partnerin e tij, duke u përpjekur që ta mbajë mend pamjen e tij. Pastaj anëtarët e çiftit kthehen me shpinë kah njëri-tjetri dhe i ndryshojnë tre gjëra në vetvete. Për shembull: hallkën/unazën e vënë në dorë tjetër, i hapin/mbyllin pullat e teshave, i kthejnë flokët në anën tjetër, e fusin/heqin bluzën nga/në pantallona etj. Pas një minute ata përsëri duhet të kthehen kah njëri-tjetrit dhe secili nga çifti duhet të qëllojë se cilat tri gjëra i ka ndryshuar.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit janë ulur në banka dhe secili prej tyre e merr nga një kopje të fletës së punës për nxënësit "Unë mundem të..." të cilën duhet ta plotësojë. Arsimitari mund ta plotësojë listën me pohime për të cilat ai mendon se janë adekuate për grupin me të cilin ai punon.

Pastaj nxënësit ndahen në grupe me nga katër persona dhe ndërmjet vete duhet t'i prezantojnë listat, duke u përpjekur t'i zbulojnë ngjashmëritë dhe dallimet.



Diskutim

1. A zbuluat ngjashmëri ndërmjet listave tuaja? A kishte edhe dallime?
2. Pse kishte dallime? A mund të dinë, të munden dhe duan njësoj të gjithë fëmijët? Pse?
3. A i keni tash dituritë, mundësitë dhe dëshirat e njëjta siç i keni pasur edhe para pesë viteve? Pse?
4. A do të ndryshohen edhe këto dituri, mundësi dhe dëshira pas një kohe? Pse?
5. Sa kohë nevojitet që ta realizojmë ndonjë dëshirë tonën apo ndonjë të arritur tonën? Nga çka varet kjo?
6. Si ndikon vetëbesimi në realizimin e qëllimeve tona?

Përfundim

Gjatë zhvillimit dhe rritjes fëmijët mund/mësojnë të bëjnë gjithnjë e më shumë gjëra. Interesat e tyre mund të mbesin të njëjta gjatë gjithë rritjes, por mund edhe të ndryshojnë dhe të pasurohen. Planifikimi na ndihmon saktë që ta përcaktojmë sa kohë na duhet që t'i realizojmë qëllimet e ndryshme. Për sa kohë do ta realizojmë ndonjë qëllim, kjo varet nga shumë gjëra dhe nga vetë ne (ushtrimi, përpjekja, pjekuria, interesat), nga vetë puna. Që ta realizojmë atë që për neve është me rëndësi, duhet ta dimë se cilat janë aftësitë tona që do të na ndihmojnë në realizimin e saj, si dhe të besojmë se mund ta realizojmë atë.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë fëmijët e bëjnë një top nga letra e mbledhur, ndërsa qëllimi i lojës është që atë t'i japin njëri-tjetrit pa rënë në tokë. Me këtë rast e këndojnë këtë këngë:

"ta jap top-in nga e maj-ta në të djathtë-të
Kë-të e bëj shu-më leh-të"

Në secilën rrokje të parë ata ia japin topin fëmijës që e kanë në anën e tyre të djathtë, ndërsa në çdo rrokje të dytë e marrin topin nga fëmija që është në anën e tyre të majtë. Ndërkaq kur këndojnë shumë, atëherë vetëm e lëvizin dorën sikur të jenë duke e dhënë topin në anën e tyre të djathtë, por përsëri e kthejnë në anën e tyre të majtë, e pastaj përsëri e japin në anën e tyre të djathtë. Këtu edhe mund të gabohet, andaj arsimtari duhet të nxisë atmosferë argëtuese, por edhe të përpiqet t'i motivojë nxënësit që të orvaten të kenë sukses.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja I-2: KRIJIMI I IMAZHIT PËR VETVETEN SI ANËTAR I FAMILJES DHE SI NXËNËS

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se me kalimin e kohës familjet ndryshojnë: lindje, vdekje dhe ngjarje të tjera » ta dijë se cilat janë detyrimet dhe të drejtat e anëtarëve të familjes » t'i dijë rolet dhe detyrimet e veçanta të nxënësve në klasë » të dijë si të kërkojë mbështetje nga nxënësit e tjerë të klasës dhe nga arsimtarët » të dijë të kërkojë informacione plotësuese për tema që nuk i ka të qarta
Shkathtësi	» të mund të identifikojë mënyra të ndryshme në të cilat anëtarët e familjes japin dhe pranojnë dashuri dhe kujdes » të mund t'i dallojë gjinitë dhe karakteristikat e anëtarëve të rritur të familjes » të mund të planifikojë dhe njëherazi t'i kryejë detyrat e tij familjare » të mund të planifikojë dhe njëherazi t'i kryejë detyrat e tij shkollore » të mund t'i kryejë detyrimet si anëtar i grupit punues ose i bashkësisë së klasës » të mund të bashkëpunojë me nxënësit e tjerë për zgjidhjen e detyrave shkollore » të mund të marrë pjesë në procesin e marrjes së vendimeve të rëndësishme për jetën shkollore » të mund të përdorë burime të ndryshme të informacioneve për pasurimin e diturive të tij
Qëndrime/vlera	» ta kuptojë se respekti, besimi dhe dashuria ndaj familjes janë shumë të rëndësishme për zhvillimin personal të secilit njeri » të pranojë se raporti proaktiv i nxënësve është shumë i rëndësishëm për funksionimin e klasës dhe të shkollës

Punëtorja I-2.1: Familje të ndryshme – dashuri e njëjtë



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Familjet
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Kartelat me anëtarët e familjeve
- » fletë pune për nxënësit I-2.1: Kartelat me emrin e familjes dhe të një anëtar të caktuar të saj
- » sellotej
- » gërshtë
- » kasetofon dhe muzikë (në vend të kasetofonit, fëmijët mund të këndojnë edhe vetë ndonjë këngë që e dinë të gjithë)

Aktiviteti kryesor

Në një rreth renditen aq karrige sa është parashikuar të ketë familje (varësisht nga numri i fëmijëve bëhet edhe kombinimi i llojeve të familjeve). Gjatë kombinimeve duhet të mbahet llogari që secili fëmijë të ketë nga një rol dhe të përfaqësohen sa më shumë familje të ndryshme (si për nga përbërja, ashtu edhe për nga aspekti i përkatësisë etnike). Veçanërisht duhet t'i kushtohet kujdes thyerjes së stereotipave për përbërjen dhe pamjen e familjeve të bashkësive të caktuara etnike dhe religjioze. Për këtë renditje përdoret fleta e punës së arsimtarit/arsimtares "Familjet".

Në karrige ngjiten kartela në të cilat janë të shkruar anëtarët e familjes pa mbiemrin e tyre nga fleta e punës së arsimtarit/arsimtares "Kartelat me anëtarët e familjeve". Secilit fëmijë i jepet nga një kartelë në të cilën është shkruar emri i familjes dhe roli që duhet ta ketë ai fëmijë në familjen e fletës së punës për nxënësit "Kartelat me emrin e familjes dhe të një anëtar të caktuar të saj", por ata nuk guxojnë ta shikojnë kartelën që u jepet. Fëmijët ndahen në dy grupe të njëjta (duke numëruar: një-dy), të cilat renditen në dy rrethë përreth karrigeve (rrethi i jashtëm dhe i brendshëm). Rrethët duhet të jenë të përbërë nga numër i njëjtë i fëmijëve (nëse numri është tek, në lojë duhet të marrë pjesë edhe arsimtari). Para se të fillojë muzika dhe gjatë secilës ndërprerje secili fëmijë duhet të ketë para vetes dhe pas vetes (varësisht nga rrethi në të cilin gjendet) një çift të tij me të cilin do të mund ta bëjë këmbimin e kartelave. Pasi të renditen ata, lëshohet muzika ose të gjithë e këndojnë një këngë për të cilën janë marrë vesh ta këndojnë. Kur të fillojë muzika (ose këndimi i ndonjë kënge), fëmijët e të dy rrethëve qarkullojnë në drejtim të kundërt përreth karrigeve. Kur të jepet shenjë, muzika ndalet, fëmijët ndalen (secili fëmijë para vetes duhet ta ketë çiftin e rrethit tjetër) dhe i ndërrojnë kartelat me fëmijën e rrethit tjetër (përballë tij). Kjo përsëritet dy herë. Kur të ndalet muzika për herë të tretë, fëmijët i shikojnë kartelat e pastaj secili fëmijë duhet t'i gjejë anëtarët e familjes së tij dhe të gjithë anëtarët e asaj familjeje që të kapen për karrigen që janë shënuar se aty e ka vendin ajo familje. Kur të grupohen të gjithë fëmijët në bazë të familjeve, ashtu të grupuar ulen në rreth.



Diskutim

1. Si ju dukej t'i gjeni anëtarët e familjes suaj?
2. Çfarë familje kemi këtu?
3. Çka është e zakonshme te secila familje?
4. Kush duhet të kujdeset për fëmijët në familje?
5. Kush kujdeset për fëmijët në familje? Kush kujdeset për ne?
6. A mund të ndodhë ndryshimi i numrit të anëtarëve të familjes?
7. Si dhe pse?
8. A mund të ndahen prindërit?
9. Çka ndodhë kur ndahen prindërit?
10. A ndahen edhe fëmijët nga prindërit gjatë shkurorëzimit të tyre?
11. Çka nëse prindërit dhe fëmija jetojnë në vende të ndryshme?
12. Përveç prindërve, kush tjetër e ka për detyrë të kujdeset për fëmijët?

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë nxënësit ndalen shumë afër njëri pas tjetrit, thuajse me trupa të ngjitur, me këmbë pak të hapura duke e kapur për

Përfundim

Ekzistojnë familje të ndryshme edhe sipas numrit të anëtarëve, por edhe sipas përbërjes. Është shumë me rëndësi fakti se nuk mund të ekzistojë familje pa fëmijë. Buri dhe gruaja mund të jenë të kurorëzuar, por familjen e bënë të pranishme vetëm prania e fëmijës, pavarësisht se kush janë anëtarët e tjerë të rritur të familjes dhe sa janë atë në numër.

Për cilësinë e jetës së fëmijëve në familje nuk është e rëndësishme përbërja e familjes, por dashuria dhe kujdesi që të rriturit ia japin fëmijës. Në rast të shkurorëzimit të prindërve, nuk ndërpritet dhe nuk ndryshon cilësia e lidhjes së fëmijës me cilindo qoftë prind. Nëse prindërit për shkaqe të ndryshme nuk mund/nuk u lejohet të kujdesen për fëmijën, atëherë shteti përmes institucioneve sociale duhet të sigurojë kujdes adekuat për fëmijët.

beli atë që është para tyre. Ku njëri prej tyre do të bëjë një hap me njërin këmbë, të gjithë do të duhet ta ndjekin dhe njëherazi të veprojnë si ai. Pastaj i pari e bën hapin më këmbën tjetër dhe kështu të gjithë lëvizin njëri pas tjetrit nëpër klasë. “Vemëza” një kohë duhet të lëvizë nëpër klasë derisa të arrihet një ecje e harmonizuar.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë punë për arsimtarin/arsimtare: Familjet

1. Babai, nëna, bija, biri/Serafimovski
2. Babai, nëna, bija, bija/Rexhaj
3. Babai, nëna, biri, gjyshja/Petrevski
4. Nëna, biri/Shotarevski
5. Babai, biri/Ballazhi
6. Babai, nëna, biri, biri, bija, gjyshja, gjyshi/Hristovi
7. Babai, nëna, bija/Hasanovi
8. Babai, bija, biri/Najdenoski
9. Babai, nëna, biri/Shabani
10. Babai, nëna, biri, biri/Lamaxhema
11. Nëna, bija, bija/Stoillkoviq



BABAI

BABAI

NËNA

NËNA

BIJA

BIJA

BIRI

BIRI

GJYSHJA

GJYSHJA

GJYSHI

GJYSHI

Punëtorja I-2.2: Përgjegjësitë e mia



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit I-2.2: Përgjegjësitë e mia
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Të gjithë nxënësit ulen në rreth, ndërsa arsimtarja u thotë se do ta luajnë lojën në të cilën ajo do t'i lexojë disa pyetje, ndërsa të gjithë ata që mendojnë se ato pyetje vlejné për ata duhet të japin shenjë me të dy duart mbi kokë, ndërsa ata që nuk kanë lidhje me ato pyetje, duhet të japin shenjë me kokë sikur të thonë JO.

Lista e pyetjeve:

1. A keni shkelë ndonjëherë këmbëzbathur në borë?
2. A e keni mbajtur frymën ndonjëherë më shumë 20 sekonda?
3. A keni vozitur ndonjëherë veturë?
4. A ju është ndalur ndonjëherë zogu në dorë?
5. A jeni qethur ndonjëherë vetë?
6. A e keni qethur ndonjëherë ndonjë shok?
7. A keni veshur ndonjëherë veshje të femrës së rritur?
8. A keni veshur ndonjëherë veshje të mashkullit të rritur?
9. A i keni ngrënë ndonjëherë pesë molla për një ditë?
10. A keni pirë ndonjëherë një koka-kolë prej dy litrave përnjëherë?

Aktiviteti kryesor¹

Secilit nxënës i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës "Përgjegjësitë e mia", të cilën ai duhet ta plotësojë për vete. Me këtë rast arsimtarja duhet të theksojë se është me rëndësi që ata të jenë të sinqertë dhe se askush nuk do ta shikojë se ç'kanë shkruar ata.

Pasi të mbarojnë, ata ndahen në çifte dhe secili që në çiftin e tij do të duhet t'ia tregojë partnerit të tij tre përgjegjësi për të cilat mendon se duhet të mundohet më shumë që t'i arrijë.



Diskutim

1. Pse është me rëndësi që edhe fëmijët të kenë përgjegjësi në shtëpi? E në shkollë?
2. Pse themi se kemi përgjegjësi edhe ndaj vetvetes? E ndaj njerëzve të tjerë me të cilët jetojmë?
3. A kënaqemi të gjithë nga kryerja e të gjitha detyrimeve tona? Pse?
4. Si ndjeheni kur e dini se i keni kryer detyrimet tuaja?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Duke u rritur fëmijët, rritet edhe numri i përgjegjësive dhe komplikohet lloji i përgjegjësive që duhet t'i ndërmarrin fëmijët. Edhe përkundër faktit se nuk e kemi çdoherë njësoj që t'i kryejmë detyrimet tona, megjithatë ato janë të patjetërsueshme për funksionimin tonë normal. Përmeshja e detyrimeve na bën të jemi të kënaqur dhe të përgatitur që lirisht të vazhdojmë të bëjmë gjëra të tjera.

¹ Ideja për aktivitetin është marrë nga Keller, A. and Floersch, G.: The Value of Responsibility. (1993) New York: The Bureau for At-Risk Youth

Punëtorja I-2.3: Secili bën diçka



Materialet:

- » fletë e madhe e letrës për të vizatuar
- » tabelë dhe shkumës

Aktiviteti kryesor 1

Arsimtari duhet të kërkojë nga fëmijët të tregojnë se cilat janë detyrat e babait, të nënës, të gjyshes dhe të gjyshit ose edhe të anëtarëve të tjerë të rritur të familjes me të cilët ata jetojnë. Secilin rol që do ta vizatojnë fëmijët, arsimtari e shkruan në tabelë.

Pastaj të gjithë së bashku duhet t'i përkufizojnë disa detyrime që ata vetë i kanë ndaj familjes. Për shembull: kujdesem për ledhatakët në shtëpi, i ruaj vëllain dhe motrën time të vogël etj.

Të gjithë detyrimet shkruhen në tabelë.

Aktiviteti kryesor 2

Arsimtari i shpreh (i shkruan në tabelë) një nga një të gjitha pohimet e poshtëshënuara dhe nxit diskutim ndërmjet nxënësve me të cilin dëshiron të shprehen mendime dhe argumente të ndryshme, me të cilat mbështeten ose kundërshtohen këto mendime:

- » Në secilën familje duhet të ketë rregulla të sjelljes.
- » Rregullave duhet t'u përmbahen njësoj të gjithë anëtarët e familjes.
- » Disa rregulla vlejnë vetëm për fëmijët.



Diskutim (për secilën çështje)

1. Pse është me rëndësi të jetë ashtu, gjegjësisht (lexohet pohimi)?
2. Çfarë dobie kanë fëmijët prej saj? E çfarë të rriturit?
3. Pse kjo nuk është mirë për fëmijët?
4. A është kjo e drejtë për të gjithë?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Të gjithë anëtarët në secilën familje duhet të kenë detyrime/role të caktuara me të cilat do të kontribuojnë për zhvillimin normal të jetës në familje. Edhe fëmija duhet të ketë detyrime të tij dhe duhet të marrë pjesë aktive në jetën familjare. Me rëndësi është që në familje të ekzistojnë rregulla të caktuara dhe ato rregulla t'i respektojnë të gjithë në familje. Në procesin e hartimit të atyre rregullave duhet të marrë pjesë edhe fëmija.

Përmbajtja I-3: NJOHJA DHE SHPREHJA E EMOCIONEVE PERSONALE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se cilat emocione janë pozitive, e cilat janë emocione negative (të këndshme-të pakëndshme) » ta dijë se çka e bën të lumtur ose të shqetësuar » t'i dijë disa strategji për t'u ballafaquar me ndjenjat e fuqishme, si zemërimi dhe dëshpërimi
Shkathtësi	» të mund t'i përshkruajë përjetimet personale të emocioneve të këndshme dhe të pakëndshme » t'i njohë ndjenjat e veta dhe të mund t'i shprehë në mënyrë adekuate në mënyra të ndryshme
Qëndrime/vlera	» të pranojë se edhe emocionet e këndshme edhe ato të pakëndshme janë pjesë e jetës së përditshme

Punëtorja I-3.1: Edhe këndshëm edhe jo këndshëm



Materialet:

- » tabelë dhe shkurtes
- » fletë pune për nxënësit I-3.1: Si ndjehem ...
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Lista e ndjenjave

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ulen në rreth. Secilit nxënës i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Si ndjehem”. Fjalitë lexohen me zë, një nga një (I lexojnë nxënësit vullnetarë), ndërsa plotësohen me zë nga vetë nxënësit, me qëllim që të identifikohen të gjitha ndjenjat e mundshme nga situata e përshkruar.

Nxënësit nxiten t’i emërtojnë të gjitha ndjenjat që kanë lidhje me situatën e përshkruar. Arsimtari ka kujdes që pjesa më e madhe e ndjenjave të dhëna të paraqiten në fletën e punës “Lista e ndjenjave”. Secila ndjenjë e dhënë shkruhet në tabelë, pa i rishkruar ndjenjat e përsëritura.

Pas mbarimit të fjalive, nga nxënësit kërkohet që ata ta plotësojnë listën në tabelë, tash me ndjenja që nuk janë dhënë. Plotësimet shkruhen në listë.

Nga dy nxënës (vullnetarë) kërkohet që ta shënojnë se cilat nga ndjenjat e dhëna janë pozitive (të lidhura me përjetime të këndshme), e cilat janë negative (të lidhura me përjetime të pakëndshme). Njëri nxënës është përgjegjës që ta shënojë shenjën “+” para ndjenjave pozitive, ndërsa tjetri duhet ta shënojë shenjën “-” para ndjenjave negative. Mund të ndodhë që disa ndjenja të jenë “neutrale” – të mos jenë as pozitive as negative (p.sh.: indiferenca) ose mund të jenë edhe pozitive edhe negative, varësisht nga situata konkrete (p.sh.: befasi e këndshme dhe e pakëndshme).

Në identifikimin e ndjenjave pozitive dhe negative ndihmojnë të gjithë. Arsimtari mund ta përdorë fletën e punës së arsimtarit/arsimtares “Lista e ndjenjave”.



Diskutim

1. Çfarë ndjenjash mbisundojnë në listë: më shumë pozitive apo më shumë negative? Pse?
2. Cilat ndjenja janë më të rëndësishme: pozitivet apo negativet? Pse?
3. Nëse disa ndjenja nuk i shfaqim, a do të thotë kjo se ato nuk ekzistojnë te ne?
4. Sa janë të pranishme ndjenjat në jetën tonë të përditshme? A mund të kalojë një ditë në jetën tonë, e ndjenjat mos të në ndryshojnë nga disa herë?
5. Sa prej këtyre fjalëve që përshkruajnë ndjenja të ndryshme i përdorim kur duhet t’i shprehemi dikujt sesi ndjehemi?
6. Cilat fjalë i përdorim më shpesh e cilat më rrallë?

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë përreth dhe e këndojnë këtë këngë duke bërë lëvizje përkatëse – tinguj:

Pasi je i lumtur, duartrok ti me duar (rrap-rrap)
Pasi je e lumtur, duartrok ti me duar (rrap-rrap)
Ditët e lumturisë tregojani gjithë shoqërisë
Pasi je i lumtur, duartrok ti me duar (rrap-rrap).

Pasi je e lumtur kërcit ti me gishta (krrap - krrap)
pasi je i lumtur kërcit ti me gishta (krrap - krrap)
Ditët e lumturisë tregojani gjithë shoqërisë
Pasi je e lumtur kërcit ti me gishta (krrap - krrap).

Përfundim !

Ndjenjat janë vazhdimisht të pranishme në jetën tonë, në të gjitha situatat dhe në të gjitha relacionet. Nuk ka ndjenja më shumë të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme. Edhe ndjenjat pozitive edhe ato negative do të duhet të pranohen, të njihen dhe të shprehen.

Kur shprehemi sesi ndjehemi, shumë shpesh i përdorim fjalët që shënojnë ndjenja më të përgjithshme, siç janë mirë dhe keq. Por, që të mund të na kuptojnë të tjerët më mirë, është shumë më e dobishme që të përdorim fjalë që ofrojnë përshkrim më preciz të ndjenjës.

Ekzistojnë më shumë fjalë për t’i shënuar ndjenjat negative sesa ndjenjat pozitive, që nuk do të thotë se ato janë më të rëndësishme se këto të fundit.

Pasi je i lumtur kërcit ti me gjunjë (tap-tap)
Pasi je e lumtur kërcit ti me gjunjë (tap-tap)
Ditët e lumturisë tregojani gjithë shoqërisë
Pasi je i lumtur kërcit ti me gjunjë (tap-tap).

Pasi je e lumtur rrahi ti këmbët (krop-krop)
Pasi je i lumtur rrahi ti këmbët (krop-krop)
Ditët e lumturisë tregojani gjithë shoqërisë
Pasi je e lumtur rrahi ti këmbët (krop-krop).

Pasi je i lumtur bërtit me zë URRRA-URRA
Pasi je e lumtur bërtit me zë URRRA-URRA
Ditët e lumturisë tregojani gjithë shoqërisë
Pasi je e lumtur bërtit me zë URRRA-URRA.

Fëmijët mund të mendojnë /shtojnë edhe ndjenja dhe lëvizje të reja



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë punë për arsimtarin/arsimtaren: Lista e ndjenjave

Lista e ndjenjave		
pozitive:	negative:	neutrale:
😊 krenar	☹ i zemëruar	😊 i habitur
😊 i/e gëzuar	☹ i/e nervozuar	😊 i/e shqetësuar
😊 i/e kënaqur	☹ i/e hidhëruar	
😊 i/e lumtur	☹ i/e tërbuar	
😊 i/e fascinuar	☹ i/e turpëruar	
😊 i/e dashuruar	☹ i/e frikësuar	
😊 i/e bukur	☹ i/e pafat	
😊 i/e rëndësishëm	☹ i/e ofenduar	
😊 falënderues	☹ i/e lënduar	
	☹ i/e pikëlluar	
	☹ i/e nënçmuar	
	☹ i/e anashkaluar	
	☹ i/e shqetësuar	
	☹ i/e brengosur	
	☹ xheloz	
	☹ i/e dëshpëruar	
	☹ keq	
	☹ i/e hutuar	
	☹ i/e lodhur	
	☹ i/e vetmuar	
	☹ i/e fajësuar	
	☹ i/e pandihmë	

Punëtorja I-3.2: Ndjenjat e fuqishme



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit I-3.2: Ndjenjat e fuqishme

Aktiviteti hyrës

Të gjithë janë ulur në rreth, ndërsa arsimtarja shpjegon se ata do të duhet të përcjellin emocione përmes shprehjes së tyre në fytyrë. Arsimtarja fillon dhe bën një shprehje të fytyrës që paraqet emocion dhe kthehet kah fëmija që është në anën e saj të majtë, i cili duhet ta pranojë atë shprehje dhe atë t'i përcjellë fëmijës tjetër që është në të majtë të tij. Loja vazhdon në atë mënyrë që shprehja emocionale mund të përcillet edhe më tej derisa ndonjë fëmijë të bërtasë NDËRRIM dhe atëherë ai bën një shprehje tjetër të fytyrës që edhe rrethin “e kthen” në anë të kundërt, gjegjësisht e përcjell lojën në anë të djathtë. Secili fëmijë në grup ka të drejtë që një herë të thotë NDËRRIM. Loja mbaron kur të gjithë do të thonë nga një herë NDËRRIM.

Aktiviteti kryesor 1

Arsimtarja u thotë fëmijëve të përkujtohen në ndonjë ngjarje në të cilën kanë përjetuar emocione shumë të fuqishme. Këtu duhet të theksohet se ndjenjat mund të jenë edhe të këndshme edhe të pakëndshme. Pas disa minutave fëmijët ndahen në çifte dhe kështu duhet të bisedojnë për ngjarjet e tyre dhe të përpiqen t'i emërtojnë ndjenjat që janë paraqitur te ata. Pastaj vijon një bisedë në rreth.



Diskutim 1

1. Cilat ndjenja të fuqishme janë paraqitur në klasë?
2. Çka i ka shkaktuar ato ndjenja?
3. Si kanë ndikuar ato ndjenja te ne? E si kanë ndikuar ndaj trupit tonë?
4. Çka bëtë me ndjenjat tuaja?

Aktiviteti kryesor 2

Arsimtarja i ndan fëmijët në pesë grupe dhe secilit grup ia jep nga një ndjenjë nga fleta e punës për nxënësit “Ndjenja të fuqishme”. Kështu secili grup duhet të aktrojë situatë në të cilën paraqitet ndjenja që e kanë marrë. Arsimtarja i inkurajon fëmijët të zgjedhin një situatë reale. Gjatë përgatitjes së situatës grupi duhet të diskutojë për këto gjëra:

- » Çka ka bërë fëmija në atë situatë?
 - » Çka ka thënë?
 - » A do t'i vinte mirë sikur t'i ndihmonte dikush dhe kush?
- Dhe, këto duhet t'i përfshijë në prezantim.

Pastaj grupet e prezantojnë para të tjerëve situatën e përgatitur.



Diskutim 2

1. A ballafaqohemi me të gjitha ndjenjat e fuqishme në mënyrë të njëjtë?
2. A ballafaqohen të gjithë fëmijët në mënyrë të njëjtë me një ndjenjë të njëjtë?
3. Si mund t'ia dalim mbanë me disa ndjenja të pakëndshme?
4. A mund të na ndihmojë dikush në ato situata? Kush dhe si?
5. A mund të na ndihmojë ndonjë shok i yni? Si?

Përfundim !

Edhe ndjenjat e këndshme edhe ato të pakëndshme mund të jenë shumë të fuqishme. Një situatë e njëjtë te njerëz të ndryshëm mund të shkaktojë ndjenja të ndryshme? Ndjenjat e fuqishme ndikojnë te ne: ato pozitive na e përmirësojnë disponimin, na mbushin me energji dhe fuqi, na lëvizin, ndërsa ato negative mund të na ngadalësojnë, na bëjnë të pafuqishëm, madje disa mund të na shkaktojnë edhe kokëdhimbje ose dhimbje në bark. Në situata kur kemi ndjenja të fuqishme mund të reagojmë në mënyra të ndryshme. Disa njerëz dëshirojnë të jenë së paku për pak çaste vetë, ndërsa disa dëshirojnë të jenë në shoqëri me njerëzit e afërt të cilëve u besojnë dhe me të cilët ndjehen më të sigurt. Në situatat kur kemi ndjenja të fuqishme negative mund të na ndihmojë edhe vaji, biseda, shëtitja në park, zbrazja e zemërimit në mënyrë jodestruktive ose veprimi për të cilin jemi të sigurt se na qetëson dhe na bën mirë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja I-3.3: Njohja e ndjenjave



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit I-3.3: Ndjenja për t'u shprehur

Aktiviteti hyrës

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth dhe duhet ta prezantojnë vetveten duke e thënë emrin e tyre të vërtetë, ndërsa në vend të mbiemrit të vërtetë duhet ta mendojnë ndonjë mbiemër tjetër i cili fillon me shkronjën e parë të emrit të tyre dhe që e shpreh ndonjë ndjenjë të caktuar, e pastaj duhet të shpjegojnë se pse e kanë zgjedhur pikërisht atë mbiemër. E para me prezantim fillon arsimtarja, e pastaj vazhdon fëmija që është në të majtë të saj e kështu me radhë derisa të prezantohen të gjithë fëmijët.

Për shembull: “Unë quhem Gëzim Gëzuari, sepse jam shumë i gëzuar në lidhje me shfaqjen që e organizuam në fund të vitit.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit duhet të ndahen në tetë grupe të vogla dhe secili nxënës duhet ta tërheqë nga një fletë prej fletës së punës për nxënës “Ndjenja për t'u shprehur”. (nëse ka më pak se 16 nxënës, mund të zvogëlohet numri i ndjenjave që do të ofrohen.)

Të gjithë atyre që u ka rënë ndjenja e njëjtë bashkohen në një grup të vogël (me nga 204 nxënës). Detyra e secilit grup të vogël është të mendojë se si ta aktorojë ndjenjën që u ka rënë, pa përdorë fjalë, por vetëm me shprehje të fytyrës, me gjeste, me duar, me lëvizjen e trupit dhe shenja të tjera joverbale.

Secili grup e aktron ndjenjën para të tjerëve, që pastaj duhet t’ia qëllojnë se cilën ndjenjë e shfaq grupi. Nëse nuk ia qëllojnë menjëherë, aktrimi mund të përsëritet edhe një herë.

Prezantimi i secilit grup duhet të jetë i përcjellë me duartrokitje nga të gjithë, pa marrë parasysh se a e qëllojnë të tjerët ndjenjën e prezantuar apo jo.



Diskutim

1. Cilat ndjenja ishin më të vështira, e cilat ishin më të lehta për t'u aktuar? Pse?
2. Si i njohim ndjenjat? Si shprehen ndjenjat? (Çka ndodhë me fytyrën dhe me trupin?)
3. A e prezantonin të gjithë ndjenjën e njëjtë në të njëjtën mënyrë? (A kishin shprehje të njëjtë të fytyrës dhe pozitë të njëjtë ose lëvizje të njëjtë të duarve dhe trupit?) A i shprehin të gjithë njerëzit në mënyrë të njëjtë ndjenjat?
4. Përveç në mënyrë joverbale, në çfarë mënyre tjetër mund të shprehen ndjenjat? Si i njohim ndjenjat sipas mënyrës në të cilën flitet?
5. Ku dy veta grinden, nëse njëri bërtet e tjetri hesht, a do të thotë kjo se vetëm ai që bërtet është i hidhëruar?
6. Si reagojmë kur jemi të gëzuar?
7. A dëshironi ta luajmë një lojë e cila sigurisht do të shkaktojë gëzim te ju?

Përfundim

Ne e dimë se dikush ndjehet sipas asaj që e shpreh në fytyrë (sytë, vetullat, goja), si e ka pozitën e trupit (i drejtë, i kërrusur) dhe si i ka lëvizjet e duarve dhe të tërë trupit (të shpejta, të ngadalshme).

Përveç shenjave joverbale, ndjenjat njihen edhe përmes intonacionit (i theksuar, i zgjatur...) dhe fuqisë së zërit (qetë, zëshëm...) derisa flitet.

Te disa njerëz ndjenjat njihen më lehtë, e te disa më vështirë. Të gjitha shprehjet e fytyrës nuk janë të pranishme te të gjithë njerëzit në masë të njëjtë dhe në mënyrë të njëjtë.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth dhe secili fëmijë do të duhet ta zgjedhë një fëmijë të grupit, pa treguar se cilin e kanë zgjedhur. Pastaj kur të jepet shenjë, secili fëmijë duhet të vrapojë te fëmija që e ka zgjedhur dhe me vrap të ngadalte t’i bëjë tre rathë përreth atij. Sigurisht shumë fëmijë nuk do të arrijnë ta kryejnë detyrën dhe kështu do të bëhet një kaos i vogël, sepse të gjithë do të vrapojnë andej-këndeje, por me rëndësi është të përjetohet atmosfera e gëzimit.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja I-4: BALLAFAQIMI ME HUMBJEN DHE PIKËLLIMIN

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se në jetë ndodhin edhe situata të këqija që kanë si pasojë lëndimin ose humbjen e njeriut të dashur, atij që e duam etj.
Shkathtësi	» të mund të flasë për humbjen e një njeriu të dashur që e ka humbur
Qëndrime/ vlera	» ta pranojë se pikëllimi nuk është shenjë e dobësisë

Punëtorja I-4.1: Barometri i emocioneve



Materialet:

- » top
- » fletë pune për nxënësit I-4.1: Barometri i ndjenjave gjatë humbjes
- » fleta për të vizatuar
- » pajisje për të vizatuar

Aktiviteti hyrës

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa arsimtari duke e mbajtur një top në dorë duhet të tregojë se çka është ajo që atë e bën krenar. Ai thotë “Krenohem....” dhe thotë diçka të mirë që e ka bërë ose ndonjë sukses të arritur në ditët e kaluara. Pastaj ia hedh topin ndonjë fëmijës tjetër, i cili po ashtu vazhdon në atë mënyrë dhe loja përsëritet me të gjithë fëmijët.

Aktiviteti kryesor 1²

Arsimtari u tregon nxënësve se do të bëjnë fjalë për humbjen dhe pikëllimin në lidhje me humbjen. Ai thotë se ajo përvojë është e njohur për të gjithë dhe se të gjithë ne kemi kaluar nëpër të, por edhe përkundër kësaj njerëzit zakonisht nuk flasin për humbjen dhe duket se secili vetë duhet të kalojë nëpër ato ndjenja. Në këtë punëtori do të bëhet përpjekje të flitet për humbjen dhe bashkërisht t’i kalojnë ndjenjat në lidhje me të. Arsimtari thotë se që të mund ta bëjnë këtë, do të duhet të përgatiten me vullnet të mirë dhe me energji pozitive.

Fëmijët ulen në bankë dhe secili duhet të përkujtohet në ndonjë situatë të së kaluarës së tij kur e ka pasur patjetër të ndahet (kur e ka humbur dikë) nga diçka/dikush që ka qenë shumë i/e rëndësishëm/me për të. Pastaj atë situatë duhet ta vizatojnë dhe pasi ta kryejnë, fëmijët ndahen në çifte dhe secili do të duhet t’ia paraqesë dhe shpjegojë fotografinë fëmijës së çiftit të tij.

Aktiviteti kryesor 2

Arsimtari e vendos në tabelë barometrin e fletës së punës për arsimtarin/arsimtaren “Barometri i ndjenjave gjatë humbjes”, i lexon ndjenjat dhe kërkon nga secili fëmijë që ta shkruajë shkronjën e parë të emrit të tij pranë ndjenjës që konsideron se është më afër asaj që ai është ndjerë në situatën që e ka vizatuar.

Pastaj arsimtari bën një rezime të shkurtër, duke konstatuar se cilat ndjenja më shpesh ndeshen, e cilat më rrallë, duke theksuar se është normale të paraqitet cilado nga këto ndjenja.



Diskutim

1. Cilat ndjenja paraqiten kur e humbim dikë ose diçka që e kemi shumë të rëndësishëm/rëndësishme?
2. Si reagojmë në ato situata?
3. Sa jemi të ngjashëm, e sa jemi të ndryshëm në reagimin ndaj atyre situatave? E ndaj ndjenjave?
4. A është mirë që ndjenjat në lidhje me vetveten të fshihen nga njerëzit e tjerë? Pse? Çka mund të na ndodhë nëse e bëjmë këtë?
5. Si mund t’ia lehtësojmë vetvetes?
6. A mund të flasim me secilin për ndjenjat tona në lidhje me humbjen? Secili le të mendojë se cili është ai person i mjedisit të tij me të cilin do të ndjehej më i sigurt dhe i kuptuar që të bisedojë me të në lidhje në situatat kur ka ndjenja të vështira.

Përfundim

Një nga ndjenjat vërtet më të dhimbshme me të cilët fëmijët ndeshen është ndarja, gjegjësisht humbja. Atëherë paraqiten disa ndjenja të pakëndshme dhe të vështira. Në ato situata të gjithë reagojmë në mënyra të ndryshme (nga tërheqja në vetvete dhe izolimi deri në sjellje agresive e destruktive). Është shumë me rëndësi që ndjenjat të pranohen, të njihen dhe të manifestohen në mënyrë adekuate. Megjithatë nuk duhet ta shpejtohet me insistimin që ndjenjat gjithsesi të shfaqen. Është me rëndësi që fëmijës t’i krijohet mjedis dhe atmosferë e mbështetjes dhe pranimit në të cilën ai do të ndjehet i sigurt dhe i respektuar dhe se atij nuk do t’i ndalohej me vetëdije ose pa vetëdije që t’i shprehë ndjenjat e tij. Mjafton që fëmija ta dijë se ekziston së paku një njeri me të cilin mund të bisedojë kur është në vështirësi. Biseda në këso raste i ndihmon fëmijës që t’i ndajë ndjenjat e tij dhe kështu t’ia lehtësojë vetvetes, ta rishqyrtojë ngjarjen në nivel verbal (e jo vetëm me të menduar) dhe të fitojë mbështetje që të mund të vazhdojë më tej.

2 Ideja për aktivitetin është marrë nga: Uzelac, M. Autor dhe bashkëpunëtorë Bezic, I., Hart B. I Mitrovic, M. (1997). Za Damire i Nemire: Vrata prema nenasilju: Doracak për zgjidhjen paqësore të problemeve në shkollë dhe zbutja e traumave. Zagreb: Hapi i vogël – Qendra e Kulturës së Paqes dhe Jodhunës.

7. Në çfarë mënyrash të tjera mund t'i lehtësojmë vetvetes?

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth dhe arsimtari u thotë se do të provojnë të shkarkohen nga ndjenjat e mbledhura me ndihmën e frymëmarrjes së thellë. “Të gjithë ngadalë dhe thellë marrim frymë duke u ngritur në majë të gishtave, e pastaj shpejt dhe menjëherë e lëshojmë frymën duke shpërthyer me PUF! dhe lëshohemi në thembra duke i shtrënguar pëllëmbët pranë trupit sikur t’u dalin rrufe nga këmbët e tyre në dysheme. Këtë e përsërisim pesë herë.”



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja I-4.2: Humbja e lepurit Zozo



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Lepuri Zozo dhe luledielli
- » fleta për të shkruar
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti kryesor

Arsimtari e lexon përrallën e fletës së punës “Lepuri Zozo dhe luledielli”³.



Diskutim

1. Si ndjehej lepur i Zozo në shoqëri me lulediellin? Çka bënte ai që ta ketë më interesant dhe më mirë me shoqërimin e tij?
2. Si ndjehej lepur i Zozo kur e kuptoi se luledielli ka vdekur? Si e shfaqte këtë?
3. Për kë mendonte ai se është fajtor për vdekjen e lulediellit?
4. Si ndjehej lepur i Zozo pastaj, kur ishte vetë në kasollën e tij? Si e shfaqte atë? Çka bënte?
5. Pse Zozo nuk donte të flasë në fillim me bufin për lulediellin? Si ndjehej ai me këtë rast? Çka bëri?
6. Si e kaloi Zozo pikëllimin? Çka i ndihmoi atij? A i mbeti diçka prej mikut të tij, Gëzimit?
7. A jeni ndjerë edhe ju ndonjëherë si lepur i Zozo?

Përfundim

Është mirë të kesh mik, me të cilin mund ta këmbehen gjërat. Kjo na bën të ndjehemi të pranuar, të respektuar dhe të sigurt. Kur ndodhë ndonjë humbje, ne e përjetojmë atë në disa faza. Së pari jemi të befasuar, të habitur, dhe nuk jemi të gatshëm ta pranojmë atë që ka ndodhur. Ne refuzojmë të besojmë se ajo humbje vërtet ka ndodhur. Pastaj paraqitet ndjenja e fajit, mendojmë se ne nuk kemi bërë diçka që ajo të mos ndodhte, me çka mbase kemi kontribuar që të ndodhë humbja. Në fazën e ardhshme ndjehemi të pikëlluar, na dhemb shumë që na mungon ai/ ajo që e kemi humbur. Nuk kemi interes për asgjë, nuk na bëhet asgjë, e humbim apetitin, madje edhe gjërat që dikur i kemi konsideruar si normale dhe të bukura, në këtë fazë na duken pa lidhje dhe ne tregoheni indiferent ndaj tyre. Pas kësaj mund të shfaqet hidhërimi, të jemi të hidhëruar me gjithçka, madje edhe ndaj atij që e kemi humbur. Kur dikush na e përmend humbjen, ne hidhërohemi e nervozohemi. Kur përgatitemi të flasim për humbjen tonë, duke u përkujtuar në gjërat e bukura dhe të hidhura që i kemi kaluar me atë që e kemi humbur, mund të ndodhë që të qajmë, si Zozo në përrallë, por kjo na bën që ta pranojmë humbjen si pjesë normale të jetës, si diçka që vjen dhe kalon, ndërsa ne me këtë rast orientohejmë drejt gjërave të reja që janë para nesh në jetë. Me këtë rast me rëndësi është të dihet se gjërat që ne i kemi mësuar nga ai që e kemi humbur, çdoherë do të jenë me ne – se ka diçka që asnjëherë nuk do të humbet.

Aktiviteti përmbyllës

Secili fëmijë në një fletë të letrës duhet ta shkruajë një mesazh ose diçka që ndonjëherë e ka humbur. Në mesazh mund të shprehet falënderim ndaj atij/asaj që e kanë humbur për atë që e kanë mësuar prej atij/asaj, gjë që u ka ndihmuar që pastaj në jetë të jenë më të mirë. Mesazhet ruhen për vete.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

3 Ideja për aktivitetin është marrë nga Martin, G. O.K. je biti tužan. (1997) Zagreb: Shoqata e Ndihmës Psikologjike

Dikur moti, shumë moti, unë isha vajzë e vogël... Tash jam gjyshe dhe dëshiroj të flas me fëmijët dhe t'u rrëfej përralla. Prandaj dëshiroj t'ua rrëfej këtë përrallë që dje ia tregova nipit tim Davidit – ai i ka dhjetë vite dhe ende dëshiron të dëgjojë përralla. Përrallën që do t'jua tregoj është për një lepurush dhe për mikun e tij.

Lepuri Zozo dhe luledielli

Lepuri Zozo me shumë kujdes e nxori kokën nga vrima e tij. Priste të ndjejë pika shiu, sepse tashmë disa ditë nuk kishte rënë shi. Por, nuk kishte shi! Dielli shkëlqente në qiell, ndërsa qielli ishte i kaltër dhe pa re. Disponimi i Zozos varej nga moti. Kur ishte moti me diell, Zozo mendonte se jeta është e mrekullueshme, ndërsa kur binte shi, atij gjithçka i dukej e përhimët dhe e mërzitshme.

Por, sot dielli shkëlqente dhe ai me shumë gëzim u nis në shëtitjen e mëngjesit.

“Jam i sigurt se edhe ti e do diellin si unë” – tha një zë i imët aty pranë. Lepuri Zozo i hapi sytë dhe shikoi përreth vetes. Nuk pa askënd. “Shiko, je pranë meje”, u dëgjua përsëri zëri. Lepuri Zozo e ngriti kokën dhe mbi vete e pa lulen më të bukur në botë që e shikonte drejt në sy.

“Kush je ti?”

“Unë jam luledielli Gëzim – çdoherë e kthej kokën kah dielli, sepse i dua rrezet e tij” – u përgjigj lulja.

„Asnjëherë më parë nuk të kam parë – je shumë i gjatë” – bërtiti lepur.

“Por, unë shpesh të shoh ty, shpesh të shikoj sesi kërcen gjithandej, çdoherë shpejton shumë. Ndërsa e kam patjetër të qëndroj në vend të njëjtë dhe të mendoj se ky lepur vazhdimisht endet andej-këndej dhe sheh gjëra shumë interesante. Të lutem, a dëshiron të m'i rrëfesh përjetimet tuaja. Kështu ato përjetime do të bëhen edhe të miat” – tha gëzimi.

“Oh, gjithsesi” – tha lepur.

Ky ishte fillimi i një miqësie të mirë. Çdo ditë Zozo vinte te luledielli dhe ia rrëfente përjetimet e tij, ndërsa Gëzimi e dëgjonte. Kalonin ditët, dielli shkëlqente, ndërsa qielli nuk kishte asnjë re. Kjo kohë i përgjigjej shumë Zozos – ndjehej shumë bukur.

Por, një ditë ai e vërejti se gjethet e Gëzimit kishin filluar të vishken.

“A mos je i pikëlluar për ndonjë gjë?”

“Jo.” – u përgjigj Gëzimi, “por kam filluar të ndjejë etje, do të doja që sa më shpejt të bie shi, sepse rrënjët e mia po thahen.”

“Unë nuk dua shi” – bërtiti Zozo.

Gëzimi e lëkundti kokën si me pikëllim, por asgjë më shumë nuk tha.

Ditët e ardhshme disa miq të Zozos erdhën te ai në shtëpi dhe kështu ai nuk mundi ta takojë Gëzimin. Por, kur shkuan miqtë dhe kur Zozo po binte në gjumë, i shkoi mendja te Gëzimi. Tha me vete: “Natën e mirë Gëzim, shihemi nesër.” Mëngjesin e nesërm Zozo menjëherë vrapoi te Gëzimi, por e gjeti të shtrirë në tokë pa shenja jete.

“Gëzim, ngrihu, nuk është mirë gjithë kohën të rrih shtrirë.”

Por Gëzimi nuk përgjigjej.

Ndërkaq një buf plak që po qëndronte në një degë i tha:

“Luledielli yt ka vdekur.”

“I vdekur, nuk është e mundur.”

“Po, po, u tha, sepse nuk kishte ujë.”

Në sytë e Zozos u mblodhën lot, andaj tha: “Për këtë unë jam fajtor që nuk doja të binte shi.”

“Çfarë marrëzie – tha bufi, nuk mund të vendosësh ti se a do të ketë apo jo shi. Shih luledielli të ka lënë një dhuratë – një farë. Zozo e mori farën ngadalë dhe kështu u tërhoq në shtëpi. Pas pak filloi të bie shi, por ai as që e vërejti shiun. Kur arriti në shtëpi, farën e vendosi në një kuti dhe atë e fshehu nën krevat. Përpiqej ta harrojë Gëzimin, dëshironte të mos kujtohej në të, por i vinte shumë keq. Lepuri Zozo ndjehej sikur të jetë vetë në botë.

Shumë shpejt erdhi edhe dimri. Ai ishte dimri më i gjatë dhe më i mërzitshëm në jetën e Zozos. Atij i mungonte shoku i tij më i dashur, luledielli, dhe bisedat me të. Nuk donte as të dalë jashtë, as të flasë me dikë.

Një mëngjes kur po dilte nga vrima e tij, e pa bufin i cili po qëndronte në dru. Bufi i tha: "Jam i sigurt se miku yt lulediell të mungon."

"Jo, jo, nuk më mungon, ik!" – bërtiti i tërbuar Zozo.

Por, bufi i urtë e dinte se Zozo ishte shumë i pikëlluar që të bisedojë me të ose që të dëgjojë çfarëdo këshille prej tij. Prandaj ai u shpërngul në një shtëpi afër shtëpisë së lepurit dhe çdo mëngjes atë e përshëndeste me "Mirëmëngjesi!". Në fillim lepuri nuk përgjigjej, por një ditë e dëgjoi një "Mirëmëngjesi" të qetë. Kështu e kuptoi se lepuri po ndjehej më mirë.

Një ditë të bukur pranvere Zozo doli nga vrima e tij dhe bërtiti: "Oh sa më mungon Gëzimi!".

"A dëshiron të flasim për këtë?" – e pyeti bufi.

"Nuk ka kuptim" – u përgjigj lepuri.

"Është mirë të kujtohesh. Të kujtohesh në të gjitha momentet e bukura që i keni kaluar së bashku" – tha bufi.

"Por, kjo është e vështirë" – tha lepuri dhe filloi të qajë.

"Po, është vështirë" – pranoi bufi – "dhe plotësisht të kuptoj pse je i pikëlluar."

Ai po priste që Zozo të qetësohet, të mos qajë, e pastaj tha: "Paj, çka bërë me farën e vogël?".

"E fsheha."

"E fshehe? Më dëgjo, tash është pranverë, ka diell dhe kjo është koha që ta mbjellësh farën e vogël të lulediellit – fëmijën e Gëzimit".

Lepuri Zozo po qëndronte i hutuar sikur mos t'i ketë dëgjuar fjalët e bufit. Atëherë kërcëu dhe e mori farë nga vrima e tij dhe me thundrat e tij e bëri një vrimë të vogël në tokë dhe aty e mbolli atë farë luledielli. Pastaj u ul dhe tha: "Të faleminderit, i dashuri Gëzim, unë asnjëherë nuk do të harroj."

Bufi e dinte se lepuri përsëri do të mund të kujdeset përsëri për veten e tij. Ishte verë e këndshme. Binte shi, por edhe dielli ngrohte. Lepuri çdo ditë e vizitonte vendin ku e kishte mbjellë farën. Dhe tash nuk ishte i pikëlluar ku binte shi – e dinte se farës së vogël i duhej shi dhe diell që të rritet. Një ditë mbi tokë në atë vend u duk një gjeth i vogël i gjelbër, i cili për disa ditë u rrit në një bimë e cila çdo ditë rritej e bëhej gjithnjë më e madhe.

Një mëngjes kur Zozo ende i përgjumur po dilte nga vrima e tij, një zë i tha: "Mirëmëngjesi, sa ditë e bukur!".

Zozo e ngriti kokën dhe e shikoi drejt lulediellit e sapodalë dhe i tha: "Mirëmëngjesi, më vjen mirë që të shoh."

"Edhe mua më vjen mirë që të shoh", u përgjigj luledielli.

"Si quhesh", e pyeti Zozo.

"Shpresa" – u përgjigj ai.

"Shpresa", e përsëriti këtë emër në vete Zozo e pastaj i tha: "E kisha një mik luledielli, që quhej Gëzim, por vdiq. A dëshiron të të rrëfej për atë?"

"Po, po, shumë" – buzëqeshi Shpresa. Kështu Zozo i rrëfente atij për Gëzimin, për ditët e bukura që i kishin kaluar së bashku dhe për atë se kishin qenë miq të mirë. I fliste edhe për atë se mësoi se edhe dielli edhe shiu janë të nevojshme që të ringjallet jeta.

Përmbajtja I-5: BALLAFAQIMI MË SUKSESIN/MOSSUKSESIN

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë kriteret e suksesit dhe mossauesit në mësim dhe në punë
Shkathtësi	» të mund ta ndajë suksesin/mossauesin e tij me të tjerët
Qëndrime/ vlera	» të pranojë se suksesi dhe mossauesi duhet të ndahen me të tjerët

Punëtorja I-5.1: Asgjë nuk shkon aq mirë sa suksesi!



Materialet:

» balona

Aktiviteti kryesor 1

Aktiviteti përbëhet nga disa lojëra me balona që luhen njëra pas tjetrës:

- 1) Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe arsimtarja fillon me aktivitetin duke e hedhur balonën në qendër të rrethit dhe duke e ftuar me emër ndonjë fëmijë. Ai fëmijë pastaj do të duhet t'i bie balonës dhe ta thotë emrin e fëmijës së ardhshëm që do të duhet t'i bie balonës. Loja vazhdon derisa të gjithë fëmijët t'i bien balonës.
- 2) Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth, ndërsa arsimtarja i lëshon 5 balona, një nga një në distancë kohore prej disa sekondash. Këto balona nxënësit duhet t'i mbajnë në ajër duke u rënë që mos të bien.
- 3) Fëmijët ndahen në dy grupe. Secili grup pastaj ndahet në çifte. Çiftit të secilit grup që fillon, i jepet nga një balonë, të cilën ai duhet ta përcjellë deri në fund të klasës, e pastaj të kthehet pas ndonjë karrigeje dhe kështu përsëri të kthehet në grupin e tij dhe t'ia japë çiftit tjetër. Të dyja grupet njëherazi garojnë, ashtu që grupi që arrin i pari shpallet fitues.
- 4) Nxënësit ndahen në disa grupe. Secilit grup i jepet nga një balonë, të cilën ai do të duhet ta mbajë sa më gjatë në ajër vetëm duke e fryrë. Fitues i këtij grupi është ai që do ta mbajë balonën më gjatë në ajër.
- 5) Secili nxënës përpiqet ta mbajë balonën në majë të gishtit të tij tregues sa më gjatë që mundet. Fitues është ai që arrin ta mbajë balonën më gjatë se të gjithë pa i rënë në tokë.



Diskutim 1

1. Si ndjeheshit gjatë kohës së lojërave?
2. Si ndjeheshit kur arrinit sukses?
3. A ishte i rëndësishëm suksesi për të gjithë njësoj?
4. Si ndjeheshit kur fitonit?
5. Si ndjeheshit kur gabonit? Çka i thoshit atij që gabonte? A ndihmonte kjo? Çka ndihmonte?
6. Si ndjeheshit kur fitonit në grup? Si e ndanit suksesin mes vete?
7. Kur fituat si çift apo si individ, a e ndatë suksesin me dikë tjetër? Si? Si ndjeheshit atëherë?
8. Si ndjeheshit kur nuk arrinit ta bëni atë që kërkohej prej jush? Si ndjeheshit kur humbët si grup? Çka bëte atëherë? Si e ndanit mossuksesin?
9. Si ndjeheshit kur si individë nuk arrinit të fitoni? A e ndatë këtë me dikë?

Përfundim

Zakonisht kur përjetojmë sukses, jemi të gëzuar, krenarë, të vetërealizuar dhe të kënaqur. Në ato situata më lehtë është t'i ndajmë ndjenjat tona me të tjerët në lidhje me suksesin e arritur. Kur jemi në çift ose në grup, ndarja e ndjenjave me të tjerët e fuqizon ndjenjën e afërsisë, përkatësisë dhe ndarjes së përgjegjësisë për rezultatin e arritur. Kur dikush do të fitojë, të tjerët i urojnë, me çka dëshmojnë se e respektojnë suksesin e tij dhe se ai sukses është arritur në garë korrekte. Nëse ai që ka arritur sukses, atë e feston në mënyrë që i nënvlerëson të arriturat e të tjerëve, kështu te ata do të nxisë ndjenja të pakëndshme dhe sigurisht ata nuk do të dëshirojnë të jenë pjesë e "ndarjes" së suksesit të tij.

Kur dikush nuk ka sukses në qëllimin e përcaktuar, i cili varet nga shumë shkaqe, te ai mund të paraqiten një varg ndjenjash – si pozitive, ashtu edhe negative. Edhe ndarja e mossuksesit në kuptim të ndarjes së përgjegjësisë së përbashkët për rezultatin e arritur, është e dobishme përballë akuzës dhe qortimit. Kështu më shpejt do të shihen mangësitë, që pastaj në atmosferë pozitive do të tejkalohen. Ndonjëherë, në situata të mossuksesit, mund të paraqiten ndjenja shumë të pakëndshme dhe pikëlluese. Ndarja e tyre me dikë në të cilin kemi besim mund të na ndihmojë dhe ta zvogëlojë gjendjen e pakëndshme që e ndjejmë.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit ndahen në tre grupe dhe dy vetë prej tyre duhet të punojnë në temën *suksesi*, ndërsa dy të tjerë në temën *mossuksesi*.

Secili grup së pari duhet të bisedojë rreth këtyre çështjeve:

SUKSESI

1. Kur e arrij ndonjë sukses, a e ndaj atë me të tjerët?
2. Me kë dhe si?
3. Si ndjehem në lidhje me të?

Pastaj duhet ta zgjedhin një situatë të jetës reale kur dikush ka arritur një sukses të caktuar dhe atë e ka ndarë me të tjerët. Këtë situatë le ta aktrojnë.

MOSSUKSESI

1. Kur më ndodhë ndonjë mossukses, a e ndaj atë me të tjerët?
2. Me kë dhe si?
3. Si ndjem në lidhje me të?

Pastaj duhet ta zgjedhin një situatë të jetës reale kur dikush ka pasur ndonjë mossukses të caktuar dhe atë e ka ndarë me të tjerët. Këtë situatë le ta aktrojnë.



Diskutim 2

1. A ju ndodhë ne jetën reale që ta ndani suksesin me dikë tjetër? Më kë e ndani më shpesh suksesin tuaj? Në çfarë mënyre?
2. E a ju ndodhë që mossuksesin ta ndani me dikë tjetër? Më kë e ndani më shpesh mossuksesin tuaj? Si?
3. A ju ndihmon dhe sa ju ndihmon ndarja e mossuksesit që të ndjeheni më mirë dhe ta pranoni atë?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja I-5.2: Proverba për suksesin dhe mossuksesin



Materialët:

- » fletë pune për nxënësit I-5.2a: Proverba për suksesin dhe mossuksesin
- » fletë pune për nxënësit I-5.2b: Kartela me pyetje
- » topa letre
- » shkumës

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çifte dhe nga dy çifte qëndrojnë në të dyja anët e bankës së njëjtë. Banka ndahet me shkumës në dy gjysma, ndërsa në mes vihet një top i vogël letre. Qëllimi i çiftit është që duke e fryrë topin (me duar të lidhura pas shpine) ta shtyjë topin në vijën e kundërshtarit, ndërsa për secilën shtyrje e fitojnë nga një pikë. Fitues është ai çift që i arrin pesë pikë.

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësit ndahen në grupe, ndërsa secili grup e tërheq nga një fletë të prerë të fletës së punës për nxënësit "Proverba për suksesin dhe mossuksesin", në të cilën është shkruar ndonjë proverb në lidhje me suksesin. Secili grup do të duhet ta diskutojë proverbin e vet, e pastaj një përfaqësues i grupit do të duhet ta lexojë shkurtimisht se çka mendon grupi i tij në lidhje me proverbin.



Diskutim 1

1. Si e shikojnë suksesin këto proverba? Nga çka varet suksesi? A pajtoheni ju me këtë?
2. Çka do të shtoni – nga çka tjetër varet se a do të ketë sukses dikush?
3. E si e shikoni mossuksesin? Nga çka varet mossuksesi?
4. A pajtoheni ju me këtë? Çka do të shtoni?

Përfundim

Në proverbat e ofruara suksesi është paraqitur si rezultat i mundit të vërtetë dhe angazhimit të vetë personit. Në veçanti janë theksuar prova dhe përpjekja që të arrihet sukses. Mossuksesi është prezantuar si diçka që është pjesë përbërëse e jetës, diçka që nuk guxon të na dekurajojë dhe diçka nga e cila mund të mësojmë shumë.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit ndahen në çifte dhe secili çift e tërheq nga një kartelë të prerë nga fleta e punës për nxënësit "Kartelat me pyetje". Në kartelë janë dy pyetje, ndërsa secili që është në çift do të duhet të përgjigjet në njërën nga ato pyetje.



Diskutim 2

1. Si ndjeheshit derisa e bënit ushtrimin? Pse?
2. Çka mund të llogaritet për sukses?
3. Kush mund të përcaktojë se a do të llogaritet diçka si sukses apo jo?
4. A mund ta përcaktojmë edhe ne vetë, pavarësisht nga kriteret e jashtme të suksesit, se çka do të llogarisim sukses e çka do të llogarisim për mossukses? Si?
5. Si ndikon suksesi ndaj aktiviteteve tona të ardhshme?
6. Si ndikon mossuksesi ndaj aktiviteteve të jashtme? A mund të ndikojë mossuksesi në mënyrë pozitive? Si?

Përfundim

Që të arrihet sukses, kjo do të thotë të realizohen gjëra të ndryshme. Ndonjëherë ato janë të vogla e cikërrima, diçka që ne e bëjmë çdo ditë, ndërsa harrojmë se edhe ato janë të arritura, ndërsa ndonjëherë ato janë të arritura të mëdha, të cilat sipas kriterëve më të larta të një institucioni të caktuar llogariten si sukses. Që diçka të vlerësohet si sukses ose mossukses, shpesh ekzistojnë kriteret e jashtme, të përcaktuara paraprakisht, siç janë: numri i përcaktuar paraprakisht i pikëve në test sjell notë adekuate, numri i caktuar i gabimeve gjatë vozitjes – sjell kalim ose rënie nga provimi i vozitjes. Por, për sukses llogaritet edhe kur kemi arritur t'i tejkalojmë kriteret tona të brendshme të suksesit ose kur e dimë se kemi dhënë mund maksimal nga vetvetja që ta realizojmë një detyrë të caktuar. Është shumë me rëndësi të përpiqemi të jemi të suksesshëm në diçka që për ne është shumë e vlefshme dhe të mos heqim dorë nëse nuk kemi sukses në përpjekjen e parë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja I-6: SHPREHJA MENDIMIT

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të dijë më shumë mënyra për ta shprehur mendimin e tij
Shkathtësi	» të mund ta shprehë qartë me argumente mendimin e tij.
Qëndrime/ vlera	» të pranojë se është me rëndësi të shprehet mendimi personal » ta kuptojë se mendimit të tij duhet t'i kushtohet kujdes i vazh- dueshëm

Punëtorja I-6.1: Unë mendoj kështu dhe dëshiroj ta dinë të gjithë!



Materialet:

- » fleta për të ngjyrosur
- » fleta për të shkruar
- » pajisje për të shkruar
- » pajisje për të vizatuar
- » sellotej
- » tabelë dhe shkumës

Aktiviteti kryesor

Të gjithë nxënësit janë ulur në banka. Arsimitarja e shkruan në tabelë këtë pyetje:

A rrihen nxënësit mes vete?

Nxënësit e kanë për detyrë që secili për vete ta shprehë mendimin e vet në raport me këtë pyetje dhe atë ta mbështetë me shpjegime dhe argumente për atë pse munden dhe pse nuk munden.

Secili fëmijë mund ta zgjedhë vetë mënyrë sesi do ta shprehë mendimin e tij – këtë mund ta bëjë përmes:

- » vizatimit (strip, grafit, fotografi, kolazh etj.)
- » të shkruarit (ese, dramatizim, vjershë, tekst për rep ose për ndonjë këngë tjetër etj.)
- » pantomima (skeç, aktrimi i “skulpturës”)
- » shprehje me zë (fjalim, parullë etj.)

Pasi të përfundojnë, duhet të grupohen sipas mënyrës që e kanë zgjedhur për ta shprehur mendimin e tyre. Në këtë mënyrë formohet grup i nxënësve që kanë vizatuar, që kanë shkruar, që kanë zgjedhur pantomimë, si dhe grup i nxënësve që janë përcaktuar që mendimin e tyre ta shprehin me zë.

Në kuadër të grupeve të formuara secili nxënës do të duhet së pari ta demonstrojë mendimin e tij bashkë me argumentet para të tjerëve në grup, e pastaj grupi të vendosë si (duke e përdorë mënyrën e njëjtë) ta demonstrojë atë para të tjerëve. Nëse ka më shumë mendime të ndryshme në grup, do të duhet të prezantohen të gjitha.



Diskutim

1. Në çfarë mënyrash e keni shprehur mendimin tuaj në lidhje me këtë çështje?
2. Si ndjeheshit në lidhje me mundësinë e shprehjes së mendimit tuaj për një temë të caktuar?
3. A e shprehin të gjithë nxënësit mendimin e tyre për çështje të caktuara? Pse?
4. Pse disa fëmijë nuk flasin para arsimtarëve?
5. E para prindërve?
6. Cilat janë shkaqet që mund të bëjnë që disa fëmijë të mos dëshirojnë ta shprehin haptazi mendimin e tyre para nxënësve të tjerë?
7. Pse është me rëndësi të shprehet mendimi personal?
8. Kush është përgjegjës që t'i mësojë fëmijët për ta shprehur mendimin e tyre?

Përfundim

Fëmijët mund ta shprehin mendimin e tyre në më shumë mënyra të ndryshme. Mendimi çdoherë duhet të shprehet verbalisht, përmes paraqitjes gojore, por mund shprehet edhe përmes formave të shprehurit me shkrim, dramës, vizatimit, këndimit etj. Kur jemi të nxitur që të shprehim mendimin tonë në atmosferë serioze dhe të sigurt dhe kur e dimë se mendimi i shprehur nuk do të shkaktojë reperkusione ndaj nesh, atëherë ndjehemi mirë dhe kemi vetëbesim që ta shprehim atë që e mendojmë. Në situata të caktuara ose para personave të caktuar ndodhë që vetë t'i vendosim kufizime vetvetes në shprehjen e mendimit tonë ose ato kufizime të jenë vendosur (të shprehura dhe të pashprehura) në anën tjetër. Ekzistojnë disa mënyra për shkakun e të cilave ndonjëherë disa fëmijë nuk e shprehin mendimin e tyre, veçanërisht nëse ai mendim është i ndryshëm ose i kundërt nga mendimi i të tjerëve: frikë nga pasojat, pasiguria, nevoja që të jetë i pranuar nga të tjerët, mungesa e vullnetit të palës tjetër për të dëgjuar, mbulimi i të vërtetës etj. Disa fëmijë nuk dinë si ta shprehin mendimin e tyre, sepse ndoshta asnjëherë nuk janë mësuar ta bëjnë atë. Të rriturit kanë përgjegjësi të krijojnë kushte që fëmijët të mund të kenë mendim të tyre dhe atë të mund ta shprehin, e gjatë kësaj atyre t'u kushtohet vëmendja e duhur.

Është shumë me rëndësi të shprehet mendimi personal, sepse në atë mënyrë fëmija merr pjesë në mjedisin i cili mund t'i përmbushë nevojat e tij.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në dy grupe që duhet të formojnë dy rrathë: rrethin e brendshëm dhe të jashtëm. Ata duhet të kthehen me fytyrë kah fëmijët e rrethit tjetër, ashtu që do të formojnë çifte të fëmijëve me një fëmijë të rrethit të jashtëm dhe një fëmijë të rrethit të brendshëm (arsimtarja mund të inkuadrohet në lojë nëse fëmijët janë me numër tek). Pastaj secili do të duhet t'i thotë partnerit të tij se çka mendon për të, por kjo PATJETËR do të duhet të jetë diçka e bukur dhe pozitive. Pasi që të dy në çift të këmbëjnë mendime të mira për njëri-tjetrin, fëmijët e rrethit të jashtëm zhvendosen një hap në të majtë, ndërsa fëmijët e rrethit të brendshëm mbeten në vendet e tyre. Kështu tash krijohet çifte të reja të fëmijëve që do të duhet t'i shprehin mendimet e tyre pozitive për njëri-tjetrin. Pastaj përsëri fëmijët e rrethit të jashtëm zhvendosen një hap majtas dhe procedura përsëritet.

Aktiviteti vazhdon derisa të formohen çiftet e njëjta si në fillim të lojës.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja I-6.2: Debat



Material:

- » fletë pune për nxënësit I-6.2a: Debat 1
- » fletë pune për nxënësit I-6.2b: Debat 2

Aktiviteti hyrës

Të gjithë nxënësit ulen në rreth dhe arsimtari u thotë se do ta luajnë një lojë në të cilën ata do të duhet t'ia qëllojnë se kush për çka mendon. Lojën e fillon arsimtari duke thënë: "Mendoj për diçka të vogël, të verdhë, që bën bëzzzzzzzzzz. Çka është ajo? Përgjigja është BLETA. Fëmijët e qëllojnë. Fëmija që ia qëllon do të duhet të tregojë se çka mendon. Gjatë paraqitjes së asaj që është mësuar do të përdoren më shumë se tre attribute. Nëse edhe pas dhjetëra përpjekjesh askush nuk arrin t'ia qëllojë, mund të shtohet edhe një atribut.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në 2 ose 3 grupe me nga 10 ose 12 fëmijë dhe secili grup me tërheqje e zgjedh temën për debat, e pastaj secilit i jepet nga një kopje e fletës gjegjëse të punës Debat 1" ose "Debat 2". Në kuadër të grupeve tash përsëri bëhet ndarja e secilit grup në dy nëngrupe. Njëri nëngrup duhet të tërheqë fletëza me fletën adekuate të punës që e i referohet argumentit PO, ndërsa gjysma tjetër duhet të tërheqë fletëza nga fleta e punës që i referohen argumentit JO. Kështu secili duhet ta mësojë argumentin e tij përmendsh. (nëse në grupe ka më pak fëmijë se që ka argumente, atëherë disa argumente dhe kundërgjegjëse mund të anashkalohen. E nëse ka më shumë fëmijë, atëherë me zgjedhje të rastësishme duhet të zgjidhen dy fëmijë që do ta kenë për detyrë ta japin fjalën ose të kujdesen që të respektohet procedura). Pastaj fillon debati, me atë që çdoherë fillon fëmija që thotë argument nga nëngrupi JO, natyrisht sipas numrit të fletës. Për secilin argument JO, duhet të japë "përgjigje" fëmija i nëngrupit PO, i cili e ka kundërgjegjësin (argumentet për PO dhe nuk janë shënuar me numra renderë). Fëmijët do të duhet të vendosin vetë se cili është kundërgjegjësi i tyre ndaj argumentit të ofruar. Aktiviteti mbaron kur të thuhet të gjitha argumentet dhe kundërgjegjëset.



Diskutim

1. A duhet ta shprehim mendimin tonë vetëm nëse është i njëjtë, gjegjësisht nëse tregon pajtim me bashkëbiseduesin? Pse?
2. Çka mund të ndodhë nëse e shprehim mendimin tonë, i cili është ndryshëm ose i kundërt me mendimin e bashkëbiseduesit?
3. Si mund të shprehet mendimi ynë i cili dallohet nga mendimi i bashkëbiseduesit pa kaluar biseda në grindje ose në garë komunikimi?
4. Çka do të thotë të përdoren argumente?
5. Kur e shprehim mendimin tonë për diçka, a do të thotë kjo se e themi gjënë e parë që na bie ndër mend ose e mendojmë njëherë dhe gjejmë dëshmi me të cilat do të mbështesim atë?
6. Si është më e sigurt se dëgjuesi do të na dëgjojë: nëse përdorim argumente apo nëse me inat e përsërisim atë që e kemi thënë duke e sulmuar dhe nënçmuar bashkëbiseduesin?
7. A mund të mësohet përdorimi i argumenteve? Si?

Përfundim

Mendimin tonë duhet ta shprehim pavarësisht nga ajo se a është i njëjtë apo i ndryshëm me mendimin e bashkëbiseduesit, sepse me rëndësi është që secili ta shprehë mendimin e tij, sepse secili e ka perspektivën e tij në kundërimin e gjërave, me çka mund të kontribuojë për pasqyrë të plotë të çështjes së bisedës. Nëse mendimin tonë e shprehim në atë mënyrë që nuk shfaq inat, grindje, ofendim ose nënçmim, atëherë bashkëbiseduesi mund të reagojë në mënyrë të njëjtë ose thjesht të tërhiqet nga komunikimi. Kur e shprehim mendimin tonë duke e mbështetur me dëshmi të ndryshme, gjegjësisht me argumente, atëherë vërtet kontribuojmë për temën e bisedës dhe kështu lëmë hapësirë që secili lirisht dhe me argumente ta shfaqë qëndrimin e tij. Përdorimi i argumenteve mund të mësohet me ushtrim të vazhdueshëm, duke menduar dhe duke kërkuar informacione plotësuese.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja I-6.3: Më thuaj çka mendon, se dua të të dëgjoj



Materialet:

- » fleta të letrës
- » pajisje për të vizatuar
- » pajisje për të shkruar
- » fletë pune për nxënësit I-6.3: Kush të vendosë?

Aktiviteti kryesor 1

Arsimtari kërkon nga nxënësit që të përkujtohen se si janë ndjerë kur janë veshur sot për të ardhur në shkollë. Kush ka vendosur se çka do të veshin ata? A i ka pritur veshja që atyre ua kishin përcaktuar prindërit e fëmija vetëm i ka veshur? A kanë marrë pjesë fëmijët bashkë me prindërit e tyre në zgjedhjen e veshjes? A është shprehur fëmija se çka do të dëshironte të veshë, pastaj prindi të ketë treguar, e në fund bashkërisht të kenë vendosur se çka do të veshë fëmija? Apo vetëm fëmija vetë ka vendosur se çka do të veshë për në shkollë? Ose, ndoshta fëmija ka vendosur se çka do të veshë, ndërsa prindi ia ka përgatitur veshjen?

Pastaj formohen grupe me nga katër nxënës që duhet t'ia tregojnë njëri-tjetritin përvojën e tyre.



Diskutim 1

1. Çfarë situatash kishte më shpesh? E çfarë më pak? Pse?

Aktiviteti kryesor 2

Secili fëmijë vetë në një fletë letre të ndarë në tre pjesë i bën tre kartela dhe njëren prej tyre e ngjyros me ngjyrë të gjelbër, tjetrën me të verdhë dhe të fundit me kuqe. Pastaj arsimtarja thotë se do t'ua lexojë disa pohime, për të cilat nxënësit do të duhet ta shprehin mendimin e tyre duke e ngritur kartelën me ngjyrë gjegjëse. Nëse mendojnë se fëmijë vetë duhet të vendosë, duhet ta ngrenë kartelën e gjelbër; nëse mendojnë se vendimin duhet ta marrë bashkë me të rriturin – prindin/kujdestarin, atëherë duhet ta ngrejë kartelën e verdhë; ndërsa nëse mendon se vendimin duhet ta marrë i rrituri (prindi/kujdestari), atëherë duhet ta ngrenë kartelën e kuqe.



Diskutim 2

1. Si ishin përgjigjet tuaja – a ishin shumica të njëjta apo dalloheshin? Ku kishte më shumë dallime?
2. A mund të ketë vetëm një përgjigje të saktë në këso situata? Pse nuk mundet?
3. A keni mendim tuajin për më shumë gjëra në shtëpinë tuaj, për të cilat ju duhet të ndërmerrni ndonjë vendim? Si e formoni mendimin tuaj?
4. A ju ofrohen mjaft informacione që të mund ta krijoni mendimin tuaj?
5. Çka bëni që të keni mjaft informacione që të mund të krijoni mendim të mbështetur për gjërat?
6. A flisni me dikë që ta krijoni mendimin tuaj?
7. A mund të vendosë fëmija vetë për gjithçka? A mund të vendosë së paku për diçka?
8. A është patjetër që fëmija të dëshirojë që për gjithçka të vendosë ai? A ju ka ndodhur që fëmija edhe pse ka mundur të marrë vendim vetë, megjithatë është konsultuar me të rriturit dhe bashkërisht kanë marrë vendim?
9. Nga çka varet se a do t'i lejohet fëmijës të marrë vendim vetë?

Përfundim

Fëmija duhet të nxitet të krijojë mendim të tij dhe atë ta shprehë për të gjitha gjërat që i referohen atij. Në një mjedis ku mendimi i lirë respektohet dhe lejohet nga të rriturit, fëmija bëhet më i pavarur dhe më i përgjegjshëm për zgjedhjet e tij. Se a do të pranohet në tërësi mendimi i fëmijës apo jo, kjo varet nga më shumë faktorë: nga moshja e fëmijës – nga shkalla e informimit dhe e njohurive të tij për t'i kuptuar dhe parashikuar gjërat, por edhe nga përgjegjësia e të rriturit që të kujdeset që secili vendim që do të merret të jetë në interesin më të mirë të fëmijës. Pavarësisht nga mundësia e fëmijës që vetë të vendosë, ai mund të zgjedhë që të marrë vendim në konsultim me personin e rritur.

10. Pse varet nga mosha?
11. Përveç nga mosha, prej çka varet pastaj?
12. A duhet të nxitet fëmija çdoherë që ta shprehë mendimin e tij për diçka që ka të bëjë me atë?
13. A duhet dhe a mundet fëmija çdoherë jo vetëm ta shprehë mendimin e tij, por edhe të vendosë vetë?
14. Cili fëmijë do të arrijë më shpejt që vetë të marrë vendime – atë që e mendon të përpiqet ta arrijë dhe ta shprehë, ndërsa atë që e konsideron të parëndësishme për vete të mos përpiqet ta shprehë?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja I-7: MENAXHIMI I KOHËS SË LIRË

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë të drejtën e kohës së lirë gjatë ditës, gjatë javës ose gjatë vitit » ta dijë rëndësinë e kohës së lirë
Shkathtësi	» të mund të identifikojë mënyra të ndryshme të organizimit të kohës së lirë
Qëndrime/vlera	» ta kuptojë se përdorimi i kohës së lirë është mundësi për ngritje dhe formim kulturor

Punëtorja I-7.1: Koha e lirë



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit I-7.1a: Kartela për kohën e lirë
- » fletë pune për nxënësit I-7.1b: Kartela: shkallë dhe gjarpërinj
- » figura (goma, gdhendëse, monedha të hekurta etj.
- » zare
- » gërrshërë

Aktiviteti hyrës

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth, ndërsa arsimtarja lexon pohime të caktuara dhe varësisht nga përgjigjja në pohimin e thënë nxënësit shkojnë në njërin ose në skajin tjetër të klasës.

“Kur i bashkon pëllëmbët, cili gisht i madh mbetet sipër? Nëse ai është gishti i majtë – shko në këndin e majtë të klasës, ndërsa nëse është gishti i madh i dorës së djathtë, atëherë shko në këndin e djathtë të klasës.”

Cilën këmbë e fut të parën në pantallona? Nëse e vë të majtën, shko në këndin e majtë të klasës, ndërsa nëse e vesh të djathtën, atëherë shko në këndin e djathtë!”

“Me cilin sy ua bën njerëzve më shpesh? Nëse ua bën me sy të majtin, shko në anën e majtë të klasës, ndërsa nëse ua bën me të djathtin, atëherë shko në këndin e djathtë.”

“Në cilën anë të krevatit zgjohesh në mëngjes? Nëse ngrihet në anë të majtë, shko në anën e majtë të klasës, ndërsa nëse ngrihet në anë të djathtë, shko në anën e djathtë të klasës!”

Kur përdor letër tualeti, a e mbledh troç ose e palos mirë? Nëse e bën troç, shko në këndin e majtë, ndërsa nëse e palos, shko në këndin e djathtë!”

Aktiviteti kryesor⁴

Sipas një zgjedhjeje të rastësishme nxënësit ndahen në grupe me nga katër persona (nëse ka nxënës që mbesin jashtë grupeve, ata e kanë për detyrë që të ecin nëpër grupe dhe të vëzhgojnë se a respektohen rregullat e lojës. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Kartela: shkallë dhe gjarpërinj”, zare, figura (secili nxënës nga një) dhe një komplet i fletës së punës për nxënës “Kartelat e kohës së lirë”, e cila është e prerë në pjesë. Pastaj arsimtarja e shpjegon lojën.

“Secili lojtar e hedh zarin një herë, ndërsa ai që ka numër më të paktë të zarit, ai e fillon lojën. Lojtari i parë e hedh zarin dhe ecë disa fusha më përpara, aq sa tregon zari. Nëse prek në fushën e prerë, atëherë ai e merr një kartelë, e lexon me zë dhe vepron sipas udhëzimeve të saj. Udhëzimet mund të jenë që të ecet përpara, prapa, të hidhet edhe një herë ose të anashkalohej rrethi. Pastaj vazhdon lojtari i dytë, pastaj i treti e kështu me radhë. Loja mbaron kur edhe lojtari i fundit do të arrijë në cak.”

Pastaj nxënësit e luajnë lojën. Pasi ta mbarojnë, zhvillohet një diskutim.



Diskutim

1. Si ndjeheshit derisa e luanit lojën? Pse?
2. Pse me disa deklarata shkohej para e me disa prapa?
3. A ka të drejtë secili për kohë të lirë? Pse është me rëndësi të kemi kohë të lirë në vit, në javë apo në ditë?
4. Si mund të kalohet koha e lirë?
5. Cilat mënyra ndihmojnë që ta pasurojmë diturinë dhe kulturën tonë?
6. A është kjo me rëndësi? Pse?

Përfundim

Secili fëmijë ka të drejtë për kohë të lirë dhe për pushim gjatë ditës, gjatë javës ose gjatë vitit. E drejta e kohës së lirë është pjesë e të drejtës së tij që të marrë pjesë në jetën kulturore, artistike dhe sportive, andaj atij duhet t'i ofrohen dhe lihen në disponim mundësi të ndryshme për rekreacion dhe lloje të tjera të aktiviteteve të lira, përmes të cilave ai do të mund të ngrihet në aspektin kulturor. Fëmijët kanë të drejtë për pushim aktiv, por edhe të drejtë për pushim pasiv, i cili i përgjigjet moshës dhe aftësive të tyre.

⁴ Ideja për aktivitetin është marrë nga European Youth Centre: Compasito: Manual on human rights education for children.(2008) Strasbourg



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Tema II: UNË DHE TI – RAPORTET NDËRPERSONALE

Përmbajtja II-1: PRANIMI I NGJASHMËRIVE DHE DALLIMEVE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime ndërmjet njerëzve për nga fizionomia, për nga aftësitë dhe prejardhja » ta dijë se njerëzit dallojnë për nga mendimi dhe bindjet e tyre » ta dijë se njerëzit kanë nevoja dhe interesa të ndryshme
Shkathtësi	» të mund t'i dallojë ngjashmëritë dhe dallimet të cilat ekzistojnë ndërmjet tij/saj dhe të tjerëve për nga fizionomia, aftësitë dhe prejardhja » të mund ta respektojë mendimin dhe bindjet e tjetrit edhe kur nuk pajtohet me të
Qëndrime/vlera	» të pranojë se ekzistimi i dallimeve ndërmjet njerëzve është një përparësi pozitive » të pranojë se duhet respektuar edhe mendimin edhe bindjet e të tjerëve » të pranojë se nevojat dhe interesat e të tjerëve janë njësoj të rëndësishme si edhe nevojat dhe interesat e tij/saj

Punëtorja II-1.1: Pjesë-pjesë - radhitëse



Materialet:

- » fletë e madhe e letrës së trashë
- » gërshërë
- » pajisje për vizatim
- » selotej
- » kuti
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Deveja dhe lepur

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari shpjegon se do t'ua lexojë disa fjali dhe të gjithë që do ta gjejnë vetën në atë që thuhet në fjali, do të duhet të ngrihen të bëjnë diçka që kërkohet prej tyre, e pastaj duhet të ulen. Pas kësaj lexohen fjalitë vijuese:

1. Lë të ngrihen të gjithë që mbajnë diçka të kuqe dhe le të shikohen mes vete.
2. Nëse keni atlete, ngrihuni dhe duartrokit një herë.
3. Ngrihuni të gjithë ju me këpucë të kuqe dhe bëni shenjë me kokë.
4. Të gjithë me flokë të zeza ngrihuni dhe bëni sikur po i shkulni flokët me dorë të djathtë.
5. Nëse keni të veshur diçka të bardhë, ngrihuni dhe vendoseni dorën e majtë në zemër.
6. Ngrihuni të gjithë me sy të kaltër dhe kërceni në një këmbë.
7. Nëse keni sy bojë kafe, ngrihuni dhe bëni sikur po shikoni me dylbi..
8. Të gjithë që keni të veshur diçka të kaltër, ngrihuni dhe kryqëzoni duart..
9. Nëse jeni të lindur në janar, ngrihuni dhe ngrijeni dorën e majtë.
10. Nëse jeni të gëzuar, çohuni në këmbë dhe ngriuni të dy duart lart.
11. Nëse mbani unazë ose ndonjë stoli tjetër, ngrihuni dhe tregojani të tjerëve.
12. Nëse jeni të mençur, ngrihuni dhe shtiruni sikur të jeni të rëndësishëm.
13. Nëse e dini ndonjë barsletë të mirë, ngrihuni dhe qeshuni me zë.
14. Nëse keni sy të gjelbër, ngrihuni dhe kruajeni shpinën.
15. Nëse keni të veshur xhinse, ngrihuni dhe tërhiqeni veshin e majtë.
16. Nëse keni ledhatak, ngrihuni dhe bëni si ai.
17. Të gjithë ata që dëshirojnë të lexojnë libra, le të ngrihen dhe le t'ia bëjnë me sy ndonjërit.
18. Të gjithë atyre që u pëlqen loja, le të rrinë ulur në vend dhe le të duartrokin

Aktiviteti kryesor

Arsimtari para punëtorisë e përgatitë një lodër të madhe për radhitjen e pjesëve të saj. Në fillim në një fletë më të madhe të letrës së trashë vizaton, ndërsa pastaj pret pjesë të parregullta, por të ngjashme për nga madhësia. Me këtë rast duhet të kemi aq pjesë sa është numri i nxënësve dhe arsimtarëve në paralele.

Në punëtori të përbashkët secili fëmijë me zgjedhje të rastësishme e zgjedh nga një pjesë të lodrës dhe në të e vizaton veten ose një pjesë të vetvetes. Në këtë aktivitet merr pjesë edhe arsimtari. Ai duhet t'i bëjë nxënësit të ndjehen maksimalisht të lirë, duke theksuar se aspak nuk është me rëndësi që vizatimi i tyre të jetë ndonjë punë mjeshtërore; me rëndësi është që ata të ndjehen të lirë gjatë vizatimit dhe të paraqesin ndonjë detal që është karakteristik për ta, pa u nënshkruar dhe të përdorin ngjyra reale për vizatim në disa pjesë të vizatimit.

Kur te mbarojnë të gjithë nxënësit, të gjitha pjesët vendosen në kuti të madhe, ndërsa nxënësit ndalen në rreth. Arsimtari e vendos kutinë në qendër të rrethit, i përzier pjesët dhe në fund secili sipas zgjedhjes së rastit e nxjerr nga një pjesë.

Fillimisht secili një nga një në rreth e prezanton pjesën e nxjerrë, e pastaj orvatet ta qëllojë se çka ka në vizatim. Pasi t'ia qëllojë, ai duhet ta thotë një gjë sipas së cilës ai dhe personi i vizatuar janë të ngjashëm, si dhe një gjë sipas së cilës ai dhe personi i vizatuar dallojnë mes vete. Gjërat për të cilat kërkohen ngjashmëri, gjegjësisht dallime, duhet t'i dedikohen ndonjërit nga kategoritë vijuese:

- » si duken (pamja e jashtme)
- » çka kerkojnë (dëshira)
- » çfarë veçori kanë (veti personale)
- » çka mendojnë për disa gjëra (mendime)

(arsimtari në mënyrë të thjeshtë mund t'i shënojë këto kategori në tabelë si përkujtim për nxënësit). Gjatë prezantimit të dallimeve, duhet theksuar se nuk tolerohet toni nënçmues, por vetëm një përshkrim i shkurtër i dallimit.

Pasi të gjithë do të radhiten në rreth, të gjithë një nga një marrin pjesë në përpilimin e lodrës me pjesë përmes ngjytjes së pjesëve të cilat i kanë nxjerrë dhe, në fund, ajo prezantohet në hapësirën e klasës.

Në rast se ka ndonjë fëmijë i cili mungon atë ditë, në fillim të aktivitetit ndahen pjesët e tyre të lodrës me pjesë, e pastaj edhe ato, ndonjëse janë të zbrazura, ngjiten në lodrën me pjesë që ajo të jetë e plotë, ndërsa në ndonjë rast tjetër edhe atyre u jepet mundësi ta vizatojnë veten në ato pjesë.



Diskutim

1. A ka dy persona që mes vete kanë vetëm ngjashmëri?
2. A ka dy persona që mes vete kanë vetëm dallime?
3. Si do të kishte bota nëse të gjithë jemi të njëjtë? E si do të ishte bota nëse të gjithë do të ishim të ndryshëm dhe nuk do të kishim asnjë ngjashmëri?
4. A janë gjithnjë të frikshme dallimet ose ka edhe diçka pozitive në ekzistimin tyre? Çka do të kishte qenë ajo?
5. Çka ishte më lehtë për ju: të gjeni ngjashmëri ose dallim mes ju dhe fëmijës në vizatim? Pse?
6. Si e shihni tani lodrën me pjesë e cila u formua në fund? Si do të dukej ajo nëse ndonjë pjesë do t'i mungonte?
7. Çka na mëson ajo?

Përfundim

Nuk ekzistojnë dy persona plotësisht të njëjtë, e as dy persona plotësisht të ndryshëm. Dallimet mes njerëzve e bëjnë botën më të pasur, më interesante, dhe ofrojnë mundësi për mësim, plotësim të ndërsjellë dhe zhvillim. Të gjithë njerëzit, me kombinimin e karakteristikave të pamjes së tyre të jashtme, aftësive, mendimeve, bindjeve, nevojave dhe interesave, e formojnë një fotografi të vetme dhe të papërsëritshme e cila është një pjesë e rëndësishme e fotografisë më të gjerë – shoqërisë njerëzore.

Aktiviteti përmbyllës

Lexohet përralla e fletës së punës për arsimtarin/arsimtare.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Deveja tha: “Nuk ka gjë më të mirë sesa të jesh e gjatë! Shih sa jam e gjatë!”

Kur i dëgjoi këta fjalë, lepuri tha: “Nuk ka gjë më të miri sesa të jesh i shkurtër! Shih sesa jam i shkurtër!”

Deveja tha: “Mirë pra, nëse nuk ia dal të dëshmoj se kam të drejtë, do të heq dorë nga shpina ime.”

Lepuri tha: “Nëse unë nuk mund të dëshmoj se kam të drejtë, do të heq dorë nga veshët e mi”.

“Pajtohem!”, tha deveja.

“Edhe unë!”, tha lepuri.

Pastaj arritën në një kopsht të rrethuar me një mur të shkurtër pa vrimë në të. Duke qëndruar në anën e jashtme të murit, deveja me qafën e saj të gjatë u lëshua dhe mori pak nga bimët e kopshtit dhe u ngop. Pastaj, me ironi u kthye kah lepuri, i cili qëndronte rreth murit dhe as nuk mund t’i shihte bukuritë e kopshtit, dhe i tha: “Tani a deshe më shumë të jesh i gjatë ose i shkurtër?”.

Megjithatë duke ecur arritën te një kopsht tjetër të rrethuar me mur të lartë me derë të vogël në njërin kënd. Lepuri hyri në derë dhe pasi u ngop duke ngrënë nga perimet e kopshtit dhe doli duke e përqeshur devenë e gjorë, e cila duhej të ngelë jashtë për shkak se ishte tepër e gjatë që të mund të kalojë nëpër atë derë. Lepuri tha: “Tani, a do të doje të jesh më shumë e gjatë apo e shkurtër?”.

Pasi menduan mirë, vendosën që deveja duhet ta ruajë shpinën e saj, ndërsa lepuri t’i ruajë veshët e tij, duke pranuar se:

ËSHTË MIRË TË JESH I GJATË KUR ËSHTË E NEVOJSHME, POR EDHE TË JESH I VOGËL ËSHTË MIRË SHKAK SE EDHE AJO MUND TË NEVOJITET.

Përrallë indiane

Punëtorja II-1.2: Ose sirtar ose kolltuk



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit II-1.2: Ndjekje pas autografeve

Aktiviteti hyrës

Secilit nxënës i jepet nga një fletë pune. Pastaj secili në atë fletë duhet të grumbullojë sa më shumë nënshkrime që mundet nga nxënësit e tjerë. Askush nuk ka të drejtë të nënshkruhet në fletën e njëjtë më shumë se njëherë, si dhe askush nuk ka të drejtë të nënshkruhet në fletën e vet. Po ashtu secili duhet të japë shpjegim të shkurtër ose të bëjë demonstrim për atë që nënshkruhet. Është shumë më me rëndësi të gjenden fëmijët e duhur për nënshkrim sesa të plotësohet tërë fleta. Kështu jepen 7-8 minuta për grumbullimin e nënshkrimeve.

Në fund bëhet një pasqyrim, duke shtruar pyetje se sa persona prej grupit janë nënshkruar në pyetje të caktuara. Për shembull: Sa prej jush dëshirojnë të këndojnë derisa bëjnë dush?

Në fund parashtrohen pyetjet vijuese:

1. A janë nënshkruar të gjithë në të gjitha pyetjet?
2. A vlejnë për të gjithë këto gjëra? Pse nuk vlejnë?

Aktiviteti kryesor

Aktiviteti realizohet në hapësirë të zbrazur (ose në hapësirë në të cilën gjithçka është tërhequr në një kënd). Arsimitarja i përcakton rregullat e komunikimit gjatë aktivitetit në mënyrën vijuese: “Le të paramendojmë se më nuk jeni njerëz, por vegla, prandaj nuk mund të flasim. Megjithatë ju nuk jeni vegla të thjeshta, por vegla speciale dhe mund të komunikoni mes vete në mënyrë joverbale – vetëm përmes lëvizjes së duarve dhe përmes grimasës së fytyrës”. Aktiviteti kryhet në disa faza dhe pas përfundimit të secilës fazë merren udhëzime për fazën vijuese:

Së pari secilit nxënës i jepet për detyrë të paramendojë në vete se në fakt është pjesë e mobileve të shtëpisë: “Kur do të ishe pjesë e mobilies që përdoret në shtëpi, çka do të dëshiroje të jesh?”

Si pikë e dytë, duke u lëvizur nëpër klasë dhe duke komunikuar vetëm në mënyrë joverbale, secili nxënës duhet t'i gjejë të gjithë të tjerët që kanë bërë zgjedhje të njëjtë (kanë zgjedhur të jenë pjesë e njëjtë e mobilies). Pjesët e njëjta të mobilies do duhet të grupohen ashtu që do të rrinë njëri pas tjetrit. Megjithatë mund të ndodh që ndonjë nxënës të ngelë vetëm për shkak se askush tjetër nuk e ka bërë zgjedhjen e njëjtë me të.

Si pikë e tretë – grupet e formuara në atë mënyrë nga pjesë të njëjta të mobilies, duke u lëvizur së bashku, pa mos u ndarë në asnjë moment, duhet të vendosen në hapësirë sipas asaj sesi radhiten zakonisht mobiliat në shtëpi. Për këtë arsye me siguri se duhet të komunikojnë në mënyrë joverbale edhe me grupet tjera. E njëjta vlen edhe për ato “pjesë të mobilies” që kanë ngelur vetë.

Në fund kur të gjitha grupet do të pozicionohen, anëtarët e tyre do të duhet të bisedojnë (në mënyrë verbale) mes vete në temën: “Pse zgjedha të jem ajo pjesë e mobilies?” dhe për arsyet se pse kanë vendosur ta bëjnë zgjedhjen e tillë dhe ato t'i prezantojnë para grupeve të tjera.



Diskutim

1. Në çka u bazuat në zgjedhjen e mobilies? Cilat karakteristika të mobilies së zgjedhur ju tërhoqën që të bëheni pikërisht ai lloj i mobilies?
2. A pajtoheni të gjithë rreth karakteristikave kryesore që ju shpjen në zgjedhjen konkrete? A kishte dikush për të cilin më të rëndësishme ishin disa karakteristika të tjera?

Përfundim !

Mes njerëzve ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime për sa i përket asaj që e konsiderojnë të rëndësishme dhe të vlefshme

Aktiviteti përmbyllës

Thojuni pjesëmarrësve që me kujdes le ta dëgjojnë përrallën për Mile Panikën dhe ta bëjnë tërë atë që e bën ai.

Derisa e lexoni përrallën, realizoni aktivitetet. Grupi duhet t'ju përcjellë.

Një mëngjes, Mile Paniku u ngrit nga krevati i tij dhe shikoi pranë dritares, duke bërë hije me duart e tij. Ai shikoi majtas pastaj shikoi djathtas. Pastaj shikoi drejt kah lumi dhe e pa një femër të bukur:

“Oooooo”

Mile Paniku i bëri shenjë vajzës me dorë të djathtë. Pastaj i bëri shenjë me dorë të majtë. Pastaj, e veshi kostumin për not, u nis drejt lumit dhe kaloi në skajin tjetër të lumit. Kur arriti në anën tjetër, Mileja e shkundi ujin nga turpi i tij, e përqafoi veten që të ngrohet dhe u ul.

Vajza e bukur i buzëqeshi dhe vazhdoi të ec kah Vendet e Largëta. Mile u nis pas saj dhe deri sot askush nuk e ka parë.

Edhe pse dëgjohen zëra se Mile Panika jeton pranë një lumi tjetër me tre Mile të vegjël – secili më i bukur se tjetri.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-1.3: Ushqim, veshje ose libra



Materialet:

- » pajisje për të shkruar
- » fletë pune për nxënësit II-1.3: Ndeshje me meteoritin
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Evakuim
- » tabelë dhe shumës (ose pajisje të duhur për shkrim)
- » një lëmsht leshi, gërshtë

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari ia jep lëmshtin ndonjë nxënësi tjetër i cili e zgjidh njërin skaj, e lidh një pjesë të perit me gishtin e tij, pastaj ia thotë emrin ndonjërit nga nxënësit tjerë, e thotë ndonjë ngjashmëri me atë të cilin e thërret dhe ia hedh lëmshtin atij. Nxënësi tjetër e merr lëmshtin, e lidh një pjesë të tij në gisht dhe pastaj në të njëjtën mënyrë sikur në rastin e parë, e thërret një nxënësi tjetër të cilit ia përcjellë lëmshtin dhe kështu vazhdojnë të gjithë derisa të gjithë ta thonë nga një ngjashmëri me ndonjë fëmijë tjetër. Kështu krijohet rrjet nga leshi me të cilin lidhen të gjithë nxënësit. Në fund lëmshti përfundon te nxënësi i njëjtë i cili e ka filluar lojën. Pastaj, arsimtari me gërshtë e pret rrjetin, ndërsa nxënësve u ngelin dy pjesë nga peri, nga një për secilën ngjashmëri që e lidh me dy nxënësi të tjerë.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit qëndrojnë në rreth. Arsimtari u thotë nxënësve ta paramendojnë situatën të cilën do t'ua lexojë sikurse ajo po ndodh tani. E lexon udhëzimin e parë të pajisjes së punës për arsimtarin/arsimtaren.

Secilit nxënësi i jepet nga një ekzemplar i fletës së punës me detyrë të dhënë të cilën duhet ta realizojnë në 3-4 minutat vijues.

Lexohet udhëzimi i dytë. Nxënësve u jepen 3 minuta të tjerë që t'i zgjedhin tre gjërat më të rëndësishme dhe t'i rrethojnë në fletë. Pastaj nxënësit ndahen në grupe më të vogla (me nga 4-5 persona). Lexohet udhëzimi i tretë. Grupet, të cilat duhet të prezantojnë familje, e kanë për detyrë që në 6-7 minutat vijues të zgjedhin gjithsej tre nga gjërat të cilat paraprakisht secili i ka vënë në listën e vetë. Secili nxënësi duhet të shënojë se për cilat tre gjëra ka vendosur "familja e tij".

Pas kalimit të kohës, nxënësit kthehen në rreth.

Nga një përfaqësues i grupeve i prezanton zgjedhjet që i kanë bërë "familjet". Arsimtari i shënon ato në tabelë. Çdo përsëritje e shënon veçmas.



Diskutim

1. Si vendosët në fillim se cilat gjashtë gjëra do t'i merrnit me vete? Sipas cilave kritere e morët vendimin?
2. Si ndjeheshit kur duhej ta ngushtoni zgjedhjen në vetëm tre gjëra? Si e bëtë zgjedhjen?
3. Kur u takua "familja" a kishte më tepër ngjashmëri apo më tepër dallime në zgjedhjet personale të anëtarëve të "familjes"? Si do ta shpjegoni këtë?
4. Si rrodhi procesi i marrëveshjes në "familje"? A orvateshit ta impononi zgjedhjen tuaj? Pse?

Përfundim

Njerëzit kanë prioritete të ndryshme në jetë. Madje edhe anëtarë e familjes së njëjtë zhvillojnë nevoja të ndryshme. Nganjëherë është shumë vështirë të përcaktohen prioritetet, njësoj si që është vështirë të ndahen nevojat nga dëshirat. Ajo për të cilën ndonjëherë themi se është nevojë, në fakt është dëshirë. Nevojat janë diçka që duhet të përmbushen që të mund të jetojmë pa pengesa, ndërsa dëshirat më së shpeshti janë vetëm mjete për të cilat mendojmë se më së miri do t'i përmbushnim nevojat. Najdobro bi gi zadovolile potrebite.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Udhëzimi 1.:

Kthehesh në shtëpi i/e lodhur nga blerja e dhuratave për vitin e ri 2120. E kyç holobimin pikërisht në momentin kur programi ndërpritet për shkak të lajmeve të jashtëzakonshme. Spikeri i frikësuar e përcjell lajmin se për diçka më pak se gjysmë orë në Tokë pritet goditje e tmerrshme e një meteoriti të madh. Meteoriti është aq i madh sa që mund të shkatërrojë gjithçka në Tokë. Për fat të mirë, ky është viti 2120, andaj njerëzit pa problem mund ta braktisin Tokën. Spikeri tregon se tashmë është organizuar evakuimi i popullatës në planetin tjetër të pabanuar dhe secili udhëtar mund të marrë me vete nga gjashtë gjëra.

Udhëzimi 2.:

Zëri i holobimit paraqitet përsëri. Këtë herë thotë: “Kërkojmë shumë ndjesë nga banorët e Tokës, por u vërtetua se nuk ka mjaft anije kozmike për evakuim. Prandaj, në vend se të merrni gjashtë sende, secili mund të marrë vetëm nga tre gjëra”. Në tre minutat e ardhshëm secili do të duhet të vendosë se cilave tre gjëra do t’ju japë përparësi.

Udhëzimi 3.:

Holobimi paraqitet përsëri. Zëri panik i spikerit kumton se tashmë anijet e ngarkuara nuk mund të fluturojnë për shkak të ngarkesës së tepërt. Prandaj është marrë vendim që zgjedhjen e gjërave që do të dërgohen në anije do ta bëjnë familjet, ashtu që secilës familje i lejohet të sjell gjithsej tre gjëra. Familjeve u jepet afat prej 5 min. Të merren vesh se cilat tre gjëra do t’i mbajnë.

Punëtorja II-1.4: E rëndësishme, më e rëndësishme



Materialët:

- » pajisje për të shkruar
- » fletë pune për nxënësit II-1.4: Gjëja e rëndësishme në fotografi

Aktiviteti hyrës

Nxënësit rrinë ulur në rreth. Secilit nxënës i jepet nga një ekzemplar prej fletës së punës dhe kërkohet që ai ta shikojë fotografinë me kujdes, t'i ndajë tre gjëra të cilat i duken të rëndësishme dhe t'i shënojë në vijat nën të.

Kur secili do të mbarojë me listën e tre gjërave të rëndësishme, jepet udhëzimi vijues: "Shkallëzoni tre gjërat në mënyrë që do t'i shënoni me njësh (1) gjërat që i konsideroni më të rëndësishme, ndërsa me tresh (3) gjërat që i konsideroni më pak të rëndësishme".

Pastaj nxënësit ndahen në grupe me nga 4-6 persona. Në kuadër të grupeve secili nxënës i prezanton gjërat të cilat i ka zgjedhur nga më e rëndësishme deri te më pak e rëndësishmja. Grupi bashkërisht konstaton se a ka më tepër ngjashmëri ose më tepër dallime në zgjedhjet e bëra.

Secili grup i prezanton para grupeve të tjera konstatimet e arritura.



Diskutim

1. A kishte dallime në gjërat që u ndanë si të rëndësishme? A kishte dallime në atë që konsiderohej si më e rëndësishme?
2. A mund të thuhet se të gjithë njerëzit të cilët e vështrojnë një situatë të njëjtë, gjërat e njëjta do t'u lënë përshtypje të njëjtë?
3. Zakonisht çka mbajmë mend nga ajo që e kemi parë: ajo që na është dukur më e rëndësishme ose ajo që na është dukur më pak e rëndësishme?
4. Si zgjodhët se çka do të jetë e rëndësishme për ju? Prej çka varet se çka do të na duket e rëndësishme (dhe më e rëndësishme)?

Përfundim

Njerëz të ndryshëm shikojnë gjëra të ndryshme dhe gjërat e ndryshme i konsiderojnë si të rëndësishme. Gjërat e rëndësishme janë ato që mbahen mend edhe më tej.

Çka do të jetë e rëndësishme për ndokënd varet nga interesat të cilat i ka zhvilluar ai.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimitarja tregon se në shpatullën e saj të majtë e ka një shpend të padukshëm. Të gjithë duhet të paramendojnë sesi duket ai. Pastaj arsimtarja dalëngadalë e merr shpendin, e përkëdhel dhe ia jep nxënësit afër saj. Ai e merr shpendin, mund ta përkëdhelë, të thotë diçka ose të luajë për një çast me të dhe pas 4-5 sekondash ia jep shpendin nxënësit tjetër. Secili në mënyrë të ndryshme e merr dhe e trajton shpendin. Kështu në rreth të gjithë e marrin dhe e bartin shpendin më tej. Në fund, kur të arrijë shpendi deri te arsimtarja, ajo e lëshon të fluturojë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-1.5: Mundem, nuk mundem/di, nuk di



Materiallet:

- » copë të vogla të letrës
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti kryesor

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në njërin skaj të klasës. Aktivitetin e fillon një fëmijë. Ai qëndron në këndin tjetër të klasës dhe bën “unazë” (një rreth me gishtin e madh dhe gishtin tregues) me njërin dorë dhe thotë: “Nga kjo anë mund/di të..” (tregon diçka për të cilën ka aftësi dhe dituri), pastaj e bën një “unazë” edhe afër dorës tjetër, por tani thotë: “Nga kjo anë nuk mund/nuk di të..”. Në secilën prej unazave të bërë atij i bashkëngjitet nga një fëmijë i grupit duke bërë “unazë” dhe duke e ngjitur me unazën e bërë, me çka krijojnë zinxhirë, por në anën në të cilën fëmija nuk ka thënë se nuk mund të bëjë ose nuk di diçka ndalet një fëmijë i cili mund ta bëjë ose e di atë, ndërsa nga ana në të cilën fëmija ka thënë se mund ta bëjë ose e di, ndalet një fëmijë që nuk mund ta bëjë atë ose nuk di, por dëshiron të mund ose të dijë.

Në këtë mënyrë radhiten të gjithë fëmijët deri sa të gjithë t’i bashkohen zinxhirit. Nëse ndonjë fëmijë thotë se diçka mund ose nuk mund të bëjë, por nuk ka asnjë fëmijë që do t’i bashkëngjitej atij në ndonjërin anë, atëherë fëmija i parë do të duhet të paramendojë diçka tjetër që do të mundësojë ndërlidhje.

Nëse ka më shumë fëmijë të cilët dëshirojnë që në të njëjtin moment të ndërlidhen me zinxhirin, atëherë thuhet se askush nuk do të ngelë jashtë zinxhirit, ashtu që edhe nëse askush nuk është bashkuar në këtë rast, sigurisht se do të ketë rast tjetër kur do ta bëjë atë.



Diskutim

1. A di dhe a mundet secili të bëjë gjithçka vetë? Si do të jetonin njerëzit kur secili do të mund të bënte gjithçka vetë?
2. A kanë të gjithë njerëzit aftësi dhe dituri të njëjta ose të ndryshme?
3. Si do të dëshironi të sillej dikush ndaj jush lidhur me atë që nuk e dini ose nuk mund ta bëni?
4. Çka mundëson dallimi ndërmjet aftësive të njerëzve?

Përfundim

Asnjë njeri nuk mund të bëjë gjithçka vetë, e as nuk e ka tërë diturinë me vete. Njerëzit dallohen mes vete për sa u përket aftësive dhe diturive të tyre – dikush mund të bëjë diçka, por nuk mund të bëjë diçka tjetër; dikush di diçka, por nuk di diçka tjetër. Dallimi, për sa u përket aftësive mes njerëzve, ofron mundësi që ata mes vete të ndihmohen dhe në atë mënyrë ta përmirësojnë jetesën e tyre personale dhe raportin ndaj njerëzve tjerë, në vend se të diskriminohen për shkak të aftësive ose diturive të ndryshme.

Aktiviteti përmbyllës

Secilit fëmijë i jepen nga dy fletë të vogla në të cilat ai e shënon nga një gjë të cilën e di mirë nëse ka prirje për të. Pas shenjës së dhënë të gjithë fëmijët qëndrojnë në hapësirë të madhe të zbrazët ku fillojnë të lëvizin duke i mbajtur letrat në dorë. Qëllimi është t’i shkëmbejnë letrat me fëmijët tjerë dhe t’i gjejnë dy fëmijë të tjerë me të cilët do të mund të shkëmbejnë nga një letër – ata të kenë shkruar diçka që i nevojitet fëmijës tjetër, si dhe fëmija tjetër të ketë të shënuar diçka që i nevojitet atij. Aktiviteti përfundon kur secili fëmijë pranë vetes do të ketë nga dy fletë të cilat dallojnë nga fletët fillestare të cilat i ka shkruar ai vetë, e të cilat ai i ka marrë përmes shkëmbimit me dy fëmijë të tjerë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja II-2: FORMIMI, MIRËMBAJTJA DHE NDËRPRERJA E LIDHJEVE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë parakushtet për mbajte të shoqërisë dhe miqësisë (besim, bashkëpunim, përkrahje, transparencë, respekt...) » ta dijë dallimin në mes miqësisë me njerëz dhe miqësisë me kafshë
Shkathtësi	» të mund t'u japë shokëve mbështetje pozitive
Qëndrime/ vlera	» të vërejë se pa mbështetje të përbashkët, pa bashkëpunim, pa besim dhe pa respekt nuk ka shoqëri dhe miqësi

Punëtorja II-2.1: Lulja e miqësisë



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit II-2.1a: Lulja e miqësisë
- » fletë punë për nxënësit II-2.1b: Kultivimi i miqësisë

Aktiviteti hyrës

Të gjithë janë të ulur në rreth. Aty ka një karrige të zbrazët. Personi, në krahun e djathtë të të cilit ndodhet karrigia e zbrazët, e fton që në këtë mënyrë të ulet edhe dikush tjetër në të: “E ftoj (emri i ndonjë nxënësi) të ulet afër meje për shkak se ...” Në vazhdim të fjalisë secili tregon diçka pozitive për personin që e fton, ndonjë vepër të mirë që e ka bërë ose ndonjë karakteristikë të tij pozitive. Pasi që personi i ftuar do të ulet në karrigen e zbrazur, afër saj vendoset një karrige tjetër e zbrazur. Personi në krahun e djathtë të të cilit ndodhet karrigia e zbrazët, e fton ndokënd tjetër të ulet në të njësoj sikur pararendësi i tij. Kështu vazhdohet derisa të gjithë të ftohen të ulen pranë njëri-tjetrit. Personi që është ftuar njëherë, nuk mund të ftohet përsëri nga dikush tjetër.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në pesë grupe të ndryshme. Arsimtari i pyet nxënësit se a e dinë se çka i nevojitet ndonjë luleje që të rritet. Nxënësit përgjigjen, ndërsa arsimtari vetëm i përsërit në shenjë të miratimit dhe pyet se nëse ka përgjigje të tjera. Pastaj secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës “Lulja e miqësisë”, duke shpjeguar se kësaj luleje të veçantë i nevojiten gjëra të tjera që të rritet. Ato gjëra janë të shënuara në fletët e lules. Pastaj bashkërisht lexohet se cilat janë ato gjëra. E pas secilit grup i jepet nga një situatë nga fleta e punës “Kultivimi i miqësisë”. (Detyrë shtëpie – BESIM, A t’i them? - TRANSPARENÇË, Bojani i ofenduar – RESPEKT, Ndihmë përmes telefonit – PËRKRAHJE, Pëllumbi dhe thnegla – BASHKËPUNIM). Secili grup e lexon situatën e tij dhe në të duhet ta zbulojë se për cilin gjë të “Lulja e miqësisë” bëhet fjalë në situatën e tyre dhe të tregojnë se pse mendojnë ashtu. Kur të mbarojnë me punën në grupe të vogla, secili grup një nga një në fillim e lexon situatën që ta dëgjojnë edhe të tjerët, ndërsa pastaj tregon se për çka bëhet fjalë dhe pse.



Diskutim

1. Çka mendoni si ndikon besimi në miqësi? Pse besimi është i rëndësishëm për miqësinë? Çka ndodh nëse nuk ka besim?
2. Çka mendoni si ndikon transparenca në miqësi? Pse është me rëndësi të jeni transparent, të hapur? Çka ndodhë nëse njerëzit nuk janë transparent, të hapur?
3. Çka mendoni si ndikon respekti ndaj miqësisë? Pse respekti është i rëndësishëm për miqësinë? Çka do të ndodhte nëse nuk ka respekt?
4. Çka mendoni si ndikon bashkëpunimi në miqësi? Pse është me rëndësi të kihet bashkëpunim? Çka do të ndodhë nëse nuk ka bashkëpunim?
5. Çka mendoni si ndikon përkrahja në miqësi? Pse është e rëndësishme përkrahja për miqësinë? Çka do të ndodhë nëse nuk ka përkrahje? Si mund të japim përkrahje?

Përfundim

Besimi, transparenca, respekti, bashkëpunimi dhe përkrahja janë shumë të rëndësishëm për miqësinë për shkak se mundësojnë që ashtu të ndërtohet miqësi, por edhe të mirëmbahet dhe të përforcohet miqësia. Nëse nuk ka besim, transparencë, respekt, bashkëpunim dhe përkrahje, kështu mund të dobësohet miqësia madje edhe të ndërpritet ajo.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në çifte. Njëri nga çifti është udhëheqës, ndërsa tjetri e ndjek atë. Ai që e ndjek duhet t’i mbyllë sytë, ndërsa udhëheqësi e mban për dore/krahu atë dhe duhet ta shëtisë rreth klasës, por njëkohësisht duhet të kujdeset të jetë i sigurt që të mos lëndohet ndokund. Pastaj çiftet i ndërrojnë rolet. Në fund mund të parashtrohen pyetjet vijuese:



Diskutim

1. Si ndjeheshit në lojë?
2. A u frikësuat se mund të lëndoheni?
3. A kishit besim në shokun/shoqen tuaj?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja II-3: RUAJTJA E SEKRETIT

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se cilat sekrete janë të mira dhe duhet të ruhen » ta dijë cilat sekrete janë “të këqija” dhe që mund t’i bëjnë dëm atij/asaj dhe/ose të tjerëve
Shkathtësi	» të mund të bëjë dallim ndërmjet sekretit të mirë dhe atij të keq
Qëndrime/vlera	» të vërejë se ruajtja e sekretit e përforcon shoqërinë (dhe miqësinë), ndërsa mosruajtja e sekretit e prish atë

Punëtorja II-3.1: Ruajtja e sekretit



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit II-3.1: Sekrete të mira dhe të këqija

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çifte në mënyrë që secili e zgjedh çiftin e tij dhe pastaj e marrin për detyrë të ndajnë ndonjë informacioni i cili do të jetë sekret i tyre. Ata do të duhet ta ruajnë sekretin e tyre dhe të mos ia tregojnë atë askujt tjetër. Për shembull, mund të tregojnë diçka që u ka ndodhur, diçka për shkak të së cilës janë turpëruar, për ndonjë rast kur prindërit i kanë qortuar, kush është simpatia e tyre ose diçka tjetër që askush tjetër nuk e di.

Aktiviteti kryesor

Nxënësve në çifte u jepet një kopje e fletës së punës: “Sekrete të mira, sekrete të këqija”. Ata i lexojnë me kujdes situatat e prezantuara dhe bashkërisht duhet të vendosin se çfarë lloji të sekretit paraqet informacioni i treguar: a është sekret i mirë ose i keq. Pastaj arsimtari i lexon me zë situatat një nga një, ndërsa nxënësit për secilën përgjigjen se a është sekret i mirë ose është i keq. Për secilën situatë ndaras arsimtari kërkon elaborim, pse dikush mendon se është sekret i mirë, gjegjësisht pse dikush mendon se është sekret i keq (nëse ka raste të tilla).



Diskutim

1. Kur një sekret është i mirë?
2. Kur është sekret i keq?
3. Çka ndodh nëse nuk e ruajmë sekretin, nëse atë ia tregojmë të tjerëve?
4. E çka ndodh nëse e ruajmë atë?

Përfundim

Kur sekreti ka të bëjë me ndonjë befasi të këndshme që duhet t’i gëzojë të tjerët, atëherë ai është sekret i mirë dhe duhet të ruhet. Po ashtu, edhe kur sekreti ka të bëjë me diçka personale për ndonjë person, ndërsa nuk ka pasoja për njerëzit tjerë, edhe ky sekret duhet të ruhet. Kur ruajtja e ndonjë sekretit mund të ketë pasoja të këqija ndaj nesh ose ndaj të tjerëve, atëherë bëhet fjalë për “sekret” të keq. Sekret i tillë nuk duhet ruajtur.

Nëse e tradhetojmë ndonjë sekret, e rrezikojmë prishjen e miqësisë me ndokënd (me atë që e kemi tradhtuar). Ruajtja e sekreteve do ta përforcojë miqësinë dhe besimin.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit qëndrojnë të grupuar në hapësirë më të madhe (që të mund të lëvizin). Kërkoni nga nxënësit t’i paramendojnë dy zogj. Njëri që quhet “VËRRR”, ndërsa tjetri “SULUMU”.

Gjithnjë kur të thoni “Vërrr” të gjithë nxënësit do të duhet të lëvizin me majat e gishtave të këmbës dhe gjatë kësaj me bërryla të bëjnë sikur zogj me krahë, ndërsa gjithnjë kur të thoni “Sulumu” të gjithë do të duhet të ndalen dhe të qëndrojnë të qetë. Përsëritni komandat njëra pas tjetrës përderisa loja është zbavitëse.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajta II-4: TREGIMI I GËNJESHTRAVE/TË VËRTETAVE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë arsyet pse njerëzit gënjejnë » t'i dijë pasojat negative të gënjeshtres
Shkathtësi	» të mund të përmbahet nga thënia e të vërtetës kur ajo e lëndon tjetrin
Qëndrime/vlera	» të vërejë se thënia e gënjeshtreve mund të jetë e dëmshme edhe për të edhe për të tjerët » të vërejë se gënjeshttra e cenon besimin

Punëtorja II-4.1: Pse gënjejme?



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit II-4.1: Disa gënjeshttra

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çifte. Kështu secili e ka për detyrë që tre herë t'i thotë për veten nga dy gjëra – njëra të jetë e vërtetë, ndërsa tjetra të jetë gënjeshtër. Njëri anëtar në fillim i thotë dy gjëra për veten, e tjetri e qëllon, e pastaj i ndërrojnë rolet. Pastaj përsëri anëtar i parë thotë diçka, ndërsa tjetri e përsërit, ndërrohen rolet dhe në fund e bëjnë edhe një raund të tillë. Në herën e parë nxënësit tregojnë se çka kanë bërë (e thonë një të vërtetë dhe një gënjeshtër). Në herën e dytë tregohet një vend ku kanë qenë (një të vërtetë dhe një gënjeshtër), ndërsa në herën e tretë tregojnë diçka që u ka ndodhur (një të vërtetë dhe një gënjeshtër).

Në fund mund të pyetet grupi që të tregojnë sesa ka qenë lehtë ose vështirë të zbulojnë se çka është e vërtetë e çka është gënjeshtër.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në katër grupe. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës: “Disa gënjeshttra” duke ua bërë me dije që t'i lexojnë situatat dhe pastaj të përgjigjen në pyetjen e parashtruar duke e rrethuar një përgjigje të dhënë.

Pastaj secila situatë lexohet para tërë grupit, ndërsa nxënësit tregojnë se cilën përgjigje e kanë rrethuar. Kërkohet që nxënësit të shpjegojnë se pse mendojnë ashtu.



Diskutim

1. Për çfarë arsye njerëzit gënjejnë?
2. Çka fitohet përmes gënjeshtres? Çka humbet, cilat mund të jenë pasojat? Kush mund t'i durojë pasojat e thënies së gënjeshtreve?
3. A ka situata në të cilat më së miri është të mos thuhet e vërteta? Kur?

Përfundim

Njerëzit mund të gënjejnë për arsye të ndryshme. Mund të gënjejnë që t'i ikin dënimit (dëmtimit), që të tjerët të kenë mendim të mirë për ta (të mos mendojnë asgjë të keqe për ta), ndonjëherë gënjejnë që të përfitojnë ndonjë dobi (të fitojnë diçka), por ndonjëherë gënjejnë që ta mbrojnë ndokënd (kur e vërteta është e dhimbshme).

Përmes gënjeshtreve mund të përfitohet ndonjë gjë (diçka materiale), të fitojnë ndonjë mbështetje ose miqësi, por gjithashtu mund të humbin shumë gjëra, siç janë: miqësia e besimi, por edhe mund të dënohen.

Gënjeshttrat mund të jenë të dëmshme për atë që i tregon, nëse e zbulojnë, por edhe për ata që gënjehen (mund të humbin diçka).

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në mes të hapësirës së klasës. Arsimitari jep udhëzime të prekin diçka që gjendet në klasë, p.sh.: murin, bankën, dërrasën, lapsin, çantën, dritaren, derën, pantallonat, dorën, flokët, kokën etj.. Detyrë e secili nxënës është që sa më shpejtë ta prekë atë që e thotë arsimtari.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja II-5: DHËNIA DHE PRANIMI I NDIHMËS

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të dijë se çka mund të ndihmojë në shtëpi dhe në shkollë » të dijë nga kush mund dhe duhet të presë ndihmë (në shtëpi dhe në shkollë) » të dijë se me cilat vështirësi ballafaqohen njerëzit me nevoja të veçanta (vështirësi të cilat burojnë nga handikapi)
Shkathtësi	» të mund të vlerësojë se dikush ka nevojë për ndihmë » të mund të ndihmojë kur dikush ka nevojë për ndihmë » të mund të jetë mirënjohës ndaj ndihmës së ofruar » të mund të identifikojë se për çfarë ndihme kanë nevojë njerëzit me nevoja të veçanta
Qëndrime/vlera	» të vlerësojë se ndihma është qasje reciproke – ajo merret dhe ofrohet » të pranojë se handikapi nuk është pengesë për krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të ndërsjella mes njerëzve

Punëtorja II-5.1: Ndhmo këtë, ndihmo aty



Materialet:

- » pajisje për të shkruar
- » fletë pune për nxënësit II-5.1a: Ndhmë në shtëpi
- » fletë pune për nxënësit II-5.1b: Ndhmë në shkollë
- » tabelë dhe shkmës (ose pajisje përkatëse për shkrim)

Aktiviteti hyrës

Një çantë mbushet me shumë libra dhe pastaj zgjidhet një vullnetar që do ta bartë çantën nga njëri kënd në këndin tjetër të kasës. Në fillim mund ta bëjë vetë atë, e pastaj të kërkojë nga ndonjë nxënës tjetër që ta kthejë çantën në vendin e mëparshëm.

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësit ndahen në grupe me nga 4-6 anëtarë. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës “Ndhma në shtëpi”. Grupeve u jepet për detyrë ta plotësojnë fletën e punës, ashtu që do të përmendin më shumë mënyra të mundshme sesi u ndihmojnë anëtarëve të familjes, si dhe sa më shumë mënyra sesi anëtarët e tjerë të familjes u ndihmojnë atyre. Atyre u jepet kohë prej rreth 7-8 minutave për punimin e detyrave.

Secili grup i prezanton përgjigjet, ndërsa arsimtari i shënon ato (në formë të shkurtër) në tabelë, në dy kolona me titull “Në shtëpi ndihmoj” dhe “Në shtëpi më ndihmojnë”



Diskutim 1

1. Kujt i ndihmojmë në shtëpi? Si?
2. Kush na ndihmon në shtëpi? Prej kujt mund të presim ndihmë?
3. A e zbuluat ndonjë mënyrë të re të ndihmës që nuk e keni përdor deri më tani?

Përfundim !

Në shtëpi mund t'i ndihmojmë secilit në njëfarë mënyre, siç mund të na ndihmojnë edhe ata neve. Prindërve mund t'u ndihmojmë ashtu që do të shkojmë deri në shitore të blejmë diçka derisa ata e përgatisin ushqimin; vëllait/motrës të/së vogël mund t'ia lëshojmë një film të vizatuar në dvd/kompjuter/televizor; gjyshit/gjyshes mund t'i lexojmë diçka nëse ata nuk mund ta lexojnë etj. Prindërit mund të na ndihmojnë ashtu që na zgjojnë në kohë që të mos vonohemi për të shkuar ndokund; motra/vëllai më e/i vogël mund të na ndihmojë ta gjejmë ndonjë gjë të humbur etj..

Aktiviteti kryesor 2

Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës “Ndhmë në shkollë”. Procedura e plotësimit të fletës së punës është identike me atë të aktivitetit paraprak, me një dallim të vogël se tani kërkohet të shënohen sa më shumë mënyra sipas së cilave u ndihmojmë nxënësve tjerë në shkollë. Edhe për këtë detyrë kohëzgjatja është rreth 7-8 minuta.

Secili grup i prezanton përgjigjet, ndërsa arsimtari i shënon ato (në formë të shkurtër) në tabelë në dy kolona me titull “Në shtëpi ndihmoj” dhe “Në shtëpi më ndihmojnë”



Diskutim 2

1. Kujt i ndihmojmë në shtëpi? Si?
2. Kush na ndihmon në shtëpi? Prej kujt mund të presim ndihmë?
3. A e zbuluat ndonjë mënyrë të re të ndihmës që nuk e keni përdor deri më tani?
4. Pse duhet ndihmuar?
5. A ka gjëra për të cilat nuk duhet ndihmuar, madje edhe nëse dikush e kërkon atë?
6. Si jemi ndjerë kur na ndihmon dikush? Si jemi ndjerë kur i kemi ndihmuar ndokujt?

Përfundim

Në shkollë mund t'u ndihmojmë shokëve/shoqeve, ndërsa ata të na ndihmojnë në mënyra të ndryshme: duke na huazuar pajisje shkollore, duke e ndarë me ne ushqimin, duke na ndihmuar në zgjidhjen e detyrave etj. Të rriturve në shkollë mund t'u ndihmohet në rast se bartet ndonjë material nga një klasë në klasë tjetër etj.

Mirë është të ndihmohet në rast se ndihma nuk ka pasoja për ne, ndërsa është e vlefshme për ata që u ndihmojmë, na mundëson të ndjehemi këndshëm dhe të respektuar.

Nuk duhet ndihmuar nëse me anë të ndihmës i bëjmë dëm vetvetes ose atij të cilit i ndihmojmë.

Kur na ndihmojnë të tjerët, ne ndjehemi të kënaqur dhe të respektuar. Ashtu ndjehemi edhe kur ne u ndihmojmë të tjerëve.

Aktiviteti përfundimtar

Nxënësit ndahen në çifte. Pastaj qëndrojnë përballë njëri-tjetrit dhe kapen me duar mes vete duke u mbajtur për bërryli. Pastaj ashtu të kapur me duar duhet të ulen së bashku dhe pas disa sekondave ngrihen përsëri së bashku, pa i liruar duart.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-5.2: Luani dhe miu



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Përralla për miun dhe luanin
- » fletë pune për nxënësit II-5.2a: Luani
- » fletë pune për nxënësit II-5.2b: Miu
- » pjata të letrës, fllomasterë ose ngjyra, ngjitëse
- » lesh, gërshërë

Aktivitet hyrës

Nxënësit qëndrojnë në rreth. Secili e paramendon nga një kafshë. Pas shenjës së dhënë të gjithë njëkohësisht prodhojnë tinguj karakteristikë për kafshën të cilën e kanë paramenduar, pastaj duhet të bëjnë një hap kah brendësia e rrethit, duke e imituar me duar kafshën e paramenduar.

Aktiviteti kryesor 1

Arsimtarja e lexon përrallën nga fleta e punës. Pastaj në pika të shkurtra bashkërisht shpjegohet përralla pas së cilës zhvillohet një diskutim me të gjithë.



Diskutim 1

1. Kush i ka ndihmuar dikujt në përrallë?
2. A do t'i ndihmonte miu luanit, nëse paraprakisht luani nuk do t'i ndihmonte miut?
3. A ka dikush që aspak nuk ka nevojë për ndihmë?
4. A tregojnë njerëzit gjithnjë kur kanë nevojë për ndihmë?
5. Si e kuptojmë që dikush ka nevojë për ndihmë?
6. Çka mund të bëjmë nëse dikush ka nevojë për ndihmë?
7. Çka mund të bëjmë kur dikush na ka ndihmuar për diçka? Çka kanë bërë luani dhe miu?

Përfundim

Ku u ndihmojmë të tjerëve, është shumë e mundur që edhe të tjerët do të na ndihmojnë kur ne të kemi nevojë për ndihmë. Sa do që të jetë dikush i fuqishëm, është shumë e mundur që edhe të tjerët të na ndihmojnë atëherë kur të kemi nevojë për ndihmë. Sa do që të jetë i fuqishëm dikush, ekzistojnë situata në të cilat asgjë nuk mund të bëhet dhe pa ndihmë nga dikush tjetër; mund të pësojmë ose mund të na ndodhë diçka. Njerëzit nuk tregojnë gjithnjë se kanë nevojë për ndihmë, andaj që t'u ndihmohet në fillim duhet "të shihet" se kanë nevojë për ndihmë. Kur e vërejmë se dikush nuk mund të bëjë asgjë, të arrijë, të mbrohet nga diçka etj., e kuptojmë se ai ka nevojë për ndihmë. Kur dikush ka nevojë për ndihmë, është mirë t'i ndihmohet. Nëse dikush na ka ndihmuar për diçka, duhet t'i falënderohemi në shenjë mirënjohjeje.

Aktiviteti kryesor 2

Arsimtarja i pyet fëmijët se cilën figurë dëshirojnë ta përpunojnë (luanin ose miun) dhe në bazë të kësaj i ndan në katër grupe. Dy grupe do ta bëjnë luanin, ndërsa dy grupet e tjera miun. Secilit grup i jepen udhëzime për atë sesi t'i bëhen figurat

Përpunimi i luanit

Arsimtarja u jep udhëzime fëmijëve që nga fleta e punës ta presin figurën dhe rrethet për veshët. Rrethet palosen në pjesën e poshtme dhe në këtë mënyrë veshët ngjiten në pjesën e sipërme të pjatës. Figura e prerë gjithashtu ngjitet në pjatë dhe ngjyrosset. Në fund xhufka e qimeve vizatohet me ngjyrë kafe.

Përpunimi i miut

Fëmijët e presin përgjysmë fletën A4 të palosur në gjatësinë e vijës së vizatuar sikur në fotografinë 1 të kësaj flete të punës. Këndet e kthyer në pjesën e epërme të fletës i ngjisin me ngjitëse, ashtu që këndi i drejtë në të djathtë (foto 2) ngel pa u ngjitur, andaj fëmijët mund ta fusin gishtin tregues në të.

Pastaj i presin dy rrathe të vegjël të letrës të cilët i paraqesin veshët dhe i ngjisin si në fotografinë 3. Në fund ngjitet edhe bishti (një copë leshi) dhe vizatohen sytë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Përrallë për luanin dhe miun

Në një pyll të largët jetonte një luan. Ai ishte i njohur për shkak se kishte zemër të mirë dhe shpesh herë u ndihmonte kafshëve të tjera të pyllit. Një ditë, derisa luani shëtiste nëpër pyll, e vërejti një mi që ishte ngatërruar ndërmjet dy degëve dhe assesi nuk mund të lirohej. Luani e ngriti njëren degë dhe miu u lirua. “Nuk më besohet”, tha miu, “më shpëtoi një mace dhe tani do të më gëlltitë”. “Ha ha ha”, qeshi luani. “Edhe po që se do të haja, asgjë nuk do të dalloja, ti je aq i vogël”. “E po atëherë pse me lirove?”, e pyeti miu. “Ti je banor i këtij pylli siç jam edhe unë”, u përgjigj luani dhe shtoi: “Thash, ja një rast që të jesh i mirë, një rast i mirë t’i ndihmosh ndokujt që është në telashe”. Kur e dëgjoji këtë miu, u ndal para tij dhe i tha: “Të betohen, o luan i madh. Të kam borxh, por mbaje mend se një ditë do ta kthej borxhin”. Atëherë luani filloi të buzëqeshë: “Ore mi, çka do të mund t’i të bësh për mua?” Unë jam mbreti i kafshëve, shih sesa jam më i madh e më i fuqishëm se ti. Si do të mund ti kaq i vogël të më ndihmosh mua për ndonjë gjë?”. “Do të shihemi përsëri”, tha miu dhe u zhduk nën gjetjet e rëna dhe bari.

Pas një kohe derisa luani shëtiste nëpër pyll erdhën gjahtarët, e zunë dhe e lidhën me litar për një dru. Gjahtarët shkuan ta sjellin kamionin që ta fusin luanin në të dhe ta dërgojnë në kopshtin zoologjik. Për fat, aty pari kaloi miu dhe filloi ta kafshojë me dhëmbë litarin. Në këtë mënyrë miu arriti ta lirojë luanin. Në fund luani u kthye dhe i tha miut: “Unë mendova se ti asnjëherë nuk do të mund të më ndihmosh, por ja tani e shoh se edhe një mi i vogël ndonjëherë mund të ofrojë ndihmë të madhe”. Miu filloi të qeshë nga gëzimi. Luani u ndal pra tij dhe i tha: “Të betohem, o mi i madh, se këtë që e bëre për mua kurrë nuk kam për ta harruar. Kudo që të shkoj do të flas për namin tënd, madje do t’u tregoj edhe nxënësve të shkollës”.

Punëtorja II-5.3: Fëmijë me nevoja të veçanta

Shënim:

Fëmijët me nevoja të veçanta kanë të drejtë për përfitime të veçanta, për kushte në të cilat mund të kenë jetë dinjitoze dhe të frytshme, si dhe mundësi për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore. Një aspekt i veçantë nga Konventa mbi të drejtat e fëmijës, në pjesën për fëmijët me të nevoja të posaçme, paraqet nevoja për inkluzion (integrim, prani dhe pjesëmarrje) të fëmijëve me të nevoja të veçanta në strukturat dhe institucionet e jetës së përditshme (mundësia që të jenë së bashku me fëmijët tjerë, të mund të arrijnë në secilën pjesë të vendbanimeve, të marrin pjesë në evenimentet kulturore dhe sportive, të trajtohen si qytetarë të barabartë dhe të dobishëm). Cilado formë e izolimit është e padëshirueshme dhe ajo duhet të paraqesë vetëm masë për rastet e jashtëzakonshme. Është me rëndësi që te fëmijët të zhvillohet ndjenja e pranimit si të barabartë, e jo ndjenja e keqardhjes. Sikur fëmijët, edhe njerëzit tjerë me ndonjë pengesë në zhvillim mund të na pëlqejnë ose të mos na pëlqejnë për shkak të disa cilësive, vetive dhe karakteristikave të tyre, të cilat nuk kanë të bëjnë me handikapi të tre. Ata kanë nevojë për përkujdesje të posaçme që të mund t'i realizojnë të gjitha potencialet e tyre dhe të mund të lëvizin dhe të marrin pjesë në jetën e përbashkët. Fëmijëve duhet t'u bëhet me dije një mënyrë e re e shikimit të personave me nevoja të veçanta. Fëmijët duhet të mësohen që edhe në këtë aspekt t'i respektojnë dallimet, të mësojnë nga njerëzit e tjerë në vend që t'u vijë keq ose t'u shmangen. Për këtë punëtori rëndësi më të madhe ka terminologjia e cila është përdorë. Në vend se të thuhet personat e handikepuar, duhet të përdoren termet: me handikap, me pengesa në zhvillim dhe me nevoja të veçanta.



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit II-5.3: Lojë me nevoja të veçanta
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Përralla për fëmijën me dy sy

Aktiviteti kryesor 1

Të gjithë nxënësve u jepet nga një copë letre e prerë nga fleta e punës "Lojë me nevoja të veçanta". Në disa prej atyre letrave është shënuar ndonjë udhëzim, ndërsa nxënësit të cilat i marrin fletët me udhëzime të tilla të shkruara, gjatë lojës do të sillen ashtu siç është shënuar në ato fleta. Pjesa më e madhe e letrave do të jenë të zbrazëta, andaj nxënësit të cilët do t'i tërheqin nuk duhet t'u përmbahen udhëzimeve të posaçme.

Të gjitha karriget radhiten në rreth. Aty ka një karrige më pak se fëmijë. Të gjithë fëmijët ulen, ndërsa njëri qëndron në mes. Nxënësit në mes e thotë një veçori ose tipar. Të gjithë fëmijët që e kanë atë tipar ose e mendojnë atë, duhet të ngrihen dhe t'i ndërrojnë vendet (të ulen në vendin e fëmijës tjetër i cili po ashtu është ngritur), ndërsa fëmija i cili është në mes orvatet të ulet në ndonjë vend të lirë. Kjo përsëritet disa herë me radhë, rreth 3-4 herë, për tipare dhe veçori të ndryshme. P.sh.: "Le t'i ndërrojnë vendet fëmijët të cilët kanë sy të kaltër, flokë të shkurtra, maica të kaltërta, kapëse për flokë, dëshirojnë akullore, e duan matematikën, kanë qen në shtëpi, kanë mace në shtëpi, kanë motër më të vogël..."



Diskutim 1

1. A ngriteshin gjithnjë fëmijët e njëjtë?
2. A ka fëmijë të njëjtë (të cilët i duan gjërat e njëjta, vishen njësoj, mendojnë njësoj, dinë njësoj)?
3. Sipas cilave gjëra mund të dallohen fëmijët?
4. A mund të kenë fëmijët ndonjë mangësi ose handikap?
5. A e njihni ndonjë fëmijë që ka ndonjë handikap?
6. Çfarë handikapi mund të kenë fëmijët?
7. Çka mendoni, a kanë fëmijët me nevoja të veçanta qasje të barabartë në të gjitha gjërat e nevojshme (si është situata në shkollën tuaj, në bibliotekën vendore, në sallën e kinemave, në terrenet sportive...)?
8. A mund t'u ndihmoni ju? Si?

Përfundim

Nuk ka fëmijë të njëjtë. Ata dallohen për nga mënyra sesi vishen, si mendojnë, çka dinë, por edhe për nga ajo se çka munden, gjegjësisht çka nuk mund të bëjnë.

Fëmijët mund të kenë edhe ndonjë mangësi ose handikap. Në këtë rast thuhet se janë fëmijë me nevoja të veçanta. Për fat të keq, shumica e gjërave të cilat të gjithë fëmijët mund t'i arrijnë, fëmijët me nevoja të veçanta nuk mund t'i arrijnë.

Aktiviteti kryesor 2

Lexohet përralla nga fleta e punës për një fëmijë me pengesa shumë të çuditshme në zhvillim. Pastaj ndahen momentet më të rëndësishme të përrallës përmes pyetjeve vijuese:

1. A ju pëlqeu përralla?
2. Çka mendoni, si është ndjerë në atë planet fëmija me dy sy?
3. Si janë sjellë të tjerët me të?
4. Pse janë sjellë ashtu?
5. A janë ndjerë në fillim të rehatshëm në shoqëri me të?
6. A kanë menduar se është normale t'i kesh dy sy?
7. Çka ndodhi pastaj?
8. A është ndryshuar sjellja e të tjerëve ndaj këtij fëmije të veçantë?
9. A është ndryshuar kjo qasje për shkak se u ka ardhur keq ose për ndonjë arsye tjetër?



Diskutim 2

1. Çka mendoni për fëmijët të cilat kanë ndonjë handicap?
2. A mund të luajmë me ata?
3. Çfarë talente të veçanta mund të kenë fëmijët me handicap?
4. A e njihni ndonjë artist të madh që ka pasur handicap?
5. A ka gjëra që fëmijët me nevoja të veçanta i bëjnë më mirë ose më ndryshe nga ne?
6. Zakonisht çka shikojmë ne? Me çka "shikojnë" personat e verbër? (Me veshë dhe me duar). Si „shikohet“ me veshë? Le të provojmë sesa mund të "shikojmë" ne me veshë? Si "shikohet" me duar? Çka mendoni, a mund të bëjë ndonjë artist ndonjë figurë të njeriut vetëm me prekje?
7. Me çka flasim zakonisht? Me çka "flasim" personat memec? (Me duar). A e keni parë sesi duket ajo? A nuk është vallë shqetsuese të bisedohet me shenja?
8. Me çka dëgjojmë zakonisht? Me çka „dëgjojnë“ shurdhët? (Me sy). Si duket „dëgjimi“ me sy? (Mund ta shohin lëvizjen e buzëve ose ta shikojnë lëvizjen e duarve). A do të ishte interesante të dihet kjo?
9. Si ecin personat e paralizuar ose ata që nuk kanë këmbë? (në qere). A keni shikuar ndeshje të tenisit, basketbollit, garave ose golfit mes njerëzve që rrinë në qerre me rrota?

Përfundim

Fëmijët të cilët kanë ndonjë handicap nuk janë më pak të vlefshëm dhe të rëndësishëm se fëmijët e tjerë. Ata janë vetëm të kufizuar në bërjen e gjërave të caktuara dhe për këtë shkak kanë nevoja të posaçme, por mund të jenë njësoj shokë të mirë, të këndshëm, interesant dhe ne mund të luajmë me ta.

Ka pasur shumë artistë të cilët kanë pasur ndonjë mangësi. Të tillë janë: Betoveni/kompozitor –shurdh; Rej Çarlisi/pianist – i verbër; Van Gogu/Artist – me handicap mendor; H.K. Andrsen/shkrimtar – me deformimet fizik etj.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuat?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Shumë larg, në univers ka një planet të njëjtë sikur Toka. Njerëzit të cilët jetojnë në atë planet janë në gjithçka të njëjtë me ne, përpos për një gjë – në vend se t'i kenë nga dy sy, ata e kanë vetëm nga një. Një sy shumë të bukur mu në mes të ballit. Ai është sy shumë i veçantë. Me atë sy të vetëm ata mund të shohin në errësirë. Ata mund të shohin shumë larg, madje edhe përtej mureve. Ata mund t'i shohin yjet në qiell.

Një ditë në një familje u lind një fëmijë i çuditshëm. Një fëmijë me dy sy. Prindërit e foshnjës u shqetësuan shumë dhe u pikëlluan. Ai aq shumë dallonte nga fëmijët tjerë, sa që prindërvë u vinte turp ta nxjerrin jashtë për ta shëtitur. E dërguan te shumë mjekë, në shumë spitale, madje edhe specialistët më të njohur të planetit e kontrolluan për ta gjetur se çka mund të bëhet që fëmija të bëhet sikur të tjerët: që të ketë një sy të bukur në mes të ballit. Mirëpo askush nuk mund të bënte asgjë. Doktorët e famshëm vetëm i ngrinin supet dhe thoshin: “Asgjë nuk mund të bëhet”. Në fillim fëmija nuk e vërente se ai dallohet shumë nga fëmijët tjerë, mirëpo gjithnjë e më shumë që rritej, gjithnjë e më tepër ballafaqohej me më shumë probleme. Përfundimisht fëmija dallohej nga fëmijët e tjerë. Jo vetëm që i dukej e çuditshme (madje edhe e pakëndshme) pamja e tillë me dy sy, por ai edhe nuk mund të shihte natën, andaj duhej të mbajë dritë me vete. Kur shkonte në shkollë, nuk mund të lexonte aq mirë si fëmijët tjerë. Arsimtari i tij e kishte patjetër t'i kushtojë vëmendje të veçantë. Ai nuk mund të shikonte në distancë të largët, andaj duhej të mbajë teleskop që t'i shohë gjërat e njëjta si fëmijët tjerë. Nganjëherë kur kthehej nga shkolla në shtëpi ndjehej shumë i vetmuar. “Fëmijët e tjerë mund t'i shohin gjërat të cilat unë nuk mund t'i shoh” – mendonte në vete. Dhe ishte shumë i dëshpëruar.

Një ditë shumë rastësisht zbuloi diçka shumë të papritur. E zbuloi se mund të shohë diçka që askush në planetin e tij nuk mund ta shihte. Me vrap shkoi te prindërit e tij dhe u tregoi për zbulimin e tij, për atë sesi i shikon gjërat. I ftoi jashtë dhe filloi t'u tregojë. Ata u befasuan. Fëmija e rrëfente një tregim të mrekullueshëm. Në atë tregim duhej të shpikë fjalë që askush më parë nuk i kishte dëgjuar. Ata ishin fjalët: e kuqe, e verdhë dhe ngjyrë portokalli. Ai fliste për drunjtë e gjelbër dhe për lulet ngjyrë vjollce. Kështu filluan të grumbullohen njerëz nga të gjitha anët. Të gjithë dëshironin të dinë sesi i shikonte gjërat ky fëmijë, ndërsa ai rrëfente tregime të papërsëritshme: tregime për detet e thella dhe të kaltra, për valët e detit me majë të bardha, për dragonjtë magjikë të smeraldit dhe për frymën e tyre flakë kuqe.

Vetëm një fëmijë në tërë planetin, i vetmi në mes të gjithë të tjerëve, mund t'i shihte të gjitha ngjyrat e mrekullueshme.

Djaloshi u rit dhe një ditë e takoi një vajzë. Ata u dashuruan. Asaj nuk i pengonte që ai i kishte dy sy, por edhe ai e vërejti që më nuk i pengon ajo. Ndërkohë u bë shumë famshëm. Rrëfimet e tij vinin t'i dëgjojnë njerëz nga i tërë planeti.

Kur u lind një vajzë e vogël, edhe ajo ishte njëjtë si fëmijët e tjerë të planetit. E kishte vetëm një sy.

Përmbajtja II-6: PAJTIMI DHE PRANIMI I GABIMEVE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se cilat janë pasojat e gabimeve në aktivitetet e ndërmarra
Shkathtësi	» të mund ta dallojë gabimin në sjelljen e të tjerëve » të mund të bëjë dallim ndërmjet gabimeve me qëllim dhe pa qëllim në veprimet e të tjerëve » të mund të pranojë falje kur dikush ka gabuar ndaj tij/saj
Qëndrime/ vlera	» të pranojë që edhe të tjerët mund të gabojnë » ta pranojë faljen si parakusht për ruajtjen e lidhjeve të mira » të pranojë se handikapi nuk është pengesë për krijimin dhe kultivimin e marrëdhënieve të ndërsjella

Punëtorja II-6.1: Gabimi dhe falja



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit: 4 situata, 4 gabime

Aktiviteti hyrës

Nxënësit në çifte i tregojnë njëri-tjetrit situata në të cilat ata kanë vepruar keq ndaj ndokujt tjetër, për çka janë ndjerë fajtorë dhe nuk kanë ditur se çka të bëjnë që ta përmirësojnë sjelljen e gabuar. Në fund, disa shembuj vullnetarisht mund të kumtohen para gjithë grupit.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në katër grupe me nga 6 nxënës në secilin grup. Secilit grup i jepet nga një situatë nga fleta e punës. Nëse ka më shumë nxënës në klasë, formohen më shumë se 4 grupe, por në atë rast disa nga situatat do të jenë të njëjta për të dyja grupet. Pastaj jepet udhëzim që ata t'u përgjigjen pyetjeve në fund të fletës, sepse që të gjithë së bashku do ta shohin se për çka bëhet fjalë në atë situatë. Pastaj grupet i prezantojnë situatat, në fillim duke e lexuar tekstin, me qëllim që të jenë në rrjedha me grupet tjera, e pastaj përgjigjen në pyetje duke arsyetuar se pse mendojnë ashtu.

Në fund, zhvillohet një diskutim me tërë grupin.



Diskutim

1. Si mund të dimë që dikush ka bërë veprim të gabuar?
2. Çfarë mund të jenë pasojat e gabimeve të bëra gjatë veprimeve të ndërmarra?
3. Cili është dallimi ndërmjet gabimeve të qëllimshme dhe të paqëllimshme?
4. Pse është me rëndësi të kërkojmë falje kur ta bëjmë ndonjë gabim?
5. Pse është me rëndësi t'ia falim ndokujt që ka bërë gabim ndaj nesh?

Përfundim

Varësisht nga pasojat e ndonjë veprimi ne mund të përfundojmë se dikush ka gabuar ose nuk ka gabuar.

Pasojat e gabimeve të bëra mund të jenë nga më të ndryshmet: prej lëndimeve fizike, hidhërimeve, acarimit të marrëdhënieve, ndërprerje të miqësive, madje edhe shkaktim të dëmeve të caktuara materiale të cilat pastaj duhet të kompensohen. Nganjëherë të tjerët qëllimisht ndërmarrin ndonjë veprim që ta lëndojnë ndokënd, por nganjëherë ndodhë që vetë ne të bëjmë diçka që do ta lëndojë ndokënd, edhe pse nuk kemi pasur qëllim të tillë.

Kur bëhet gabim, kërkimi i faljes është masë e patjetërsueshme fillestare me qëllim që të përmirësohet dëmi i shkaktuar. Falja mund të pranohet ose mund të mos pranohet, por vetëm me falje (pranim të faljes) mund të ruhen marrëdhëniet e mira.

Aktiviteti përmbyllës

Secili nxënës e ka për detyrë që në një copë letre ose në një fletore të shkruajë si do t'i kërkojë falje atij ndaj të cilit ka bërë gabim gjatë muajit të fundit.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja II-7: BALLAFAQIMI ME EMOCIONET

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë kur shkakton hidhërimi sjellje agresive
Shkathtësi	» të mund të shprehë simpati për moshatarët e tij/saj » të mund ta kontrollojë hidhërimin/zemërimin personal drejt të tjerëve » të mund të përmbahet nga reagimet jo të qëlluara të shprehjes së hidhërimit/zemërimit ndaj të tjerëve
Qëndrime/vlera	» të vërejë se emocionet jo të këndshme zakonisht janë pengesë, ndërsa emocionet e këndshme janë nxitje në raportet mes njerëzve » ta pranojë se njerëzit mund krejtësisht pa arsye të bëhen viktimë të hidhërimit/zemërimit të ndokujt tjetër (sjellja agresive pa arsye lëvizë nga burimi i hidhërimit kah dikush tjetër ose diçka tjetër)

Punëtorja II-7.1: Sjellja gjatë hidhërimit



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit II-7.1a: Sjellja në situata konflikti
- » fletë pune për nxënësit II-7.1b: Sjellja destruktive
- » pajisje për të shkruar
- » letër të vjetër, gazeta
- » tabelë dhe shkurtesa

Aktiviteti hyrës

Në tabelë vizatohet një siluetë njeriu. Nga gazetatat bëhen topa jo shumë të mëdhenj. Ndërkaq nxënësit duhet të paramendojnë se janë shumë të hidhëruar ndaj ndokujt tjetër. Pas shenjës së dhënë secili nga vendi i tij e hedh topin drejt siluetës së vizatuar në tabelë. Pastaj grumbullohen topat dhe hidhen në shportë.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe të vogla (me nga 3-5 nxënës në grup, por gjithsej tre, gjashtë ose nëntë grupe). Secili grup e tërheq nga një situatë konflikti nga fleta e punës “Sjellja në situata konflikti” dhe merr për detyrë:

- 1) të paramendojë sesi sillen më së shpeshti personat kur gjenden në situatën e përshkruar në letër
- 2) të përgatitet ta aktrojë atë situatë, duke e pasqyruar sjelljen e të gjithë personave të përfshirë në atë situatë.

Përafërsisht pas 5 minutave grupet fillojnë me prezantimin e sjelljes në situata konflikti. Në fillim u jepet mundësi të gjitha grupeve të cilat kanë punuar në situatën e njëjtë që ta aktrojnë sjelljen në atë situatë, pastaj vazhdohet me situatën vijuese

Prezantimi i secilit grup ndiqet me duartrokitje të nxitur nga arsimtari. Secilit grup i jepet nga një ekzemplar i fletës së punës “sjellje destruktive”. Në këtë rast nxënësit e kanë për detyrë të theksojnë së cilat nga sjelljet e dhëna në fletë kanë qenë të pranishme në situatën të cilën e ka aktruar grupi i tyre dhe grupet të cilat kanë punuar në atë situatë.

Përafërsisht pas 5 minutave fillohet me prezantimin asaj që secili grup e ka shkruar në fletën e punës. Fillohet me një situatë, ndërsa përfaqësuesit e grupeve të cilët kanë punuar në atë situatë në mënyrë të ndërsjellë i lexojnë sjelljet e shënuara. Kur të përfundohet me një situatë, kalohet në situatën tjetër.

Arsimtari i shënon përgjigjet në tabelë, me çka çdo përsëritje e shënon me yll.

Pasi të mbarojë leximi i sjelljeve që hasen në të tre situatat, arsimtari kërkon të shpjegohen sjelljet të cilat janë theksuar më shpesh përmes shembujve nga reagimet konkrete të përfaqësuar gjatë aktrimit të situatës.



Diskutim

1. Çka kanë të përbashkët të gjitha sjelljet e theksuara? A janë pozitive ose negative (të mira ose të këqija)?
2. Çka i detyron njerëzit të cilët gjenden në situatë konflikti që të sillen në atë mënyrë? Cilat ndjenja dominojnë në situatat e theksuara?
3. A duhet të shprehet hidhërimi ose duhet të mbahet në vete? Pse? (Çka mund të ndodhë nëse hidhërimi mbahet në vete dhe nuk shprehet në situatën në të cilën është shkaktuar?)
4. A ju ka ndodhur në ndonjë situatë të jeni aq të hidhëruar, saqë të keni dëshiruar t'i lëndoni të tjerët dhe në njëfarë mënyrë t'u shkaktoni dëm?
5. Sjellja negative në situatë konflikti a është konstruktive ose është destruktive? Si ndikon ajo në komunikimin me njerëzit e tjerë? Si reflektohet në raportet me njerëzit tjerë?

Përfundim

Nëse nuk kontrollohen ndjenja e hidhërimit dhe e pezmit që dominon në situatë konflikti, atëherë ajo i shtyn njerëzit të sillen në mënyrë destruktive. Si pasojë e kësaj ndërpritet komunikimi midis palëve në konflikt dhe acarohen raportet mes tyre.

Ndjenja e hidhërimit nuk duhet mbajtur brenda, por duhet shprehur në situatë në të cilën është shkaktuar dhe drejt personit i cili konsiderohet burim i hidhërimit. Nëse nuk ndodh kjo, atëherë hidhërimi i shkaktuar nga një person ose nga një situatë mund të bartet te personi ose situata tjetër ose të akumulohet derisa të shpërthejë edhe për imtësinë më të vogël në situatë tjetër ndaj ndonjë personi që nuk është shkas për hidhërim.

Mirëpo është shumë me rëndësi që hidhërimi të shprehet në mënyrë që nuk do të shkaktojë përkeqësim të konfliktit dhe ndërprerje të komunikimit ndërmjet palëve të konfrontuara.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në gjysmërreth. Arsimtari qëndron në pjesën e hapur të rrethit dhe tregon një fjalë me zë të pazakonshëm me çka bën një hap kah mesi i rrethit dhe menjëherë kthehet mbrapa. Nxënësit duhet ta përsërisin atë që e thotë arsimtari dhe ta bëjnë një hap drejt mesit dhe të kthehen mbrapa. Pastaj arsimtari e thotë një fjalë tjetër me një ton më ndryshe nga i pari dhe bën një hap kah mesi i rrethit. Ai madje mund të gjestikulojë me duar dhe trup për ta përforcuar efektin e fjalës së thënë. Nxënësit e imitojnë atë. Pas 8-9 fjalëve të thëna, ftohet ndonjë vullnetar që ta marrë rolin e atij që duhet të thotë fjalë të tilla, siç bënte arsimtari.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-7.2: Sjellja sulmuese



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Lilja e hidhëruar
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Futboll
- » stikerë (ngjites) ose pjesë të vogla të letrës dhe sellotej

Aktiviteti hyrës

Nxënësit janë të radhitur në rreth. Aktivitetin e fillon një nxënës i cili nxënësit në anën e tij të djathtë me zë të ndryshuar dhe me fytyrë të mrrolur i thotë: “Komshi, komshi, shumë të jam hidhëruar që m’i ke shkelur lulet, por këtë herë do të përmbahem”. Nxënësi tjetër, pa u qeshur, do të duhet të përgjigjet në këtë mënyrë: “Më fal ore fqinj, për besë nuk i pashë, do të të sjellë lule të reja”. Nëse qeshet, atëherë nxënësi i parë vazhdon më tej me nxënësin tjetër i cili është në radhë. Aktiviteti rrjedh përdërisa të kalojnë të gjithë nxënësit.

Aktiviteti kryesor 1

Arsimtari ua lexon nxënësve tekstin e fletës së punës “Lilja e hidhëruar”. Pastaj inicion diskutim lidhur me situatën e përshkruar.



Diskutim 1

1. Ku qëndron problemi sipas nënës? Pse është e hidhëruar?
2. Ku qëndron problemi sipas Liles? Pse është e hidhëruar?
3. Çka ka mund të bëjë Lilja që të shmanget konfliktit?
4. Çka ka mund të bëjë nëna që të shmanget konflikti?
5. Si reagojmë zakonisht kur dikush na drejtohet me hidhërim?
6. Pse hidhërimi i të tjerëve shkakton hidhërim edhe te ne?
7. Ndaj sulmit me të cilin shprehet hidhërimi mund të përgjigjemi në mënyrë të qetë dhe të sjellshme. Çfarë efekti do të kishte përgjigja e qetë dhe e sjellshme ndaj personit të hidhëruar?
8. Çka duhet të bëjmë kur dikush na sulmon për shkak se është i hidhëruar?

Përfundim

Kur hidhërimi i të tjerëve është i drejtuar kah ne, në të shumtën e rasteve reagojmë në të njëjtën mënyrë – me hidhërim. Hidhërimi shprehet me sulm, ndërsa mbrojtja më e mirë nga sulmi është sulmi prapa të cilit qëndron hidhërimi. Kur përkundër hidhërimit tonë, dikush do të na drejtohet qetë dhe me mirësjellje, ajo ndikon në qetësimin e hidhërimit tonë dhe e përmirëson raportin me personin tjetër. Kur ju sulmon dikush për shkak se është i hidhëruar, NDALUNI dhe mendoni! Çka e ka shtyrë të hidhërohet? Si keni ndikuar ju në hidhërimin e tij? Si mund të ndihmoni në një situatë të tillë?

Aktiviteti kryesor 2

Fillimisht, arsimtarja ua lexon të gjithë fëmijëve përshkrimin e ndodhisë së fletës së punës Futboll (vetëm pjesën e parë):

Arsimtarja e lexon edhe njëherë tregimin, por kësaj herë me udhëzim plotësues: “Më ndërpritni gjithnjë kur do t’i lexoj reagimet që e kanë shkakuar konfliktin ndërmjet Isës dhe Pepit me çka kanë kontribuar në përkeqësimin e konfliktit deri në rrahje”.

Arsimtarja inicion diskutim për analizën e ngjarjes së prezantuar: “Të shohim, në rast se Pepi nuk do t’ia kthente me gjeeste, me fjalë dhe me veprime kërcënuese, a do të mund të shmangej rrahja?”



Diskutim 2

1. Çka ka mund të bëjë Pepi që të shmanget konflikti kur Isa e shikon vëngër?
2. Çka ka mund të bëjë Pepi kur Isa filloi ta ofendojë?
3. Çka ka mund të bëjë Pepi kur Isa ka filluar ta tërheqë për blue?

Përfundim

Kur të neutralizohet sjellja sulmuese e shkakuar nga hidhërimi i i tjetrit, atëherë ndryshon tërë kahja e konfliktit – në vend se të ashpërsohet, ai mund të zgjidhet.

Aktiviteti kryesor 3

Arsimtarja kërkon që fëmijët të ulen në bankat e tyre që t'u kujtohet ndonjë situatë kur me hidhërim i janë drejtuar ndokujt tjetër. Ndërkohë ndonjë prej situatave të tilla mund të aktrohet para të gjithëve dhe të analizohet bashkërisht.

- » Pse ishit të hidhëruar me njëri tjetrin?
- » Në çfarë mënyre çdonjëri prej jush ka shkaktuar që të hidhërohet tjetri?
- » Çka keni mund të bëni që të zgjidhet konflikti?

Aktiviteti përmbyllës

Gjysmës së nxënësve u jepen spikerë të vegjël ose pjesë të letrës dhe sellotej të cilat do të duhet të ngjiten në ndonjë pjesë të trupit, por do të jenë të dukshme. Ata e kanë për detyrë të lëvizin nëpër klasë me hapa të ngadalshëm, me duar të shtrira përpara dhe me grimasa të hidhërimit, me qëllim që t'i kapin nxënësit e tjerë të cilët nuk kanë stikerë ose letër. Ndërsa fëmijët do të duhet t'i shtypin në stiker ose në letër dhe në atë mënyrë t'i shndërrojnë në njerëz normal.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Lilja e hidhëruar

Lilja dhe Olja janë motra. Lilja i ka pesëmbëdhjetë vjeç, ndërsa Olja i ka dhjetë. Lilja është më e madhe, andaj gjithnjë i kryen punët e saj më shpejt. Olja është më e re, por edhe është “mashtroese” më e madhe – më së shpeshti “zvarritet” dhe pret dikush tjetër t'i ndihmojë për t'i kryer punët e veta. Një ditë gjithë familja përgatitej të shkojë mysafir. Të gjithë duhej të përgatiteshin. Babai ende e lexonte gazetën, ndërsa Lilja e kishte veshi fustanin e ri dhe, derisa të niseshin, u ul dhe shikonte televizor. Olja nuk mund të vendoste vetë se çka të veshë. Nëna duhej të përgatitej vetë e le më t'i ndihmojë edhe Oljes. Dhurata të cilën duhej ta dërgojnë ende nuk ishte e mbështjellë.

Papritmas e ëma (shpërtheu): “A të gjithë pritni që unë t'ju organizojë, bile bile edhe dhuratën ta mbështjellë. Deri kur unë do të jem ajo e cila vrapon për gjithçka?”

Lilja me hidhërim ia ktheu: “Më është bezdisur që vazhdimisht të më bërtasësh mua, edhe pse unë e para jam bërë gati, më duhet t'ju pres të gjithëve!”

1. Në fushën e sportit dy grupe të shokëve luajnë futboll. Pepi dhe Acoja luajnë për ekipin e njëjtë. Isa ia gjuan topin Pepit para golit bosh të ekipit kundërshtar, por Pepi pa dashje e huq golin. Isa e shikon vëngër. Pepi ia kthen në të njëjtën mënyrë. Isa e quan: “A be marroq njeri!” Pepi ia kthen në të njëjtën mënyrë: “A ti do të më quash mua marroq?”. Isa, duke iu afruar, i thotë: “Jo vetëm që je marroq, por je edhe torollak!” Pepi, duke iu kërcënuar, i vërsulet Isës me grushta përpjetë. Isa e kap për bluze. Pepi e shtyn. Dhe (çka ndodh?)

2. Në fushën e sportit dy grupe të shokëve luajnë futboll. Pepi dhe Acoja luajnë për ekipin e njëjtë. Isa ia gjuan topin Pepit para golit bosh të ekipit kundërshtar, por Pepi pa dashje e huq golin. Isa e shikon vëngër. Pepi ia kthen në të njëjtën mënyrë. *(Isa është i hidhëruar -kërcënim jo verbal)* Isa e quan: “A be marroq njeri!” Pepi ia kthen në të njëjtën mënyrë: “A ti do të më quash mua marroq?”. *(Konflikti përkeqësohet-ofendime)*

Isa duke iu afruar, vazhdon: “Jo vetëm që je marroq, por je edhe torollak!” Pepi, duke iu kërcënuar, i vërsulet Isës me grushta përpjetë. *(Konflikti edhe më tej përkeqësohet – ofendimet shkaktajnë sjellje agresive)* Isa e kap për bluze. Pepi e shtyn. Dhe *(rrahje)*

Punëtorja II-7.3: Kontrollimi i hidhërimit personal



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit II-7.3a: Kontrollimi i hidhërimit - 1
- » fletë pune për nxënësit II-7.3b: Kontrollimi i hidhërimit - 2
- » fletë pune për nxënësit II-7.3c: Kontrollimi i hidhërimit - 3
- » fletë pune për nxënësit II-7.3ç: Kontrollimi i hidhërimit - 4
- » fletë pune për nxënësit II-7.3d: Kontrollimi i hidhërimit sipas mënyrës sime
- » tabelë dhe shkurtes

Aktiviteti hyrës

Të gjithë janë të ulur në rreth. Fillon një vullnetar dhe i thotë dy gjëra për vete, diçka që e hidhëron dhe diçka që e gëzon edhe atë në mënyrën vijuese: “Më së shumti më hidhëron..., ndërsa më së shumti më gëzon...” Vazhdon tjetri pranë tij, e kështu me radhë derisa të gjithë të thonë se çka i hidhëron e çka i gëzon.

Aktiviteti kryesor 1

Arsimtarja u drejtohet të gjithëve:

“Nga përvoja e dimë që nuk mund ta kemi (ose ta bëjmë) atë që dëshirojmë ta kemi (ose ta bëjmë) atëherë kur duam. Kur nuk mund ta kemi (bëjmë) atë që dëshirojmë për shkak se na pengon dikush ose diçka, ne “nervozohemi”. Në situatë të tillë mund të bëjmë ndonjë veprim me çka do ta dëmtojmë veten ose do ti lëndojmë të tjerët”. Pastaj nxënësve u prezantohen dy situata për diskutim të përbashkët. Përgjigjet e pyetjeve shënohen në tabelë:

- » Ilija nuk mund të dalë të luajë me shokët për shkak se e ëma e tij e detyron ta ruajë motrën më të vogël, Vesnën. Kuptohet që Ilija është shumë i hidhëruar. Çka do të mund të bënte Ilija? (Si do të reagoje?) (Përgjigje të mundshme: të refuzojë ta ruajë motrën, ta rrahë atë kur të ngelin vetëm, ta lë vetë në shtëpi ose ta mbylli në dhomë...)
- » Babai e dërgoi Ajshen në shitore t’ia blejë një gazetë derisa ajo e shikonte filmin e dëshiruar vizatimor. Kuptohet që Ajshja është e hidhëruar. Çka mund të bënte Ajshja? (Si do të reagoje?) (Përgjigje të mundshme: të refuzojë t’ia blejë gazetën, të shkojë, por kur të kthehet të thotë se nuk kishte gazetë, ta detyrojë vëllain më të vogël të shkojë në shitore ...)



Diskutim 1

1. A ka njerëz të cilët asnjëherë nuk hidhërohen?
2. A është gabim nëse hidhërohem me ndokënd?
3. A do të thotë që gjithnjë kur jem të hidhëruar me ndokënd, gjithnjë edhe t’i prishim marrëdhëniet me të?
4. A mund të bëjmë diçka që të na kalojë hidhërimi, e ne ndërkohë të mos e lëndojmë ndokënd ose vetveten?

Përfundim

Hidhërimi dhe zemërimi janë ndjenja normale të cilat paraqiten herë pas herë te secili njeri. Nuk është gabim nëse hidhërohem me ndokënd, por është keq nëse hidhërimi mbahet në vete. Hidhërimi nuk është patjetër të përfundojë me armiqësi, edhe pse nganjëherë njerëzit hidhërohen shumë – bëhen si bombë të gatshëm për të eksploduar. Me rëndësi është të dihet sesi duhet ballafaquar me hidhërimin pa mos e lënduar veten ose të tjerët.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësve, të ndarë në çifte, u jepet njëri nga katër versione të fletës së punës: “Kontrollimi i hidhërimit”. Arsimtari e shpjegon domethënien e secilës strategji të prezantuar. Pastaj kërkohet nga çiftet që të shkruajnë se në çfarë rastesh do të mund ta shfrytëzojnë teknikën e dhënë nga fleta e punës. Pas plotësimit të fletës, ajo i dorëzohet çiftit afër vetes dhe njëkohësisht fitohet fletë e re e çiftit tjetër ku është prezantuar ndonjë teknikë tjetër. Edhe kjo fletë plotësohet dhe i jepet çiftit që gjendet pranë, ndërsa merret fletë e re nga çifti paraprak.

Vërejtje: Që të ketë qarkullim të pandërprerë të fletave ndërmjet çifteve, si dhe secilit çift t'i jepet fletë me teknika të ndryshme, do të duhet që nga katër çifte të lidhen mes vete dhe t'i shkëmbejnë fletat. Nëse numri i nxënësve në paralele nuk lejon të krijohen grupe me nga katër çifte, atëherë disa nga çiftet mund të shndërrohen në treshe.

Pasi që secili çift të ketë mundësi të shënojë diçka për të gjitha 4 versionet e fletës së punës, ndonjë vullnetar i lexon disa nga shembujt e dhënë.

Në fund secilit çift i jepet fleta e punës: "Kontrollimi i hidhërimit sipas mënyrës sime" ku ata i shënojnë shembujt e tyre për atë se si ose çka zakonisht bëjnë kur janë të hidhëruar, e çka u ndihmon t'u kalojë hidhërimi. Pas 4-5 minutash vullnetarët i lexojnë shembujt e tyre.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtarja jep udhëzime që të gjithë fëmijët t'i shtrëngojnë fuqishëm duart e tyre dhe t'i mbajnë ashtu rreth 5 sekonda, pastaj ngadalë t'i hapin duart. Pastaj kërkohet nga të gjithë që ta shtrëngojnë trupin dhe pas 5 sekondave ngadalë të lirohen. Në fund përsëri duart mbahen të shtrënguara për 5 sekonda dhe përsëri lirohen.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-7.4: Simpa, simpa, ti dhe unë



Materialet:

- » balonë e madhe
- » stikerë në formë të zemrave të vogla ose letër e prerë në formë të zemrës
- » gërvshërë, fllomasterë, markerë permanent
- » sellotej
- » zemër e prerë nga një flipçart /letër më e madhe

Aktiviteti hyrës

Pasi të fryhet balona, në të shkruhet fjala “Dashuri” me marker permanent. Nxënësit ia gjuajnë balonën njëri-tjetrit duke u orvatur që “dashuria” të mbetet lart në ajër (të gjendet në mesin e nxënësve).

Aktiviteti kryesor

Secilit nxënës i jepet nga një stiker në formë të zemrës ose fillimisht secili e bën nga një zemër nga një copë e letër, duke e prerë, vizatuar dhe theksuar këndet me fllomaster etj. Pastaj secili “në zemrën e tij” do të duhet ta shënojë një porosi të mirë, diçka që atij i pëlqen te simpatia e tij, qoftë reale ose e imagjinuar (nëse për momentin nuk kanë simpati), por nuk do ta shënojë emrin e simpatisë. Pastaj secili nxënës e lexon porosinë e tij dhe e ngjet në një zemër më të madhe të letrës të përgatitur paraprakisht.



Diskutim

1. A e kishit vështirë të shënoni porosi të bukur për simpatinë tuaj?
2. A e kishit vështirë ta lexoni atë?
3. Çka e kishit më vështirë: Ta shkruani ose ta lexoni? Pse?

Përfundim

Është mirë kur mundeni ndonjërit ose ndonjërës që ju pëlqen t’ia thuash atë. Kjo na bën të gëzuar dhe të hareshëm. Mirëpo, është mirë edhe kur ndonjëri ose ndonjëra ju thotë se ju pëlqen. Edhe kjo na bën të gëzuar dhe të hareshëm.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Fillohet me vullnetar, i cili kështu do të duhet ta pyesë nxënësin pranë tij: “I/e dashur a me do?”. Njëherazi do të duhet ta bëjë për të qeshur atë që e dëgjon. Detyrë e atij që e dëgjon është që ta shikojë në sy dhe të orvatet të mos qeshet. Nëse qesh, ai bie prej loje dhe nxënësi tjetër vazhdon me pyetjen e njëjtë në raundin tjetër. Kur nuk do të qesh më nxënësi që dëgjon, atëherë ai e merr radhën e pyetjes dhe krijimit të situatës për qeshje.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja II-8: KOMUNIKIMI

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se cilat janë efektet e shfrytëzimit të shenjave të ndryshme joadekuate joverbale » ta dijë sesi ndikojnë shpejtësia e të folurit, toni, intonacioni dhe lartësia e zërit ndaj komunikimit verbal » t'i dijë rregullat e dëgjimit aktiv
Shkathtësi	» të mund t'i shfrytëzojë shenjat joverbale dhe shprehjet verbale që kanë ndikim pozitiv ndaj raporteve me të tjerët » të mund të përmbahet nga shfrytëzimi i shenjave joverbale dhe shprehjeve verbale të cilat kanë ndikim negativ ndaj njerëzve të tjerë » të mund të parafranojë » të mund të parashtrojë pyetje për shpjegim
Qëndrime/vlera	» të vërejnë se komunikimi joverbal mund të bëhet pjesë përbërëse e komunikimit verbal, por edhe të realizohet në mënyrë të pavarur » të vërejnë se komunikimi verbal dhe joverbal mund të kenë pasoja pozitive dhe negative në raportet me njerëzit e tjerë » të vërejnë se në fillim duhet të kuptojë se çka kërkon tjetri, e pastaj të reagojë

Punëtorja II-8.1: Të folurit e fytyrës sime



Materialët:

- » fletë pune për nxënësit II-8.1: Shprehjet e fytyrës
- » fllomasterë, ngjyra

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Një nxënës fillon të bëjë grimasë e cila ka të bëjë me ndonjë ndjenjë. Të gjithë e shikojnë grimasën e bërë, e pastaj nxënësi e “heq” atë nga fytyra e tij dhe ia “jep” nxënësit afër tij. Ai duhet “ta marrë” dhe ta vendosë në fytyrën e tij (ta bëjë grimasën e njëjtë). Pasi që të gjitha ta shohin grimasën e imituar, ajo nxirret dhe hidhet në hapësirën e zbrazur në mes të rrethit. Pastaj nxënësi e bën një grimasë tjetër – u tregon të tjerëve, e nxjerr dhe të gjithë vazhdojnë me radhë derisa të gjithë t’i bëjnë nga dy grimasa – një imitim të nxënësit afër tyre dhe një grimasë personale.

Aktiviteti kryesor

Secilit nxënës i jepet nga një ekzemplar i fletës së punës i përcjellë edhe me këtë udhëzim: “Vizatojeni në çdo rreth nga një person i cili do të tregojë sesi ndjehet personi që është gjendur në situatën e përshkruar në atë rreth”. (Nxënësit inkurajohen të vizatojnë shprehje më të hollësishme të fytyrës – fytyrë me vetulla, flokë, lot, grimasa ...) Pastaj nxënësve u parashtrihen pyetje:

“Cilat ndjenja i reflektojnë fytyrat e vizatuara?” (Përgjigje: turpin/turpërimin, dëshpërimin, gërditjen ...)

Në vazhdim nga disa nxënës kërkohet që ta vendosin tërë trupin në pozicion që i përshkruan situatën e përshkruar në secilin rreth ndaras: “Tani le të shohim sesi duket i tërë trupi i njeriut i cili është gjendur në situatat e dhëna. Kush do të na tregojë?”. Përpos shprehjes së fytyrës (p.sh. vetullat e ngritur, shenja me sy ...), duhet pasur kujdes edhe për pjesët e tjera të trupit (p.sh.: pozita e shpatullave, goditja në ballë, lëvizja e gishtave, duart në kërdhokulla ...)

Në fund, arsimtari u drejtohet të gjithëve: “Përpos me fjalë, njerëzit shprehin edhe përmes fytyrës dhe trupit. Kjo nënkupton shprehje pa fjalë ose shprehje joverbale.”



Diskutim

1. Kur flasim, a përdorim në të njëjtën kohë edhe shenjë joverbale? Si duket ajo?
2. A përcjellim ndonjëherë porosi vetëm me shenja dhe gjeste, pra pa fjalë? Kur ndodh kjo?
3. Cili lloj i shprehjes joverbale mund të shkaktojë konflikt? Kush do të tregojë si duket ai? Përgjigje të mundshme: nxjerrja e gjuhës, lëvizjet e caktuara me duar për nënçmim, ofendim ...)
4. Cili lloj i shprehjes verbale (cilat shenja) ndikon pozitivisht në marrëdhëniet me të tjerët? Cili do të na tregojë? (Përgjigje të mundshme: lëvizja e kokës në shenjë miratimi, buzëqeshja, bërja me gishtin e madh për të dhënë shenjë OK ose bërja e rrethit me gishtin e madh dhe atë tregues për të dhënë shenjë OK, duartrokkitja, bërja me sy, shikimi me kujdes në sy i përcjellë me buzëqeshje etj.)
5. Cilat fjalë do të na shkaktonin probleme në rast se do t’i përdornim? (përgjigje të mundshme: sharje, fjalët torollak, marroq, budalla... dhe çdo fjalë ose shprehje tjetër që është ofendues në mjedis të caktuar)
6. A ka fjalë ose shprehje të cilat në rast se do t’i përdornim do të na i përmirësonin raportet me të tjerët? Cilat janë ato? (Përgjigje të mundshme: të lutem, ju faleminderit, përmendja e emrit – njerëzit dëshirojnë ta dëgjojnë emrin e tyre, etj.)

Përfundim

Kur flasim zakonisht i shfrytëzojnë shenjat verbale dhe joverbale. Mirëpo, nganjëherë mund të komunikojmë vetëm me shenja joverbale, pra pa fjalë. Shfrytëzimi i fjalëve, shprehjeve të caktuara, si dhe i disa shenjave joverbale, mund të na shkaktojë probleme. Disa fjalë, shprehje dhe shenja të tjera joverbale na ndihmojnë të krijojmë marrëdhënie me të mira me të tjerët.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në çifte. Anëtarët e çiftit qëndrojnë njëri prapa tjetrit dhe prezantojnë “automobil” – personi përpara dhe vozitësi – personi prapa. “Automobili” i ka sytë e mbyllur dhe lëviz me anë të udhëzimeve vijuese të vozitësit: dy herë

ia shtyp shpatullën e djathtë – kthim djathtas, dy herë ia shtyp shpatullën e majtë – kthim majtas, dy duart e vëna në të dy shpatullat – vozitje drejtë, heqja e duarve, pa mos e prekur – ndal, automobili “ndalet”. Me shenjën e arsimtarit vozitësit fillojnë ta vozisin automobilin në klasë. Pas një kohe ndërrohen rolet.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-8.2: Pyetje për ta qëlluar



Materialet:

- » pajisje për të shkruar
- » letër

Aktiviteti kryesor

Në mes të hapësirës vendosen 5-6 karrige në një rreth anë dhe një karrige në anën tjetër. Përreth tyre radhiten karriget e tjera. Aktiviteti realizohet në dy pjesë:

1. Arsimitari paralajmëron se aktiviteti do të përbëhet nga të qëlluarit e kafshëve të paramenduara. Për këtë qëllim e zgjedh një vullnetar i cili do ta paramendojë veten se është ndonjë kafshë e caktuar dhe e zgjedh një grup prej 5-6 nxënësve (vullnetarë) që ta qëllojnë se cilën kafshë e ka paramenduar. Nxënësi e paramendon veten se është një kafshë e caktuar, e shënon atë kafshë në një copë letre dhe ia jep atë arsimtarit. Pastaj ulët në karrigen në mes të hapësirës së klasës. Nxënësit që duhet ta qëllojnë atë duhet të ulen në karriget përballë tij dhe të jenë të gatshëm t'i parashtrojnë pyetje. Pyetjet të cilat kanë të drejtë t'i parashtrojnë fillojnë me formën pyetëse A, ndërsa përgjigja duhet të jetë vetëm Po ose Jo. Pra, nxënësi e cili e paramendon veten se është kafsha, duhet të përgjigjet vetëm me Po ose Jo. Pyetjet i parashtrojnë një nga një nxënësit të cilët janë nga grupi që duhet ta qëllojë. Nxënësit e tjerë që janë të (ulur përreth) janë vëzhgues. Detyra e tyre është ta shënojnë sesa pyetje janë parashtruar derisa është qëlluar se për cilën kafshë bëhet fjalë. Pasi të qëllohet se për cilën kafshë bëhet fjalë, vëzhguesit tregojnë sesa pyetje janë parashtruar. E njëjta procedurë përsëritet 2-3 herë me vullnetarë të rinj që do ta paramendojnë veten se është kafshë e caktuar dhe me grupe të reja të nxënësve që do të qëllojnë. Sipas mundësisë, vullnetarët e rinj zgjidhen nga vëzhguesit paraprakë.

2. Arsimitari paralajmëron ndryshim në rregullat e lojës. Përsëri do të ketë nxënës të cilët do të paramendojnë se janë ndonjë kafshë e caktuar, nxënës që do të qëllojnë dhe nxënës që do të jenë vëzhgues dhe do t'i numërojnë pyetjet. Mirëpo rregullat e reja kanë të bëjnë me mënyrën sesi do të parashtrohen pyetjet, gjegjësisht si do të jepen përgjigjet. Pyetjet e parashtruara do të duhet të jenë të tipit të hapur – në vend se të pyetet A, ato duhet të fillojnë me format Çka, Si, Ku, Kur... dhe në vend se të përgjigjet me Po ose Jo, duhet të jepet përgjigje me fjalë ose fjali të tëra.

(p.sh: në vend se të pyetet A jeton kafsha në mal?, duhet të pyetet Ku jeton kafsha?; në vend të A fluturon?, duhet të pyetet Si lëviz ajo?).

Vetëm se nuk lejohet të pyetet drejtpërsëdrejti se për cilën kafshë bëhet fjalë. Procedura përsëritet 3-4 herë, me vullnetarë të rinj, të cilët do ta paramendojnë veten se janë kafshë, por tani me grupin e vjetër që orvatet ta qëllojnë se për cilën kafshë bëhet fjalë.

Vëzhguesit përsëri i numërojnë pyetjet dhe e tregojnë numrin e pyetjeve të parashtruara pasi të gjendet se cila kafshë është paramenduar



Diskutim

1. Në cilën situatë të parashtrimit të pyetjeve u zbulua me shpejt se për cilën kafshë bëhet fjalë? Pse?
2. Çka mund të përfundohet lidhur me dallimin esencial ndërmjet pyetjeve të hapura dhe atyre të mbyllura. („A“ ose „po-jo“)?
3. Çfarë pyetje mund të parashtrojmë më lehtë? Cilave pyetje mund t'u përgjigjemi më lehtë?
4. Kur është më mirë të përdoren pyetjet e llojit të parë, ndërsa kur është më mirë të përdoren pyetjet e llojit të dytë? Pse?

Përfundim

Është normale të presim që më shpejtë dhe më lehtë të arrihet informacioni i duhur kur parashtrohen pyetje të hapura. Pyetjet e hapura i nxisin njerëzit të flasin, ndërsa pyetjet e mbyllura më së shpeshti e pengojnë bisedën.

Kur dëshirojmë të kuptojmë se çka mendojnë njerëzit dhe si ndjehen ata, më së miri është t'u parashtrojmë pyetje të hapura. Kur dëshirojmë t'i orientojmë që të mendojnë në drejtim të përcaktuar saktë, është e arsyeshme që t'u parashtrojmë edhe pyetje të mbyllura.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Një nxënës ulët në mes të rrethit me sy të mbyllur. Arsimitari e cakton një nxënës që me zë të ndryshuar do të pyesë “Sa është ora?” Nëse e qëllon, atëherë ndryshohen rolet – ai që pyet hyn në mes të rrethit (mundësisht njërin nga ata që janë paksa më të përmbajtur) që ta parashtrojë pyetjen e njëjtë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-8.3: Dëgjim dhe kuptim



Materialet:

- » rrip i gjatë 4 metra
- » katër shami për t'i mbyll sytë

Aktiviteti kryesor 1

Aktiviteti realizohet në hapësirën e klasës në të cilën shumica e nxënësve rrinë ulur në karrige të radhitura përreth murit, ndërsa më mes ngel një hapësirë e madhe dhe e zbrazët për lëvizje. Zgjedhet një grup prej pesë vullnetarëve, të cilët do të prezantojnë shumëkëmbësh. Shumëkëmbëshi përbëhet nga pesë nxënës vullnetarë të radhitur në kolonë, njëri pas tjetrit, në distancë prej 10 cm. Pjesët e shumëkëmbëshit janë të lidhura mes vete përmes një rripi në të cilin janë kapur fëmijët. Gjatësia e rripi prej te i pari e deri të i fundit është 1 m. (Në pozicionin fillestar, rripi tërhiqet për toke, për shkak se gjatësia e rripit është shumë më e madhe në krahasim me distancën në mes nxënësve).

Koka e shumëkëmbëshit gjendet prapa, kurse sytë janë të pozicionuar te personi i fundit i kolonës, andaj ai është i vetmi që mund të shikojë. Për këtë shkak katër personave të parë iu mbyllen sytë me shami që të mos mund të shikojnë.

Shumëkëmbëshi lëviz me hapa të vogla me bishtin përpara dhe me kokën prapa, ndërsa udhëzimet për lëvizje kuptohet se i fiton nga koka – vetëm koka mund të shikojë dhe të flasë, ndërsa pjesët tjera të trupit duhet të dëgjojnë se çka u thotë koka. Koka mund të tregojë vetëm përshkrime të përgjithshme që kanë të bëjnë me tërë trupin, por nuk mund të jep udhëzime të ndara që do t'u dedikoheshin vetëm pjesëve të ndara të trupit.

Zgjedhet një vullnetarë i cili do ta prezantojë ushqimin më të dashur. Shumëkëmbëshi do të lëvizë drejt “ushqimit” që ta mos e humb nga syri (edhe pse nuk do të orvatet ta kap). “Ushqimi” do të lëvizë ngadalë (me hapa të vogël) dhe shtrembër – vazhdimisht do të duhet të të kthehet njëherë në njërin e njëherë në anën tjetër.

Shumëkëmbëshit i jepen 3 minuta që të mund koka dhe trupi t'i përshtaten strategjisë së lëvizjes.

Shumëkëmbëshi fillon të lëviz duke e ndjekur “ushqimin” nga njëri kënd në këndin tjetër të hapësirës, ekskluzivisht sipas udhëzimeve të cilat i merr nga koka.

Kur të arrijë në fund të hapësirës së klasës, të gjithë ndalen, i çelin sytë dhe e kuptojnë se ku gjenden – a është trupi i shumëkëmbëshit ende i lidhur ose është ndarë (mos vallë është liruar rripi).

Aktiviteti duhet të përsëritet së paku dy herë, me vullnetarë të ndryshëm. Për secilin shumëkëmbësh të ri, zgjedhet “ushqim” i ri që duhet të lëvizë nëpër shteg të ri.



Diskutim 1

1. “trupit”: A e kishit të lehtë të lëvizni sipas udhëzimeve të “kokës”? A e kishit me lehtë nëse do të mund të parashtroni pyetje?
2. “kokës”: A i respektonin të gjithë pjesëtarët e trupit udhëzimet e dhëna me përpikëri? Si ndjeheshit ju?
3. Pse ndodhte që pjesët e trupit të ndahen dhe në fund të gjithë të gjende në vende të ndryshme? A qëndronte problemi kryesor te udhëzimet?
4. Në çfarë kushte do të mundte shumëkëmbëshi të lëvizte më me sukses, pa mos iu ndarë pjesë të trupit?

Përfundim

Detyrat e përbashkëta janë më të lehta atëherë kur komunikimi mund të vijojë rrjedhshëm në të dy drejtimet. Mirëpo kur njëra palë është e detyruar ta ndjekë tjetrën, pa mos pasur të drejtë t'i parashtrojë pyetje, shumë është me rëndësi që njëra palë të mund me kujdes të dëgjojë, ndërsa pala tjetër të dijë të jep udhëzime të qarta dhe precize, për shkak se ato mund të kuptohen ndryshe.

Aktiviteti kryesor 2

Aktiviteti përsëritet në të njëjtën mënyrë (me lloj të njëjtë të shumëkëmbëshit, i cili lëviz pas ushqimit), por këtë herë ka mundësi por komunikim më të ndryshëm mes koës dhe pjesëve të trupit:

- » shumëkëmbëshi mund të komunikojë ndaras me secilën pjesë të trupit
- » secila pjesë e trupit mund të parashtrojë pyetje

Aktiviteti mund të përsëritet disa herë, derisa pjesëmarrësve iu duket se është interesant.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-8.4: Dëgjim aktiv



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit II-8.4a: Si dëgjoj në mënyrë aktive
- » fletë pune për nxënësit II-8.4b: Dëgjim aktiv, joaktiv
- » flip çart ose tabelë, sellotej

Aktiviteti hyrës

Aktiviteti realizohet në hapësirë të zbratur në mes të klasës. Nxënësit janë të ndarë në çifte. Nxënësit në çift qëndrojnë njëri përballë tjetrit.

Njëri nga çifti imagjinoi se po qëndron përballë pasqyrës në të cilën e shikon veten e tij. Duke qëndruar në vend dhe duke u shikuar në pasqyrë, me tërë trupin lëviz në të gjitha mënyrat e mundshme – ndonjëherë lëviz më shpejtë e ndonjëherë më ngadalë. Pjesëmarrësi tjetër në çift e paraqet imazhin e të parit në pasqyrë. “Imazhi” lëviz duke i imituar të gjitha lëvizjet e tij sa më shpejtë dhe në mënyrë sa më precize.

Pas 2-3 minutave ndërrohen rolet e pjesëmarrësve në çift. Ai që e shikonte veten në pasqyrë, tani bëhet imazh i tjetrit që tash e shikon veten në pasqyrë. Dallimi vetëm është se nga ai që tani e shikon veten në pasqyrë pritet që derisa ta shikojë imazhin e tij të lëvizë ngadalë nëpër hapësirën e klasës. “Imazhi”, kuptohet, duhet ta përcjellë atë. Aktiviteti përfundon për 2-3 minuta.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit janë të ndarë në çifte dhe janë të kthyer kah njëri-tjetri për të zhvilluar bisedë. Secilit nxënës i jepet nga një letër udhëzimi i fshehtë prej fletës së punës “Si dëgjoj në mënyrë aktive 1” dhe u bëhet me dije të mos ua tregojnë nxënësve tjerë. Pastaj e emërtojnë veten si personi A, ndërsa tjetrin si personi B.

“A-ja” fillon i pari – ai duhet ta përshkruajë ndonjë rast kur nuk është ndjerë mirë. Atyre u bëhet me dije se kanë një minutë në dispozicion, e pastaj - pas shenjës së dhënë - do të duhet t’i ndërrojnë rolet. Partneri B e ndjek udhëzimin në kartelën me udhëzim të fshehtë. Pas një minute ndërrohen rolet. “B-ja” flet për diçka shumë të mirë që i ka ndodhur, ndërsa “A-ja” i ndjek udhëzimet.



Diskutim

1. Si ndjeheshit derisa bisedonit? Pse? Si ndikoi në të sjellja e dëgjuesit?
2. Çka na ndihmon që të dëgjohe mi mirë?
3. Çka ju pengon që të dëgjoheni mi mirë?
4. Pse është me rëndësi që në fillim të dëgjojmë se çka na thotë bashkëbiseduesi e pastaj të reagojmë?

Përfundim

Ka gjëra të cilat nëse i bëjmë, kontribuojnë për dëgjim më të mirë reciprok, por ka edhe gjëra të cilat e pengojnë dëgjimin aktiv. Në fillim duhet ta kuptojmë se çka dëshiron të thotë tjetri, e pastaj të reagojmë nëse dëshirojmë të kemi marrëdhënie të mira, si dhe të mos e ofendojmë ndokënd po qe se shpejtojmë.

Pastaj arsimtari i merr kartelat e fletës së punës: “Dëgjim aktiv, joaktiv” dhe për secilën pyet se a e përmirëson dëgjimin aktiv ose e pengon atë. Nxënësit përgjigjen, me çka kërkohen arsye të lidhura me përgjigjet e tyre, ndërsa në fund kartela ngjitet në flipçart - tabelë të përgatitur paraprakisht, e cila është e ndarë në dy kolona: Dëgjimi aktiv dhe dëgjimi joaktiv.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-8.5: Nëse të kuptova si duhet...



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit II-8.5a: Parafrzim 1
- » fletë pune për nxënësit II-8.5b: Parafrzim 2
- » tabelë, shkumës

Aktiviteti hyrës

Grupi ulet në formë të patkoit. Ata të gjithë së bashku paraqesin recepcion të hotelit. Një nxënës e personifikon një mysafir të hotelit. Ai nuk është i kënaqur, ka disa probleme (i jepet një copë letre) dhe duhet ta paraqesë atë para recepcionit (nxënësve tjerë), por pa bisedë (është mysafir i huaj dhe nuk e flet gjuhën e vendit), por komunikon vetëm me gjeste dhe pantomima. Të tjerët me anë të parashtrimit të pyetjeve duhet të zbulojnë se ku qëndron problemi. Mysafiri shpjegon gjithçka përdorisa plotësisht ta përcjellë porosinë tij, e pastaj ulet dhe ndonjë fëmijë tjetër ngrihet dhe bëhet mysafir. Atij i jepet një porosi tjetër të cilën do të duhet ta shpjegojë.

Shembuj për porosi të mysafirëve të pakënaqur:

- » E kërkova një dhomë me pamje. Mendoja për pamje kah deti e jo kah parkingu.
- » Gruaja ime/burri im ka kokëdhembje. A keni ndonjë bar?
- » Nuk i kam mbyll sytë për shkak të mushkonjave. A keni sprej kundër mushkonjave?
- » Desha ta bëj një dush, por nuk ka ujë të nxehtë.

Aktiviteti kryesor 1

Arsimtari tregon që në këtë punëtori do të ushtrojnë detyra për komunikim. Ngjashëm sikur në matematikë, edhe këtu duhet të dihet një formulë e cila mundëson komunikim më të mirë, që njerëzit të kuptohen më mirë mes vete. Formula është $P=N_1+N_2$. Tregohet se P-ja është parafrzim, përsëritej e asaj që është dëgjuar, por me fjalë tjera (jo e plotë, fjalë për fjalë). N_1 është ndjenja e atij që flet dhe N_2 tjetër do të thotë ndodhi – ajo që ka ngjarë dhe ka ndikuar të paraqitet ndonjë ndjenjë e caktuar.

Nxënësve të ndarë në çifte u jepet fleta e punës “Parafrzim 1” dhe u shpjegohet që secili parafrzim mund të bëhet ashtu siç është prezantuar përmes formulës së fletës së punës.

P: “Nëse të kuptova mirë,”

N₁: “ti ndjehesh...” (tregohet ndjenja)

N₂: “për shkak se” (tregohet se çka ka ndodhur).

Pastaj bashkërisht analizohen shembulli i dhënë, kërkohet të zbulohet se cila është ndjenja dhe cili është fakti (ajo që ka ndodhur).

Çifteve të njëjta u jepen nga dy situata nga fleta e punës “Parafrzimi 2” me udhëzim që të theksojnë sesi do ta parafrazonin atë që flet, i cili gjoja se u drejtohet atyre.

Pastaj secila situatë analizohet bashkërisht në dërrasë. Për identifikim më të lehtë të ndjenjave dhe fakteve (ndodhive) mund të jenë të dobishme pyetjet në vijim:

“Si ndjehet ai apo ajo në këtë situatë?”

“Çka ndodhi që ai/ajo të ndjehet ashtu?”



Diskutim 1

1. A ishte lehtë të zbulohen ndjenjat e atij që flet?
A ishte lehtë të kuptohet ajo që ka ndodhur?
2. Pse është me rëndësi të përsëritet me fjalë ajo që është thënë? Pse duhet të përsëriten ndodhitë?
E pse ndjenjat?

Përfundim

Që t'i tregojmë bashkëbiseduesit se e dëgjojmë dhe e kuptojmë çka dëshiron të na tregojë, duhet që sa më saktë t'i përsërisim faktet që na i ka treguar, si dhe ndjenjat të cilat drejtpërsëdrejti ose tërthorazi na i ka treguar. Kjo e lehtëson komunikimin – i shpjegon gjërat edhe për personin që flet edhe për atë që dëgjon.

Aktiviteti kryesor 2

Në çiftet e njëjta, nxënësit vetë e paramendojnë nga një shembull për diçka që ka ndodhur, e që për ata ka qenë problematike. Njëri fillon ta shpjegojë problemin, ndërsa tjetri e dëgjon dhe duhet ta parafranojë sipas modelit të mësuar. Pastaj ndërrohen rolet.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja II-9: BALLAFAQIMI ME SJELLJE TË DHUNSHME

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se cilat lloje të sjelljes së dhunshme ekzistojnë (reketi, izolimi, maltretimi, rrahjet, mbajtja dhe përdorimi i armës së ftohtë dhe armës së zjarrit) » ta dijë se cilat emocione paraqiten te viktimat e sjelljes së dhunshme
Shkathtësi	» të mund të reagojë ndaj përqeshjes dhe nënçmimit të drejtuar ndaj tij » të mund të reagojë ndaj përqeshjes dhe nënçmimit të bërë ndaj të tjerëve » të mund të futet nën lëkurën e viktimës, duke u ngushëlluar me të
Qëndrime/vlera	» t'i shqyrtojë pasojat negative të sjelljes së dhunshme ndaj viktimës » ta shqyrtojë nevojën për ngushëllim me të tjerët

Punëtorja II-9.1: Lea e përqeshur



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Lea e përqeshur
- » tabelë, shkumës

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Një nxënës fillon të bëjë grimasë e cila ka të bëjë me ndonjë ndjenjë. Të gjithë e shikojnë grimasën e bërë, e pastaj nxënësi e “heq” atë nga fytyra e tij dhe ia “jep” nxënësit afër tij. Ai duhet “ta marrë” dhe ta vendosë në fytyrën e tij (ta bëjë grimasën e njëjtë). Pasi që të gjitha ta shohin grimasën e imituar, ajo nxirret dhe hidhet në hapësirën e zbrazur në mes të rrethit. Pastaj nxënësi e bën një grimasë tjetër – u tregon të tjerëve, e nxjerr dhe të gjithë vazhdojnë me radhë deri te nxënësi i fundit.

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësit rrinë ulur në gjysmërreth të hapur në drejtim të dërrasës. Arsimtari e lexon përrallën nga fleta e punës.

Pastaj arsimtari i pyet nxënësit sesi është ndërje Lea, si dhe si do të ndjeheshin ata nëse do të ishin në vend të saj. Përgjigjet e të dyja pyetjeve shënohen në dy letra të mëdha e pastaj kërkohet nga nxënësit t'i krahasojnë përgjigjet.

Pastaj ndahen në grupe me nga katër-pesë nxënës. 2-3 grupeve u parashtrohet kjo pyetje: “Çka do të mund të thoshit dhe të bëni që t'ia bënit me dije Leas se e kuptoni, si dhe t'i ndihmoni që ajo të ndjehet më mirë?”. Pastaj në kuadër të grupit kërkohet që bashkërisht të shkëmbejnë mendime. Nga 2-3 grupet kërkohet që Lea të reagojë vetë me qëllim që të mbrohet nga ofendimet (çka i pengon asaj dhe çka mund të ndërmarrë që ata të cilët e ofendojnë të kenë pasoja).

Pastaj në secilin grup kërkohet nga një vullnetar që ta luajë rolin e Leas, ndërsa anëtarët e tjerë të grupit në mënyra të ndryshme do t'i ndihmojnë asaj që të ndjehet më mirë. Secili grup e aktron këtë situatë, ndërsa te tjerët janë spektatorë. Në fund luhet edhe situata në të cilën Lea mbrohet vetë.



Diskutim 1

1. Sa është i rëndësishëm ngushëllimi për ata që janë të përqeshur dhe të ofenduar? Pse?
2. Çka pamë se mund të ndodhë që të dëshmohej se ndjejmë dhembshuri për ata që janë të përqeshur dhe të ofenduar?
3. Pse është me rëndësi që të ndërmerret diçka në situata të këtilla?
4. A keni marrë pjesë ndonjëherë në situatë të ngjashme kur dikush është përqeshur nga të tjerët?
5. Çka mund të bëjë ai që është i përqeshur dhe i ofenduar që ta lehtësojë situatën?

Përfundim

“Futja nën lëkurën e tjetrit” na ndihmon t'i kuptojmë ndjenjat negative të cilat paraqiten si rezultat i përqeshjes dhe ofendimit. Kjo shkakton nevojë për dhembshuri ndaj atyre që janë të përqeshur ose të ofenduar, andaj duhet të orvatem t'i zbusim ndjenjat negative, të cilat mund të kenë pasoja të rënda për personalitetin e tyre.

Dhembshuria shfaqet përmes pranimit (se ato ndjenja ekzistojnë), e jo me mohim ose nënvlerësim të tyre, pa u referuar në përvoja personale ose në përvoja të të tjerëve të ngjashme me to, si dhe pa sulm, pa nënçmim dhe ofendime ndaj shkaktesit të ndjenjave të tilla. Nëse u bëhet me dije të tjerëve ajo që na e bëjnë neve (përqeshja, nënçmimi), që na lëndojnë, se nëse vazhdojnë ashtu do t'u tregojmë më të rriturve (arsimtarëve, pedagogut, prindërve) që të marrin masa kundër tyre, kjo mund të ndihmojë që t'i ndërpresin ofendimet. Nëse nuk ndalen, duhet të jemi të përpiktë dhe t'u tregojmë të rriturve.

Aktiviteti kryesor 2

Arsimtari tregon se shembulli i Leas së përqeshur është një mënyrë e sjelljes së dhunshme ndaj ndokujt. Pastaj parashtrohet pyetja se në cilat mënyra të tjera njerëzit/fëmijët sillen dhunshëm ndaj ndokujt tjetër. Nxënësit japin ide, ndërsa arsimtari i

Përfundim

Eksitojnë forma të ndryshme të sjelljes së dhunshme, siç janë: “reketi” (marrja e ndonjë gjëje me forcë), izolimi, maltretimi, rrahjet, mbajtja dhe përdorimi i armës së ftohtë etj. Pasojat e sjelljes së dhunshme mund të jenë lëndime fizike dhe/ose psikike, ndërprerja e shoqërisë, dhuna e re (në shenjë hakmarrje) etj.

shënon ato në tabelë. Pasi të shënojnë më shumë gjëra, arsimtari parashtron pyetje për atë se cilat janë pasojat e sjelljeve të theksuara të dhunshme ndaj viktimës. Përgjigjet përsëriten dhe shënohen në tabelë.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit dhe arsimtari qëndrojnë në rreth dhe janë të kthyer me krahun e djathtë kah qendra e rrethit – të rreshtuar njëri pas tjetrit. Secili i shtrin duart dhe i vendos në supet e atij/asaj që është para tij.

Vijon masazh në një mënyrë të pazakonshme, duke i ndjekur udhëzimet e arsimtarit:

1. *Ngadalë fillon të bie shi* (secili nxënës ngadalë fillon t'i bie me gishta në supe nxënësit para tij – sikur t'i bie pianos). Lëvizjen e fillon arsimtari, ndërsa secili do të duhet ta bartë arë te ai i cili është para tij menjëherë kur ta ndjeje në supet e tij dhe duhet të vazhdojë ashtu derisa të ndjejë lëvizje të re.
 2. *Shiu bëhet më i fuqishëm* (goditjet e njëjta, por më të fuqishme);
 3. *Bie gjithnjë e më fuqishëm* (goditjet janë më të fuqishme dhe më të shpejta);
 4. *Fillon të fryjë edhe era* (shtrihen duart dhe me lëvizje të buta kalohet nëpër shpinë dhe shpatulla);
 5. *Fillojnë të vijnë valë nga lumi* (masazh pak më e fuqishme);
 6. *Fillon të bubullojë* (bashkim i gishtave dhe duarve dhe goditje e supeve me maje të gishtave);
 7. *Tani fillon të ndalet shiu, bie gjithnjë e më pak dhe ngadalë fillon të ndalet* (zvogëlohet intensiteti i goditjeve dhe ndërpriten lëvizjet e filluara në fillim).
 8. *Tani më nuk bie shi, por po ngroh dielli* (përkëdhelje e butë e shpatullave me gishta).
- Arsimtari u tregon pjesëmarrësve se është ndërprerë shiu, është ndalur edhe era me çka ka përfunduar edhe loja.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Lea ka probleme me të parit. Kur shkoj me të ëmën në kontroll, mjeku u rekomandoi të blejnë thjerrëza që Lea të mos detyrohet të mbajë syze të rënda me qelq shumë të trashë. Por, thjerrëzat e tilla ishin shumë të shtrenjta. Nënë e Leas para do kohe e kishin pushuar nga puna, andaj ata nuk kishin të holla për të blerë thjerrëza. Lea nuk ka baba që të mund t'u ndihmojë, andaj ajo ishte e detyruar t'i mbajë syzet të cilat ia kishte rekomanduar mjeku. Shumë shpesh fëmijët e shkollës, për shkak të syzeve, e tallin atë. Para disa ditëve në pushimin e madh Riki dhe Sara filluan ta provokojnë. Sara tha: "Oh Lea, si i mban ato kavanoza me grykë të shtrënguar? A e shikon veten ndonjëherë në pasqyrë sesa pamje idioteske ke me ato syze?!" Leas i erdhi keq, iu shtrëngua fyti, por arriti të thotë: "Sara nuk është puna jote se çfarë syza kam unë. Pse nuk e shikon veten e të më lësh mua rehat!"

Ateherë kërceu edhe Riki: "Çka e zë veten ti mori qorre? Shikoje veten çfarë je! Sigurisht, kur gjyshes tënde i harxhohen kavanozat, vendos hajvar në syzet tua. Aq je e verbër, sa që nëna jote çdo ditë duhet të të marrë prej shkollës që të mos humbasësh rrugës për në shtëpi!" Të gjithë fëmijët që ishin tubuar rreth tyre filluan të qeshen. Disa prej tyre, madje, filluan të sillen rreth saj dhe të thonë "Leaa – kavanoz!!!!"

Lea mezi e përmbajti veten nga të qarit. Dëshironte të zhduket.... Vrapoi, që të ikë sa më shpejt nga fëmijët të cilët e provokonin, ndërsa në vete vendosi që kurrë më të mos kthehet në shkollë. Duke vrapuar, i zuri këmba dhe u rrëzua. I lëndoi duart dhe njërin gju. I ranë edhe syzet dhe iu thyen. Fëmijët të cilët e provokonin tani edhe më shumë filluan të qeshen.

Përmbajtja II-10: ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë burimet konflikteve » t'i dijë llojet e ndryshme të reagimeve në situatë konflikti si dhe pasojat e reagimit të tillë » ta dijë se cilat janë nevojat themelore të njerëzve dhe si mund të shkaktojnë konflikt » t'i dijë rregullat e "bisedës unë"
Shkathtësi	» të mund t'i dallojë konfliktet e shkaktuara nga burime të ndryshme » të mund të përmbahet nga kundërshtimi dhe të dijë të vlerësojë se kur duhet "të shmanget" që të sigurohen kushte për komunikim efikas » të mund të përdorë "unë mesazhe"
Qëndrime/vlera	» të pranojë se në secilin konflikt ka së paku dy palë » të shqyrtojë se nga mënyra e reagimit varet se a do të zgjidhet konflikti ose do të dalë jashtë kontrollit » të pranojë se njerëzit mund t'i shohin ndryshe gjërat e njëjta gjë që mund të jetë burim i konfliktit » të pranojë se mosplotësimi i nevojave themelore të njerëzve mund të shkaktojë konflikt

Punëtorja II-10.1: E shikojmë të njëjtën, shohim gjëra të tjera



Materialet:

- » tre qese të errëta me sende të ndryshme: 4-5 vegla, 4-5 pjesë nga pajisja për ngrënie dhe pije ose 4-5 kafshë të plastikës
- » fletë pune për nxënësit II-10.1a: Përralla për elefantin dhe gjashtë mendarët e verbër
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Elefanti
- » fletë pune për nxënësit II-10.1b: Bmx
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Vonimi që nuk është vonim

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në tre grupe. Secilit grup i jepet nga një qese në të cilën ka mjete të cilat përbëjnë komplete të ndryshme. Qesja rri e mbyllur – vetëm me një vrimë të vogël, sa të mund të hyjë dora brenda. Nxënësit në secilin grup shkojnë një nga një dhe çdonjëri e vendos dorën brenda në qese, e kap një send, e hulumton (e mban dorën në qese gjatë gjithë kohës), e përshkruan zëshëm dhe në fund e qëllon se për cilin send bëhet fjalë. Kur të kalojnë të gjithë pjesëtarët e grupit (mundësisht të prekin sende të ndryshme), nga grupi tjetër kërkohet ta tregojë emrin e kompletit në qese.

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësve në çifte u jepet nga një ekzemplar i fletës së punës: “Përralla për elefantin dhe gjashtë mendarët e verbër”. Derisa nxënësit dëgjojnë, arsimtarja ua lexon përrallën me zë. Pastaj, nga gjashtë nxënës kërkohet që ta luajnë këtë përrallë. Ata ndërkohë shërbehen me fotografinë e elefantit (të cilën e mban arsimtarja). Me këtë rast duhet t’u jepet shenjë për pjesët e elefantit. Pastaj vijon një diskutim me të gjithë.



Diskutim 1

1. Cili prej mendarëve ka pasur të drejtë?
2. Cili ka gënjyer?
3. Çka “kanë parë” gjashtë mendarët e verbër sipas bindjes së tyre?
4. Si duket elefanti në të vërtetë?
5. Pse ata nuk kanë mundur ta zbulojnë atë?
6. A kanë qenë vërtetë të urtë gjashtë mendarët e verbër?
7. Çka është dashur të bëjnë që ta zbulojnë se si duket elefanti?

Përfundim

Asnjëri nga mendarët nuk ka pasur të drejtë, për shkak se elefanti nuk duket ashtu si e përshkruajnë ata. Mirëpo asnjëri nga mendarët nuk ka gënjyer për shkak se asnjëri prej tyre nuk e ka shtrembëruar të vërtetën me qëllim, por e ka thënë të vërtetën e vete. Megjithatë ata mendarë kanë qenë në iluzion. Kur njerëzit janë të bindur se e dinë të vërtetën, nuk janë të gatshëm të dëgjojnë çka thonë të tjerët. Të urtit ranë në konflikt mes vete për shkak të dallimeve për atë që e kanë “parë” në vetëdijen e tyre. Konflikti i tyre nuk ka shkaktuar dhunë – por thjesht u ka penguar ta kuptojnë se si në të vërtetë duket elefanti. Nëse kanë dashur ta kuptojnë sesi në të vërtetë duket elefanti, është dashur ta kontrollojnë nga të gjitha anët ose t’i bashkojnë “të vërtetat” e tyre në një të vetme.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësve në çifte u jepet nga një ekzemplar i fletës së punës “Bmx” dhe u parashtrohet pyetja vijuese “Çka ndodh në këtë tregim dhe çka është ilustruar në fotografi? Çka ndodhë në skenën e parë..., e çka në skenën e fundit?”



Diskutim 2

1. Çka mendoni, pse fëmija ka vrapuar t’u tregojë shokëve se e ka parë një biçikletë shumë të mirë, në vend se t’u tregojë se e ka parë një ndeshje të rëndë të trafikut në të cilin një fëmijë ka gjasa ta kishte humbur jetën?

Përfundim

Njerëzit më së lehti i vërejnë dhe më gjatë e mbajnë mend atë që ka të bëjë me nevojat, interesat, vlerat dhe ndjenjat e tyre.

Aktiviteti kryesor 3

Në fillim lexohet situata e fletës së punës: “Vonimi që nuk është vonim” dhe menjëherë pastaj inicohet biseda vijuese:



Diskutim 3

1. Pse e ëma e ka qortuar Elvisin?
2. Pse është vonuar Elvisi?
3. Pse nënat i qortojnë fëmijët kur vonohen?
4. Si e ka shikuar e ëma vonimin e Elvisit? Çka ka menduar ajo?
5. Nëse “do të shikonte me sytë” e Elvisit, çka do të mendonte ajo?
6. Çka është dashur të bëjë e ëma në vend se ta qortojë?
7. Nëse Elvisi “do të shikonte me sytë” e së ëmës, a do të përgjigjej ashtu (në atë mënyrë do ta kundërshtonte dhe do të shfrytëzonte të atin)? Pse?
8. Si do t’i përgjigjej së mëmës në atë rast?


Përfundim

Njerëzit shpeshherë krijojnë ndonjë mendim të caktuar pa pasur informacione të sakta dhe kështu shumë lehtë mund të vijë deri te keqkuptimi dhe mospajtimi me të tjerët të cilët kanë mendim, gjegjësisht pikëpamje, krejtësisht të kundërt për situatën e njëjtë. Për të mos u shkaktuar mospajtime më të mëdha, duhet të orvatemi t’i shikojmë gjërat me sytë e të tjetrit/tjetrës.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Në fund të orëve Zorani sëmuret dhe arsimtarja e lus Elvisi që ta përcejellë Zoranin deri në shtëpi. Si një shok i mirë i Zoranit, Elvisi është i brengosur për shëndetin e tij. Meqë prindërit e Zoranit nuk janë në shtëpi, Elvisi vendos të qëndrojë një kohë te Zorani që të mos e lërë atë vetë derisa t'i kthehen prindërit. Por, kështu kalojnë dy orë dhe kur kthehet Elvisi në shtëpi, nëna e tij e pret në derë e nervozuar: “Ku je deri tash!? Njëqind herë të kam thënë që prej shkolle të vish drejt në shtëpi. Për këtë vonesë do të kesh dënim që sot të mos shikosh televizion!” “Pse të mos shikoj! Babai edhe ashtu do të më lejojë.” – përgjigjet Elvisi.

Punëtorja II-10.2: Konfliktet janë shkallë-shkallë



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Konfliktet janë shkallë-shkallë - 1
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Konfliktet janë shkallë-shkallë - 2
- » shkumës dhe tabelë
- » sellotej
- » balona

Aktiviteti kryesor 1

Kërkohen tre vullnetarë. Secilit prej tyre i jepet nga një balonë, me detyrë që ta fryjnë balonën derisa të pëlçasë.



Diskutim 1

1. A kënaqeshit në lojën apo aktivitetin?
2. A frikësoheshit nga diçka?
3. Si ju dukej juve që e shikonit lojën? A frikësoheshit?
4. A sillen edhe njerëzit ndonjëherë si balonat? Si duket kjo?
5. A ndjehen mirë në këtë rast?

Përfundim

Njerëzit ndonjëherë sillen si balonat. Diskutojnë, u shtohet hidhërimi dhe në një moment mund “të eksplodojnë” dhe kjo të ketë pasoja të këqija ndaj atyre vetë ose ndaj të tjerëve që marrin pjesë në diskutim.

Aktiviteti kryesor 2

Në tabelën e murit vizatohen disa shkallë shumë të thjeshta me nëntë këmbë që janë mjaft të gjera që në secilën prej tyre të mund të ngjitet ndonjë vizatim. Arsimtarja shpjegon se nëpër shkallë mund të shkohet përpjetë, por edhe teposhtë; në rast të konfliktit, nëpër shkallë mund të shkohet përpjetë drejt përmirësimit ose teposhtë drejt përkeqësimit të situatës.

Pastaj ai e lexon përrallën e fletës së punës “Konfliktet janë shkallë-shkallë – 1” duke e shpjeguar me ndihmën e vizatimeve, me ç'rast secili vizatim i ri që paraqitet ashtu edhe ngjitet një shkallë më sipër se vizatimi paraprak.



Diskutim 2

1. Çka ndodhi në fillim? E pastaj? (me ndihmën e vizatimeve përsëriten elementet më të rëndësishme të përrallës, duke i vënë në pah reaksionet e njëpasnjëshme në të dyja anët)
2. Çka ndodhi në fund?
3. Si ndjehet në fund Jana, e si ndjehet Semiri?
4. A sillëshin ata mes vete në mënyrë miqësore apo armiqësore? Pse?
5. Kush është përgjegjës për atë që ndodhi?
6. A u zgjidh konflikti me atë që Semiri dhe Janeja u ulën në banka të ndara?
7. Çka do të ndodhë nëse konflikti ndërmjet tyre nuk zgjidhet?

Përfundim

Për konflikt nevojiten së paku dy vetë. Të dyja palët me sjelljen e tyre ndikojnë në situatën konfliktuale, zakonisht duke u ndërlidhur me njëri-tjetrin në reagime. Sjellja armiqësore në njërin anë (akuza, ofendime, kërcënime, rrahje...) zakonisht shkakton sjellje të tillë, ndërsa në anën tjetër shkaktohet me tendencë që “të fitohet tjetri”. Nëse konflikti nuk zgjidhet, kjo paraqet kërcënim për marrëdhëniet e mira ndërmjet njerëzve dhe rrezik për kultivimin e ndjenjave të mira pozitive ndërmjet vete. Në rastin e Semirit dhe Janës kjo nënkupton se nga këta fëmijë mund të pritet të mos dëshirojnë të ndajnë asgjë mes vete, të mos dëshirojnë të shkojnë në vende ku shkon tjetri, të mos qëndrojnë pranë njëri-tjetrit kur kjo është e nevojshme, të mos dëshirojnë të luajnë në lojën ku luan tjetri, t'i montojnë njëri-tjetrit gjëra, të mos luajnë më ata shokë që luajnë me tjetrin..

Përkundër kësaj sjellja miqësore gjatë konfliktit krijon mundësi që ai të zgjidhet ashtu që të dyja palët të bisedojnë miqësisht dhe të ndjehen mirë, sepse nuk është qëllimi i tyre që ta fitojnë tjetrin, por që të zgjidhet problemi. Në shembullin e përrallës kjo do të thoshte bisedë ndërmjet Janës dhe Semirit në të cilën do të shpjegohet ajo që ka ndodhur, të mos ketë ofendime, kërcënime ose diç tjetër të ngjashme, por të ketë shqyrtim të përgjegjësishë personale dhe kërkim të faljes, madje eventualisht edhe rregullim të pasojave që kanë buruar nga konflikti, mbledhje e ujit të derdhur mbi vizatim, ndihmë gjatë vizatimit ose ngjyrosjes së një vizatimi tjetër nëse nuk mund të shpëtohet vizatimi i lagur...).

8. Si mund të zgjidhet konflikti ndërmjet Janes dhe Semiri që ata të pajtohen në vend që të mbeten të hidhëruar?

Aktiviteti kryesor 3

Fëmijët ndahen në çifte. Secili çift aktron situatë në të cilën zgjidhet konflikti ndërmjet Semirit dhe Janës në ndonjërin nga mënyrat e lartpërmendura. Pastaj disa çifte vullnetare e prezantojnë zgjidhjen e tyre edhe para fëmijëve të tjerë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Konfliktet janë shkallë shkallë - 1

vizatimi 1

Semiri dhe Jana mësojnë në klasë të njëjtë dhe ulen në bankë të njëjtë. Një ditë gjatë pushimit të gjatë Semiri nuk donte të dalë jashtë klasës, por dëshironte të mbetet në klasë që ta përfundojë me ngjyrosje me temperë vizatimin e tij. Ndërkaq Jana dëshironte të dalë me shoqen e saj në oborrin e shkollës. Kështu sapo mbaroi arsimtarja me orën dhe doli nga klasa, edhe ajo menjëherë shpejtoi të ngrihet nga karrigia.

vizatimi 2

Mirë, por duke shpejtuar ashtu, ajo pa dashje e lëkund bankën. Për fat të mirë nuk u derdhën ngjyrat dhe uji, por meqë u lëkund banka, Semiri duke dashur ta mbrojë vizatimin që të mos i priset, e ngriti dorën lart duke harruar se e ka në dorë brushën me temperë të kuqe. Tre pika të ngjyrës së kuqe ranë pikërisht në bluzën e Janës.

vizatimi 3a dhe 3b

(Dialogu rrëfhet me lëvizje të njëpasnjëshme të fletave të prera me personazhin e Janës dhe me personazhin e Semiri)

Jana: „Ahuu, ma përleve bluzën!“

Semiri: „Punë e madhe! Ngjyra lahet me ujë dhe i del “.

Jana: „Po, ama unë nuk mund ta laj këtu në shkollë. Duhet të pres të shkoj në shtëpi. A gjithë ditën të rri kështu me këtë bluzë në shkollë?“

Semiri: „Ehee, po ti ishe fajtores! Ti e lëkunde bankën dhe ngjyra fluturoi!“

Jana: „Sa i marrë je – ngjyrat nuk fluturojnë! Ti me qëllim më spërkate!“

Semiri: „E ti qorrja njëherë, pse mban syze kur nuk shikon sesi e lëviz karrigen!“

Jana: „Po, më mirë qorre se trashalug si ti!“

Semiri: „Kush është bre trashalug? Tash do ta shohësh ti!“

vizatimi 4

Atëherë Jana filloi të vrapojë nëpër klasë, ndërsa Semiri vrapoi të kapë.

vizatimi 5

Derisa po ikte Jana në një moment kaloi pranë vizatimit të Semiri. U ndal aty, e mori gotën me ujë dhe e derdhi të tërën mbi vizatimin e Semirit

vizatimi 6

Atëherë Semiri u tërbua. E kapi Janën dhe e shtyu në tokë.


vizatimi 7


Kur hyri arsimtarja, Jana dhe Semiri i thanë se ata nuk dëshirojnë më të ulen në bankën e njëjtë. Kur i pyeti ajo se për çfarë arsye, edhe Semiri edhe Jana njëzëri filluan të akuzohen mes vete – Semiri thoshte se Jana ia ka prishur vizatimin, ndërsa Jana thoshte se Semiri e ka shtyrë.


vizatimi 8


Arsimtarja i zhvendosi në banka të ndryshme.


Prej atëherë Jana dhe Semiri nuk luajnë më bashkë.























Punëtorja II-10.3: Nevoja



Materialet:

- » fletë pune për nxënës II-10.3a: Nevoja 1
- » fletë pune për nxënës II-10.3b: Nevoja 2
- » fletë pune për nxënës II-10.3c: Nevoja 3
- » fletë pune për nxënës II-10.3ç: Nevoja 4
- » fletë pune për nxënës II-10.3d: Nevoja 5
- » fletë pune për nxënës II-10.3dh: Të gjitha nevojat
- » fletë pune për nxënës II-10.3e: Nevoja – situata
- » tabelë muri dhe shkurtes (ose pajisje përkatëse për të shkruar)

Aktiviteti kryesor 1

Në klasën e zbrazët para fillimit të orës nëpër vende të ndryshme ngjiten fletët e punës për nxënës “Nevojat 1-5”, ashtu që të shihet pjesa e prapme e fletës, ndërsa vizatimi të mbetet i fshehur. Gjatë orës fëmijët ndahen në pesë grupe dhe atyre u jepet udhëzimi që të kërkojnë në klasë pesë gjëra (secili grup nga një) që orën e kaluar nuk kanë qenë aty. Pasi t’i gjejnë të gjithë pesë gjëra, arsimtarja ua shpërndan fletën e punës “Të gjitha nevojat”, e pastaj nga secili grup kërkon t’i shqyrtojnë vizatimet që i kanë zbuluar më parë dhe të tregojnë se cilat nevoja të njerëzve janë prezantuar në vizatime dhe ku e shohin këtë. Në fund zhvillohet një diskutim.



Diskutim 1

1. Si ndjehen njerëzit kur i kanë nevojat e plotësuara?
2. E si ndjehen kur nuk i kanë nevojat e plotësuara?
3. Çka mund të bëjë njeriu kur është i hidhëruar, nervoz...?

Përfundim

Kur i kanë nevojat e plotësuara, njerëzit ndjehen të gëzuar dhe të kënaqur.

Kur nuk i kanë nevojat e plotësuara, njerëzit ndjehen të hidhëruar, nervozë, të pikëlluar, të lënduar, xhelozë, të pa fat etj.

Ndjenjat e pakënaqësisë që shkaktohet nga mosplotësimi i nevojave mund të shkaktohen nga konfliktet.

Aktiviteti kryesor 2

Grupeve të aktivitetit paraprak u jepet nga një situatë e fletës së punës “Nevojat – situatat”. Secilit grup i jepet nga një situatë në të cilën duhet të punojë. Detyra e tyre është të zbulojnë se cila nevojë e paplotësuar e shkakton konfliktin në një situatë. Pastaj secili grup nga një e lexon situatën, e pastaj tregon se cila nevojë e paplotësuar e ka shkaktuar konfliktin. Gjatë kësaj kihet kujdes që kjo të rezultojë me ndërlidhje ndërmjet situatave të fletës së punës dhe nevojave të paplotësuara.

Situata 1 – Nevoja për mbijetesë (pushim)

Situata 2 – Nevoja për siguri

Situata 3 – Nevoja për dashuri dhe miqësi

Situata 4 – Nevoja për respekt

Situata 5 – Nevoja për vetërealizim



Diskutim 2

1. Cila nevojë nuk është përmbushur këtu (Situata 1; 2;...)?
2. E çka mendoni cila/cilat ishte/ishin nevoja/nevojat e të tjerëve në situatë?
3. Çka ndodhë kur nuk plotësohen nevojat?

Përfundim

Nevojat e paplotësuara shkaktojnë ndjenjë të pakënaqësisë dhe mund të shkaktojnë konflikte.

Aktiviteti përmbyllës

Bëhet një top me letër të vjetër, nga gazeta etj., ose përdoret ndonjë top i vogël. Të gjithë qëndrojnë në rreth me karrige pranë vetes. Secili nxënës, kur i jepet topi, i drejtohet ndonjë nxënësi tjetër në këtë mënyrë: Sikur të kishte qenë ky top dhuratë për ty (e thotë emrin e ndonjë nxënësi), kjo do të ishte ... (thotë diçka të bukur). Pastaj topi hidhet te ai nxënës i cili duhet ta përsërisë procedurën e njëjtë, por t'i drejtohet ndonjë nxënësi tjetër, sepse ai që e kaloi rendin tashmë është ulur në karrigen pranë tij dhe nuk mund të pranojë më topa. Loja luhet derisa nuk e kalojnë të gjithë fëmijët. Ai që e merr topin i fundit, i drejtohet nxënësit që e ka filluar lojën.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-10.4: Burimet e konflikteve¹



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit II-10.4a: Burimet e konflikteve
- » fletë pune për nxënësit II-10.4b: Burimet e konflikteve – situata
- » Letër e vjetër, gazeta

Aktiviteti hyrës

Ashtu siç janë ulur, secili nxënës e thotë nga një asociacion të fjalës konflikt, në atë mënyrë që së pari thuhet “konflikt”, e pastaj shtohet fjala që asocion në konflikt; pastaj tjetri thotë “konflikt” dhe shton një asociacion të ri e kështu me radhë derisa secili fëmijë të thotë ndonjë asociacion të fjalës konflikt.

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësit ndahen në 4-5 grupe dhe u jepet për detyrë që secili në grupin e tij ta përmendë një konflikt që i ka ndodhur gjatë javës së kaluar atij ose dikujt që ai e njeh mirë. Pastaj secilit grup i jepet fleta e punës “Burimet e konfliktit”, me ç’rast arsimtarja jep një shpjegim të shkurtër për secilën kategori.

Resurset e kufizuara – paraqesin shkak për konfliktin kur diçka është e kufizuar, kur nuk ekziston në sasinë e duhur. Për shembull: I biri dëshiron t’i blejnë jakne, ndërsa nëna nuk ka kohë ose nuk ka të holla. Ose: është një lodër me të cilën dëshirojnë njëherazi të luajnë edhe vëllai edhe motra.

Nevojat e paplotësuara – për shembull: nëse motra e pi ujin gjatë rrugës dhe vëllai mbetet i etur ose nëse dikë nga shokët nuk e ftojnë në aheng etj.

Vlerat e ndryshme – paraqiten si shkak për konflikt atëherë kur dy persona i japin vlerë të ndryshme të njëjtës gjë ose kur për njërin është më me rëndësi diçka, ndërsa për tjetrin diçka tjetër. P.sh.: gruaja dëshiron të shkojë në pushim në det, ndërsa burri e urren detin dhe dëshiron të shkojë në mal.

Pastaj nxënësit përpiqen që konfliktet e dhëna në gupet e tyre t’i vendosin në njërin nga tre kategoritë, varësisht nga shkaqet që i kanë shkaktuar ato. Pas kësaj, secili grup e zgjedh një konflikt, e prezanton dhe e thotë burimin e konfliktit (në cilën kategori bie dhe pse).



Diskutim 1

1. Çka mendoni, cili do të ishte burimi i këtij konflikti? Pse?

Përfundim

Ekzistojnë konflikte të ndryshme, por çdoherë burimi i konfliktit gjendet në resurset e kufizuara, në nevojat e paplotësuara ose në vlerat e ndryshe të palëve në konflikt.

Aktiviteti kryesor 2

Secilit grup të formuar më parë i jepet kompleti i situatave të prera nga fleta e punës “Burimet e konflikteve - situatat”. Detyra e tyre është që konfliktet e dhëna t’i vendosin në njërin nga tre kategoritë e dhëna nga situatat e prera prej fletës së punës “Burimet e konflikteve – situatat”. Detyra e tyre është që konfliktet t’i vendosin në njërin nga tre kategoritë e dhëna, varësisht nga ajo se cili është burimi i konfliktit në situatat përkatëse. Pastaj arsimtarja i lexon një nga një situatat dhe kërkon nga nxënësit të deklarohen se në cilën kategori i kanë vendosur dhe të shpjegojnë pse.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në dy grupe. Ndërmjet të dyja grupeve vendosen “mina” nga letra e mbledhur në fushën e minuar me gjerësi prej rreth 4 metrash. Nxënësve të njërit grup u lidhen sytë. Secili nxënës i grupit të cilit nuk ia kanë lidhur sytë i prin një nxënësi të palës së kundërt nëpër fushën e minuar duke i dhënë udhëzime sesi të ecë. Qëllimi i aktivitetit është që fusha e minuar të kalohet pa u shkelur minat. Nëse shkelet në mina, loja kthehet prej fillimit.

¹ Rekomandohet që kjo punëtorja të vijojë pas punëtorisë së nevojave.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-10.5: Shmangia, kundërshtimi ose...



Materialet:

- » tabelë muri dhe shkurtesa (ose pajisje përkatëse për të shkruar)
- » stilografë (ose lapsa)
- » fletë pune për nxënësit II-10.5a: Shmangia
- » fletë pune për nxënësit II-10.5b: Kundërshtimi
- » fletë pune për nxënësit II-10.5c: Biseda

Aktiviteti hyrës

Mblidhen të gjitha çantat shkollore dhe vendosen në një grumbull para tabelës. Nxënësit ndahen në tre grupe (A, B dhe C). Secilit grup i jepet nga një udhëzim i mëposhtëm, duke ua tërhequr vërejtjen se derisa punojnë në atë detyrë, nuk guxojnë të flasin:

Për grupin A – detyra juaj është t'i vendosni të gjitha çantat shkollore pranë derës.

Për grupin B – detyra juaj është t'i vendosni të gjitha çantat shkollore në mes të klasës dhe

Për grupin C – detyra juaj është t'i vendosni të gjitha çantat shkollore pranë dritareve të klasës.

Kujdes: Para kësaj duhet të rregullohet hapësira duke i vendosur së paku nga 2 banka në të gjitha vendet e përcaktuara më parë, aty ku duhet të mblidhen çantat.



Diskutim

1. A i ndiqnit udhëzimet?
2. Çka bënit me ata që dëshironin të bëjnë ndryshe nga ju? A u grindët, a u tërhoqët nga detyra juaj, a bashkëpunuat?...

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësit janë ulur në rreth. Arsimtarja e fton secilin nxënë, sipas radhitjes në rreth, që të përgjigjet në këtë pyetje: “Nëse rrëzohesh ngaqë dikush me qëllim ta ka vënë ndërkëmbëzën, si do të ndjehesh?”

Përgjigjet duhet të përbëhen vetëm nga një fjalë dhe procedura e përgjigjeve duhet të rrjedhë shpejt. Arsimtarja i shkruan përgjigjet në tabelë, në një hapësirë të titulluar si “Ndjenjat”. Ato që përsëriten, nuk shkruhen, por vetëm shënohen. Në këtë mënyrë (përmes përgjigjes së dhënë në grup me përgjigje shumë të shkurtra) jepet përgjigje edhe në këtë pyetje:

“Çka do të mund të bëje në situatë të tillë?”

Arsimtarja i thjeshtëson përgjigjet vetëm në dy fjalë, e pastaj i shkruan në tabelë, në një hapësirë të titulluar si “Reagime”. Me ato përgjigje që përsëriten vepron njësoj si herën e kaluar – nuk i shkruan, por vetëm i shënon.

Arsimtarja i shkruan në tabelë tre tipat e reagimeve në situatën konfliktit:

- SH - shmangie
- K – kundërshtim dhe
- B - bisedë

Dhe shkurtimisht shpjegon:

Shmangia si mosinkuadrim në duel të drejtpërdrejtë me atë që e ka shkaktuar konfliktin (p.sh.: ankesa ndaj të tjerëve, braktisja e situatës, injorimi sikur mos të ketë ndodhur asgjë...)

Kundërshtimi si sjellje agresive, qoftë me natyrë fizike ose verbale (p.sh.: sulm, goditje, sharje, kërkesa ndaj të tjerëve që të ndihmojnë të hakmerret...)

Biseda si përpjekje që të kërkohet dhe të ofrohet shpjegim për procedurën joadekuate.

Në vazhdim zgjidhen tre vullnetarë që ta shënojnë tipin e reagimit për secilën nga procedurat e dhëna në situatën konfliktuale. Njëri e shkruan shkronjën Sh para secilit reagim që bie në shmangie, tjetri e shkruan shkronjën K për kundërshtim, ndërsa i treti e shkruan shkronjën B për bisedë.

Në identifikimin e tipave të reagimeve ndihmojnë të gjithë nxënësit.



Diskutim 1

1. Çfarë ndjenjash paraqiten në situatat konfliktuale, siç është ajo e ndërkëmbës? Pse?
2. Cilat janë mënyrat më të shpeshta të reagimit në situata të konfliktit? Pse?

Përfundim

Në situata konflikti, siç është ajo e ndërkëmbës, dominon ndjenja e hidhërimit, e përcjellë me tërbim dhe zemërim. Në situata të tilla mund të reagohej me shmangie, me kundërshtim ose me bisedë.

Mënyrat më të shpeshta të reagimit në kulturën tonë janë shmangia dhe kundërshtimi, zakonisht për shkak të edukatës familjare, por edhe si rezultat i ndikimit të mediave.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit ndahen në grupe me 4-6 anëtarë. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punë “Shmangie”, “Kundërshtim” dhe “Bisedë”, me detyrë që t’i plotësojë në atë mënyrë që në hapësirat e zbrazëta do t’i shkruajë pasojat e mënyrës konkrete të reagimit ndaj:

- » Rezultatit/zgjidhjes së konfliktit (a është konflikti i zgjidhur apo jo; përkohësisht ose vazhdimisht)
- » Vetvetes (si ndjehet ai që ka reaguar në mënyrën e dhënë)
- » Raportit me palën tjetër në konflikt (a do të përmirësohen ose do të përkeqësohen raportet me atë që e ka vënë ndërkëmbës)

Pastaj secili grup i prezanton para të tjerëve përfundimet në të cilat ka arritur për shmangien. Kjo përsëritet edhe për kundërshtimin, e në fund edhe për bisedën.



Diskutim 2

1. Si është zakonisht rezultati i kundërshtimit/bisedës/shmangies? (A është zgjidhur konflikti?) Pse? A janë pasojat ndaj vetvetes pozitive apo negative? A përmirësohen apo përkeqësohen marrëdhëniet me palën tjetër?
2. Kur mund të reagohej me kundërshtim? Kur është e arsyeshme të reagohej me injorim?

Përfundim

Konflikti nuk zgjidhet me kundërshtim. Madje ashtu vetëm fuqizohet – sjellja agresive, nga njëra anë, lind sjellje agresive te pala tjetër dhe kjo shkon deri në pakufi. Edhe pse mund të duket se arrihet një kënaqësi personale (veçanërisht nëse “pala tjetër” është më e dobët fizikisht), ajo çdoherë shpie drejt përkeqësimit të marrëdhënieve të ndërsjella.

Nëse bisedohet, ka gjasa të mëdha që konflikti të zgjidhet përgjithmonë, pa u cenuar marrëdhëniet e ndërsjella, madje edhe me mundësi që ato të përmirësohen. Kënaqësia personale arrihet sepse u jepet mirënjohje ndjenjave personale, e njëherazi shfaqet gatishmëri që të dëgjohen shkaqet që e kanë shkaktuar konfliktin.

Shmangia nuk ofron zgjidhje – shkakton vetëm konflikte të reja, ngase njëra palë vazhdimisht do të dëshirojë t’i hakmerret palës tjetër, me çka përkeqësohen marrëdhëniet e ndërsjella. Nëse asnjëherë nuk kalohet në zgjidhjen e konfliktit, vetëbesimi i palës “së dëmtuar” do të bie. Shmangia është e dobishme vetëm nëse është e përkohshme – kur njëra ose pala tjetër (ose të dyja) në konflikt janë shumë të hidhëruar, ashtu që ky hidhërim nuk u lejon të reagojnë me arsye.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit janë të grupuar në mesin e hapësirës. Kur jepet shenjë, ata fillojnë të këmbëjnë “le të plasë!”, secili me secilin për kohë sa më të shkurtër.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-10.6: “Unë” mesazhe



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit II-10.6a: “Unë” mesazhi 1
- » fletë pune për nxënësit II-10.6b: “Unë” mesazhi 2
- » fletë pune për nxënësit II-10.6c: “Unë” mesazhi 3
- » fletë pune për nxënësit II-10.6ç: “Unë” mesazhi 4
- » pajisje për të shkruar – nga një për secilin grup
- » sellotej

Aktiviteti hyrës

Duke qëndruar në rreth nxënësit e thonë nga një fjali për vete që fillon në këtë mënyrë “Nuk më pëlqen kur të tjerët...”, e pastaj secili e përfundon atë në mënyrë të tij, duke treguar diçka që vërtet nuk u pëlqen te të tjerët (shokët, anëtarët e familjes etj.)

Aktiviteti kryesor 1

Secilit nxënës i jepet nga një kopje e fletës së punës “Unë mesazhi 1”, me ndihmën e të cilës shpjegohet formulimi i “unë mesazheve”. Arsimitarja e lexon me zë situatën dhe fjalinë me të cilën nxënësi i drejtohet arsimtares, duke e shprehur pakënaqësinë e tij ndaj problemit të krijuar. Gjatë kësaj ajo në veçanti ka kujdes ndaj tonit me të cilin e thekson fjalinë e “unë mesazhit”. Pastaj shkurtimisht i shpjegon të tre komponentët e “unë mesazhit” formal, duke e vënë në pah në veçanti radhitjen e prezantimit të komponentëve siç janë dhënë më poshtë.

“Unë mesazhi formal” i ka tre komponentë:

- 1) shfaqjen e ndjenjës që është shkaktuar nga situata e konfliktit – “Unë ndjehem”,
- 2) përshkrimi i sjelljes së personit që llogaritet si burim i drejtpërdrejtë i konfliktit – “kur ti...” dhe
- 3) ofrimi i zgjidhjes për tejkalimin e problemit – “do të dëshiroja/lusja...”



Diskutim 1

1. A siguron kjo mënyrë e të drejtuarit mundësi që personi i pakënaqur ta shfaqë pakënaqësinë e tij? Pse? Si?
2. Çka arrihet me atë që shfaqen ndjenjat e pakëndshme?
3. Çka arrihet me atë që sulmohet vetëm procedura (sjellja) e personit tjetër që llogaritet si burim i problemit? Çka do të ndodhte nëse sulmohet personaliteti i tij?
4. Çka arrihet me atë që ofrohet zgjidhje për problemin? Si duhet të jetë zgjidhja nga pikëpamja e personit tjetër? (a lejohet të ofrohet zgjidhje që nuk është e pranueshme për të dyja palët?)

Përfundim

“Unë mesazhi” siguron shfaqje të pakënaqësisë në mënyrë joakuzuese (nuk e detyron personin tjetër që të mbrohet), por në mënyrë që është konstruktive dhe e cila fton atë në përmirësimin e raportit të ndërsjellë.

Kur i shfaqim ndjenjat e pakëndshme, ne i japim mundësi personit tjetër që të shohë se ajo që ai e ka bërë ka shkaktuar paraqitjen e atyre ndjenjave dhe të dëshirojë që ta ndryshojë sjelljen e tij.

Kur sulmohet vetëm procedura (sjellja) e personit tjetër, atëherë personi tjetër krijon mundësi që t’i kuptojë se cilat nga veprimet e tij nuk na pëlqejnë, që na lëndojnë. Ajo që nuk bën është sjellja. Kur sulmohet sjellja e tij, atëherë personi tjetër fillon të mbrohet me atë që përsëri na sulmon, na lëndon etj. Në këtë rast ne themi se ajo që nuk bën është personaliteti, e jo veprimet e tij. Ku ofrohet zgjidhje për konfliktin, kështu pengohet përsëritja e problemit në të ardhmen. Zgjidhja patjetër duhet të jetë korrekte dhe e pranueshme edhe për personin tjetër.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit ndahen në grupe të vogla (me nga 3-5 anëtarë). Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës “Unë mesazhi 2” duke i dhënë udhëzim që së pari ta lexojë situatën konfliktoze, e pastaj t’i plotësojë fjalitë e deklaratimit formal të “unë mesazheve, me çka personi i pakënaqur ia shfaq problemin personit që e ka shkaktuar atë. Me këtë rast në veçanti theksohet plotësimi që duhet t’u përmbahet komponentëve të kërkuar të “unë mesazhit” – të mos përmbajë fjalë që mund të përjetohen si akuzë, ofendim, kritikë dhe/ose kanosje.

Pas rreth 5 minutash grupet fillojnë me prezantimin e fjalive të shkruara të “unë mesazhit”. Kështu nga një përfaqësues i secilit grup e lexon atë që është shkruar, e pastaj vijon një duartrokitje.

Pasi t’i lexojnë të gjitha grupet fjalitë e tyre të fletës së punës “Unë mesazhi 2”, atëherë u jepet fleta e punës “Unë

mesazhi 3” po ashtu me udhëzimet e njëjta. Pasi të gjitha grupet t’i lexojnë fjalitë e fletës “Unë mesazhi 3”, pastaj u jepet fleta e punës “Unë mesazhi 4” dhe procedura e plotë përsëritet edhe një herë në këtë mënyrë.

Arsimtarja nxit diskutim me tërë grupin në lidhje me këto çështje:



Diskutim 2

1. Sa gjendet në mjedisin tonë kjo mënyrë e të drejtuarit në situatë konflikti: ndërmjet shokëve, në shkollë, në familje?
2. Cilën formë të mesazheve në situatë konflikti do ti quanim “ti mesazhe”?
3. Si ndjehet personi tjetër kur e dëgjon “unë mesazhin”, e si ndjehet kur e dëgjon “ti mesazhin”?
4. Si do të veprojë ai person në një tërë situatë, e si në tjetrën?
5. A e ndjen ai se në të dyja situatat është i sulmuar njësoj? Pse
6. Si do të dëshironit ju t’u drejtoheshin kur dikush është i pakënaqur nga ndonjë punë/ veprim i juaji?

Përfundim

Për fat të keq “unë mesazhi” shumë rrallë haset në komunikimin e përditshëm me shokët, në shkollë ose në familje.

“Ti mesazhe” në situatë konflikti kemi kur njëra palë akuzohet, ofendohet ose kritikohet për diçka.

Kur përdorim “unë mesazh”, te personi tjetër paraqitet ndjenja e turpërimit dhe keqardhjes për veprimet personale, andaj shfaqet gatishmëri që të përmirësohen gjërat, ndërsa kur përdorim “ti mesazhe”, personi tjetër ndjehet i hidhëruar dhe i lënduar, andaj do të përpiqet të mbrohet duke na ofenduar ose duke na sulmuar ose, thjesht, nuk do të dëshirojë të shoqërohet më tej me ne.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësve u jepen nga pesë copa të shiritit me ngjites, të mbështjellë në rrathë, ashtu që në të gjitha anët do të ngjitet. Secili i ngjet shiritat në pjesë të caktuara të trupit të tij. Kur të jenë gati me ngjitjen, arsimtari u shpjegon se kur të japë ai shenjë, secili do të duhet të lirohet nga shiritat e tij, duke i shqepur dhe duke bërë prej tyre një top, të cilin në fund do të duhet ta ndërrojë me dikë tjetër.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Tema III: UNË DHE TË TJERËT – RAPORTET SHOQËRORE

Përmbajtja III-1: NJOHJA E TË DREJTAVE ELEMENTARE TË NJERIUT (TË DREJTAT E FËMIJËVE)

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të ketë informacione për të drejtat e fëmijëve » ta njohë konventën e të drejtave të fëmijëve » të dijë për raportin e drejta / përgjegjësia
Shkathtësi	» të mund t'i dallojë të drejtat e tij dhe të drejtat e fëmijëve të tjerë » të mund ta dallojë shkeljen e të drejtave të tij dhe të drejtave të fëmijëve të tjerë » të mund t'i praktikojë të drejtat e tij në aktivitetet e përditshme
Qëndrime/ vlera	» ta kuptojë se të gjithë fëmijët kanë të drejta » ta pranojë se të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta » të dëshirojë që të drejtat e fëmijëve të praktikohen dhe të zbatohen » të mos e pranojë shkeljen e të drejtave të fëmijëve

Punëtorja III-1.1: Të drejtat dhe rregullat



Materialet:

- » letër për të shkruar
- » pajisje për të shkruar
- » letër e madhe e letrës
- » markerë
- » tabelë dhe shkurtesa
- » fletë pune për nxënësit III-1.1: Komplet i dhjetë të drejtave (neni 31, 42, 23, 12, 15, 19, 32, 38, 9 dhe 7)

Aktiviteti kryesor 1

Fëmijët ndahen në grupe me nga pesë vetë. Secili grup e merr nga një kopje të fletës së punë për nxënësit “Kompleti i 10-të të drejtave” (të prerë në kartela në të cilat në njërin anë është fotografia që e ilustron të drejtën, ndërsa në anën e prapme është neni gjegjës), prej të cilave duhet të zgjedhë pesë të drejta për të cilat mendon se fëmijët i praktikojnë në shkollë dhe pastaj të diskutojë për mënyrat e zbatimit të të drejtave të zgjedhura. Pastaj secili grup e prezanton detyrën e tij të punës para grupeve të tjera.



Diskutim 1

1. Cilat të drejta hasen më shpesh, gjegjësisht cilat të drejta përsëriten në secilin grup?
2. (Për secilën të drejtë) Si e realizojnë nxënësit këtë të drejtë në shkollë?

Aktiviteti kryesor 2

Secili grup duhet t'i mendojë dhe t'i shkruajë nga tre mënyra që i shkelin të drejtat e fëmijëve ndërmjet vete në shkollë dhe tre mënyra me të cilat të drejtat mund t'i lëndojnë të rriturit në shkollë. Pastaj gjysma e grupeve e zgjedhin një situatë të shkeljes së të drejtave ndërmjet vetë fëmijëve, ndërsa gjysma tjetër e zgjedh një situatë të shkeljes së drejtave nga të rriturit. Secili grup duhet ta përgatitë dhe ta aktrojë atë situatë dhe të shpjegojë se cila e drejtë e tij është shkelur, e pastaj ta përgatitë dhe ta aktrojë situatën në atë mënyrë siç do të duhet të ishte respektimi i drejtave të fëmijëve.

Secili nga grupet e prezanton listën e vet, ndërsa arsimtarja e shkruan në tabelë dhe bashkërisht me pjesëmarrësit e hartojnë një listë të shkeljeve më të shpeshta të të drejtave të fëmijëve në shkollë.



Diskutim 2

1. Kush është përgjegjës për realizimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë?
2. Çka mund të bëjnë fëmijët që të luftojnë për respektimin më të madh të të drejtave të tyre?
3. Si mund të sigurohet respekt i drejtave të fëmijëve përmes inkuadrimin të rregullave të sjelljes në klasë dhe në shkollë?
4. Kush duhet të marrë pjesë në miratimin e rregullave? Pse?
5. Kush duhet t'i respektojë rregullat në klasë? Pse?

Përfundim

Shkolla duhet të jetë vend ku fëmijët mësojnë për të drejtat e tyre, ku i zbatojnë këto të drejta dhe ku pritët që të drejtat e tyre të jenë të respektuara dhe të mbrojtura. Rregullat e sjelljes në shkollë duhet të ndërtohen mbi parimet bazë të dhëna në Konventën e të drejtave të njeriut, ndërsa në hartimin e tyre duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive edhe fëmijët.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja III-1.2: Të drejtat dhe përgjegjësitë



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit III-1.2: Komplet i gjashtë çifteve të fotografive të të drejtave dhe përgjegjësie
- » letër
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Nxënësi ndahen në çifte. Ata duhet të qëndrojnë njëri përballë tjetrit me pëllëmbë të prekura për njëri-tjetrin. Pastaj duhet t'i shtrijnë duart kah njëri-tjetri dhe të kapen për pjesën nën bërryl dhe ngadalë të tërhiqen së prapmi që kështu ta ndejnë baraspeshën. Pastaj njëri nga çifti duhet të shtyhet së prapmi, ndërsa tjetri duhet ta përcjellë dhe anasjelltas.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe me nga pesë fëmijë. Secili grup e merr nga një copë të prerë të "Kompletit të gjashtë çifteve të fotografive të të drejtave dhe përgjegjësie" (gjashtë fotografi në të cilat është dhënë e drejta gjegjëse pa tekst në të cilat paraqiten përgjegjësitë që përkojnë me të drejtat e dhëna).

Secili grup merret vesh për tekstin që duhet të qëndrojë pranë përgjegjësisë që vijon nga e drejta e ofruar. Pastaj ato lexohen një nga një: e drejta dhe përgjegjësia e secilit grup. Pastaj për to diskutohet individualisht me të gjithë fëmijët bashkërisht.



Diskutim

1. Çka do të thotë ajo se secila e drejtë e ka edhe përgjegjësinë e saj?
2. A mund të kemi vetëm të drejta? Çka do të ndodhte nëse secili ka vetëm të drejta?
3. A mund të ndeshen njerëzit me të drejtat e njerëzve të tjerë?
4. A janë më të mëdha ose më të fuqishme të drejtat e dikujt nga të drejtat e dikujt tjetër?
5. Si mund t'i realizojmë më lehtë disa të drejta tona, vetë ose bashkërisht me njerëzit e tjerë?

Përfundim

Të drejtat nënkuptojnë edhe përgjegjësi personale për realizimin e tyre. Kjo do të thotë se duhet t'i dimë, t'i zbatojmë dhe aktivisht të inkuadrohemi në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive tona në momentin kur ato janë të rrezikuara ose të shkelura, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve. Përgjegjësi do të thotë edhe vendosja e kufirit të të drejtave dhe lirive tona, i cili lëviz nëpër vijën e realizimit të të drejtave dhe lirive të njerëzve të tjerë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja III-1.3: Sa i njeh të drejtat tuaja?



Materialet:

- » zare, figura (goma, gdhendëse, monedha)
- » fletë pune për nxënësit III-1.3a: Kartela për lojë - kartela me të drejta
- » fletë pune për nxënësit III-1.3b: Kartela për lojë - kartela ndëshkuese
- » fletë pune për nxënësit III-1.3c: Fleta me “të drejtat për neutralizim”
- » fletë pune për nxënësit III-1.3ç: Tabela për lojë
- » fletë pune për nxënësit III-1.3d: Konventa e të drejtave të fëmijëve
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Kartela ndëshkuese dhe të drejtat e neutralizuara
- » shkumës

Aktiviteti kryesor

Formohen grupe me nga dy deri në gjashtë fëmijë dhe secili grup e merr nga një zar, komplet të kartelave me të drejta dhe kartela ndëshkuese (Fletë pune për nxënësit: Kartela për lojë (kartela me të drejta dhe kartela ndëshkuese)”, dhe nga një kopje të fletës së punës për nxënësit “Fleta me të drejtat e neutralizuara”. Po ashtu secilit fëmijë i jepet nga një kopje e Konventës së të drejtave të fëmijëve. Në këtë lojë fëmijët i përdorin vetëm fushat e ngjyrosura të tabelës. Kartelat e lojës do t’u tregojnë fëmijëve se çka duhet të bëjnë. Fëmijët lëvizin para prapa sipas kartelave që i tërheqin. Nëse mund ta emërtojnë të drejtën e shkelur të fëmijës, ata mund edhe “të neutralizojnë” kartelë negative.

Rregullat e lojës:

- » Secili fëmijë e hedh zarin një herë. Fëmija me numër më të lartë është i pari që do ta fillojë lojën.
- » Fëmijë që do të luajë e hedh zarin dhe me figurë lëvizë përpara, pra sipas numrit të zarit.
- » Nëse lojtari gjendet në fushën e ngjyrosur, atëherë e merr një kartelë, e lexon me zë se çka shkruan në të dhe i ndjek udhëzimet që mund të jenë: të shkojë para ose prapa ose ta lëshojë rendin e lojës.
- » Megjithatë, kartela që thotë se duhet të shkohet prapa mund të “neutralizohet” nëse lojtari mund ta emërtojë nenin e shkelur të Konventës së të drejtave të njeriut. Në atë rast lojtari shkon një fushë më përpara.
- » Vazhdon fëmija tjetër që qëndron në të majtë të lojtarit që ka qenë i pari.
- » Fitues është lojtari që ka ardhur i pari në fund, por loja duhet të vazhdojë deri kur të arrijnë të gjithë fëmijët në fund.

Sugjerime për arsimtarin

- » Kur ndonjë fëmijë (nga cilido grup do të hasë në kartelë ndëshkuese, ndërsa nuk e di të drejtën e “neutralizimit”, ai mund të kërkojë ndihmë nga arsimtari. Në atë rast arsimtari do ta lexojë të drejtën me zë (nga fleta e punës së arsimtarit, që të mund ta dëgjojnë të gjithë. Nëse kartela e njëjtë përsëritet edhe te ndonjë fëmijë tjetër (nga ndonjë grup tjetër), arsimtari nuk ndihmon më.
- » Loja mund të luhet edhe në ekip (në vend vetë, mund të bëjë çifte dhe kundërçifte), që të ndihmohen mes vete për identifikimin e “të drejtave të neutralizuara”.



Diskutim

1. Çka mendoni për këtë lojë?
2. A mësuat diçka të re në lidhje me të drejtat e njeriut? E për botën përreth jush?
3. A ju dukeshin disa situata të çuditshme dhe të panjohura?
4. A kishte situata që ju dukeshin të njohura? Cilat ishin ato?

Përfundim

Të drejtat e njeriut janë universale dhe u takojnë të gjithë njerëzve në botë. Në mjedise të ndryshme ndodhë lëndim dhe shkelje e të drejtave të caktuara të njerëzve. Me Deklaratën universale të të drejtave të njeriut është bërë përpjekje që të përfshihen të gjitha të drejtat e njerëzve që, në kushte dhe situata të ndryshme, mund të jenë të rrezikuar.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Kartela ndëshkuese 1

Një shok/shoqe i yti/e ytja e ka humbur një këpucë, por nuk ka mjaft të holla që të blejë një palë këpucë. Shkolla thotë se aty nuk mund të hyjnë nxënës këmbëzbathur. Shko prapa 2 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 27, Standardi jetësor adekuat:
Fëmijët duhet të jetojnë në kushte të mira jetësore që janë adekuate me nevojat e tyre fizike dhe mendore. Qeveria duhet t'u ndihmojë familjeve që nuk kanë mundësi ta sigurojnë këtë vetë.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

Kartela ndëshkuese 2

Prindërit e një fëmije me të cilin ti mëson janë romë. Familja e tyre ka problem të gjejë vend për banim, sepse njerëzit nuk i pranojnë dhe thonë "Ata janë të ndryshëm". Shko prapa 4 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 2, Mosdiskriminimi:
Të drejtat e Konventës i referohen secilit që, pavarësisht nga raca, ngjyra, religjioni, gjinia, aftësitë, botëkuptimet, opinionet, gjuha që e flet e prejardhja, shteti patjetër duhet ta mbrojë fëmijën nga çfarëdo diskriminimi.

Kartela ndëshkuese 3

Ti mëson se në disa vende ka fëmijë që janë të detyruar të luftojnë. Ata janë të uritur, të etur dhe shumë të frikësuar. Shko prapa në fushën 1

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 38, Mbrojtja e fëmijëve në kushte të konfliktit luftarak:
Qeveritë nuk duhet të lejojnë që fëmijët nën moshën 15 vjeç të marrin pjesë në armatë ose të marrin pjesë në çfarëdo mënyre të drejtpërdrejtë në veprime luftarake. Aq më tepër që fëmijët e zonave luftarake duhet të fitojnë mbrojtje të veçantë.

Kartela ndëshkuese 4

Një vajzë e shkollës tënde merret me manekieri. Ajo fiton shumë para dhe fotografia e saj gjendet nëpër gazeta. Por, ajo shpesh mungon nga orët dhe nuk ka kohë t'i bëjë detyrat e shtëpisë ose të luajë me miqtë. Ajo vërtet duket e lodhur. Shko prapa 2 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 32, Mbrojtja nga punët e rënda:
Qeveria duhet t'i mbrojë fëmijët nga puna e rrezikshme, e cila mund ta dëmtojë shëndetin ose shkollimin e tyre ose e cila shpie drejt eksploatimit të tyre.

Kartela ndëshkuese 5

Në shkollë na lejohet ta flasim vetëm gjuhën zyrtare të shtetit. Fëmijët që flasin në gjuhë tjetër, dënohen, madje edhe nëse flasin derisa luajnë jashtë shkollës.

Lëshoje rendin tënd.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 29, Qëllimet e shkollimit:

Arsimi duhet ta zhvillojë deri në maksimum personalitetin e fëmijës, si dhe shkathtësitë dhe talentin e tij. Arsimi i përgatit fëmijët për jetë. Kjo duhet t'i inkurajojë fëmijët që t'i respektojnë prindërit e tyre, kulturën e tyre, si dhe kulturën dhe kombet e tjera.

Ose:

E drejta neutralizuese: Neni 30, Fëmijët e pakicave dhe kombeve autoktone:

Fëmijët që u takojnë pakicave dhe kombeve autoktone: kanë të drejtë ta mësojnë dhe ta përdorin gjuhën dhe traditat e familjeve të tyre, pa marrë parasysh se a janë ata të ndarë ose jo nga shumica e njerëzve në shtet.

Arsimi duhet ta zhvillojë deri në maksimum personalitetin e fëmijës, si dhe shkathtësitë dhe talentin e tij. Arsimi i përgatit fëmijët për jetë. Kjo duhet t'i inkurajojë fëmijët që t'i respektojnë prindërit e tyre, kulturën e tyre, si dhe kulturën dhe kombet e tjera.

Kartela ndëshkuese 6

Në lagjen tënde ka shkollë në të cilën të gjithë fëmijët e religjioneve të ndryshme janë të mirëseardhur, por aty nuk lejohet të hyjnë fëmijë që nuk janë religjiozë.

Lëshoje rendin tënd.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 14, Liria e të menduarit, besimit dhe religjionit:

Fëmijët kanë të drejtë të mendojnë dhe të besojnë çka duan, si dhe ta praktikojnë religjionin e tyre, derisa me të nuk i pengojnë njerëzit e tjerë në përmbushjen e të drejtave të tyre. Prindërit duhet t'i nxisin fëmijët në këto gjëra.

Ose:

E drejta neutralizuese: Neni 2, Mosdiskriminimi:

Të drejtat e Konventës i referohen secilit që, pavarësisht nga raca, ngjyra, religjioni, gjinia, aftësitë, botëkuptimet, opinionet, gjuha që e flet e prejardhja, shteti patjetër duhet ta mbrojë fëmijën nga çfarëdo diskriminimi.

Kartela ndëshkuese 7

Prindërit e shokut tënd vitin e kaluar janë ndarë. Tash nëna nuk e lejon atë ta shohë babanë e vet ose gjyshin e gjyshen e tij. Atij vërtet i mungon babai.

Shko prapa 3 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 9, Prindër që do të kujdesen për të:

Fëmijët nuk duhet të ndahen nga prindërit e tyre, pos nëse kjo është për të mirën e tyre, si në rastet kur prindi sillet keq me fëmijën ose e braktis atë. Fëmijët e prindërve të ndarë kanë të drejtë të mbeten në kontakt me të dy prindërit, pos nëse kjo mund ta lëndojë fëmijën. Qeveria e ka për detyrë t'i sigurojë të gjitha informacionet e nevojshme për ndonjë anëtar të humbur të familjes.

Kartela ndëshkuese 10

Djemtë e klasës tënde kanë ekip futbollit dhe shumë ekupe sportive pas mbarimit të orarit në shkollë, ndërsa vajzat nuk e kanë asnjë ekip.
Shko prapa 2 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 2, Mosdiskriminimi:

Të drejtat e Konventës i referohen secilit që, pavarësisht nga raca, ngjyra, religjioni, gjinia, aftësitë, botëkuptimet, opinionet, gjuha që e flet e prejardhja, shteti patjetër duhet ta mbrojë fëmijën nga çfarëdo diskriminimi.

Kartela ndëshkuese 8

Në klasën tënde është një vajzë që kurrë nuk mund të luajë pas orëve, madje as që ka kohë të mësojë, sepse ajo duhet të kujdeset për vëllezërit e motrat e saj më të vegjël.
Shko prapa 3 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 31, Koha e lirë, loja dhe kultura:

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për pushim dhe lojë, si dhe të drejtë që të jenë pjesë e një numrit të madh të aktiviteteve rekreative dhe kulturore.

Ose:

E drejta neutralizuese: Neni 32, Mbrojtja nga punët e rënda:

Qeveria duhet t'i mbrojë fëmijët nga puna e rrezikshme, e cila mund ta dëmtojë shëndetin ose shkollimin e tyre ose e cila shpie drejt eksploatimit të tyre.

Kartela ndëshkuese 9

Një djalë i klasës tënde refuzon të ndihmojë në pastrim pas drekës, ngase thotë: "Pastrimi është punë vajzash!".
Shko prapa 2 fusha.

A e di të drejtën me të cilën mund ta neutralizosh këtë dënim?

E drejta neutralizuese: Neni 2, Mosdiskriminimi:

Të drejtat e Konventës i referohen secilit që, pavarësisht nga raca, ngjyra, religjioni, gjinia, aftësitë, botëkuptimet, opinionet, gjuha që e flet e prejardhja, shteti patjetër duhet ta mbrojë fëmijën nga çfarëdo diskriminimi.

PËRMBAJTJA III-2: RESPEKTIMI I TË TJERËVE (MOSDISKRIMINIMI)

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se ekzistojnë dallime ndërmjet njerëzve (racore, gjinore, etnike, religjioze) » të dijë për principin e barazisë
Shkathtësi	» të mund të marrë pjesë në diskutime për jetën e tij dhe të tjerëve » të mund të shfaqë respekt ndaj dallimeve ndërmjet njerëzve » të mund ta dallojë kur ndaj dikujt veprohet në mënyrë të pabarabartë
Qëndrime/vlera	» ta pranojë dallimin si diçka pozitive » ta pranojë raportin e njëjtë ndaj të tjerëve pa marrë parasysh ngjashmëritë dhe dallimet

Punëtorja III-2.1: Biznesmenë dhe fotomodelë



Materialët:

- » markerë ose flomasterë të trashë
- » fleta më të mëdha të letrës
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Fletë pune me shenja të pesë grupeve të ndryshme
- » kuti
- » katrorë të letrave ngjyeshme në pesë ngjyra të ndryshme

Aktiviteti hyrës

Arsimtari qysh më parë ka përgatitur katrorë të vegjël të letrave ngjyeshme në pesë ngjyra ndryshme dhe secilit fëmijë ia ngjet nga një letër të tillë në ballë. Fëmijët duhet të ngrihen dhe të grupohen në pesë grupe, sipas ngjyrës së fletës së letrës ngjyeshme që e kanë në ballë, por gjatë kësaj nuk guxojnë të flasin.

Aktiviteti kryesor

Në pjesë të ndryshme të hapësirës do të renditen pesë grupe të karrigeve në të cilat pritët të ulen nxënësit pasi të bëhet ndarja në grupe.

Pastaj arsimtari nga fleta e punës i ofron fletat me shenja të grupeve: nxënës të shkëlqyeshëm, biznesmenë, shkencëtarë të njohur, fotomodelë të famshëm dhe politikanë, të cilat i ka kthyer me tekst të fshehur dhe kërkon nga secili grup që ta tërheqë një fletë. Pastaj të gjithë anëtarët e grupit paramendojnë se i takojnë atij grupi.

Secili nga ata e merr nga një flomaster dhe nga një fletë letrë. Me këtë rast arsimtari ua jep këtë udhëzim: “Shkruani në letra me shkronja të mëdha të gjitha tiparet që zakonisht i përshkruhen grupit në të cilit ju tash gjoja i takoni!”.

Pas dhjetë minutave, kur secili grup do të ketë listë të dhjetëra tipareve, fillohet me prezantim. Fletat e letrës ngjiten në mur dhe prej aty një përfaqësues i grupit lexon se çka është shkruar.

Kur të mbarojnë të gjitha grupet me prezantimin, për secilin nga tiparet e dhëna arsimtari (bashkë me të tjerët) shënon se a është ai pozitiv ose negativ (ose neutral).



Diskutim

1. Nëse vërtet u takoni grupeve të dhëna, me të cilat tipare do të krenoheshit? Cilat tipare do të dëshironit t'i ndryshoni?
2. A i kanë edhe në realitet të gjitha tiparet e dhëna të gjithë njerëzit që u takojnë grupeve të tilla. A janë të sakta ato botëkuptime të thjeshta që ne i kemi për ata?
3. Si ndjehen ata të cilëve ne ua përshkruajmë disa tipare negative, ndërsa ata aspak nuk kanë lidhje me ato sjellje?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Madje edhe njerëzit që u takojnë grupeve të njëjta nuk kanë karakteristika identike; ata dallohen mes vete për një varg tiparesh. Shumë shpesh pjesëtarëve të grupeve të veçanta u përshkruajmë karakteristika që nuk u takojnë të gjithë pjesëtarëve të grupit dhe ato karakteristika shpesh janë negative, e ndonjëherë edhe pozitive. Karakteristikat negative që ua përshkruajmë grupeve shumë shpesh i lëndojnë pjesëtarët e grupit.



NXËNËS TË
SHKËLQYESHËM

BIZNESMENË

SHKENCËTARË
TË NJOHUR

FOTOMODELË

POLITIKANË

Punëtorja III-2.1: Me sy bojë kafe ose pa to

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në treshe dhe detyra e secilit tresh është që t'i paramendojë tre punë që vlejnë për të gjithë ata në tresh me çka do të prezantohen para të tjerëve. Dy nga ato gjëra duhet të jenë të vërteta, ndërsa njëra nuk duhet të jetë e vërtetë. Grupi duhet ta qëllojë se cila nuk është e vërtetë:

Për shembull:

Të gjithë ne kemi qenë në pushim, në mal. – gënjeshtër

Të gjithë ne kemi motra më të vogla. – e vërtetë

Të gjithë ne e pëlqejmë aktorin Bred Pit. – e vërtetë

Pas secilit pohim të qëlluar arsimtarja kërkon nga fëmijët që ta sqarojnë zgjedhjen e tyre.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ulen në rreth, ndërsa arsimtarja e jep këtë udhëzim:

"Të gjithë ata që kanë sy bojë kafe le të ngrihen!"

Nëse ka më pak se 10 nxënës me sy bojë kafe, kërkohet të ngrihen edhe ata me sy të zinj. Arsimtarja kërkon që të gjithë me sy bojë kafe (dhe eventualisht të zinj) që të vijnë në mesin e hapësirës. Nxënësit e tjerë duhet t'i tërheqin karriqet kah muret dhe të ulen derisa zgjat aktiviteti, pa pasur mundësi të marrin pjesë në të në çfarëdo mënyre (nuk guxojnë as të hedhin fjalë).

Nxënësit me sy bojë kafe (dhe të zinj), të ndarë në grupe prej 6-10 personash, do ta luajnë këtë lojë:

Në kuadër të secilit grup nxënësit renditen njëri pas tjetrit dhe kapen për beli, duke formuar një vëmje. Meqë kjo vëmje përpiket vazhdimisht ta kapë bishtin e saj, edhe ata do të përpiqen ta bëjnë këtë. Kështu, koka e vëmjes (i pari i kolonës) do të duhet ta gjuajë bishtin (të fundit në kolonë), ndërsa të gjithë të tjerët duhet ta pengojnë, duke lëvizur majtas-djathtas, pa u shkëputur fëmija që është para tyre. Kur ta arrijë koka bishtin, ajo shkon në fund të kolonës dhe qëndron në bisht. Nxënësi që më parë ka qenë pas saj, tash bëhet koka. Derisa vazhdon aktiviteti, duhet të kihet kujdes për nxënësit e tjerë që në asnjë mënyrë të mos mund të marrin pjesë në të. Pas disa minutave aktiviteti ndërpritet dhe të gjithë kthehen në rreth.



Diskutim

1. (atyre që luanin) A ishte argëtuese loja? (atyre që nuk luanin) A dëshironi të merrni pjesë në lojë?
2. Pse dikush mori pjesë, ndërsa të tjerët jo? A ishte kjo e drejtë?
3. A është e drejtë në përgjithësi që të veprohet ndryshe me njerëzit për shkak të disa karakteristikave të tyre të jashtme ose për shkak të disa tipareve të tjera që nuk kanë lidhje me aktivitetin që e zgjedhin?
4. A mund të jetë i drejtë veprimi i pabarabartë?
5. Si ndjehen personat ndaj të cilëve veprohet ndryshe?

Përfundim

Me të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh tiparet dhe karakteristikat e tyre, në të gjitha kushtet duhet të veprohet njësoj. Kur dikujt i lejohet diçka që të tjerëve u ndalohej, pa pasur shkak të vërtetë për këtë, kjo do të thotë se kemi shkelje të principit të barazisë, gjegjësisht diskriminim.

Diskriminimi është i padrejtë dhe të gjithë që janë të diskriminuar ndjehen të anashkaluar dhe të ofenduar.

Aktiviteti përmbyllës

Arsimtarja i fton të gjithë nxënësit që të marrin pjesë në aktivitet: "Hajde tash të gjithë ta luajmë lojën!"

Loja përsëritet edhe një herë, tash me të gjithë nxënësit. Me këtë rast, detyrimisht formohen disa vëmje.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja III-3: MBËSHTETJA DHE BASHKËPUNIMI I NDËRSJELLË

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të dijë për raportet e ndryshme që vendosen mes njerëzve » të dijë për gjërat që nuk mund t'i bëjë dikush vetë » të dijë për situatat e ndryshme në të cilat njerëzit mund të kenë nevojë për mbështetje » të dijë se pse kanë nevojë për mbështetjen e të tjerëve
Shkathtësi	» mund t'i ndajë interesat, nevojat dhe problemet e tij me të tjerët » mund t'i kuptojë problemet dhe nevojat e të tjerëve » mund ta vërejë kur të tjerët kanë nevojë për mbështetje dhe ndihmë
Qëndrime/ vlera	» të hetojë se ka dobi nga bashkëpunimi dhe mbështetja » të miratojë dhënie të ndihmës dhe të pranojë ndihmë » të jetë i/e bindur se bashkërisht mund të arrihet më shumë

Punëtorja III-3.1: Tre në një



Materialet:

- » dy gota të njëjta të letres ose të plastikës (patjetër të jenë të lehta)
- » orë ose telefon celular që i mat edhe sekondat
- » bankë ose shportë mbeturinash
- » batanije

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në dy grupe dhe ecin në dy anët e kundërta të klasës. Pastaj kërkohet nga një vullnetar prej secilit grup të cilët do ta mbajnë batanijen në mes të klasës të ngritur në ajër – si perde, ashtu që grupet nuk do të mund të shihen mes vete. Secili nga grupet e cakton një fëmijë që do të qëndrojë afër batanijes, në mes të klasës (secili në anën e tij). Pas shenjës së dhënë nga arsimtarja, të dy vullnetarët e lëshojnë batanijen të bie, ndërsa fëmijët e zgjedhur pranë batanijes sapo të bie batanija do të duhet ta thonë emrin e fëmijës që e shohin përballë tyre. Fëmija që do ta thotë i pari emrin e fëmijës së ekipit kundërshtar është fitues, ndërsa fëmija tjetër do të duhet të kalojë në anën e fituesve. Loja luhet rreth 10 herë.

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësit qëndrojnë të ulur në rreth, ndërsa në mes të rrethit të formuar prej tyre është vendosur një bankë. Në njërin cep të bankës ka gotë letre, ndërsa nën këndin tjetër të bankës është vënë shporta e mbeturinave.

Së pari merr pjesë njëri prej tyre – ai që është paraqitur i pari. Arsimtarja jep shenjë për fillim dhe e mat kohën e harxhuar për kryerjen e detyrës. Nxënësit tjerë mund të luajnë rol tifozi.

Pastaj detyrën e njëjtë e marrin ta bëjnë edhe tre vullnetarë të tjerë – prej tyre pritet që bashkërisht t'i fryjnë gotës derisa ta hedhin në shportën e mbeturinave.

Procedura për matjen e kohës përsëritet, me ç'rast pritet që në situatën e dytë koha të jetë më shkurtër.



Diskutim 1

1. Kur kryhej më shpejt detyra – kur frynte vetëm një apo kur frynin tre vetë? Kur ishte detyra më e lehtë? Pse?
2. Si ndjeheni kur nuk mund të kryeni ndonjë detyrë (ose kur e kryeni shumë ngadalë) sepse keni pasur nevojë për ndihmë, ndërsa askush s'ju ka ndihmuar?
3. Cilat janë përparësitë e punës grupore ndaj kryerjes individuale të detyrave?
4. Cilat janë mangësitë (çka nëse anëtarët e grupit nuk bashkëpunojnë ndërmjet vete, por secili vepron si i pavarur)?

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit ndahen në disa grupe me nga pesë vetë. Secili grup merr shkronja të njëjta nga një fjalë e njëjtë (secila shkronjë është e shkruar në letër) dhe detyra e tyre është që të krijojnë fjalë sa më të gjata për kohë sa më të shkurtër. Arsimtarja e përcakton kohën që duhet të jetë rreth 2 minuta për një detyrë. Fitues do të jetë ai grup që ka krijuar fjalë më të gjatë në secilin rreth të lojës.

Propozim-fjalë

KRYETAR

KOLEKTIVISHT

SHOQËROR

LULISHTË

KOTEC PËLLUMBASH



Diskutim 2

1. Çka mendoni, kur do të kryhej kjo detyrë më shpejt: nëse secili vetë do të duhej të formulojë fjalë apo kështu në grup?
2. Ndërsa kur kryhet më mirë: nëse punon secili vetë apo nëse punohet në grup?
3. Çka u arrit më shumë që në këtë detyrë morën pjesë më shumë nxënës?

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në grupe me nga dhjetë veta dhe secilit grup i jepet nga një batanije. Njëri nga nxënësit duhet të shtrihet në mes të batanijes, ndërsa nxënësit e tjerë duhet ta kapin batanijen nëpër skaje dhe me kujdes ta ngrenë në ajër. Pastaj batanijen duhet ta luhatin ashtu që ai që është i shtrirë në të të kërcejë në ajër. Procedura përsëritet me të gjithë nxënësit që dëshirojnë “të hidhen” në batanije..



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Shumica e gjërave që mund të bëhen edhe vetë edhe në mënyrë grupore, më mirë (më me sukses dhe më shpejt) kryhen nëse punohen në mënyrë grupore. Që puna grupore të jetë e suksesshme, patjetër duhet të ekzistojë bashkëpunim ndërmjet anëtarëve të grupit – të gjithë të japin gjithçka nga vetja e tyre dhe ta ndihmojnë njëri-tjetrin në realizimin e qëllimit të përbashkët.

Punëtorja III-3.2: Nga fjalët deri te fjalitë



Materialet:

- » tabelë dhe shkumës
- » fletë punë për nxënësit III-3.2: Fjali të shpërndara – nga një komplet për secilin grup (në secilin komplet ka nga pesë zarfe me pjesë të fjalive, të përgatitura në karton)
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Fjali të formuluar

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në grupe me nga shtatë-tetë vetë dhe secili grup e ka për detyrë të bëjë një fjalë të shkurtër me trupat e tyre. Arsimtari e tregon fjalën dhe secili grup pastaj e ushtron që ta formojë atë fjalë. Pastaj arsimtari kërkon nga grupet që një nga një ta shfaqin fjalën, ndërsa të tjerët i shpërblejnë me duartrokitje.

Propozim-fjalë

KËNDON

GJUMË

TULIPAN

PESHK

LEJLEK

DITË

DHI

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe nga pesë anëtarë. (Ata që mbesin vihen në rol të vëzhguesve). Secili grup e merr nga një komplet të fletës së punës për nxënësit "Fjalitë e shkapërderdhura". Secili nxënës në grup e zgjedh nga një zarf nga kompleti (zarfet janë shënuar me numrat 1 deri në 5).

Arsimtari i jep udhëzimet e mëposhtme:

"Nga fjalët që i keni marrë, secili grup duhet të formulojë nga pesë fjalë të kuptimta. Detyra do të konsiderohet si e kryer atëherë kur secili anëtar i grupit para vetes do të ketë të formuluar një fjalë të kuptimtë, me ç'rast të gjitha fjalët që janë në disponim të grupit tuaj do të përdoren:

Gjatë gjithë kohës derisa i formuloni fjalitë, patjetër duhet t'i respektoni këto rregulla:

Askush me askënd të mos flasë.

Askush askujt nuk guxon t'i japë kurrfarë shenje.

Askush nuk guxon të marrë ose të japë fjalë që nuk janë të tij.

Secili mund të japë nga fjalët e tij anëtarëve të tjerë të grupit.

Rregullat në version të shkurtuar shkruhen në tabelë:

Pa fjalë

Pa shenja

Pa marrje ose dhënie

Vetëm me dhënie



Diskutim

1. A mund ta përmbushë dikush detyrën pa ndihmën e anëtarëve të tjerë të grupit?
2. A i shkelë dikush rregullat? Çka ndodhi?
3. Kur filluat ta ndihmoni njëri-tjetrin dhe të bashkëpunoni?
4. Si ndjeheshit kur e kishit patjetër të bashkëpunoni?

Përfundim

Bashkëpunimi shumë shpesh do të thotë ndihmë e ndërsjellë – ai që pret të ndihmohet patjetër edhe vetë duhet të ndihmojë. Sa më shumë që vështirësohen kushtet, aq më shumë nevojitet ndihmë.

Aktiviteti përmbyllës

Fëmijët ndahen në grupe me nga 10 persona dhe të gjithë ndalen njëri pas tjetrit, duke formuar rreth. Fëmijët duhet të jenë shumë afër njëri-tjetrit dhe secili fëmijë me shputën e tij të majtë duhet ta prekë shputën e fëmijës që e ka përpara dhe prapa. Pastaj fëmijët fillojnë të lëvizin në rreth sipas ritmit që e përcakton arsimtarja (për shembull: duke i rrahur duart). Pasi ta harmonizojnë fëmijët lëvizjen, ajo u thotë se kur të japë ajo shenjë se duhet të ulen, ata do të mbështeten ngadalë në gjurin e njëri tjetrit. Në shenjën “Tash” të gjithë fëmijët ulen. Loja përsëritet derisa fëmijët nuk e përfundojnë me sukses, e pastaj shpërblehen me duartrokitje të madhe.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Fjali të formuluar

2 Muri	1 kinez	4 është	2 ndërtimi	3 i vetëm	5 që	4 shihet	3 nga Hëna.
-------------------------	--------------------------	--------------------------	-----------------------------	----------------------------	-----------------------	---------------------------	------------------------------

2 Balenat	5 komunikojnë	1 me tinguj	4 në largësi	3 të mëdhaja.
----------------------------	--------------------------------	------------------------------	-------------------------------	--------------------------------

2 Busulla	3 e parë	5 është bërë	1 në Kinë.
----------------------------	---------------------------	-------------------------------	-----------------------------

4 Pianoja	1 është	3 instrument	1 me tela,	5 njësoj si	2 kitara.
----------------------------	--------------------------	-------------------------------	-----------------------------	------------------------------	----------------------------

5 Betoveni	3 ka kompozuar	2 muzikë	4 edhe kur	5 ka qenë	1 plotësisht	4 i shurdhër.
-----------------------------	---------------------------------	---------------------------	-----------------------------	----------------------------	-------------------------------	--------------------------------

Punëtorja III-3.3: NDIHMË!



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit III-3.3: NDIHMË!
- » fletë për vizatim
- » pajisje për ngjyrosje
- » sellotej

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth dhe secili duhet të japë nga një shembull për atë se si i ka ndihmuar dikujt javën e kaluar. Për shembull: “Unë i ndihmova vëllait tim që t’i lidhë lidhëset e atleteve.” ose “Unë e vizitova gjyshen time të sëmurë dhe bisedova me të”.

Aktiviteti kryesor

Arsimtari i ndan nxënësit në grupe me nga katër nxënës dhe secili grup e merr nga një komplet kartelash, të prera nga fleta e punës për nxënësit “NDIHMË!”. Detyra e tyre është që të merren vesh dhe t’i ndajnë kartelat në bazë të asaj se në çfarë situatë mendojnë se duhet të ndihmohet ose të jepet mbështetje më shumë, ndërsa në cilin situatë më pak. Gjatë ndarjes së kartelave duhet të shërbehen me skemën e diamantit, që do të thotë se situatat duhet t’i shpërndajnë në këtë mënyrë:

		-			1 më shumë
	-		-		2 shumë
-		-		-	3 mesatarisht
	-		-		2 pak
		-			1 më së paku

Pastaj nga një përfaqësues i secilit grup e prezanton rendin e kartelave të grupit të vet, të përcjellë me zgjedhjen e kartelës së parë dhe të fundit.



Diskutim

1. Kujt mund t’i duhet ndihmë apo mbështetje?
2. Me çka mund ta vërejmë se dikujt i duhet ndihmë apo mbështetje?
3. A mund të presim çdoherë që ai që ka nevojë për ndihmë ose për mbështetje që atë ta shprehë ose ta kërkojë?
4. Në cilat mënyra mund të ndihmohet?
5. Pse është me rëndësi të ndihmohet?
6. Pse është me rëndësi të jepet mbështetje?

Përfundim

Secili nga ne pavarësisht nga mosha në një periudhë të caktuar mund të ketë nevojë për ndihmë ose për mbështetje. Ndonjëherë kjo është shumë e qartë, ndërsa ndonjëherë nevojitet një ndjenjë e veçantë e përjetimit të gjendjes së tjetrit që të kuptohet se ai ka nevojë për ndihmë. Ai që ka nevojë për ndihmë ose për mbështetje mund ta kërkojë atë haptazi, por ndonjëherë mund të mos ketë fuqi të kërkojë ndihmë. Ndhima mund të jepet në mënyra të ndryshme; ndonjëherë edhe ndihma më e vogël për dikë mund të jetë shumë, sepse përmes saj mund të shihet se është i respektuar dhe se dikujt i vlen për diçka që të fitojë vullnet dhe të vazhdojë më tej. Është shumë me rëndësi që të ndihmohet dhe të jepet mbështetje dhe kështu të ndërtohen marrëdhënie të bashkëpunimit dhe ndihmës ndërmjet njerëzve. Kështu më lehtë dhe më shpejt mund t’i realizojmë nevojat dhe dëshirat personale dhe kolektive. Nëse ofrojmë ndihmë dhe mbështetje për të tjerët, kështu krijojmë kushte që edhe ne të fitojmë ndihmë dhe mbështetje kur do të kemi nevojë për të.

Aktiviteti përmbyllës

Secili nxënës e merr nga një fletë letre dhe në të duhet ta vizatojë dorën e vet, ndërsa në pjesën e sipërme të letrës duhet ta shkruajë “Dorë që ndihmon”. Pastaj në do të duhet t’i shkruajë disa mënyra me të cilat dora e tij u ndihmon të tjerëve dhe pastaj duhet ta stolisë “dorën”. Në fund, kush dëshiron nga nxënësit, mund ta prezantojë dorën e tij para të tjerëve, e pastaj të gjithë nxënësit i ngjisin duart ne një poster të përbashkët..



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja III-4: NJOHJA E STRUKTURËS SË GRUPIT

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë elementet e grupeve të ndryshme (shkolla, sporti, grupet joformale) » ta dijë raportin ndërmjet elementeve të caktuara » ta dijë rolin e secilit element » ta dijë vendin e tij në grup
Shkathtësi	» të mund të jetë pjesë e grupeve të ndryshme » të mund të komunikojë në mënyrë adekuate me pjesët e caktuara të grupeve » të mund ta përdorë grupin për qëllimin (mandatin) e tij
Qëndrime/ vlera	» ta kuptojë dhe ta pranojë vlerën e strukturës » të dëshirojë të jetë pjesë e strukturës së caktuar » ta pranojë ekzistimin e strukturave të ndryshme

Punëtorja III-4.1: Sa shumë grupe!?



Materialet:

- » letër për të shkruar
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti kryesor 1

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa me numëratore përcaktohet se kush duhet të dalë jashtë rrethit. Pastaj të gjithë që janë në rreth kapen për duar dhe detyra e tyre është që ta pengojnë nxënësin që është jashtë rrethit që ai të hyjë në rreth, ndërsa ai duhet të mundohet që në çdo mënyrë të futet në rreth. Loja ndërpritet nëse vullnetari arrin të hyjë në rreth ose pas një ose dy minutash lojë, pavarësisht nga fundi.



Diskutim 1

1. Si ndjehej vullnetari?
2. Si është ndjenja kur mund të bëhesh pjesë e grupit?
3. Si ndjeheshin fëmijët në rreth?
4. Si është ndjenja që mos ta lejosh dikë të bëhet pjesë e grupit?

Përfundim

Njerëzit kanë nevojë t'i përkasin ndonjë grupi dhe të jenë bashkërisht me njerëzit e tjerë. Është ndjenjë e keqe kur dikush dëshiron, e nuk mund të bëhet pjesë e një grupi të caktuar.

Aktiviteti kryesor 2

Të gjithë nxënësit ulen në rreth dhe arsimtarja u thotë se do t'i lexojë disa pohime të cilat kanë të bëjnë me përkatësinë në grupe të caktuara dhe nxënësit që kanë lidhje me pohimin e lexuar do të duhet të ngrihen në këmbë, ndërsa të tjerët duhet të ulen.

- » grupi i vëllezërve dhe motrave më të mëdhenj
- » grupi i adhuruesve të muzikës tekno
- » grupi i fëmijëve që ushtrojnë ndonjë sport
- » grupi i nxënësve
- » grupi i adhuruesve të natyrës
- » grupi i fëmijëve që janë vegjetarianë
- » grupi i fëmijëve që janë anëtarë të ndonjë seksioni
- » grupi i nxënësve të (paralelja ku mësojnë)
- » grupi i nxënësve të (shkolla ku mësojnë ata)
- » grupi i nxënësve të (vendi ku është shkolla)



Diskutim 2

1. A ngriheshin gjatë gjithë kohës fëmijët e njëjtë?
2. A kishte fëmijë që asnjëherë nuk u ngritën?
3. A kishte që u ngritën disa herë?
4. Me çka dalloheshin fëmijët që ngriheshin apo që nuk ngriheshin në situata të ndryshme?
5. A janë të organizuara të gjitha këto grupe që i përmendëm, gjegjësisht a kanë strukturë dhe role të veçanta që u delegohen anëtarëve?
6. Cilat nga këto grupe janë të organizuara (cilat janë formale)?
7. Cilat nga këto grupe formale ekzistojnë?
8. E cilat nga këto grupe nuk janë të organizuara në veçanti (cilat janë joformale)?
9. Cilat grupe të tjera joformale i njihni?

Përfundim

Të gjithë ne u takojmë grupeve të caktuara. Disa prej tyre kanë struktura të caktuar dhe janë të organizuara me role të veçanta të deleguara për anëtarët. Ato janë grupe formale. Të tilla janë: klubet sportive, anëtarët e seksionit, shkolla, shoqatat e natyrës, organizatat e ndryshme joqeveritare, klubet rinore etj. Ekzistojnë edhe grupe joformale. Në një pjesë të tyre ne bëjmë pjesë që nga lindja (fëmija i parë/i dytë/i tretë) ose në ngjashmërinë e interesave që i kemi me të tjerët. Për shembull, grupi i moshatarëve, grupi i dashamirëve të natyrës ose i ndonjë lloji të muzikës etj.

Aktiviteti kryesor 3

Secili nxënës në letër duhet të shkruajë së paku katër grupe të ndryshme (formale dhe joformale) të cilave u takon dhe të cilat i konsideron si të rëndësishme për të. Pastaj duhet të shkruajë se cili është roli i tij në secilin grup.

Pastaj nxënësit ndahen në çifte; ata do të duhet t'ia tregojnë dhe t'ia shpjegojnë njëri-tjetrit atë që e kanë shkruar.



Diskutim 3

1. Cilat janë rolet ndërmjet jush?
2. Në cilin rol ndjeheni më mirë?
3. E cilin rol e dëshironi më shumë?
4. A është mirë të keni më shumë role në grupe?
5. Pse është me rëndësi të keni më shumë role në grupe dhe ato të jenë qysh më parë të përkufizuar?
6. Si do të dukej loja e futbollit pa i përcaktuar qysh më parë rolet? Për shembull, portieri të shkojë prapa, të gjithë lojtarët e mbrojtjes të ndalen në mbrojtje të golit, referi t'i ndërrojë lojtarët dhe t'i këshillojnë për taktikën e lojës, trajneri të japë kartona të verdhë dhe të kuq, ndërsa fëmijët që i zënë topat, të gjuajnë penallti?

Përfundim

Në grupet formale është shumë me rëndësi të ekzistojnë role qysh më parë të përcaktuara për anëtarët e grupit që grupi të mund të funksionojë mirë dhe me sukses ta kryejë detyrën për të cilën ekziston.

Loja përmbyllëse

Të gjithë lojtarët qëndrojnë në një hapësirë të gjerë e të zbrazët. Arsimitarja u thotë se ajo do t'u japë udhëzime për grupimin e tyre duke i thënë numrat e anëtarëve që duhet të formojnë grup dhe duke duartrokitur. Kur ta dëgjojnë nxënësit numrin që e thotë arsimtarja dhe duartrokitjen e saj, ata do të duhet të grupohen ndërmjet vete në mënyrë adekuate. Kur ta bëjnë këtë, do të duhet të kapen për duar. Ata duhet të kenë kujdes për secilin udhëzim vijues që të mos të jenë në grupin e njëjtë me fëmijën me të cilin kanë qenë më parë.

Për shembull: Arsimitarja thotë "Tresha" dhe duartroket një herë me duar. Atëherë të gjithë nxënësit duhet të përpiqen të formojnë tresha. Fëmija/fëmijët që do të mbetet/mbeten jashtë grupit, dikush duhet ta/t'i marrë në grup, në rrethin e tij. Pastaj arsimtarja jep një udhëzim të ri për grupim. Në fund përfundon duke kërkuar nga të gjithë nxënësit që të formojnë një grup duke u mbajtur me duar.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja III-5: MARRJA E VENDIMEVE NË GRUP

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se çka do të thotë sesi duket vendimi, rregulla e procedura » t'i dijë qëllimet e grupit » t'i dijë aktivitetet e grupit » t'i dijë procedurat e marrjes së vendimeve » t'i kuptojë rregullat dhe procedurat që ndihmojnë në marrjen e vendimeve
Shkathtësi	» të mund të propozojë mënyra të ndryshme për të marrë pjesë në vendimmarrje » të mund ta shprehë mendimin e tij dhe të argumentojë » të mund t'i shpjegojë shkaqet dhe motivet e secilit vendim të marrë » të mund të ankohej » të mund të përdorë më shumë burime të informacioneve
Qëndrime/vlera	» ta kuptojë rëndësinë e marrjes së vendimeve në grup » të pranojë se procedurat dhe rregullat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve » ta pranojë respektimin e rregullave » ta vlerësojë mundësinë e vetë dhe mundësinë e të tjerëve në grup për të marrë pjesë në vendimmarrje » të pranojë se të tjerët mund të kenë mendime të ndryshme nga ne » ta pranojë përgjegjësinë e tij për marrjen e vendimeve

Punëtorja III-5.1: Stuhi idesh



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit III-5.1: Stuhi idesh
- » tabelë dhe shkumës
- » fleta letre në format A3 – nga disa për secilin grup
- » fllomaster i trashë – nga një për secilin grup

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësit ulen në rreth. Arsimtari zhvillon brainstorming – stuhi idesh në temën “për çka mund të shërbejë një peshqir”. Të gjitha idetë i shkruan në tabelë dhe vazhdimisht i inkurajon nxënësit që të tregojnë ide të reja. Ai gjatë gjithë kohës:

- » i nxit nxënësit ta shprehin secilën ide që u bie në mend
- » e shkruan secilën ide të shprehur, sado që t’i duket pa lidhje
- » i pengon nxënësit që t’i komentojnë idetë dhe vetë përmbahet nga përcaktimi i ideve të shprehura si të mira ose të këqija.

Pastaj secili nxënës e merr nga një kopje të fletës së punës: “Stuhi idesh”, ku janë dhënë rregullat e procesit.



Diskutim 1

1. Pse është e rëndësishme rregulla – mendohen sa më shumë ide? A i përmbaheshim ne asaj rregulle? Cila nga ajo që e bënim ne tregon pse ne i përmbahemi asaj rregulle? Çka do të ndodhë nëse nuk e bëjmë këtë?
2. Pse është me rëndësi të shprehet secila ide që na bie në mend? A i përmbaheshim ne asaj rregulle? Cila nga ajo që e bënim ne tregon pse ne i përmbahemi asaj rregulle? Çka do të ndodhë nëse nuk e bëjmë këtë?
3. Pse është me rëndësi të shkruhet secila ide e shprehur? A i përmbaheshim ne asaj rregulle? Cila nga ajo që e bënim ne tregon pse ne i përmbahemi asaj rregulle? Çka do të ndodhë nëse ndonjë ide nuk shkruhet?
4. Pse është me rëndësi që asnjë ide të mos shpallet si e mirë apo e keqe gjatë procesit të stuhisë së ideve? A i përmbaheshim ne asaj rregulle? Cila nga ajo që e bënim ne tregon pse ne i përmbahemi asaj rregulle? Çka do të ndodhte nëse nuk lejohej vlerësimi i ideve?

Përfundim

Sa më shumë ide që mendohen, aq më e madhe është mundësia që të arrihet në ide më të dobishme. Prandaj është me rëndësi që procesi të vazhdojë një kohë të caktuar, të mos heqim dorë vetëm pas disa ideve të shprehura.

Gjatë procesit nuk duhet të mendohet shumë e shumë për atë se a është ideja e mirë ose e keqe; nga ajo që në shikim të parë duket ide “pa lidhje” mund të lindin shumë ide “të mençura” (edhe idetë me katastrofale janë të mirëseardhura).

Idetë e shënuara shqyrtohen dhe pastaj nxiten ide të reja; edhe atëherë kur na duket se ideja e re gjendet në ndonjë ide të shprehur më parë, megjithatë ajo duhet të shkruhet, sepse ajo mund të na shpijë në ide të reja.

Derisa mendohen, të gjitha idetë janë njësoj të vlefshme; vlerësimi i ideve mund ta pengojë shprehjen e ideve të reja.

Aktiviteti kryesor 2

Formohen grupe me nga 4-6 nxënës. Secili grup e merr nga një tabak/ë letre dhe një fllomaster. Arsimtari e paraqet situatën e dhënë:

“Paramendoni se fabrika për prodhimin e shisheve na ka dhuruar 25 shishe plastike të zbrazëta të koka-kolës. Ne dëshirojmë t’i përdorim që pritjen e vitit të ri ta bëjmë më të pasur dhe me interesante. Si mund të bëjmë këtë?”

Duke i zbatuar rregullat e stuhisë së ideve, grupet duhet të mendojnë se në çfarë mënyrash do të mund t’i përdorin shishet. Para se të fillojë produktioni, secili grup duhet të zgjedhë nga një nxënës që do t’i shënojë idetë në fletat e mëdha.

Pas 6-7 minutave ndërpritet procesi dhe grupet i prezantojnë idetë deri te të cilat kanë ardhur dhe fletat i varin në tabelë.

Zbatohet vlerësimi i ideve, sipas kriterit të realizimit. Si të realizueshme llogariten ato ide që ka kush, ku dhe kur t’i zbatojë në periudhën e dy viteve deri në natën e vitit të ri.

Arsimtari i lexon ide pas ideje dhe të gjithë nxënësit vendosin bashkërisht se cila ide është më e realizueshme, e cila jo.



Diskutim 2

1. Në cilat raste është e dobishme të zbatohet teknika “stuhi idesh”?
2. Kur zbatohej vlerësimi i ideve – gjatë kohës së mendimit të ideve apo kur të gjitha idetë ishin menduar? Pse?
3. Kur e bën vlerësimin, a bën fjalë për ide të mira ose të këqija ose për më shumë a më pak të realizueshme?
4. Nëse i vlerësonim idetë sipas dobisë, cilat ide do të ishin më të dobishme?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Stuhia e ideve përdoret kur duhet të zgjidhet ndonjë problem dhe/ose kur duhet të miratohet ndonjë vendim grupor.

Gjatë stuhisë së ideve nuk ka ide të mira ose të këqija – ka vetëm ide më shumë a më pak të dobishme për një qëllim të caktuar (për ndonjë qëllim tjetër, disa ide të tjera do të ishin më të dobishme). Idetë më të dobishme janë zakonisht kombinim i disa ideve. Vlerësimi i ideve do të bëhet pasi të përfundojë mendimi i ideve.

Punëtorja III-5.2: Lider i mirë, klasë e mirë



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit II-5.2: Kartela për lider

Aktiviteti hyrë

Nxënësit ulen në rreth. Secili me radhë tregon për vete ndonjë personazh të cilin e pëlqen, me shpjegim shumë të shkurtër (me më së shumti një fjali) se pse e pëlqen pikërisht atë personazh.

Aktiviteti kryesor

Formohen grupe me nga 3-5 nxënës. Secili grup e merr nga një komplet me nga tetë kartela të fletës së punës, me udhëzimin që ato t'i renditin sipas rëndësisë në gjatësi të një rreshti. Më në fund vendoset ajo që është më pak e rëndësishme që ta ketë një lider në klasë e pastaj kartelat e tjera renditen deri te e fundit – se cila ka qenë gjëja më e rëndësishme që duhet ta ketë dikush për të qenë lider i klasës.

Pastaj secili grup e paraqet renditjen e vet, ndërsa arsimtari për secilin grup veçmas e shkruan në tabelë gjënë e parë dhe të dytë më të rëndësishme, si dhe atë që është vlerësuar si më pak e rëndësishme. Pasi t'i paraqesin të gjitha grupet zgjedhjet e tyre dhe arsimtari t'i shënojë ato në tabelë, grupet i shpjegojnë zgjedhjet e tyre (dy gjërat më të rëndësishme dhe një që ka qenë më pak e rëndësishme), duke treguar se pse i llogaritin për më të rëndësishme, gjegjësisht për tipare më pak të rëndësishme që duhet t'i ketë një lider i klasës.



Diskutim

1. A janë të gjitha gjërat njësoj të rëndësishme si tipare që duhet t'i ketë një lider i klasës?
2. Si e bën përzgjedhjen, gjegjësisht renditjen e tipareve të liderit?
3. Me çka e dimë se disa tipare të liderit janë më të rëndësishme, gjegjësisht më pak të rëndësishme se të tjerat?

Përfundim

Lideri mund të ketë më shumë tipare ose shkathtësi. Disa prej tyre janë më shumë e disa më pak të rëndësishme që të kemi lider. Disa tipare ose gjëra janë të mira vetvetiu, si për shembull: të lexohet mirë ose të kemi vetëm pesëshe në të gjitha lëndët, por mund jeni lider i mirë edhe pa to.

Gjërat më të rëndësishme që duhet t'i ketë një lider i referohen asaj se sa ndihmojnë ato që ai të jetë i dobishëm për nxënësit e tjerë, gjegjësisht i dobishëm për ata që i përfaqëson.

Aktiviteti përmbyllës

Secili në fletoren e tij e shkruan këtë fjali: “Sikur të isha lider i klasës, unë do të ...”, e pastaj e përfundon fjalinë në si do ai, me diçka që secili mendon për vete se do ta bënte po të ishte lider i klasës. Në fund secili e lexon fjalinë e shkruar.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja III-5.3: TË hedhim një monedhë ose të votojmë?



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit III-5.3a: Situata për vendosje
- » fletë punë për nxënësit III-5.3b: Llojet e vendimeve grupore

Aktiviteti hyrës

Arsimtarja i përmend disa pohime që fillojmë me “Fluturon, fluturon....” dhe pastaj shtohet ndonjë kafshë ose send. Nxënësit duhet ta ngrenë dorën sa më shpejt që mundem nëse kafsha ose sendi i përmendur mund të fluturojë me të vërtetë ose nëse kafsha ose kur sendi i përmendur nuk mund të fluturojë – atëherë nuk duhet ta ngrenë dorën. Nëse gabohet, dilet nga loja.

Aktiviteti kryesor

Formohen grupe me nga 4-5 nxënës (së paku 5 grupe). Secili grup e tërheq nga një situatë nga fleta e punës “Situata për vendosje” (nëse janë më shumë e 5 grupe, disa situata mund të përsëriten). Pastaj secili grup duhet ta aktrojë situatën e tij dhe përmes kësaj të ofroj mënyrë të vendosjes. Pasi të përfundojë aktrimi, grupeve u jepet fleta e punës “Llojet e vendimeve grupore” me detyrë që t’i shkruajnë emrat e situatave të aktruara në katrorët gjegjësisht. Në fund, për secilën situatë veçmas grupet duhet të japin shpjegim të posaçëm se pse e kanë vendosur atë aty (secili grup nga një situatë; nëse ka mendime të kundërta, duhet të dëgjohen të gjitha).



Diskutim

1. Çka është më e rëndësishme për vendimin e liderit? Kur mund të zbatohet?
2. Çka është më e rëndësishme për vendimin e rastit? Kur mund të zbatohet?
3. Çka është më e rëndësishme për vendimin me votim? Kur mund të zbatohet? Cili është dallimi ndërmjet votimit publik dhe atij të fshehtë?
4. Cili vendim është më i mirë? Pse?
5. Cili vendim përdoret më shpesh? Pse?



Reflektim

1. Çka bëme sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Vendimi i liderit është i rëndësishëm në situata kur është shumë me rëndësi të dëgjohen mendimet e ndryshme të anëtarëve të grupit që të merret vendimi më i qëlluar i cili më së shumti do t’i përmbushte nevojat e anëtarëve të grupit. Që të zbatohet ky lloj i vendimit, grupi duhet të ketë lider i cili duhet të jetë i respektuar nga të gjitha dhe atij t’i besojnë të gjithë.

Vendimi i rastit është më i rëndësishëm në situatat kur duhet të veprohet me korrektësi me dy ose më shumë palë (persona) dhe me këtë rast të mos favorizohet asnjëra prej tyre. Mund të zbatohet kur duhet të zgjidhet një ose më shumë alternativa të ofruara, por me kusht që të gjitha t’i kenë mundësitë e njëjta për t’u zgjedhur.

Vendimi me votim mundëson zgjedhje të asaj që e do shumica e anëtarëve të grupit. Ky vendim zbatohet në situatat kur supozohet se shumica e anëtarëve të grupit e parapëlqejnë një situatë më shumë se ndonjë tjetër, ashtu që vendimi i rastit në këtë rast do të thoshte se ka mundësi për pakënaqësi për preferencat e shumicës së pjesëmarrësve. Votimi publik është më praktik, sepse është i shpejtë, por kur me aktin e votimit mund të bëhet prishja e marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të grupit, atëherë duhet të zbatohet votimi i fshehtë.

Votimi me kompromis është vendimi më i rëndësishëm i cili siguron përmbushjen e një pjese të nevojave ose dëshirave të të gjitha palëve të përfshira, në vend të gjetjes së një vendimi i cili plotësisht do t’i përmbushë nevojat/dëshirat e njëjës palë, ndërsa nuk i përmbushë nevojat/dëshirat e palës tjetër. Zbatohet kur ka zgjidhje alternative që janë të pranueshme për të gjitha palët e përfshira në vendimmarrje.

Nuk ka vetëm një lloj më të mirë të vendimit i cili do të mund të zbatohet në të gjitha situatat. Në rrethana të ndryshme disa lloje të situatave janë më pak ose më shumë adekuate për t’u zbatuar.

Punëtorja III-5.4: Të kundërshtoj apo jo?



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit III-5.4a: Notat e mira 1
- » fletë punë për nxënësit III-5.4b: Notat e mira 2

Aktiviteti hyrës

Arsimtarja pa ndonjë rend të caktuar i jep këto instruksione: DITË; NATË; DIMËR dhe VERË. Kur thuhet NATË – nxënësit i ulin kokat, ndërsa kur thuhet DITË – nxënësit i ngrenë kokat. Ndërkaq kur thuhet DIMËR – nxënësit i ulin kokat majtas, ndërsa kur thuhet VERË – nxënësit i ulin kokat në anë të djathtë. Nëse gabohet, dilet prej loje. Loja zgjat derisa të mbesin në lojë 4-5 nxënës.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në 4-6 grupe. Gjysma e tyre e marrin fletën e punës “Notat e mira 1”, ndërsa gjysma tjetër e marrin fletën e punës “Notat e mira 2”. Në fletën e punës “Notat e mira 1” nxënësit shkruajnë se cilat do të ishin dobësi nëse vendosin të veprojnë sipas mënyrës së dhënë (këto do të llogariten si plus). Në fletën e punës “Notat e mira 2” nxënësit do të shkruajnë se çka do të humbin nëse vendosin të veprojnë në mënyrën e dhënë (ato do të llogariten si minus). Pastaj secili grup e prezanton para të tjerëve atë që e ka shkruar, ndërsa arsimtari i shkruan në tabelë në dy kolona përgjigjet.



Diskutim

1. A kemi më shumë pluse ose minuse?
2. A do të mund të vendosim tash të gjithë se sa është mirë të veprohet në mënyrën e dhënë? Mbi çfarë baze?
3. Kur është më lehtë të merret vendim: kur kemi më shumë pluse/minuse apo kur kemi numër të njëjtë të pluseve/minuseve?
4. Kur ne marrim vendim, a i shikojmë edhe anët pozitive edhe anët negative të vendimit të marrë?
5. Pse është me rëndësi të bëhet kjo? Çka fitojmë nga kjo?

Përfundim

Është shumë me rëndësi që gjatë marrjes së vendime të shihen edhe anët pozitive edhe ato negative të vendimit, sepse ndonjëherë injorohen pasojat negative të ndonjë vendimi në të mirë të diçkaje që është pozitive e pastaj mund të shihet se është marrë një vendim i gabuar. Duke i theksuar anët pozitiv dhe negative të ndonjë vendimi, ne japim mundësi që të marrim vendim më praktik nga i cili do të kemi dobi edhe ne edhe ata që janë përreth nesh.

Ndonjëherë me vetë faktin që nga njëra anë ka më shumë pluse e në anën tjetër më shumë minuse (çka humbim e çka fitojmë) është mjaft që të vendosim që mbi këtë bazë të vendosim.

Megjithatë, ndonjëherë mund të ndodhë të kemi pluse dhe minuse të njëjta, por të kemi më shumë argumente për njërin anë dhe kjo të jetë vendimtare që të marrim vendim.

Aktiviteti përfundimtar

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari fillon ta thotë këtë: “Dëshiroj të shkoj në Afrikë”. Në këtë moment nxënësi që është pranë tij duhet ta mendojë ndonjë anë negative për udhëtimin në Afrikë dhe atë ta thotë. Për shembull: “Mund të të hanë luanët”. Nxënësi tjetër, në të kundërtën e pararendësit të tij, mendon një anë pozitive të vajtjes në Afrikë. Për shembull: “Do të mund t’i shohësh piramidat”. Nxënësi i ardhshëm përsëri thotë diçka negative, tjetri diçka pozitive e kështu me radhë derisa të shprehen të gjithë, qoftë me diçka pozitive ose negative për vajtjen në Afrikë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja III-5.5: Vendimi im, vendimi yt



Materialet:

- » tabelë, shkumës
- » fletë pune për nxënësit III-5.5: Ligji i të drejtave

Aktiviteti hyrës

Në tabelë vizatohet një tabelë me dy radhë dhe katër kolona, ashtu që të formohen 8 katrorë identikë. Pastaj secili në fletë e shkruan se sa katrorë gjithsej i sheh. Në fund nxënësit tregojnë sa katrorë kanë gjetur derisa kanë arritur në numrin 11 katrorë (bashkë me katrorët në të cilët gjenden katrorët më të vegjël që janë vizatuar), e pastaj bashkërisht gjenden në vizatimin e tabelës.

Aktiviteti kryesor

Secilit nxënësi i jepet fleta e punës “Ligji i të drejtave”, duke i udhëzuar se secili të zgjedhë 5 të drejta të ofruara nga 20 sa janë gjithsej, për të cilat ai mendon se janë më të rëndësishme. Pastaj formohen çiftet dhe në to nxënësit duhet të merren vesh për listën e përbashkët prej 5 të drejta më të rëndësishme. Pas 6-7 minutave të dyja çiftet bashkohen dhe në këtë mënyrë formohen katërshë, që po ashtu do të duhet të merren vesh për listën e përbashkët prej 5 të drejtave më të rëndësishme.

Në fund secili grup i prezanton 5 të drejtat e veta e pastaj tregon se në çfarë mënyre është arritur deri te vendimi se cilat 5 të drejta duhet të vendosen në listë.



Diskutim

1. Kur e kishit më lehtë të merrni vendim se cilat 5 të drejta do t’i zgjidhni? Pse?
2. E kur e kishit më vështirë? Pse?
3. Kur ndjeheshit më mirë me vendimin e marrë? Pse?
4. E kur ndjeheshit keq ose të lënduar me mënyrën e marrjes së vendimit? Pse?

Përfundim

Shumë shpesh sa më shumë njerëz që marrin pjesë në marrjen e vendimeve, aq më shumë arrihet në pajtueshmëri rreth vendimit, gjegjësisht duhet më shumë kohë për t’u marrë vesh. Por, ndonjëherë marrja e vendimeve në grupe mund të jetë e lehtë dhe e shpejtë nëse më shumë pjesëmarrës angazhohen shumë më tepër dhe pajtohen me atë që do ta thotë njëri në emrin e tyre.

Kur kontribuojmë në marrjen e vendimeve, kur të tjerët na pyesin për mendim dhe kur mendimet tona merren parasysh, atëherë ne ndjehemi më së miri me marrjen e vendimeve.

Kur vendimi për ne është i rëndësishëm, ndërsa mendimet tona nuk merren parasysh, por dikush tjetër vendos si dëshiron ai, atëherë mund të ndjehemi keq me vendimin e marrë, madje mund të ndjehemi edhe të lënduar.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit janë ulur në rreth. Ata ndahen në tre grupe (të grupuar sipas vendit ku janë ulur) – TIP, TAP dhe TEP. Arsimitari i tregon emrat e grupeve ngadalë; çdoherë që përmendet emri i ndonjë grupi, anëtarët e tij duhet të ngrihen në këmbë. Ashtu qëndrojnë derisa nuk përmendet ndonjë emër tjetër i grupit, me ç’rast ata ulen, ndërsa grupi që përmendet ngrihet në këmbë. Kështu ndryshojnë emrat e grupeve. Mund të thuhet edhe TUP, me ç’rast të gjithë nxënësit e të gjitha grupeve ngrihen në këmbë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja III-6: BALLAFAQIMI ME TRYSNINË SOCIALE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të dijë se çka llogaritet sjellje e mirë dhe e keqe (e pranueshme dhe e papranueshme) në më shumë situata » t'i dijë disa norma dhe tradita sociale » të dijë se ekzistojnë pikëpamje/veprime të ndryshme për gjëra të njëjta » të dijë se mund të ketë pikëpamjen e tij të ndryshme nga grupi
Shkathtësi	» të mund t'i vlerësojë normat dhe traditat e pranueshme » të mund të zgjedhë ndërmjet llojeve të aktiviteteve të drejta dhe të gabuara » të mund të formulojë qëndrim/mendim personal dhe ta argumentojë atë » të mund të kërkojë ndihmë me qëllim të forcimit të pozitës së tij
Qëndrime/vlera	» të mund ta vërejë se mund të jetë më ndryshe nga grupi » të miratojë dhe ta pranojë të ndryshmen » të dëshirojë të marrë pjesë dhe të provojë përvoja të reja » ta dijë vlerën e kundërshtimit të qëndrimit/mendimit të tij me atë të grupit

Punëtorja III-6.1: Sjellje e pranueshme dhe e papranueshme



Materialët:

- » fletë punë për nxënësit III-6.1a: E lindur – e mësuar
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: E lindur – e mësuar
- » fletë punë për nxënësit III-6.1b: Adekuate – joadekuate
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Adekuate – joadekuate
- » tabelë dhe shkumës

Aktiviteti kryesor 1

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe secili prej tyre duhet ta zgjedhë njërin nga tre figurat e dhëna, ndërsa kur të jepet shenjë, secili duhet ta aktrojë figurën që e ka zgjedhur.

- » Jashtëtokësor - të dy gishtat tregues të duarve vihen në kokë si antena dhe pastaj lëvizet koka djathtas-majtas duke bërë “Biip – Biip”.
- » Lopa - gishti tregues dhe gishti i mesëm vihen në kokë si brirë, bëhet një hap para kah rrethi dhe thuhet “Muuuuuu”.
- » Tigri – shtrihet të dyja duart para dhe me to lëvizet sikur në pëshpëritje dhe pastaj lëshohet zëri “Gërrrr – voou”.

Qëllimi i të gjithëve është që të bëjnë figurë, pa u marrë vesh mes vete. Loja përsëritet aq herë sa ka nevojë që të gjithë ta bëjnë figurën e njëjtë – të sillen në mënyrë të njëjtë.



Diskutim 1

1. Si silleshit në këtë lojë? Si silleshit në fillim, e si në fund?
2. Shpeshherë i dëgjoni prindërit dhe arsimtarët kur flasin për sjelljen tuaj. Çka është sjellja? (Çka nënkuptohet me fjalën “sjellje”?)
3. A janë të kënaqur prindërit dhe arsimtarët çdoherë me sjelljen tuaj? Pse?
4. A jeni ju vetë i kënaqur nga sjellja juaj?
5. A ju pëlqen juve çdoherë si sillen prindërit dhe arsimtarët tuaj?
6. Shpeshherë fëmijët ose të rriturit thonë për vete se nuk janë fajtorë për sjelljen e tyre, porse ashtu janë për nga natyra. Por, a janë të përcaktuar njerëzit që nga lindja të sillen në një mënyrë të caktuar?

Përfundim

Sjellja është gjithçka që bën njeriu. Me “sjellje” nënkuptohen veprimet e njerëzve – mënyra e veprimit të njerëzve. Ndonjëherë disa forma të sjelljes nuk u pëlqejnë disa personave, madje ndonjëherë as ne nuk jemi të kënaqur nga sjellja jonë. Sido që të sillemi, ne duhet ta pranojmë përgjegjësinë e sjelljes sonë.

Aktiviteti kryesor 2

Fëmijët ndahen në çifte dhe secili çift e merr nga një kopje të fletës së punës për nxënësit “E lindur – e mësuar”, të përcjellë me shpjegimin se ekzistojnë disa veprime të sjelljes që janë të pranishme te njeriu që nga lindja e tij. Por, pjesën më të madhe e veprimeve të sjelljes njerëzit i mësojnë gjatë jetës.

Në fletën që e kanë para vetes janë dhënë më shumë veprime të ndryshme që janë pjesë e sjelljes së disa njerëzve ose të gjithë njerëzve. Çifti duhet t’i lexojë, të vendosë dhe ato t’i shënojë me shenjë “X” ato për të cilat mendon se janë të lindura (të pranishme te njerëzit nga lindja e tyre), e cilat janë ato që mësohen gjatë jetës. Për secilën sjellje të dhënë vihet shenja “X” në kolonën e titulluar “E LINDUR” ose në kolonën e titulluar si “E MËSUAR”. Pasi të përfundojnë, arsimtari për secilën sjellje veçmas i pyet se çka kanë shënuar dhe pse, madje, nëse ka nevojë, ai e korrigjon përgjigjen e gabuar. Secili çift e thotë një pohim.



Diskutim 2

1. A sillen njerëzit çdoherë në mënyrë të njëjtë?
2. A hanë njerëzit në shtëpi njësoj si në restorant? Pse?
3. A bisedoni ju njësoj me shokët, me prindërit dhe me arsimtarët? Pse?
4. A është çdoherë një sjellje e njëjtë adekuate për situata të ndryshme?

Aktiviteti kryesor 3

Secili nxënës e merr nga një kopje të fletës së punës “Adekuate – joadekuate” dhe atë duhet ta plotësojë ashtu që duhet ta shënojë me shenjën “X” për secilën sjellje se a është adekuate, joadekuate dhe/ose edhe adekuate edhe joadekuate – kjo varet nga situata.

Pasi të përfundojnë të gjithë, ndahen në grupe me nga katër veta dhe ndërmjet vete duhet të diskutojnë për atë që e kanë shënuar, të harmonizohen dhe mendimin e përbashkët ta shënojnë në një fletë të re të punës.

Pastaj nga një vullnetar i secilit grup e prezanton atë që e ka vendosur grupi i ri, ndërsa arsimtari kërkon shpjegim. Kështu nëse ndonjë tjetër e ka shënuar më ndryshe – ai kërkon shpjegim edhe nga ata.

Arsimtari e ka vizatuar në tabelë një tabelë të madhe në të cilën i shënon përgjigjet për të cilat janë pajtuar të gjithë.



Diskutim 3

1. Nga çka varet se a do të jetë ndonjë sjellje adekuate apo joadekuate?
2. T'i japim gjatë orës disa shembuj të sjelljeve që janë adekuate. Pse janë adekuate?
3. T'i japim gjatë orës disa shembuj të sjelljeve që janë joadekuate. Pse ato janë joadekuate?

Përfundim

Se si do të sillen njerëzit, kjo varet nga ajo se me kë dhe ku gjenden. Ajo që është sjellje adekuate në një situatë, mund të jetë sjellje joadekuate në një situatë tjetër. Joadekuate është secila sjellje që u pengon të tjerëve dhe që mund të shkaktojë konflikt.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Adekuate – joadekuate

SJELLJA	A	JA	A-JA
Këndimi			X
Loja me top në banesë		X	
Vrapimi në korridore			X
Hedhja e mbeturinave në kosh	X		
Gjuajtja e maceve me guralecë		X	
Përthypja e çam-çakëzit			X
Leximi i librit			X
Ndihma e tjerëve	X		
Kur i biem dikujt me shuplaka		X	
Kundërshtimi i prindërve			X
Huazimi pa marrë leje		X	
Vizatimi nëpër mure			X
Pështymja e dikujt		X	
Kalimi i rrugës në dritë të gjelbër	X		
Fyerja		X	

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: E lindur – e mësuar

SJELLJE	E LINDUR	E MËSUAR
Frymëmarrja	X	
Kafshimi i thonjve		X
Gënjeshtër		X
Gëlltitja	X	
Përthypja e çam-çakëzit		X
Lidhja e lidhëzave		X
Ndihma e të tjerëve		X
Shkelmimi		X
Teshtitja	X	
Gjuajtja e topit		X
Shkrimi		X
Vizatimi në mure		X
Gogësima	X	
Vozitja e biçikletës		X
Shenja me sy	X	
Noti		X
Fyerja		X

Punëtorja III-6.2: Të grithim vetura!



Materiallet:

- » fleta e punës së arsimtarit/arsimtares: Të grithim vetura!

Aktiviteti hyrës

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa arsimtarja u thotë të shndërrohet në “diçka”. Kështu secili do të duhet ta mendojë vetën se është “diçka” e pastaj të marrë një pozitë të caktuar të trupit me të cilën do ta prezantojë “diçkanë” e tij. Pastaj arsimtarja me zgjedhje të rastësishme e zgjedh një fëmijë që përmes tingujve e lëvizjeve duhet ta prezantojë atë “diçka” të menduar prej tij. Pastaj i zgjedh edhe tre fëmijë të tjerë që ta tregojnë atë që e kanë menduar. Loja vazhdon duke kërkuar që të shndërrohen në diçka tjetër.

Propozime për t’u bërë “diçka”:

- » Lejlek
- » Futboll
- » Pluhurthithëse
- » Tenxhere me ujë të vluar
- » Kangur
- » Lumë

Aktiviteti kryesor

Arsimtarja të gjithë fëmijëve ua lexon një përshkrim të një ngjarjeje nga fleta e punës së arsimtarit/arsimtares “Të grithim vetura”. Herë pas here e ndërpret leximin dhe i pyet fëmijët që të tregojnë se çka mendojnë se ka ndodhur më tej, pa e komentuar në veçanti atë që është thënë.



Diskutim

1. A ka qenë adekuate sjellja e Denisit, Ivanit dhe Nebojshës?
2. Pse nuk ka qenë adekuate?
3. Si do të ndjehen pronarët e veturave kur do të shohin se dikush qëllimisht ua ka grithur diçka?
4. A ka të drejtë Denisi kur thotë se fajtorë janë vetëm Ivani e Nebojsja?
5. A e detyruan Ivani e Nebojsja Denisin që t’i grithë veturat?
6. A mund ta detyronin Ivani e Nebojsja Denisin që t’i grithë veturat?
7. Kush është përgjegjës për veprimet e Denisit?
8. A mund të na e përshkruajë dikush shkurtimisht një situatë të ngjashme – kur ai (ajo) vetë ose dikush që ai/ajo e njeh ka qenë në situatë të bëjë diçka joadekuate nën ndikimin e shokëve?
9. A i keni kundërshtuar ndonjëherë shokët e shoqet që kanë kërkuar të silleni në mënyrë joadekuate? (situata mund edhe të aktrohet)

Përfundim

Askush nuk guxon të lejojë të jetë i detyruar të bëjë diçka që nuk është adekuate. Madje edhe sikur të jetë nën presion të shokëve të afërt. Secili duhet ta marrë përgjegjësinë e veprimeve të veta – nëse pa dashje bën diçka të keqe, të mos i fajësojë shokët, por vetë ta pranojë fajin dhe të pendohet për atë që e ka bërë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Në një pasdite të qetë e nxehtë Denisi po rrinte ulur para ndërtesës së tij. Ishte vetë dhe kjo i shkaktonte mërzia. Pyetje se pse askush nga shokët nuk del jashtë. Pas një kohë në këndin e ndërtesës u dukën Ivani e Nebojsa.

„Çka bën?” – e pyeti Ivani.

„Asgjë.” – u përgjigj Denisi, „Jam i mërzitur. Nuk di çka të bëj.”

„Të shkojmë në fushën e sportit, të shohim mos dikush atje luan basket.” – propozoi Nebojsa.

Denisi dhe Ivani pranuan, ashtu që të tre së bashku shkuan në fushën e sportit. Por, atje nuk e gjetën askënd. Kështu mërzia u shtua edhe më shumë te ata.

Në një moment Ivani u kujtua se në rrugë, kur po e kalonin rrugën për të ardhur te fusha, ishin parkuar disa vetura të bukura. Prandaj ai propozoi: “Të gjejmë një gozhdë dhe t’i grithim ato vetura.”

Denisi hamendej. I dukej pa lidhje kjo gjë. “Nuk e di”, - tha ai, - “Mund të na shohin dhe ta pësojmë keq.”

“Do të kemi kujdes që askush mos të na shohë” – tha Nebojsa – “Në këtë kohë edhe ashtu të gjithë janë në shtëpi duke pushuar”.

(Pyetje për fëmijët: Çka mendoni, a është pajtuar Denisi?)

“Mirë” – u pajtua Denisi. Edhe pse atij nuk i pëlqente propozimi, ai vendosi ta bëjë atë vetëm që të jetë bashkë me shokët.

(Pyetje për fëmijët: Çka mendoni, çka ka ndodhur pastaj?)

Pasi që e grithën veturën e parë dhe filluan ta grithin të dytën, u paraqitën dy burra. I kapën të tre për veshë dhe i dërguan në polici. Ndërkaq policia i ftoi prindërit e tyre.

(Pyetje për fëmijët: Çka mendoni, si është ndjerë Denisi kur është arsyetuar para prindërve të tij se pse e ka bërë atë vepër?

Kur e pyetën prindërit Denisin se pse e ka bërë atë vepër, ai u përgjigj “Ivani dhe Nebojsa janë fajtorë, ata më detyruan.”

Punëtorja III-6.3: Djemtë nuk qajnë...



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit III-6.3: Sjellja e pritur dhe rolet
- » shkumës
- » fleta letre
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti kryesor 1

Arsimtari e ndan klasën në katër pjesë. Secili nga këndet është i emërtuar me një fletë në të cilën shkruan: PAJTOHEM, NUK E DI, ENDE MENDOJ, NUK PAJTOHEM. Pastaj u thotë fëmijëve se do t'u lexojë pohime të ndryshme, ndërsa ata do të duhet të shkojnë në njërin nga këndet të klasës, varësisht se çka mendojnë për pohimin e lexuar. Pasi të pozicionohen, kërkon nga ata që ta shpjegojnë mendimin tyre pa hyrë në polemika mes vete. Nëse dikush dëshiron që pas diskutimeve ta ndërrojë pozitën e vet, lejohet ta bëjë këtë.

Procedura përsëritet tre deri në katër pohime.

Shembuj të pohimeve:

- » Djemtë janë të fortë, ndërsa vajzat të dobëta.
- » Vajzat gënjejnë më mirë se djemtë.
- » Djemtë mund të rrihen, ndërsa vajzat assesi.
- » Më mirë është të jesh vajzë se djalë.



Diskutim 1

1. A ju befasoi diçka në raport me mendimet e të tjerëve?
2. Pse mendoni se njerëzit kanë mendime të ndryshme në lidhje me këto çështje?
3. A dëgjuat ndonjë argument që ju detyroi ta ndryshoni mendimin tuaj? Cili ishte ai argument dhe si ndikoi ai në ndryshimin e mendimit tuaj?
4. Si mund ta dimë se cili pozicion është i saktë?

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit ndahen në grupe me nga katër vetë dhe secili grup e merr nga një pohim të prerë nga pajisja e punës për nxënësit "Sjellja e pritur dhe rolet", ndërsa detyra e grupit është që të diskutojë për pohimin dhe të përpiqet të paramendojë dhe aktojë para të tjerëve një situatë në të cilën haset kjo gjë.

Pasi të aktojnë të gjitha grupet, zhvillohet bisedë.



Diskutim 2

1. Çka ishte e përbashkët për pohimet që i kishit? A dini ndonjë pohim të ngjashëm?
2. A ekzistojnë rregulla, norma dhe pritje të ndryshme për djemtë dhe për vajzat në shoqërinë tonë? A ka pritje të tilla edhe në jetën familjare? E a ka në jetën shkollore?
3. A ka këso pritje edhe në vende të tjera në botë?
4. Çka ndodhë kur ndonjë djalë ose vajzë nuk pajtohet me këto pritje dhe kur dëshiron të sillet më ndryshe?

Përfundim

Mjedisi (familja, arsimtarët në shkollë, miqtë, shoqëria) krijojnë disa pritje të caktuara nga sjellja dhe rolet e djemve dhe vajzave që shumë shpesh janë të ndryshme për njërin dhe për grupin tjetër. Këto pritje dhe role janë të paarsyeshme dhe e kufizojnë mundësitë e fëmijëve për ta zgjedhur atë që vërtet e dëshirojnë. Kur një vajzë ose një djalë i kundërshton rolet gjinore, has në përqeshje, paragjykim, madje edhe në përgjashtim nga mjedisi. Të gjithë ne duhet të jemi të vetëdijshëm për rolet e ndryshme gjinore me të cilat ndeshemi çdo ditë, andaj duhet t'i kundërshtojmë duke dhënë mbështetje për përcaktimet e ndryshme të njerëzve dhe të ofrojmë mundësi të barabarta për të gjithë, pavarësisht nga gjinia.

5. A keni qenë ju ndonjëherë në situatë të tillë? Si kanë reaguar të tjerët ndaj zgjedhjes suaj të lirë?
6. Si ndikojnë këto ide në kufizimin e zgjedhjeve që i kanë djemtë dhe vajzat?
7. A mund të ndikojmë vetë që të gjithë djemtë dhe vajzat lirisht dhe pa presion ta bëjnë atë që e dëshirojnë vetë, e jo atë që u imponohet nga mjedisi Si?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja III-6.4: Hirushi



Materialët:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Hirushi
- » tabelë dhe shkurtes

Aktiviteti hyrës

Të gjithë nxënësit ulen në rreth, ndërsa secili duhet të thotë diçka të pazakonshme për veten e tij. Ajo mund të jetë ndonjë interes i pazakonshëm, ndonjë hobi, ndonjë ushqim që dëshiron ta hajë, ndonjë ngjarje nga fëmijëria, ndonjë personalitet që e njeh etj. Me rëndësi është se ajo duhet të jetë diçka shumë e pazakonshme dhe, mundësisht, diçka që sa më pak fëmijë të dinë për të.

Aktiviteti kryesor 1¹

Të gjithë fëmijët ulen në rreth dhe arsimtarja u thotë se ajo do t'ua lexojë një përrallë (nga fleta e punës për arsimtarin/ arsimtare "Hirushi"), ndërsa detyra e tyre është që ta dëgjojnë me kujdes dhe të vërejnë se a ka diçka të pazakonshme në të.



Diskutim 1

1. Si ju pëlqeu përralla?
2. A vërejtët diçka të pazakonshme në të?

Aktiviteti kryesor 2

Arsimtarja e vizaton në tabelën e murit një tabelë dhe kërkon nga nxënësit të tregojnë se çka ka qenë në përrallë sjellje e pazakonshme dhe cilat kanë qenë karakteristikat e djemve dhe të vajzave, ndërsa cilat kanë qenë sjelljet dhe karakteristikat e tyre të zakonshme – në përrallë, por edhe në jetën e përditshme.

Shembull i tabelës:

	vajzat	djemtë
Aktivitete dhe karakteristika të zakonshme		
Aktivitete dhe karakteristika të pazakonshme		

1 Ideja është marrë nga : Schneidewind, N., Davidson, E. (1983). Open Minds to Equality. Massachusetts, USA: Allyn and Bacon A Division of Simon & Shuster, Inc.



Diskutim 2

1. A ekzistojnë edhe në jetën e përditshme këso aktivitete dhe karakteristika të zakonshme dhe të pazakonshme të djemve dhe të vajzave?
2. Sa sjellje janë të lindura dhe cilat janë ato, ndërsa cilat janë të përvetësuar gjatë jetës? (Gjatë numërimit arsimtarja mund të shërbehet me karakteristikat e dhëna në tabelë)
3. A janë të lindura gratë me ndonjë aftësi më të madhe për t'i kryer disa detyra shtëpiake? A janë të lindur meshkujt me aftësi më të madhe për të riparuar vetura?
4. Nga çka duhet të varet se kush me çka duhet të merret? A do të varet edhe nga interesat dhe dëshirat?
5. Nga çka varet se si do të ndahen përgjegjësitë në shtëpi ndërmjet prindërve? Pse nëna patjetër duhet të kujdeset për fëmijët, ndërsa babai duhet të shkojë në punë? A mundet edhe e kundërta? Pse?

Përfundim

Ne jetën e përditshme dhe në përralla shumë shpesh takojmë sjellje dhe karakteristika të a.q. të pritura të djemve dhe të vajzave që i bëjnë ata të dallohen mes vete. Shumë pak karakteristika janë prej lindjes. Shumë pak prej tyre janë përcaktuar me lindje, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë formuar gjatë rritjes dhe pjekurisë, nën ndikim të mjedisit. Këto role dhe karakteristika të pritura imponojnë diçka që jo çdoherë edhe e dëshirojnë edhe vetë ata të cilëve u referohet ajo dhe kështu e kufizojnë zgjedhjen e njerëzve. Secili ka të drejtë të sillet, të veprojë dhe të zgjedhë gjëra në bazë të dëshirave, interesave dhe nevojave të tij, e jo sipas të priturve të të tjerëve.

Loja përmbyllëse

Fëmijët qëndrojnë në rreth, ndërsa arsimtarja fillon me një fjali. Për shembull: “Në karrigen E VOGËL është ulur një ELEFANT”. Detyra e secilit nxënës është që të bëjë fjali që do të fillojë me “Elefanti I MADH....” dhe të vazhdojë me diçka të vogël. Për shembull “... ka kravatë TË VOGËL”. Nxënësi i ardhshëm përsëri e përdorë pjesën e fundit të fjalisë paraprake dhe vazhdon me diçka TË MADHE. Loja vazhdon në rreth derisa të vijë përsëri në rend mësuesja.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Dikur moti jetonte një djalë shumë fatkeq. Atij i kishte vdekur babai, ndërsa nëna e tij e solli në shtëpi një burrë tjetër, po ashtu i ve, por me dy djem të tjerë. Por, njerku aspak nuk e donte djaloshin. Të gjitha gjërat e mira, fjalët e mira dhe privilegjet e veçanta ishin vetëm për djemtë e tij. Ata visheshin me tesha moderne, me ushqim të mirë dhe kishin mundësi për argëtim. Ndërsa djaloshi jetim i pafat nuk kishte thujasë asgjë. Në vend të teshave të bukura, ai mbante tesha të vjetra nga gjysmëvëllezërit. Ai nuk hante nga specialitetet e kuzhinës, por vetëm nga ajo që mbetej nga ushqimi. Thjesht nuk kishte kurrfarë privilegjesh – madje as pushim. Ai e kishte patjetër të punojë tërë ditën – të blejë ushqim, të gatujë, të lajë tesha dhe ta mbajë shtëpinë të pastër. Atij vetëm në mbrëmje i lejohej të ulej pranë vatrës. Gjatë netëve të gjata të vetmuara, ai ndonjëherë qante dhe fliste me macen e tij. Macja bënte “Mjau” që për ishte “Kthjellohu! Ti ke diçka që askush nga gjysmëvëllezërit tu nuk e kanë. Ajo është bukuria.” Atë që e thoshte macja ishte plotësisht e vërtetë. Edhe pse i veshur me partalle dhe me fytyrë të zbehtë nga hiri, ai ishte një djalosh i ri shumë tërheqës. Gjysmëvëllezërit e tij, edhe pse kishin tesha shumë më elegante, ishin të shëmtuar dhe dukeshin keq dhe të tillë do të mbeteshin gjithnjë.

Një ditë në shtëpi filluan të vijnë tesha të bukura, këpucë dhe ar. Mbretëresha po e organizonte një ballo dhe gjysmëvëllezërit po përgatiteshin të shkojnë. Ata vazhdimisht qëndronin para pasqyrës. Ndërkaq djaloshi duhej t’u ndihmonte të vishen në gjithë atë rrëmujë teshash. Ai vetë as që munda të pyesë “Po unë?”, sepse ai e dinte shumë mirë përgjigjen: “Ti, djali im, mbetesh në shtëpi t’i lash enët, ta fshish dyshe-menë dhe t’i përgatitësh shtrëtit për gjysmëvëllezërit tu. Ata do të kthehen në shtëpi të lodhur dhe pa gjumë.”

Pasi që vëllezërit dhe babai i tyre shkuan në ballo, djaloshi i mjerë i fshiu lotët dhe i tha maces: “Oj macja ime, unë jam aq i pafat”, ndërsa macja iu pëshpëriti: “Mjau”.

Në atë moment një dritë e madhe hyri në kuzhinë dhe prej saj doli një zanë. “Mos u pikëllo, djalosh i ri” – i tha zana, - “era ma solli dëshirën tënde dhe unë e di se di digjesh për të shkruar në ballo. Andaj, do të shkosh”.

“Si do të shkoj??? I veshur me partalle.” – u përgjigj djaloshi i mjerë – “Shërbëtorët më kthejnë.” Zana buzëqeshi. Duke e prekur me një shkop magjik, djali u bë i veshur me tesha të mrekullueshme – më të mira s’kishte parë kurrë ai.

“Tash kur e zgjodhëm problemin e veshjes” – tha zana – “duhet të të gjejmë edhe një karrocë. Xhentëlmeni i vërtetë asnjëherë nuk shkon në këmbë. Ma sjell një kungull” – tha ajo. “Oh, nënkuptohet” – tha djaloshi duke vrapuar. Atëherë zana u kthye kah macja: “Ti m’i sjell shtatë minj!”. Djaloshi u kthye shpejt me një kungull të bukur, ndërsa macja me shtatë minjtë që i kapi në nëpër shtëpi. “Mirë!” – bërtiti zana Një të rënë me shkop dhe mrekulli mbi mrekullitë – kungulli u bë karrocë që shkëlqente, ndërsa gjashtë minj u bënë gjashtë pela të bardha, ndërsa miu i shtatë u shndërrua në një femër të bukur me fustan dhe kamxhik që ta voziste karrocën. Djaloshi i mjerë nuk mund t’u besonte syve.

Së shpejti do ta shohësh se princesha, për nderë të së cilës mbahet ballo, sesi do të mahnitet nga pamja yte. Por, mbaje mend! Patjetër duhet të dalësh nga balloja para mesnatës dhe të vish në shtëpi. Sepse në atë kohë përfundon mrekullia. Karroca përsëri kthehet në kungull, pelat kthehen në minj, si dhe karrocierja që po ashtu kthehet në mi. Kështu ti përsëri do të jesh i veshur me partalle dhe do të mbash opinga të shqyera

në vend të atyre këpucëve të mrekullueshme për vallëzim! A kuptove? – iu drejtua zana. Djaloshi buzëqeshi dhe u përgjigj: “Po, kuptova!”.

Kur hyri ai në sallën e ballos, në pallat mbretëroi heshtja. Të gjithë u shtangën dhe mbetën pa fjalë – u mahnitën nga eleganca, bukuria dhe gracioziteti i tij. “Kush mund të jetë ky djalosh?” – pyeteshin njerëzit mes vete. Edhe dy gjysmëvëllezërit e tij pyeteshin se kush është ky i ri që nuk e njihnin dhe as që u shkonte mendja se djaloshi i bukur mund të ishte gjysmëvëllai i tyre që fliste me macen.

Kjo bukuria i ra në sy princeshës. Ajo u drejtua kah ai, u përkul dhe e ftoi në një vallëzim. Për dëshpërimin e të gjithë xhentëlmenëve të rinj atë natë, ajo tërë natën po vallëzonte me djaloshin. “Kush je ti, djalosh kaq i mrekullueshëm?” – vazhdimisht e pyeste princesha. Megjithatë djaloshi iu përgjigj vetëm se: “Nuk është me rëndësi kush jam. Edhe ashtu asnjëherë më nuk do të më shohësh.” “Oh, mos – do të shoh përsëri, unë jam e sigurt në këtë!” – përgjigjej ajo.

Hirushi po kalonte shumë bukur në ballo, ku përnjëherë e dëgjoi rrahjen e orës – një rrahje për mesnatë. Atij iu kujtuan fjalët e zanës dhe pa asnjë fjalë për natë të mirë i tërhoqi duart nga princesha dhe vrapoi shkallëve. Derisa vraponte, i ra njëra këpucë, por ai as që mendonte më të ndalet ta marrë. Nëse e dëgjonte rrahjen e fundit të orës që e shënonte në mesnatë ooooo çfarë katastrofe do ta gjente. Ai vrapoi jashtë dhe u zhduk në errësirë.

Princesha që u dashurua marrëzisht me të, e ngriti këpucën e tij lart dhe shpalli se do të martohet me atë djalë, shputa e të cilit do t’i përgjigjet këpucës. Ajo u tha të gjitha shërbëtoreve: “Shkoni dhe kërkoni gjithkund djaloshin që i bën kjo këpucë. Unë asnjëherë nuk do të jem e qetë derisa nuk e gjej!”

Shërbëtoret dolën ta gjejnë dhe e ia provonin këpucën të gjithë djemve. Kur erdhën te shtëpia ku jetonte djaloshi me njerkun dhe gjysmëvëllezërit, kërkuan që edhe djemtë e kësaj shtëpie ta provojnë këpucën. Dy gjysmëvëllezërit as që mund ta fusin në të gishtin e madhtë këmbës. Kur shërbëtoret pyetën se mos ka ndonjë djalë tjetër në shtëpi, njerku u tha “Jo!”.

Megjithatë pikërisht në atë moment macja ia tërhoqi vëmendjen njërës nga shërbëtoret, duke e tërhequr për një cep të fustanit dhe duke e sjellë në kuzhinë. Hirushi ishte ulur pranë qymyrit. Shërbëtorja ia provoi këpucën dhe, për habinë e saj, ajo i bënte tamam atij. “Ai djalë i shëmtuar e i papastër nuk mund të merrte pjesë ne ballo” – shpërtheu njerku. “Thuaji princeshës se ajo patjetër duhet të martohet me njërin nga djemtë e mi! A nuk sheh sa i neveritshëm është ai djalë!?”

Në atë moment u paraqit zana. “E mjaft më!”, - tha ajo, duke e ngritur shkopin magjik. Për një çast djaloshi kishte veshje të bukur në trup dhe shkëlqente me rininë dhe pamjen e tij. Njerku dhe gjysmëvëllezërit e tij plasën nga habia, ndërsa shërbëtorja tha: “Eja me ne, djalosh i bukur! Princesha të pret që të ta vë në gisht unazën e martesës!” Dhe, djaloshi i lumtur shkoi me ato.

Pas disa ditëve princesha u martua me të dhe jetuan të lumtur deri në fund të jetës. E sa i përket maces, ajo vetëm bëri “Mjau”.

Përmbajtja III-7: MARRJA E PËRGJEGJËSISË PËR VEPRIMET

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë rregullat dhe procedurat që vlejné në raportet ndërmjet njerëzve (në shoqërinë më të gjerë) » t'i dijë detyrimet dhe përgjegjësitë e veta » t'i dijë pasojat e mosrespektimit/shkeljes së rregullave » ta dijë se mësohet nga gabimet
Shkathtësi	» të mund të parashtrojë qëllime të arritshme » të mund të propozojë dhe formulojë rregulla të sjelljes » të mund t'i parashikojë pasojat kur vetë nuk i respekton rregullat
Qëndrime/ vlera	» ta miratojë ekzistimin e rregullave dhe sanksioneve për shkeljen e tyre » ta çmojë rëndësinë e ndërmarrjes së përgjegjësisë për veten dhe të tjerët » është i/e qëndrueshëm/me në arritjen e qëllimeve të parashtruara

Punëtorja III-7.1: Ngjarjet e Ogit



Materialet:

» fletë punë për nxënësit III-7.1: Ngjarjet e Ogit

Aktiviteti hyrës

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa me numëratore zgjidhet njëri që qëndron në mes dhe i mbyll sytë. Të gjithë fëmijët e tjerë me zë e këndojnë këtë këngë:

Ngrihu, ngrihu, o lakuriq
Pse sot ti po fle
Eja luaj me ne
Mos u fsheh si iriq.
Ne do të këndojmë
Gëzimi le të të jehojë
Po qëllaja, o lakuriq,
Cili prej nesh të ftoi!

Pastaj një fëmijë, të cilin grupi e zgjedh me mimikë, me zë të shtirur e thërret emrin e fëmijës symbyllur, ndërsa ai do të duhet t'ia qëllojë se kush e ka përmendur emrin e tij. Nëse ia qëllon, ai del në rreth, ndërsa në mes të rrethit hy fëmija që e ka përmendur emrin e tij dhe kështu edhe ai do të duhet t'ia qëllojë.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe dhe ulen përreth bankave. Secili i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit "Ngjarjet e Ogit". Ata do të duhet ta lexojnë dhe të diskutojnë se a ka vepruar Ogi drejt dhe me përgjegjësi në secilën nga situatat e dhëna apo jo. Në fund, secili grup ftohet që ta përgjigjet në pyetjet e parashtruara për një situatë të caktuar.



Diskutim

1. Pse është me rëndësi të sillemi në mënyrë të përgjegjshme?
2. Si është e lidhur sjellja e përgjegjshme me besimin e të tjerëve ndaj nesh?
3. E si është e lidhur me respektin ndaj të tjerëve?
4. A është lehtë që çdoherë të sillemi me përgjegjësi? Pse?
5. Si ndjehemi në vetvete kur sillemi me përgjegjësi, e si ndjehemi kur sillemi në mënyrë të papërgjegjshme?

Përfundim

Sjellja e përgjegjshme në vete përfshin:

- Përkushtim dhe besim – nëse dikujt i ke premtuar diçka, atëherë atë edhe e bën; sekretin e besuar nuk e ndan me askënd; detyrimet e tua i kryen vete pa pritur që dikush të të përkujtojë (situata 1, 2 dhe 4);
- Vetëdije për pasojat – qysh më parë duhet të mendosh për pasojat e sjelljes tënde dhe t'u shmangesh situatave në të cilat ti ose dikush tjetër mund të jetë i lënduar (situata 3);
- Sjellja me kompetencë personale – kur diçka do të gabosh ose nuk do ta bësh mirë, si duhet, nuk duhet t'ia hedhësh fajin dikujt tjetër ose ndonjë sendi tjetër (situata 2)

Kur sillemi me përgjegjësi, atëherë njerëzit e tjerë na besojnë, na respektojnë dhe na marrin seriozisht. Më e rëndësishmja është se kur sillemi me përgjegjësi, ne vetvetiu ndjehemi mirë, sidomos në plan afatgjatë.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth dhe secili duhet të kujtohet në një situatë në të cilën është sjellë me përgjegjësi dhe pastaj secili nga grupi, një nga një, duhet ta tregojë atë situatë, ndërsa të tjerët do të duhet ta shpërblejnë me duartrokitje. Situatat duhet të përshkruhen me nga dy-tre fjali dhe të mos përsëriten.

Për shembull: "Unë sillem me përgjegjësi kur secilën mbrëmje para se të bie në gjumë i laj dhëmbët" ose "Unë veprova si i përgjegjshëm kur nuk u pajtova që bashkë me shokun tim ta lëpijmë akulloren e njëjtë".



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja III-7.2: Rregulla, rregulla, rregulla!



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit III-7.2: Rregulla në ...
- » pajisje për të shkruar
- » fletë letre

Aktiviteti hyrës

Të gjithë fëmijët qëndrojnë ulur në karrige të renditur në formë rrethi, ndërsa arsimtarja qëndron në këmbë në mes të rrethit. Ajo thotë diçka që asnjëherë nuk e ka bërë, ndërsa të gjithë ata që po ashtu nuk e kanë bërë atë asnjëherë, duhet t'i ndërrojnë vendet. Për shembull; "Unë asnjëherë nuk kam kërcyer me parashutë". Me këtë rast nuk guxojnë t'i ndërrojnë vendet dy nxënës që janë ulur pranë njëri-tjetrit – patjetër t'i ndërrojnë vendet me dikë që është më larg. Po ashtu edhe arsimtarja duhet të ulet në ndonjë karrige të zbrazët. Fëmija që do të mbetet në këmbë në mes të rrethit duhet po ashtu të thotë diçka që asnjëherë nuk e ka bërë. Loja luhet së paku 7-8 herë.

Aktiviteti kryesor 1

Fëmijët ndahen në grupe me nga 5 vetë dhe secili grup e merr nga një kartelë të fletës së punës për nxënës "Rregulla në..." në të cilën duhet t'i shkruajnë:

- » tre rregulla që i dinë në lidhje me situatën ose aktivitetin e dhënë në kartelë;
- » tre sanksione, gjegjësisht dënime nëse bëhet shkelja e tyre dhe
- » kush është ai që do ta mbikëqyrë zbatimin e rregullave.

Pastaj në grup duhet të diskutojnë se pse janë të rëndësishme tre rregulla dhe sanksione dhe çka mundësojnë ato.

Pastaj nga një anëtar prej secilit grup e prezanton para të tjerëve atë që është shkruar.



Diskutim 1

1. Pse duhet të ekzistojnë rregullat?
2. Çka sigurojnë ato?
3. Cilat mund të jenë pasojat e shkeljes së rregullave?
4. Pse rregullat vlejnë për të gjithë?
5. Pse duhet të ekzistojë dikush që do ta mbikëqyrë zbatimin e rregullave?
6. Pse është me rëndësi të ekzistojnë sanksione për shkeljen e rregullave?
7. Cilat rregulla ekzistojnë në shkollë? (Nxënësit i thonë, ndërsa arsimtarja i shkruan në tabelë)
8. Kujt i referohen ato rregulla?
9. Cilat janë sanksionet për shkeljen e tyre?
10. Përveç sanksioneve, a ekzistojnë edhe pasoja të tjera për shkeljen e rregullave?

Aktiviteti kryesor 2

Fëmijët ndahen në grupe me nga katër persona dhe bashkërisht do të duhet të zgjedhin një ose më shumë rregulla në shkollë, të cilat e kanë ma lehtë t'i respektojnë dhe një ose dy rregulla që e kanë vështirë t'i respektojnë dhe për këtë duhet të japin shpjegim pse.

Pastaj nga një përfaqësues i secilit grup e shpall zgjedhjen dhe shpjegimin e grupit para të tjerëve

Përfundim

Pa pasur rregulla qysh më parë të përkufizuara dhe të qarta, shumë aktivitete as që do të mund të zhvilloheshin. Rregullat mundësojnë kushte për zhvillimin e papenguar të aktiviteteve dhe trajtimin korrekt dhe të drejtë të të gjithë pjesëmarrësve në aktivitete. Rregullat mund të jenë të ndryshme për tip të ndryshëm të pjesëmarrësve në një aktivitet, por patjetër duhet të ekzistojnë rregulla që do t'u referohen të gjithëve që marrin pjesë në aktivitet. Nuk mund të lejohet për askënd që të mos ketë fare rregulla ose të mos vlejnë rregullat e njëjta. Edhe pse pjesëmarrësit në aktivitet janë të njoftuar me rregullat, megjithatë për arsye të ndryshme mund të ndodhë shkelja e tyre dhe prandaj patjetër duhet të ekzistojnë edhe sanksione për mosrespektimin e tyre. Ai që e vëzhgon respektimin e rregullave më mirë është të jetë i pavarur dhe neutral. Kjo do të sigurojë objektivitet në respektimin e rregullave dhe shqiptimin e sanksioneve.

Përveç sanksioneve, ekzistojnë edhe pasoja natyrore, gjegjësisht logjike që vijnë nga mosrespektimi i rregullave. Për shembull, nëse një fëmijë vazhdimisht i shtyn të tjerët në futboll, ai jo vetëm që do të sanksionohet nga gjyqtari me karton të verdhë ose të kuq, por pas një kohe edhe fëmijët e tjerë nuk do të kenë dëshirë të luajnë më me të, sepse do të frikësohen se mund t'i lëndojë.



Diskutim 2

1. Pse disa rregulla është më lehtë të respektohen e disa më vështirë?
2. Çka mund të bëhet që të lehtësohet respektimi i rregullave të caktuara?

Përfundim

Mund të ekzistojnë më shumë shkaqe se pse disa rregulla respektohen më vështirë se të tjerat. Disa rregulla është vështirë të respektohen, sepse janë në kundërshtim të pjesërishtë me disa dëshira dhe nevoja tona; disa i ndjejmë si të imponuara, andaj e kemi vështirë t'i respektojmë; disa janë shumë të rrepta dhe prandaj, edhe përkundër përpjekjeve tona për t'i respektuar, megjithatë edhe një pakujdesi e vogël mund të shkaktojë shkelje të tyre etj. Përgjegjësia për respektimin e rregullave rritet nëse edhe vetë nxënësit marrin pjesë në miratimin e tyre dhe nëse ato përjetohen si të dobishme dhe korrekte për të gjithë.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth. Pastaj një fëmijë i drejtohet fëmijës që e ka në të majtë duke i thënë: "I/e dashur, a më do?". Gjatë kësaj nuk guxon të qeshë, gjegjësisht nuk lejohet t'i shihen dhëmbët. Fëmija që është majtas i përgjigjet: "Po, i/e dashur, shumë të dua, por fatkeqësisht nuk mund të të buzëqeshë.", po ashtu duke pasur kujdes që mos t'i shihen dhëmbët, gjegjësisht mos të qeshet. Loja vazhdon në këtë mënyrë edhe më tej në rreth, derisa përshëndetja të arrijë te fëmija që e ka filluar lojën.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja III-8: NDËRTIMI I RAPORTIT POZITIV PËR VENDIN TËND

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë simbolet e vendit të tij (kushtetuta) » të dijë një numër më të madh të gjërave të bukura në vendin e tij (turistike dhe atraksione të tjera)
Shkathtësi	» të mund ta përshkruajë pozitivisht dhe ta prezantojë vendin e tij në kudër të diturive të tij » ta marrë pjesë në aktivitete me të cilat prezantohen të arriturat e vendit të tij » të marrë pjesë në manifestime, gara dhe festa që kanë të bëjnë me prezantimin vendit të vet
Qëndrime/vlera	» t'i respektojë simbolet e identitetit të vendit të vet » të krenohet që është shtetas i atij vendi

Punëtorja III-8.1: Në pajtim me kushtetutën ose jo?



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit III-8.1a: Në pajtim me kushtetutën ose jo?
- » fletë punë për nxënësit III-8.1b: Nenet e kushtetutës së R. së Maqedonisë

Aktiviteti kryesor 1

Të gjithë ulen në rreth dhe arsimtarja u thotë se bashkërisht do ta hartojnë një përrallë për Maqedoninë. Kjo përrallë duhet të ketë informacione për Maqedoninë në raport me madhësinë, mënyrën e rendit shoqëror, përbërjen etnike, monumentet kulturore të arriturat sportive, bukuritë natyrore e kështu me radhë. Së pari fillon arsimtarja dhe e thotë një fjali, ndërsa nxënësi që është pranë saj vazhdon duke thënë një fjali tjetër dhe përralla vazhdon kështu derisa të vijë përsëri në rend arsimtarja. Ndërkohë arsimtarja e shkruan përrallën e përbashkët dhe ajo tashmë mund të përdoret në ndonjë rast tjetër.



Diskutim 1

1. Cilat janë tiparet kryesore të vendit tonë?
2. Nëse duhet të prezantohet diku zyrtarisht para të tjerëve, atëherë me çfarë simbolesh do ta prezantonim?
3. Si duket flamuri i Maqedonisë?
4. E si duket stema?
5. Cili është himni i Maqedonisë?
6. Çka do të thotë fjala KUSHTETUTË?
7. A e dini se çfarë rregullimi kushtetues ka vendi ynë?
8. A janë të barabartë njerëzit në Maqedoni? Pse është me rëndësi që të gjithë njerëzit të jenë të barabartë?

Përfundim

Simbolet me të cilat një vend mund të prezantohet janë: flamuri, stema dhe himni i saj. Tipar i rëndësishëm i një vendi është mënyra e rregullimit politik të tij, gjë që përcaktohet me kushtetutën e vendit (Maqedonia është republikë). Kushtetuta paraqet ligjin më të lartë të një shteti – ligj mbi ligjet. Me kushtetutën e Maqedonisë janë garantuar të drejtat e të gjithëve në vendin tonë, pa marrë parasysh gjininë, moshën, përkatësinë etnike dhe religjioze, si dhe dallimet e tjera. Me kushtetutë është përcaktuar se të gjithë janë të barabartë dhe kanë të drejta të barabarta. Të gjitha ligjet e shtetit duhet të jenë të harmonizuara me kushtetutën.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit ndahen në çifte dhe secilit çift i jepet nga një situatë e fletës së punës për nxënësit “Në pajtim me kushtetutën ose jo?”, për të cilën duhet të gjykohet se a është në pajtim me kushtetutën ose nuk është. Po ashtu në të njëjtën kohë atyre u jepet edhe nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Nenet e kushtetutës” e cila duhet t’u shërbejë për ta përcaktuar kushtetutshmërinë e veprimi gjegjë. Pastaj njëri nga çiftet që ka pasur aso situatë e prezanton atë dhe e shpjegon qëndrimin e çiftit, ndërsa të tjerët që e kanë pasur atë situatë e plotësojnë atë. Procedura përsëritet për të gjitha situatat.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtoria III-8.2: Përfaqësoje Maqedoninë



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit III-8.2a: Përfaqësoje Maqedoninë si...
- » fletë punë për nxënësit III-8.2b: Fotografi nga Maqedonia
- » sellotej
- » ngjites
- » pajisje për të shkruar
- » pajisje për të ngjyrosur
- » letër për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Të gjithë fëmijët ulen në rreth dhe më numëratore zgjidhet një fëmijë i cili duhet ta mendojë një qytet në Maqedoni ose ndonjë fshat të qytetit/fshatit të mjedisit të tij dhe ta thotë shkronjën e parë. Të tjerët duhet t'ia qëllojnë. Fëmija që ia qëllon për cilin qytet ose fshat është fjala, në rrethin e ardhshëm do ta ketë rolin e atij që mendon dhe e thotë shkronjën e parë, ndërsa të tjerët ia qëllojnë. Loja përsëritet disa herë.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet nga një komplet kartelash me sendet e rëndësishme në Maqedoni, kjo nga fleta e punës "Fotografi nga Maqedonia".

Pastaj secili grup e tërheq nga një fletë të punës së nxënësve "Përfaqësoje Maqedoninë si..." në të cilën është shkruar se si duhet ta përfaqësojë Maqedoninë e pastaj nga të gjitha kartelat do të duhet ta zgjedhë atë që shërben që ta prezantojë Maqedoninë sipas detyrës së dhënë, e pastaj duhet ta mendojnë dhe prezantojnë atë.

Pas prezantimit secili grup shpërblehet me duartrokitje.



Diskutim

1. Në çfarë mënyrash ju e përfaqësuar vendin tonë?
2. Në çfarë mënyrash të tjera mund të përfaqësohet?
3. Cilat janë disa gjëra dhe karakteristika të rëndësishme në Maqedoni?
4. Cilat ndjenja lindin kur flitet për vendin tënd në dritë të mirë?

Përfundim

Maqedonia shkëlqen me shumë pasuri natyrore, monumente kulturore-historike, si dhe lloje të ndryshme të bimëve dhe shtazëve, si dhe të ushqimeve. Disa (si këto që janë përmendur në punëtoria) janë shumë të njohura për të gjithë ne, por ka edhe shumë gjëra të tjera që janë më pak të njohura për ne dhe janë specifike për një rajon të caktuar të vendit tonë. Kur prezantohet vendi jonë në dritë të mirë, lindin ndjenja të mira të krenarisë, dashurisë ndaj atdheut dhe ndjenja të respektit ndaj trashëgimisë kulturore-historike si sfida që ai të ruhet dhe të shpërblehet.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në grupe me nga katër vetë dhe e luajnë lojën "Gjeografia e shpejtë". Së pari merren vesh për fushat për të cilat do të shkruajnë, e pastaj një nxënës e thotë një shkronjë të alfabetit, ndërsa të gjitha grupet (secili më vete) në fletë të letrës duhet të shkruajë diçka në secilën kategori që fillon me atë shkronjë. Koha për të shkruar është e kufizuar në një gjë për secilën kategori që fillon me atë shkronjë. Koha e shkrimit është e kufizuar dhe pas kalimit të kohës së caktuar të gjithë duhet të ndalen dhe të kalohet në leximin e asaj që është shkruar. Pastaj vijon dhënia e pikëve. Nëse vetëm një grup ka përgjigje të ndryshme nga grupet e tjera, ai i fiton dy pikë; ato grupe që kanë përgjigje të njëjtë e fitojnë nga një pikë, ndërsa ato që nuk kanë përgjigje nuk e fitojnë asnjë pikë. Pastaj mbledhen pikët dhe përcaktohet shuma e përgjithshme. Loja përsëritet me shkronjë tjetër. Fituesi është ai grup që ka fituar më shumë pikë.

Shembuj të tabelës për “gjeografi të shpejtë”

MAL	LUMË	QYTET	FSHAT	BIMË	KAFSHË	USHQIM



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja III-9: NDËRTIMI I NDJENJËS PËR PËRKATËSINË E PËRGJITHSHME CIVILIZUESE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë se njerëzit në botë kanë nevoja dhe interesa të përbashkëta » t'i dijë disa zbulime dhe të arritura botërore
Shkathtësi	» të mund të gjejë dhe të prezantojë informacione për të arriturat civilizuese
Qëndrime/vlera	» ta pranojë përkatësinë e përgjithshme të bashkësisë njerëzore

Punëtorja III-9.1: Bota pas 20 viteve



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit III-9.1: Të arriturat më të mëdha
- » fletë për të shkruar
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe arsimtarja fillon me lojën duke thënë EVOLUCION. Pastaj e kthen kokën kah nxënësi pranë saj, i cili duhet ta përsëritë fjalën dhe të vazhdojë me lëvizjen e njëjtë djathtas kah nxënësi që qëndron pranë tij. Kështu fjala duhet të kalojë më tej në rreth. Secili nga lojtarët ka të drejtë që një herë ta përdorë fjalën REVOLUCION dhe, kur ta thotë atë fjalë, drejtimi i përcjelljes së fjalës duhet të ndryshojë. Tash ajo fjalë përcillet së pari te nxënësi majtas atij që e ka thënë fjalën, e pastaj vazhdon krejt ashtu majtas. Pas një kohe, kur ndonjë nxënës do të dëshirojë ta ndryshojë përsëri drejtimin e fjalës, këtë do ta bëjë duke e thënë fjalën REVOLUCION.



Diskutim

1. Çka është evolucioni? E çka revolucioni?
2. Si janë arritur sukseset e njerëzimit, gradualisht, hap pas hapi, me përkryerje të vazhdueshme ose përnjëherë, pa inovacione paprakte?

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet nga një fushë me të arritura të larta në atë fushë në atë moment nga fleta e punës "Të arriturat më të mëdha". Ata duhet ta lexojnë atë që është e shkruar dhe në fletë tjetër të veçantë duhet t'i shkruajnë nga tre gjëra revolucionare që pritet të arrihen në 20 vitet e ardhshme në atë fushë.

Pastaj secili grup e prezanton atë që e ka shkruar para të tjerëve.



Diskutim

1. Cilat janë të arriturat më të larta që kanë ndodhur në 50 vitet e fundit?
2. Çka fitojnë njerëzit prej tyre?
3. Kujt i dedikohen ato? A kanë nevojë njerëzit për ato?
4. A i përjetojnë të gjithë njerëzit ato? Pse po/jo?
5. Çka do të mund të bëhet që të gjithë njerëzit të kenë qasje të njëjtë në të arriturat më të dobishme botërore?
6. Si do të dukej bota nëse realizohen idetë tuaja?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Evolucioni është ndryshim kuantitativ gradual nga diçka që është e thjeshtë në diçka që është më e komplikuar, ndërsa revolucioni është i shpejtë, ndryshim dramatik në të cilin krijohet diçka krejt e re. Të arriturat e njerëzimit janë zhvilluar edhe me rrugë të evolucionit, gradualisht – duke punuar çdo ditë në një problem të caktuar dhe në përkryerjen e tij ditë për ditë (vetura) ose ndonjëherë kjo ka ndodhur përnjëherë – një zbulim i ri i cili në tërësi e ka ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve (penicilina). Zbulimet shkencore u takojnë të gjithë njerëzve në botë, sepse të gjithë njerëzit i kanë nevojat e njëjta themelore. Të gjithë njerëzit duhet të kenë qasje në ato zbulime që të munden në tërësi t'i përdorin efektet pozitive të tyre.

Punëtorja III-9.2: Ne jemi ylber



Materialet:

- » fletë punë për arsimtarin/arsimtare: Ne jemi ylber

Aktiviteti kryesor 1

Secilit nxënës duhet t'i jepet nga një kopje e fletës së punës "Dallimet e njëjta" me detyrë që në mënyrë të pavarur ta plotësojë atë, duke i përmendur nga tre ngjashmëri dhe tre dallime ndërmjet vete dhe pesë kategori të tjera.

Pasi ta plotësojnë fletën e punës, formohen grupe të vogla me nga 4-5 nxënës. Ata marrin për detyrë që t'i krahasojnë përgjigjet në kuadër të grupeve.



Diskutim 1

1. A ishte e mundur që për të gjitha kategoritë të mendohen ngjashmëri dhe dallime?
2. Çka kishit më lehtë të mendoni, ngjashmëri apo dallime? Pse?
3. A e kishit vështirë që për disa kategori të caktuara të mendoni gjëra të ndryshme? Pse?
4. Cilat ngjashmëri janë më specifike – ato me shokët ose ato me të gjithë njerëzit në botë? Ndërsa dallimet?

Aktiviteti kryesor 2

Arsimtari e lexon përrallën nga fleta e punës së arsimtarit/arsimtares "Ne jemi ylber".



Diskutim 2

1. Si ju pëlqeu përralla?
2. Si mendoni, si është ndjerë fëmija kur është shpërngulur në vendin e ri?
3. A kanë qenë atje gjërat njësoj apo kanë qenë të ndryshme me vendin ku ka jetuar më parë?
4. A kanë qenë të njëjtë apo të ndryshëm fëmijët si në vendin ku ka jetuar më parë?
5. Në çka dalloheshin?
6. E në çka ishin të njëjtë?
7. Nëse fëmija juaj shkon të jetojë në një vend krejt tjetër, a do të ketë ngjashmëri dhe dallime me fëmijët e tjerë? Pse?
8. Çka mendoni se është e përbashkët për të gjithë fëmijët në botë? Çka u duhet të gjithëve që të mund të rriten dhe të jenë të gëzuar?
9. A dëshirojnë të gjithë të luajnë?

Tash të gjithë do ta luajnë një lojë që tradicionalisht luhet në Kinë dhe quhet "Pula dhe skifteri".

Loja përmbyllëse

Me numëratore përcaktohet një fëmijë që do të jetë "skifteri" dhe një fëmijë që do të jetë "pula". Fëmijët e tjerë janë "zogj" të vegjël. "Zogjtë" e vegjël renditen njëri pas tjetrit në një vijë pas "pulës" dhe ata do të duhet të mbahen për shpatulla si të jenë "tren". "Pula" u prin "zogjeve" duke vrapuar nëpër klasë, ndërsa "zogjtë" nuk guxojnë të shkëputen nga njëri-tjetri. "Skifteri" u rri mbi dhe nëse sheh se ndonjë "zog" është shkëputur, ai menjëherë ndalet ndërmjet atij dhe "zogut" që është para atij dhe kështu bëhet "zog", ndërsa fëmija i shkëputur prej "trenit" bëhet "skifter".

Përfundim

Njerëzit dallohen ndërmjet vete me shumë gjëra (sjellje, interesa, shije, shprehi, zakone dhe shumë gjëra të tjera). Por, ata kanë edhe një numër të madh të ngjashmërive. Disa njerëz pavarësisht se jetojnë në kushte dhe mjedise të ndryshme, mund të kenë edhe interesa dhe hobi të ngjashme. Më e rëndësishmja është se njerëzit janë të ngjashëm me nevojat e tyre për siguri, respekt, miqësi, dashuri, lojë dhe argëtim, vetërealizim etj.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtarene: Ne jemi ylber¹

Familja jonë shpërngulet në një shtet tjetër.
Vende të reja. Fytyra të reja.
Aq shumë gjëra të reja dhe të ndryshme!

Atje prej ku vij unë natën në hënë duket një lepur.
Këtu këtu natën në hënë duket një njeri.

Atje liqeni është i bukur dhe i ngrohtë.
Këtu liqeni është i bukur, por i ftohtë.

Atje gjethet e hithrave lëkundeshin para tarracës së shtëpisë sonë dykatëshe.
Këtu degët e pishës së madhe luhaten para dritareve të shtëpisë sonë të drurit.

Atje kur takoheshim me njerëz të rinj, përshëndeteshim me dorë, ndërsa përqafoheshim dhe putheshim vetëm me më të afërmit.
Këtu të gjithë njerëzit përshëndeten me dorë, përqafohen dhe puthen.

Atje për desert hanim petulla me krem.
Këtu hanë petulla me djathtë për mëngjes.

Ty ndoshta unë të dukem i ndryshëm.
Por, edhe ti mua më dukesh i ndryshëm.

Unë përpiqem shumë të kuptoj se çka thua ti.
Edhe ti përpiqesh shumë të më kuptosh mua.

Kur nuk kuptohemi me njëri-tjetrin, në ndjehemi keq.
Lëndohemi. Rrihemi. Qajmë. Ndahemi.
Pushojmë të kërkojmë mënyrë që të jemi bashkë.
Të ndarë. Vetë.
Të lutem ndalu dhe mendo.
A jemi vërtet aq të ndryshëm siç duket se jemi?

Unë them DIELL, e ti thua SAN.
Por, sido që t'i themi diellit, ai është i njëjtë.

Ne të gjithë dëshirojmë të vrapojmë dhe të luajmë.
Ne të gjithë dëshirojmë të vallëzojmë dhe të këndojmë.
Ne në shumë gjëra jemi të njëjtë.

Është shumë më argëtuese të jemi së bashku – t'i këmbejmë gjërat, të kujdesemi për njëri-tjetrin, të qeshemi dhe të shoqërohemi.

Lotët dhe buzëqeshjet tona janë si shiu dhe dielli. Ato ndihmojnë që miqësitë tona të rriten.

Ndërsa miqësitë janë si ylberi...
Ato shkëlqejnë për të gjithë!

1 Teksti i përrallës është marrë dhe është përshtatur nga Maria Grande Tabor, N. (1997) We Are a Rainbow> Charlsbridge Publishing, USA, Watertown

Përmbajtja III-10: PERCEPTIMI I MODELEVE POZITIVE TË IDENTIFIKIMIT

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të dijë për njerëzit që në mënyra të ndryshme kanë kontribuar për zhvillimin e njerëzimit » të dijë për të arriturat e njerëzve në profesione të ndryshme » t'i njohë njerëzit e mjedisit të tij që kanë dhënë ndihmë dhe mbështetje për individët dhe bashkësinë më të gjerë » të dijë për "heronjtë" e historisë më të afërt dhe më të largët të vendit të tij
Shkathtësi	» të mund të diskutojë për mënyrat e ndryshme në të cilat njerëzit kontribuojnë për zhvillimin e tyre në plan lokal dhe më të gjerë » të mund t'i dallojë njerëzit që kanë kontribuar për zhvillimin e njerëzimit » të mund ta dallojë kur ndonjë njeri do të kontribuojë për bashkësinë (kur u bën mirë të tjerëve)
Qëndrime/vlera	» ta kuptojë se zhvillimi i njerëzimit bazohet në punën e shumë individëve » të dëshirojë të jetë si njerëzit që kanë dhënë kontribut në zhvillimin e njerëzimit » ta kuptojë rëndësinë e veprimit të njerëzve të profesioneve të ndryshme.

Punëtorja III-10.1: Dëshiroj të bëhem...



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit: Profesione të ndryshme
- » fletë letre
- » pajisje për të shkruar
- » sellotej
- » kuti

Aktiviteti hyrës

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth dhe një nga një duhet të thonë se me cilin profesion dëshirojnë të merren në të ardhmen. Pasi të gjithë ta thonë këtë, duhet të grupohen së bashku ata që e kanë zgjedhur profesionin e njëjtë ose të ngjashëm. Nëse ndodhë që disa nxënës të mbeten vetë, gjegjësisht të jenë përcaktuar për profesion të cilin askush tjetër s'e ka zgjedhur, ata nxënës formojnë së bashku një grup. Në grupet e formuara do të duhet të diskutojnë për shkaqet pse janë përcaktuar për atë profesion.

Në fund secili grup i thotë disa shkaqe se pse e ka zgjedhur atë profesion.

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup e tërheq nga një fletë në të cilën është shkruar nga një profesion i fletës së punës "Profesione të ndryshme". Ata do të duhet të diskutojnë për atë profesion dhe pastaj t'i shkruajnë përgjigjet për këto pyetje:

1. Çka do të thotë dikush të jetë i/e mirë?
2. Cilat shkathtësi dhe aftësi janë të nevojshme për kryerjen e suksesshme të këtij profesioni?
3. Cilat janë anët e mira, ajo me çka mund të kënaqesh derisa e ushtron këtë punë, e cilat janë anët jo të mira?

Pasi të përfundojnë, nga një përfaqësues i grupit i prezanton përfundimet e grupit.



Diskutim 1

1. A duheshin njësoj aftësitë dhe shkathtësitë e njëjta për të gjitha profesionet? Pse?
2. Çka nevojitet që dikush të jetë i suksesshëm në profesionin e tij?
3. A kishte ndonjë profesion në të cilin ka vetëm gjëra të mira?
4. A kishte ndonjë profesion në të cilin kishte vetëm gjëra të pakëndshme?

Aktiviteti kryesor 2

Grupeve të njëjta të nxënësve tash u jepen fletë në të cilat janë shkruar të gjitha profesionet e fletës së njëjtë të punës, ndërsa detyra e tyre është që t'i renditin sipas asaj se cili profesion me cilin profesion ka pikëtakime, gjegjësisht si janë lidhur mes vete. Pastaj në një fletë të letrës duhet t'i ngjisin dhe t'i shënojnë me vija dhe shigjeta relacionet e zbuluara.



Diskutim 2

1. Çka mendoni për ndërlidhjen e profesioneve?
2. A janë profesionet vetëm të lidhura ndërmjet vete apo janë edhe të varura prej njëri-tjetrit?
3. Si kontribuojnë këto dhe profesionet e tjera për zhvillimin dhe mirëqenien e shoqërisë?

Përfundim

Ekzistojnë një numër i madh i profesioneve me të cilat merren njerëzit. Për profesione të ndryshme nevojiten edhe aftësi, dituri dhe shkakësi të ndryshme. Por, për të gjitha profesionet, që të jesh i suksesshëm, kjo do të thotë të investosh dituri dhe aftësi deri në maksimum, të dëshirosh që vazhdimisht të mësosh dhe të përsosesh, si dhe të veprësh sipas etikës profesionale. Të gjitha profesionet kanë edhe aktivitete dhe detyrime që janë shumë të mira, por edhe jo shumë të mira.

Përfundim

Një numër i madh i profesioneve janë të ndërlidhur mes vete dhe realizimi i suksesshëm i njërit varet nga realizimi i suksesshëm i tjetrit/tjerëve. Që të mund të funksionojë shoqëria, patjetër duhet të funksionojë si duhet edhe puna e qytetarëve në të gjithë profesionet.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë fëmijëve u jepet nga një fletë dhe secili në të duhet të shkruajë nga një profesion. Pastaj duhet ta mbështjellë fletën që të mos lexohet. Më pas arsimtarja i mbledh të gjitha fletat në një kuti dhe me kutinë me fleta kalon pranë secilit nxënës që ta tërheqë një fletë. Pastaj nxënësit ndahen në çifte dhe ia përshkruajnë njëri-tjetrit me pantomimë profesionin që e kanë tërhequr, ndërsa çifti tjetër duhet t'ia qëllojë se për çka është fjala.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja III-10.2: Intervista



Materialet:

- » fletë për të shkruar
- » pajisje për të shkruar
- » tabelë dhe shkurtesa

Aktiviteti hyrës

Arsimtari u thotë fëmijëve të mendojnë se çfarë profesione kanë farefisi dhe miqtë e tyre e prindërit e tyre. Pastaj secili duhet ta zgjedhë nga një profesion (mundësisht të pazakonshëm) dhe pasi të ndahen në çifte, duhet ta qëllojnë profesionin që e ka zgjedhur partneri duke luajtur një variant të lojës “Varësja”.

Në atë lojë shkruhet shkronja e parë e fjalës së menduar, ndërsa për shkronjat e tjera vizatohen vija të zbrazëta. Për secilën shkronjë të thënë që nuk shtënë fjalë, në letër shkruhet nga një shkronjë e fjalës GABIM. Nëse ai që duhet ta qëllojë fjalën arrin ta qëllojë fjalën para se kundërshtari ta shkruajë fjalën GABIM, atëherë ai është fitues, ndërsa nëse nuk arrin, atëherë kundërshtari ia tregon fjalën. Pastaj anëtarët e çiftit i ndryshojnë rolet.

Aktiviteti kryesor

Arsimtari kërkon nga nxënësit që t’i numërojnë profesionet e të gjithëve që punojnë në shkollë dhe ato i shënon në tabelë.

Ai i ndan nxënësit në grupe me nga katër persona dhe secili grup e tërheq nga një fletë në të cilën është shkruar një nga profesionet e thëna, kështu që secili grup duhet të përgatitet për intervistën e personit konkret të atij profesioni në shkollë, me çka do ta kuptojë se çka nevojitet për kryerjen e atij profesioni dhe në çka qëndron kryerja e atij profesioni. Pastaj ftesat ia japin arsimtarit i cili ua dorëzon ato personave të zgjedhur të shkollës dhe merret vesh me ata për kohën dhe ditën e intervistës.

Përgatitja duhet ta përmbajë këtë:

- Nxënësit duhet ta vizatojnë një vijë të thjeshtë – “vija jetësore” – e cila duhet ta paraqesë jetën e personit që e intervistojnë që nga lindja e tij e deri në këtë moment. Fletën me vijën e vizatuar qysh më parë duhet t’ia japin personit që e intervistojnë, që të mund t’i shënojë ai momentet më të rëndësishme të jetës së tij që kanë lidhje me profesionin (kur dhe çfarë arsimit ka kryer, kur është punësuar, çfarë trajnimesh të veçanta ka kaluar dhe kur i ka kaluar ato, kur është punësuar dhe ku....);

- Duhet të përgatiten dhjetëra pyetje që i referohen profesionit të personit që do ta intervistojnë. Duhet edhe të merren vesh kush prej tyre do t’i parashtojë pyetjet dhe me çfarë renditje dhe

- Duhet të bëjnë ftesa me të cilën do ta ftojnë personin të marrë pjesë në orën e tyre që të intervistohet.



Diskutim

1. Cila është rëndësia e profesioneve?
2. Si kontribuon secili profesion që shkolla të punojë dhe të jetë vend i sigurt për qëndrimin e nxënësve?
3. Si kaluat në përgatitjen e pyetjeve? Pse?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Secilin profesion që e kanë njerëzit në shkollë është i rëndësishëm dhe i patjetërsueshëm për zhvillimin normal të mësimin dhe për sigurinë e nxënësve. Rolet e ndryshme janë të lidhura ndërmjet vete dhe janë në raport ndërvarësie.

Punëtorja III-10.3: Heronjtë



Materialet:

- » tabelë dhe shkumës
- » karton i hollë
- » letër
- » gërshtë
- » pe më i trashë
- » perforator
- » pajisje për të shkruar
- » fletë pune për nxënësit III-10.3: Heroi/heroina ime

Aktiviteti kryesor 1

Arsimtarja kërkon nga nxënësit që përmes stuhisë idesh të tregojnë se çfarë karakteristikash kanë heronjtë. Karakteristikat e përmendura i shënon në tabelë.

Pastaj fëmijët ndahen në grupe dhe secili grup duhet të bëjë një Hero-sandviç". Nga kartoni i hollë fëmijët i presin dy copëza në formë të bukës, e pastaj nga një letër në formë të njëjtë presin aq copëza sa mendojnë se duhet të shtojnë në sandviçin e tyre. Fëmijët duhet t'i zgjedhin së paku gjashtë karakteristika të cilat i konsiderojnë si më të rëndësishme, që ashtu secili sandviç të llogaritet hero. Në secilën letër e shkruajnë karakteristikën e zgjedhur, e pastaj i fusin ndërmjet copëzave të bukës. Në fund bëhen disa vrima dhe lidhen me pe të trashë – si libër. Pastaj secili grup e prezanton sandviçin e tij.



Diskutim 1

1. Si ju vinte kur duhej të përcaktoheshit për vetëm disa karakteristika?
2. A kishte ngjashmëri ose dallime ndërmjet "sandviçeve" tu? Pse?
3. A janë heronjtë persona të njohur? Pse?
4. A mund të jetë hero edhe dikush nga njerëzit që ne i njohim dhe i takojmë në jetën e përditshme?

Përfundim

Nuk janë vetëm personat e njohur heronj. Heronj mund të jenë edhe njerëzit e zakonshëm të jetës sonë të përditshme që kanë bërë diçka jashtëzakonisht të mirë dhe të rëndësishme për njerëzit përreth vetes. Disa tipare që mund t'i kenë heronjtë janë: qëndrueshmëria, bujaria, sakrifica, guximi, profesionalizmi, besimi në të mirën ndaj njerëzve etj.

Mendoni për anëtarët e familjeve tuaja, për shokët, fqinjët, arsimtarët, trajnerët etj. A ka dikush nga këta njerëz karakteristika me të cilat ne mahnitemi? A e llogaritni dikë nga ata hero?

Aktiviteti kryesor 2

Secili nxënës e merr nga një kopje të fletës së punës për nxënës "Heroi/heroina ime" në të cilën duhet ta vizatojë heroin/heroinën e vet të jetë së përditshme dhe të shkruajë se pse pikërisht atë e ka zgjedhur. Pastaj duhet t'i shtojë tre fjalë që e përshkruajnë më së miri heroin dhe çështjen se çka ka mësuar prej tij.

Nxënësit i ngjisin vizatimet e heronjve/heroinave të tyre në fletën e punës dhe pastaj e vizitojnë ekspozitën e plotë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja III-11: ZHVILLIMI I QASJES KRITIKE NDAJ MEDIAVE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të dijë media dhe emisione që janë adekuate për moshën e tij/saj
Shkathtësi	» të mund të konsultojë media të ndryshme » të mund të kërkojë informacione të ndryshme nga media të ndryshme » të mund t'i krahasojë informacionet e një ngjarjeje të njëjtë të marra nga media të ndryshme » të mund të vlerësojë se a janë të kuptueshme disa informacione për të apo jo
Qëndrime/ vlera	» ta pranojë rëndësinë e informimit » ta vërejë rëndësinë e informimit të plotë dhe të gjithanshëm

Punëtorja III-11.1: Përralla e “tjetrit”



Materialet:

- » Fletë pune për nxënësit III-11.1: Format gjeometrike
- » fletët e letrës
- » pajisje për të shkruar
- » sellotej
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Ujku dhe Kësulëkuqja
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Ujku dhe tre derrkucët

Aktiviteti kryesor 1

Fëmijët ndahen në çifte dhe ulen të kthyer me shpinë kah njëri-tjetri. Njëri fëmijë i çiftit ka para vetes një vizatim nga pajisja e punës për nxënësit “Format gjeometrike”. Për shembull, kamion. Ai do të duhet t’i tregojë partnerit të tij se çka të vizatojë, por pa ia thënë emrin e sendit. Pra, duhet t’i shpjegojë pjesët e vizatimit dhe shpërndarjen e tyre në hapësirë (p.sh.: “vizatoji dy rathë të lidhur me një vijë e mbi to vizato një katror, po ashtu edhe përpara le të ketë dy rathë etj.) Ai që dëgjon mund të parashtrojë pyetje, po nuk guxon të pyet se për çfarë sendi bëhet fjalë. Kur të gjithë do ta vizatojnë atë që ua thotë partneri i tyre, atëherë kthehen dhe e shikojnë fotografinë origjinale. Pastaj bëhet ekspozitë e origjinaleve dhe e vizatimeve që janë bërë nga shpjegimet.



Diskutim 1

1. A ka dallim ndërmjet origjinalit dhe vizatimit?
2. Prej nga burojnë ato dallime?
3. Çka ishte më e lehtë, të dëgjosh apo të japësh informacion?
4. A mund ta shprehim saktë me fjalë atë që e mendojmë apo që e shikojmë?
5. A mund ta kuptojmë saktë se çka mendon ai që na tregon diçka?
6. A do të ndihmonte kuptimi ndërmjet njerëzve që ata më shumë t’i përshkruajnë gjërat që i mendojnë ose që dëshirojnë t’i thonë.

Përfundim

Më së shpeshti dallime ka ndërmjet origjinalit dhe vizatimit. Madje ato dallime burojnë nga shpjegimi i pamjaftueshëm preciz dhe i qartë, si dhe nga subjektiviteti i interpretimit të asaj që thuhet prej atij që dëgjon.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit qëndrojnë në rreth dhe arsimtarja lajmëron se të gjithë bashkërisht do të përkujtohen në përrallat e moçme të bukura të fëmijërisë së tyre. Pastaj kërkon që dikush nga nxënësit shkurtimisht ta rrëfejë përrallën e Kësulëkuqes. Pas rrëfimit, nxënësi shpërblehet me duartrokitje. Nga fleta e punës së arsimtarit/arsimtares “Ujku dhe Kësulëkuqja” arsimtari e lexon përrallën e Kësulëkuqes të rrëfyer nga ujku.



Diskutim 2

1. Si ju dukej Kësulëkuqja para se ta dëgjoni përrallën e ujkut?
2. E ujkut?
3. Çka ndjeni tash për Kësulëkuqen?
4. E për ujkun?

Aktiviteti kryesor 3

Arsimtari kërkon që njëri nga nxënësit shkurtimisht ta tregojë përrallën për tre derrkucët që kanë ndërtuar shtëpi dhe ujku ua ka prishur duke dashur t’i zë që t’i hajë. (Nëse në përrallë nuk thuhet edhe versioni më i rreptë në të cilën ujku pasi ua prish shtëpinë i ha derrkucët, arsimtari e thotë edhe atë. Pas rrëfimit nxënësi shpërblehet me duartrokitje nga gjithë grupi. Nga fleta e punës së arsimtarit “Ujku dhe tre derrkucët” arsimtari e lexon versionin “e vërtetë” sipas asaj sesi do ta rrëfente atë përrallë ujku.



Diskutim 3

1. A ndryshoi mendimi juaj për ujkun pasi e dëgjuat këtë përrallë? Pse?
2. A ka të drejtë ujk? A ka argumente për t'i besuar? A është versioni i tij më pak i besueshëm se përrallat klasike?
3. Cila është e vërteta: në njërin nga versionet, në versionin e ri apo në versionin e bashkuar?
4. A mund të kujtoheni në situatat kur ju diçka e keni menduar në një mënyrë, e pastaj e keni ndryshuar mendjen kur e keni dëgjuar versionin e dikujt tjetër (ose të palës tjetër)?
5. Si është gjendja me mediat (televizioni, radioja, gazetatat, mediat elektronike)? A jepen edhe në media çdoherë të gjitha anët e një ngjarjeje?
6. Çka duhet të bëhet që të përfitohet pasqyrë e plotë për atë që ka ndodhur në të vërtetë?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Që të krijojmë pikëpamje të drejtë dhe reale për gjërat dhe ngjarjet, nevojitet të kemi sa më shumë informacione precize për ato. Është shumë me rëndësi të dihet edhe se secili mendim i krijuar në bazë të të vështirimit të njëanshëm të gjërave është subjektiv dhe paraqet vetëm një pjesë të realitetit (ashtu siç duket në sytë e raportuesit).

Që të nxjerrim përfundim të drejtë për diçka ose për dikë, patjetër duhet ta shikojmë situatën edhe përmes “syve” të tjetrit. Nëse dëshirojmë që të informohemi plotësisht dhe në mënyrë të gjithanshme për çdo ngjarje, patjetër duhet të kërkojmë t'i lexojmë ose t'i dëgjojmë edhe versionet e tjera të ngjarjes, gjegjësisht të kemi informacione nga më shumë persona.

Ujku dhe Kësulëkuqja

- përralla e ujkut -

Jetoja në mal. Aty ishte shtëpia ime për të cilën kujdesesha vazhdimisht dhe përpiquesha ta mbaj të pastër. Një ditë me diell, derisa i mblidhja mbeturinat që i kishin lënë njerëzit pas vete, i dëgjova ca hapa. Kur shikoj pas drurit, shoh një vajzë që mbante në dorë një shportë dhe shkante rrugës. M'u duk e dyshimtë, sepse ishte e veshur pak si në mënyrë të çuditshme – e tëra në të kuqe, me shami në kokë, sikur të dëshirojë që të mos e njohin.

Edhe pse e di se nuk duhet të gjykoj për njerëzit në bazë të pamjes së tyre, ajo ishte në malin tim dhe më dukej e udhës që të kuptoj diçka më shumë për të. E pyeta kush është, nga vjen dhe gjëra të tilla. Së pari m'u përgjigj me paedukatë se nuk flet me të panjohur. Unë i panjohur? Unë, që me gjithë familjen ime jetoj në mal, qenkam i panjohur!? Pas kësaj vajza u qetësua pak dhe më tregoi për gjyshen e saj, e cila kishte qenë e sëmure dhe ajo po ia dërgonte drekën. Në të vërtetë vajza m'u duk e sigurtë dhe mendova se do të ishte mirë që ajo të marrë pak mësim – se nuk është mirë të endet ashtu nëpër shtëpi të huaja e veshur ashtu si e dyshimtë.

E lëshova të shkojë, ndërsa pas një kohe të shkurtër unë vrapova pas saj për te shtëpia e gjyshes së saj. Kur u takova me gjyshen e saj, ia shpjegova tërë situatën. Edhe ajo u pajtua se do të ishte mirë që mbesa e saj të mësojë të sillet më mirë me të tjerët. U morëm vesh që ajo të fshihet nën krevat derisa ta ftoj unë të dalë.

Kur arriti vajza, unë e ftova në dhomën e gjumit, aty isha shtrirë, tash i veshur me veshjen e gjyshes së vajzës. Ajo me fytyrë të çuditshme u fut në dhomë dhe menjëherë më bëri një vërejtje ofenduese për veshët e mi. Mua edhe më parë më ka ndodhur që të më ofendojnë, ashtu që u përpoqa të mos i jap shumë rëndësi asaj dhe thjesht komentova se veshët e tillë më shërbejnë për të dëgjuar më mirë. Me këtë desha t'i them se atë vajzë e kam në sy të mirë dhe se ajo duhet të ketë kujdes se si shprehet. Por, ajo menjëherë pas kësaj bëri një vërejtje qesharake për sytë e mi. Tashmë sigurisht edhe ju e keni të qartë se ndjenjat e mia ndaj vajzës së vogël menjëherë filluan të ndryshojnë, ashtu që ajo nga një vajzë simpatike, u bë një qenie shumë e pakëndshme. Megjë kisha përvojë në kontrollimin e hidhërimit tim, unë vetëm i thashë se sytë e mi të mëdhenj më shërbejnë për shikuar më mirë.

Vërejtja e saj e ardhshme vërtet i tejkaloi kufijtë. Unë edhe ashtu kam problem me dhëmbët dhe gjëja e fundit që ajo vajzë duhej ta bënte ishte që të m'i përmendë dhëmbët e mi të mëdhenj. Unë e di se nuk duhej të reagoj me shpërthim, por nuk munda – kërceva nga shtrati dhe i bërtita se dhëmbët e mi të mëdhenj do të më shërbejnë mirë që ta ha atë.

E kam patjetër t'u them se një ujk asnjëherë nuk do të dëshironte ta hajë një vajzë të vogël. Këtë e di secili. Po, për befasinë time, ajo vajzë e marrë vrapoi të ikë nëpër shtëpi dhe të bërtasë si e çmendur. Unë vrapova pas saj që ta qetësoj, madje edhe e hoqa veshjen e gjyshes së saj, por përnjëherë u dëgjua një e trokitur në derë dhe aty u paraqit pylltari. Një burrë i madh me sëpatë në dorë. Kur pashë atë, e kuptova se jam i zënë keq. Andaj shpejt kërceva nga dritarja dhe ika.

Do të ishte mirë që këtu të përfundonte gjithë puna, por gjyshja asnjëherë askujt nuk i tregoi se çka ndodhi në të vërtetë. Kështu shpejt u përhap fjala se unë jam një qenie e tmerrshme të cilës nuk mund t'i besohet. Pastaj nuk e di se çka ndodhi me vajzën, por mund t'ju them se deri në fund të jetës sime unë mbeta një qenie shumë fatkeqe.

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Ujku dhe tre derrkucët

Përrallë e vërtetë për Ujkun dhe tre derrkucët
E treguar nga A. Vollkov

Qysh në kohën e *na ishte njëherë* një ditë të martë unë po rrija në shtëpi dhe po bëja shllag torte për miken time më të mirë që të gjithë e thërrasim Gjyshëze. E kisha edhe një ftohje të marrë – desh pëlcita nga teshtitja. Aq më tepër që s’kisha sheqer.

Prandaj vendosa të shkoj te fqinji im të kërkoj një filxhan sheqer. Ndërsa fqinji im më i afërt ishte një derrkuc. Por, ai nuk ishte prej të mençurve. Ai e kishte bërë një shtëpi kashte. Mos të të besohet. Gjithë shtëpia ishte prej kashte. Mendoj, po kush me mendje të pjekur do të bënte një shtëpi prej kashte?

Normalisht, si i rashë derës, ajo e tëra u prish. Unë nuk desha të hyj pa leje, prandaj nga hyrja thirra: “O derrkuc, a je këtu?”. Por, asnjë përgjigje. Dhe, sapo desha ta kthej shpinën të shkoj në shtëpi dhe t’ia lë një letër derrkucit se më vinte keq që ia theva derën dhe se do t’i ndihmoj ta bëjë një të re, kur më erdhi të teshtij. E po, ta dini, unë nuk jam prej atyre që teshtijnë si një mace. Kur më vjen të teshtij, unë i tëri mbushem me ajër dhe e nxjerr një AAAAAA-PCAHA!!! ... të fortë. Dhe teshtiva. Me një teshtimë të madhe.

Dhe, e dini çka ndodhi? Gjithë shtëpia e tij e kashtës ra. Dhe, ja në mes të shtëpisë e shoh Derrkucin e Parë të Vogël, të vdekur si një gozhdë. Gjithë kohën paska qenë në shtëpi, ama kot, kur iu paska shtrënguar kërthiza. Mua më dukej pa lidhje ta lë pa e ngrënë një ushqim të tillë të mirë të priset në atë kashtë, andaj e hëngra. Mos më shikoni me habi: edhe ju po të shihni një hamburger të lënë në tavolinë, sigurisht do ta hani.

Tash, pasi hëngra, isha më mirë. Por, megjithatë ende nuk kisha sheqer për ditëlindjen e Gjyshëzës sime të dashur. Prandaj shkova te fqinji i ardhshëm – Derrkuci i Dytë i Vogël. Ai ishte vëllai i derrkucit të parë. Ishte më i mençur se vëllai i tij, por jo se e kishte farefis Ajnshtajnin. Shtëpia e tij ishte e bërë prej degëve.

I rashë ziles, por askush nuk e hapi. Bërtita “Derrkuc, a je këtu?”. Kësaj radhe m’u përgjigj: “Aleks, nuk mund ta hap derën se po rruhem. Eja një herë tjetër”. Dhe, unë tamam ta lëshoj rezen e derës dhe të nisem për në shtëpi, kur prapë më erdhi të teshtij. U përpoqa të përmbahem, madje edhe e kapa hundën, por kot. Aq shumë teshtiva sa gjithë pylli jehoi. Ndërsa shtëpia..., prej saj më mbeti vetëm reza e derës në dorë. Kur u pastrua pluhuri, shoh se edhe derrkucin e dytë e kishte lëshuar shpirti si të parin. Dhe, çka të bëj. Është gjynah të priset ushqimi. Jo se më hahej aq shumë, ama do më brente ndërgjegjja se e kam lënë derrkucin e mjerë të mbetet aty dhe të priset. Ashtu-kështu, mezi e hëngra disi edhe atë. Dhe, e kisha patjetër pak ta liroj rripin.

Tash isha pak më mirë me ftohjen. Por, megjithatë sheqer nuk po gjeja. Prandaj shkova te fqinji i tretë. Ky ishte vëllai i dy derrkucëve të tjerë dhe dukej se ishte më i mençur se ata dy. Shtëpia e tij ishte e bërë prej tullave, si të gjitha shtëpitë normale në botë. Madje edhe si hapësirë e kishte rregulluar më mirë.

I rashë derës edhe te ai. Askush nuk m’u përgjigj. “Derrkuc, derrkuc, a je në shtëpi?”. Dhe, e dini çka më tha, derrkuci i ligë: “Aleks, ik dhe mos më mërzit shumë!” Uh, sa jemi “të dashur”... Ndërsa e dija sigurisht se ai kishte në shtëpi një thes me sheqer. Dhe, nuk po donte të më japë asnjë filxhan për tortën e shoqes sime – Gjyshëzës. Ndërsa pastaj do të dijë të hajë në aheng. Derri njëherë!!! Megjithatë, ani thashë, do të shkoj në shtëpi dhe në vend të tortës do të bëj ndonjë urim tjetër, por ja përsëri më erdhi të teshtij. Dhe, përsëri u drodha deri në thembra. Ndërsa derrkuci ende po qeshej dhe më thoshte: “Gjyshëzja le të vdesë nëse do!”.

Shih këndej... Unë jam njeri i qetë, mendoj ujk i qetë. Por, kur dikush e ofendon Gjyshëzën, nuk mund të kalojë lehtë. Kur erdhën policët, unë ende përpiqesha ta shtyj derën e Derrkucit të Tretë të Vogël dhe, aq më tepër, u mbyta me teshtima dhe britma, çka t’ju them – dukësha krejt i marrë.

Se çka ndodhi pastaj, krejt e qartë është. Gazetarët morën vesh për dy derrkucët që i hëngra më parë. Ata sigurisht mendonin se përralla për një ujk të ftohur që shkon të huazojë sheqer për tortë nuk është përrallë për ballinë, prandaj bënë një përrallë për UJKUN E MADH TE LIGË, i cili fryn dhe rrëmon shtëpi kah të mundet.

Kjo është e tëra. Përralla e vërtetë. Më keqpërdorën....

autor i përrallës: Jon Scieczka

Punëtorja III-11.2: Programi për fëmijë?!



Materialet:

- » letër për të shkruar
- » pajisje për të shkruar
- » fletë pune për nxënësit III-11.2a: Shenjat e kategorizimit
- » fletë pune për nxënësit III-11.2b: Shpjegimi i kategorive

Aktiviteti kryesor 1

Secili fëmijë në një fletë letre do të duhet të shkruajë se cilat emisione televizive i shikon më së shumti dhe në cilën pjesë të ditës (seri, filma të vizatuar, ndeshje sportive, emisione muzikore, filma artistikë, programe kontaktuese, talk-show dhe realit-show, emisione dokumentare shkencore....)

emisioni/programi	ora
1.	
2.	
3.	

Pasi t'i shkruajnë këto, arsimtarja i mbledh fletat dhe i shkruan në tabelë emisionet e përmendura dhe pranë secilit emision që përsëritet vihet edhe nga një vizë.

Në fund i mbledh vizat dhe e shpall se cili emision mesatarisht është më i shikuar nga fëmijët e kësaj klase.



Diskutim 1

1. Çka mendoni, a janë (jo)adekuate për moshën tuaj shumica e emisioneve që i shikoni ju?
2. Me çka mund të kuptohet se është përmbajtja adekuate për moshën tuaj?
3. A duhet dhe a mundet që të gjitha programet në televizion t'i shikojnë të gjithë fëmijët? Pse?
4. Cilat përmbajtje në veçanti mund të jenë shqetësuese dhe të dëmshme për fëmijët?
5. Çka mendoni se është plotësisht e ndaluar të shfaqet në kanalet televizive nacionale?
6. A keni vërejtur ndonjëherë ndonjë shenjë për programet televizive që vijnë të cilat i referohen kategorisë së moshës për të cilën janë të dedikuara?

Përfundim

Nuk janë të gjitha programet dhe emisionet televizive adekuate për fëmijë. Në veçanti janë shqetësuese ato në të cilat ka dhunë, erotikë, sjellje seksuale të ndaluar me ligj, fjalor vulgar, forma sugjestibile të sjelljes që janë të lehta për imitim, ndërsa janë të dëmshme për shëndetin dhe sigurinë, si dhe ofenduese për dinjitetin e njeriut etj.

Këshilli për radiodifuzion sipas një rregulloreje të përcaktuar bën renditjen dhe shënimin e programeve të radios dhe të televizionit që mund të ndikojnë keq te të rinjtë dhe, sipas kësaj rregulloreje, të gjitha emisionet që shfaqen në TV patjetër para fillimit duhet të jenë të shënuara me shenjë gjegjëse që tregon për moshën e rekomanduar të publikut për programin gjegjës.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup e merr nga një kopje të prerë nëpër vija të fletës së punës për nxënë "Shenjat e kategorizimit të programeve" dhe nga një kopje prej fletës së punës për nxënë "Shpjegimet e kategorive". Detyra e tyre është që t'i lidhin shenjat me shpjegimin gjegjës, ndërsa pastaj me zgjedhje të rastësishme të marrin (arsimtarja e përcakton se kush) tre emisione/programe të ndryshme televizive nga ato që janë dhënë më parë si më të shkuara dhe ato të përpqen t'i klasifikojnë në një njërën nga kategoritë e ofruara.



Diskutim 2

1. Si ndjeheshit kur po e kryenit detyrën? A kishit vështirësi diku?
2. Cilës kategori i takojnë emisionet që ju i shikoni më shpesh?
3. Pas këtyre njohurive a do të ndryshonit ndonjë gjë në zgjedhjen e emisioneve/programeve që i shikoni? Çka? Pse?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja III-12: PËRDORIMI I INSTITUCIONEVE PËR MBROJTJE DHE SIGURI

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të dijë se cilat institucione të shtetit ofrojnë mbrojtje dhe siguri » të dijë se çka bëjnë ato dhe me se merren
Shkathtësi	» të mund ta shprehë problemin që e ka dhe për të cilin kërkon ndihmë » të mund të drejtohen në vendin e duhur në situatën konkrete
Qëndrime/ vlera	» ta kuptojë rëndësinë e këtyre institucioneve » ta pranojë veprimin e institucioneve dhe dobinë e ekzistimit të tyre » t'i respektojë njerëzit që punojnë në këto institucione dhe ta vlerësojë veprimtarinë e tyre » të besojë se mund të marrë mbrojtje dhe ndihmë nga institucionet

Punëtorja III-12.1: Institucionet e mbrojtjes



Materialet:

- » fletë punë për nxënësit III-12.1a: Fusha për lojë
- » pajisje për të shkruar
- » fletë punë për nxënësit III-12.1b: Situatat e lëndimit, maltretimit ose nënçmimit
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtares: Reagimi i fëmijëve
- » fletë e madhe e letrës
- » flomasterë

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çift dhe menjëherë pastaj dy nga dy duhet të formojnë katërshe. Secili grup e merr nga një kopje të fletës së punës “Fusha për lojë” dhe një laps. Pastaj secili çift merret vesh se ku do t’i shkruajë fjalët e mëposhtme, pa shikuar te çifti tjetër.

- » PRINDI
- » ARSIMTARI
- » PSIKOLOGU
- » POLICI

Pastaj duhet t’i qëllojnë fjalët, gjegjësisht gjendjen e tyre në fletën e çiftit kundërshtar. Çiftet paraqiten njëri pas tjetrit dhe e thonë nga një shkronjë që e përkufizon fushën që dëshirojnë ta zbulojnë. Për shembull, çifti i parë mund të thotë “Hape 4 B”, ndërsa çifti kundërshtar duhet të tregojë se a ka në atë fushë shkronjë apo është krejt e zbrazët. Nëse është e zbrazët, të dyja çiftet e shënojnë këtë në fletë me X dhe tash vjen radha e qëllimit të çiftit të dytë. Ndërkaq nëse në atë fushë ka shkronjë, atëherë çifti i parë vazhdon të qëllojë fusha të tjera derisa të arrijë në një fushë të zbrazët, me ç’rast vazhdon çifti tjetër. Loja përfundon kur njëri nga çiftet do t’i zbulojë ato fjalë.

(Loja është një variant i lojës së popullarizuar Nëndetësja)

Shembull:

	A	B	C	Ç	D	Dh	G	GJ	E	Ë
1										
2		P	S	I	K	O	L	O	G	U
3	A	R	S	I	M	T	A	R	I	
4		N								
5		D								
6		I								
7				P	O	L	I	C	I	
8										
9										
10										

Aktiviteti kryesor

Arsimtari kërkon nga fëmijët “vullnetarë” të cilën do t’i ndajë në tre grupe. Secili grup do ta marrë nga një situatë të paraqitur në fletën e punës për nxënësit, të cilën duhet ta lexojnë dhe të merren vesh si do ta aktrojnë. Pas dhjetë minutash përgatitje, secili grup duke aktruar e prezanton situatën, e pastaj ato analizohen, përcaktohet lëndimi e pastaj sugjerohet reagimi i fëmijëve.

Fleta e punës së arsimtarit/arsimtares “Reagimi i fëmijëve” mund të shërbejë si orientim për komentimin e situatave.



Diskutim

1. Çka mendoni për këto situata?
2. A ndodhin gjëra të këtilla në jetë?
3. A keni përjetuar ju diçka të këtillë?
4. A mendoni se është e drejtë që fëmijët të ndëshkohen me rrahje?
5. Kur të keni ju fëmijë, si do të silleni me të?
6. Si mund të ndihmohemi mes vete kur të bëhemi viktima të sjelljes së këtillë të të rriturve?
7. Prej kujt mund të kërkojmë ndihmë?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
1. Si ndjeheshim?
1. Çka mësuam?
1. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Nuk është e lejuar që fëmija të maltretohet nga askush në asnjë mënyrë. Maltretimi dhe sjellja jonjerëzore ose sjellja nënçmuese nuk mund të arsyetohen me sjelljen e tyre të keqe, me ndonjë gabim që e kanë bërë në raport i rritur-i ri, prind-fëmijë, arsimtar/e-nxënës. Askush nuk duhet ta durojë maltretimin ndaj tij ose ndaj dikujt tjetër. Në rast të maltretimit fëmija duhet të drejtohet te prindi, arsimtari, kujdestari i klasës, pedagogu ose psikologu i shkollës, në telefonin SOS për mbrojtjen e fëmijëve viktima të dhunës, te punëtori social në qendrën e mbrojtjes sociale, ndërsa gjatë rasteve të rënda duhet të paraqitet edhe në polici.

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Reagimi i fëmijëve

Situata e parë - në atë moment të reagohet te prindërit që të ndërmerret diçka

Situata e dytë – lutet arsimtari të qetësohet dhe bashkërisht me fëmijët ta analizojnë situatën. Nëse nuk ka sukses kjo, atëherë fëmijët duhet ta paraqesin sjelljen e arsimtarit te drejtori, pedagogu ose psikologu i shkollës dhe të kërkojnë reagim adekuat prej tyre dhe ta shpjegojnë rastin edhe para prindërve të tyre.

Situata e tretë – të përpiqen t'ua shpjegojnë prindërve se mund të ulen dhe të bisedojnë për problemin, që bashkërisht t'i gjejnë shkaqet e notës së dobët, të kërkojnë zgjidhje. Për sjellje të dhunshme të prindërve mund të bisedohet me: pedagogun, psikologun, arsimtarin, me punëtorin social në qendrën e mbrojtjes sociale, ndërsa gjatë rasteve të rënda, mund të paraqiten edhe në polici.

Punëtorja III-12.2: Kur je në fatkeqësi, paraqitu në...



Materialet:

- » fleta të mëdha të letrës
- » pajisje për të vizatuar
- » pajisje për të shkruar
- » sellotej

Aktiviteti hyrës

Të gjithë fëmijët ulen në rreth dhe arsimtarja kërkon nga ata që t'i mbyllin sytë dhe të përpiqen të kujtohen në ndonjë vend dhe situatë kur ata janë ndjerë plotësisht të sigurt. Ata duhet të përpiqen të përkujtohen se ku kanë qenë atëherë, me kë, si janë ndjerë dhe pse janë ndjerë ashtu. Pas disa minutave mund t'i hapin sytë, ndërsa disa vullnetarë do të tregojnë se ku dhe kur janë ndjerë të sigurt.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në tre grupe dhe secili grup e merr për detyrë që të mendojë dhe vizatojë ose shkruajë në një fletë të madhe të letrës sesi në mjedisin gjegjës vetë fëmijët kujdesen për sigurinë e tyre, si dhe kush mund t'u ndihmojë atyre nëse gjenden në situata të pasigurta ose të rrezikshme.

- Grupi I – në shtëpi
- Grupi II – jashtë
- Grupi III – në shkollë

Pasi të përfundojnë, nga një përfaqësues i secilit grup e prezanton para të tjerëve atë që është shkruar dhe e ngjet fletën e letrës në një vend të dukshëm në klasë.



Diskutim

1. Kush është përgjegjës për sigurinë tonë?
2. A është e vërtetë se sado që të kujdesemi ne për sigurinë tonë, megjithatë mund të na ndodhë ndonjë situatë e pakëndshme ose të biem në ndonjë fatkeqësi?
3. Kush mund të na ndihmojnë në ato situata?
4. Cilat janë shërbimet dhe institucionet e shtetit që mund të na ndihmojnë në situata të kanosjes së rrezikut për ne?
5. A i dini numrat e telefonave të shërbimeve urgjente?
Arsimtarja i shkruan në tabelë

POLICIA	192
BRIGADA E ZJARRFIKËSVE	193
NDIHMA E SHPEJTË	194
AMSM – NDIHMA NË RRUGË	196
TELEFONI SOS PËR FËMIJË dhe TË RINJ 0800 1 22 22	
AVOKATI I POPULLIT	02 3129 351

6. Pse duhet t'i dimë përmendsh këto numra?
7. Çka duhet të themi kur të paraqitemi në ndonjërin nga këto numra?
8. A është e vërtetë se këto institucione dhe shërbime janë të patjetërsueshme dhe a mund të ndihmohemi ne vetë pa i pasur edhe ato? Pse?
9. A duhet të jenë të stërvitur njerëzit që ta kryejnë detyrën në këto shërbime apo këtë mund ta kryejë detyrë secili që mund të punojë aty Pse?

Përfundim

Përveç që ne vetë duhet të kujdesemi për sigurinë tonë, ekzistojnë edhe institucione dhe shërbime shtetërore që mundësojnë mbrojtje dhe siguri për qytetarët e një shteti. Disa prej tyre janë policia, brigada e zjarrfikësve, ndihma e shpejtë, AMSM, avokati i popullit, telefoni SOS – për fëmijët dhe të rinjtë që janë viktimë të dhunës etj. Është me rëndësi që numrat e këtyre shërbimeve t'i dimë përmendsh që të mund të paraqitemi shpejt dhe të kërkojmë ndihmë prej tyre kur jemi të rrezikuar. Në këto shërbime punojnë profesionistë që janë të stërvitur për punë në atë fushë dhe detyra e tyre është që të ndërhyjnë dhe të ndihmojnë sa herë që të kërkohet shërbimi i tyre. Këto numra të telefonit nuk shërbejnë për argëtim dhe për dërgim të thirrjeve të rrejshme. Kur të paraqitemi në ndonjërin nga këta numra, duhet të tregojmë kush jemi, t'i themi disa fjalë për problemin dhe adresën e saktë ku dëshirojmë të na vijë ndihma. Është shumë me rëndësi që të jemi të qetë që të mund të na kuptojnë saktë dhe drejt.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Tema IV: UNË DHE SHËNDETI – JETA E SHËNDETSHME

Përmbajtja IV-1: PËRVETËSIMI I SHPREHIVE PËR USHQIM TË SHËNDETSHËM

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë llojet e ndryshme të ushqimit » të dijë se ushqimi ndikon në sëmundje dhe në parandalimin e sëmundjeve (lloji, përpunimi, përgatitja dhe ruajtja) » të dijë sesi merret ushqimi me rregull (koha e caktuar dhe vendi)
Shkathtësi	» të mund të bëjë zgjedhje të llojeve të ndryshme të ushqimit » të mund të përgatitë ushqim të thjeshtë për vete (sandviçë, sallatë) » të mund ta konsumojë ushqimin si duhet
Qëndrime/vlera	» ta kuptojë rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm për shëndetin dhe zhvillimin e trupit » ta kuptojë se një pjesë e sëmundjeve shkaktohet nga ushqimi joadekuat dhe jo i rregullt (helmimet, diarreja, vjellja) » ta kuptojë se ushqimi i pamjaftueshëm, ushqimi i tepërt dhe ushqimi i çekuilibruar janë të dëmshëm për shëndetin

Punëtorja IV-1.1 Barometri që harxhon kalori



Materialet:

» fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Pohime

Aktiviteti kryesor

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Në dy anë të kundërta të klasës janë ngjitur fleta, kur në njërin skaj shkruan “pajtohem”, ndërsa në skajin tjetër shkruan “nuk pajtohem”. Nxënësve u thuhet se nëse pajtohen me pohimin që do ta lexojë arsimtari të shkojnë në atë anë ku shkruan “pajtohem”, ndërsa nëse nuk pajtohen me atë pohim, të shkojnë në atë anë ku shkruan “nuk pajtohem”. Pasi të pozicionohen ata, atëherë pyeten se pse e kanë bërë atë zgjedhje dhe kështu zhvillohet një diskutim i vogël pas secilës pyetje. Atyre u lexohen pohimet e mëposhtme të fletës së punës për arsimtarin/arsimtaren “Pohime”.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Ushqimi është burimi i energjisë për trupat tanë. Shumë shpesh harrohet se duhet t'i kushtohet vëmendje serioze çështjes se si, kur dhe çfarë ushqimi hamë.

- » Nëse fëmija është shumë i uritur, mund të hajë pa i larë duart, natyrisht nëse nuk i ka të përlyera.
- » Është krejt njësoj a do të hash në tryezë ose para televizorit, nëse e ha atë që duhet ta hash. (ashtu si është e rëndësishme zgjedhja e ushqimit, po ashtu e rëndësishme është edhe kur hahet ai ushqim, pastaj me rëndësi është që gjithë vëmendja të jetë e përqendruar në ushqim, që mos ta teprojmë, që të jemi të vetëdijshëm për procesin e ushqimit).
- » Çipsat janë ushqim si secili ushqim tjetër. (çipsat shiten si ushqim, por në to nuk ka kurrgjë që është e dobishme ose e shëndetshme për organizmin tonë; përkundrazi, çipsat përmbajnë vetëm materie që janë të dëmshme për shëndetin; çipsat mund të përmbajnë edhe materie kancerogjene).
- » Perimet duhet të hahen, sepse ashtu dëshirojnë nënat, etërit ose gjyshet. (perimet janë burim i rëndësishëm i vitaminave, mineraleve dhe fijeve bimore, si dhe i proteinave që janë shumë të rëndësishme për rritjen e zhvillimin normal)
- » Hamburgerët janë ushqim i shëndetshëm, sepse përmbajnë edhe drithëra, edhe mish, edhe perime. (është e saktë se hamburgerët përmbajnë edhe drithëra, edhe mish edhe perime, por mënyra e përgatitjes së tyre nuk është aspak e shëndetshme. Buka mund të mos jetë e dëmshme, edhe pse është mirë të jetë nga mielli integral, perime zakonisht ka shumë pak në hamburger dhe ato janë jo mirë të lara, ndërsa mishi është përgatitur në mënyrë shumë të parregullt – grillë; kështu nga ushqimi krijohen materie të dëmshme, sepse ai është ushqim me plot yndyra. Hamburgerët, si çdo ushqim tjetër i shpejtë, po ashtu nuk bien në ushqimet e shëndosha)
- » Pemët janë menduar që t'i bëjnë të vuajnë fëmijët që i hanë ato. (Pemët janë një burim i rëndësishëm i vitaminave, mineraleve dhe fijeve bimore, që janë shumë të rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin e rregullt)
- » Është krejt njësoj nëse në pushimin e madh do të hash gjëra për përtyypje ose banane. (gjërat e imëta për përtyypje vërtet janë më të shijshme, por shumë shpesh për nga cilësia janë njësoj me ushqimin e shpejtë)
- » Fasulja hahet vetëm që të ndotet mjedisi. (fasulja është burim i rëndësishëm i proteinave)
- » Mund të hahet edhe kur ecim.
- » Spinaqi është një bar i gjelbër dhe i lëngët, i cili shërben vetëm për t'i dënuar fëmijët (spinaqi ka edhe erë edhe shije specifike, me të cilën shpejt mësohemi; është shumë i pasur me hekur dhe disa vitamina që janë shumë të rëndësishme për rritjen normale të fëmijëve; nëse spinaqi i zier na duket pa shije, mund ta hamë në pite ose me sallatë)
- » Në mish ka albuminë, vitamina dhe minerale që nuk gjenden në asnjë ushqim tjetër. (mishi është burimi më i madh i albuminave, i vitaminës B12, që është shumë e rrallë dhe me përqindje shumë të vogël në ushqime të tjera, por mishi është i pasur edhe me hekur. Disa fëmijë nuk hanë mish, por nuk e dinë se nëse nuk hanë mish, do të jetë shumë e rëndësishme se me çka do t'i kompensojnë ato materie ushqyese)

Punëtorja IV-1.2 Piramida e të ushqyerit



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Piramida e të ushqyerit
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Jeta dhe vepra e një pufke

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në dy grupe. Duhet të ketë mjaft vend që të dyja grupet të renditen në radhë paralele, të kthyer kah njëri-tjetri ballë për ballë, ndërsa ndërmjet radhëve duhet të ketë hapësirë rreth një metër. Pastaj njëri pas tjetrit kalojnë nëpër këtë hapësirë të krijuar mes rreshtave dhe aktrojnë sikur të jenë një kafshatë ushqimi. Fëmijë e rreshtave janë pjesë e sistemit të tretjes dhe me duar të shtrira bëjnë lëvizje lart-poshtë, duke u përkulur e duke u ngritur njëri pas tjetrit me tempo të ndryshme. Të gjithë fëmijët duhet të kalojnë si ushqim nëpër këtë hapësirë, pra të jenë edhe ushqim edhe organ i tretjes.

Aktiviteti kryesor

Arsimtarja e vizaton në tabelë një siluetë të thjeshtë të qenies së njeriut. Pastaj gjithë grupit i parashtron pyetje, ndërsa përgjigjet shkurtimisht i shkruan në siluetën vizatuar në tabelë. Pasi të shkruhen të gjitha përgjigjet e një pyetjeje, ato komentohen, shtrohen nënpyetje dhe bëhen përfundime (nuk komentohet derisa të shkruhen përgjigjet):

- » Pse na nevojitet ushqimi?
(ushqimi na nevojitet për energji, për material ndërtues për rritjen e trupit, për vitamina, minerale dhe për procesin e metabolizmit)
- » Pse na nevojitet uji? (për tretjen e ushqimit, për mënjanimin e helmeve nga trupi, për rregullimin e temperaturës së trupit). Sa kohë mund të qëndrohet pa ujë?

Paraqitet piramida e ushqimit. Pastaj kërkohet nga fëmijët që vullnetarisht t'i shpjegojnë disa pjesë të piramidës. Është e pëlqyeshme që ajo të vizatohet në një fletë të madhe dhe të ngjitet në mur, që të mund ta shohin të gjithë nxënësit gjatë tërë vitit, veçanërisht kur punohet ushqimi i shëndetshëm).

Përfundim

Trupave tanë u duhet ushqim dhe ujë që të mund të funksionojnë. Pa ushqim mund të durojmë disa javë, ndërsa pa ujë vetëm disa ditë. Nevojitet që në trup të futet ushqim i llojllojshëm dhe i ekuilibruar. Për pije, më së miri është të përdoret uji.

Aktiviteti përmbyllës


Të gjithë qëndrojnë në rreth. Në këtë aktivitet pritet nga pjesëmarrësit që ta bëjnë atë që e bën ose që i ndodhë personazhit kryesor të përrallës. E jo është një pufkë. Arsimitarja i lexon udhëzimet e fletës së punës së arsimtarit/arsimtares "Jeta dhe vepra e një pufke" (fjalët që janë me shkronja të mëdha i lexon më të theksuara dhe më ngadalë – ajo është ajo që pritet ta bëjnë fëmijët).



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
1. Si ndjeheshit?
1. Çka mësuam?
1. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

SASIA E REKOMANDUAR E USHQIMIT TË SHËNDETSHËM DHE TË EKUILIBRUAR SIPAS ORGANIZATËS BOTËRORE TË SHËNDETËSISË



U lind në fushë një kokërr e verdhë e misrit, aty ku era i rrihte degët që hareshëm LUHATESHIN në fushë. Ato LUHATESHIN MAJTAS dhe LUHATESHIN DJATHTAS. Të gjitha kokrrat e misrit kënaqeshin dhe QESHNIN me zë në secilën frymë të erës. Kështu gjithë verën. U RRITËN, u poqën dhe u kënaqën. Kur erdhi kombajna që t'i korrë, ato paksa u DRIDHËN nga frika. Por, shpejt e kuptuan se asgjë nuk është kjo. Kombajna i RROTULLONTE në të gjitha anët, LART, POSHTË, MAJTAS dhe DJATHTAS. URRAAAAA nga kënaqësia. I dërguan në fabrikë dhe i paketuan të SHTYPURA në njëra-tjetrën. Atyre u vinte ngushtë. Përnjëherë ndodhi një dridhje dhe korrat një nga një KËRCYEN dhe bërtitën JUHUUUUU!!!! Ato i priste një vaj i nxehtë, por shumë i nxehtë, ashtu që pufka jonë u MBLODH si një fëmijë kur PËRKULET. Filloi të djersitet dhe të ndjejë një shqetësim dhe fuqi të brendshme. Gjithnjë më shumë e më shumë. I vinte nxehtë, ishte vapë e padurueshme. Dhe, përnjëherë mori fuqi dhe KËRCEU lart duke bërtitur NXEHTË ËSHTËËËËË!!! Dhe, LULËZOI.

Punëtorja IV-1.3 Patatja e nxehtë



Materialet:

- » top letre (në madhësi të topit të tenisit)
- » dy lugë kafeje
- » disa kokrra fasule (7-10)
- » fletë pune për nxënësit IV-1.3: Produktet ushqimore 1
- » pajisje për të shkruar
- »

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ulen në rreth. Arsimitarja e fillon aktivitetin duke u thënë se këtë top të letres mund ta shndërrojë lehtë në patate të nxehtë. Qëllimi i aktivitetit është që patatja të përcillet te secili, që të gjithë t'i ngrohin duart, sa më shpejt që mundet, por pa rënë aspak në tokë. Ajo e mban topin në duar dhe e cakton fillimin. Ajo duhet të aktrojë se si vërtet është duke mbajtur një patate të nxehtë në duar. Detyra e secilit nxënës është që ta pranojë dhe ta përcjellë pataten te fëmija që është pranë tij, duke aktruar se është duke mbajtur një patate të nxehtë. Arsimitarja i nxit (jep shembull) sesi duhet të aktohet lëvizja e patates së nxehtë. Kjo mund të përsëritet disa herë.

Aktiviteti kryesor

- Nxënësit ndahen në katër grupe. Atyre u jepen listat me produkte ushqimore. Grupeve u jepen njëra nga këto detyra:
- » Cilat nga këto produkte i hamë më së shumti kur jemi të sëmurë? Pse?
 - » Si mund të përgatiten këto produkte që të mund të të hahen? Pse?
 - » Si duhet të ruhen këto produkte që të mund të hahen? Pse?
 - » Cilat nga këto produkte duhet të hahen më shumë e cilat më pak që njeriu të jetë i shëndoshë? Pse?

Pas pesëmbëdhjetë minutave grupet prezantohen.



Diskutim:

1. Çka dimë për limonët? Çfarë shije kanë? Pse janë të thartë? (të pasur me vitaminë C)
2. Çka dimë për qumështin dhe produktet e qumështit? Çfarë ngjyre kanë? E çfarë shije?
3. Si bëhet djathi? Ku duhet të ruhet? Pse?
4. Ku duhet të mbahet jogurti? Pse? A ka provuar dikush jogurt që është harruar në frigorifer një kohë më të gjatë? Çfarë shije ka?
5. A ka ngrënë dikush vezë që nuk janë të pulës? Çfarë ishin ato? (të patës, shkurtëzës, strucat) Në çfarë mënyre hahen vezët? Sa mund të qëndrojnë vezët të fërguara ose të gjalla? A është e njëjtë nëse vezët mbahen në frigorifer apo në ballkon?
6. Çka dimë për çipsat dhe gjërat për përtpje? Nga çka bëhen ato? Çka përmbajnë?
7. E biskotat? Prej çka bëhet ato?

Përfundim

Sasia, lloji dhe renditja e ushqimit gjatë ushqimeve ndikon mjaft në gjendjen e përgjithshme të organizmit, pa marrë parasysh se a është dikush i sëmurë ose i shëndoshë. Në situata ose gjendje të ndryshme kemi nevojë për lloje të ndryshme të ushqimit, varësisht nga situata ose nga gjendja. Llojet e ndryshme të ushqimit kërkojnë trajtim të ndryshëm. Çipsat, biskotat dhe gjërat për përtpje janë shumë të popullarizuara, por janë shumë të dëmshme për shëndetin. Çipsat bëhet nga shumë gjëra, ka miell, patate, amidon dhe shumë gjëra të tjera që kanë emër të komplikuar dhe karakteristika të panjohura. Ato nuk kanë albumina. Biskotat bëhen nga mielli, ëmbëltuesit, më shpesh me sheqer, aromat artificiale, çokollatat dhe shumë kimikate me emra të komplikuar dhe karakteristika të panjohura. Shumë shpesh kanë shumë sheqer, saqë për një njeri mjafton për disa ditë ose kanë aq energji sa të vrapohet së paku tre kilometra.

Aktiviteti përmbyllës

Pjesëmarrësit ndahen në dy grupe, me numër të njëjtë të anëtarëve (nëse është numër tek, aty merr pjesë arsimtarja). Grupet mblidhen në njërin skaj të klasës, njëri në anë të majtë, e tjetra në anë të djathtë. Pastaj caktohet vija e fillimit. Në anën tjetër të klasës janë vënë dy karrige, ndërsa karriget e tjera hiqen anash që të mund të kalohet më lehtë. Grupet delegojnë nga një fëmijë që të fillojë. Atij fëmijë duke qëndruar në vijën e fillimit i jepet një luge kafeje me tre kokrra fasule. Secili anëtar i grupit duhet të qëndrojë një herë në vijën e fillimit, pastaj duhet që sa më shpejt të bëjë një rreth përreth karriges dhe të kthehet në fillim që ta dorëzojë lugën me fasule te fëmija tjetër, por duke pasur kujdes që të mos i bien kokrrat e fasules. Nëse i bien, duhet të vrapojë edhe një rreth. Fitues i kësaj loje është ai që e kryen rrethin më shpejt.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-1.4: Sallatë ose sandviç?



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Piramida e ushqimeve (nga punëtorja IV-1.2 „Piramida e ushqimeve“)
- » fletë pune për nxënësit IV-1.4: Produktet ushqimore 2

Aktiviteti hyrës

Nxënësit qëndrojnë në rreth. Pasi të jepet shenjë për fillimin e aktivitetit, ata duhet të fillojnë të lëvizin lirisht në rreth. Kur të jepet udhëzimi Sandviç!, ata duhet ta renditen në vijë me së paku tre nxënës, por pa u prekur mes vete. Madje edhe nëse në ndonjë grup mbasin dy veta ose vetëm një fëmijë, aty duhet sa më shpejt ta bashkohet në ndonjë figurë të formuar. Kur të jepet udhëzimi Sallatë!, tre-katër nxënës (varësisht nga klasa) mbahen për duar, ndërsa dy-tre tjerë pozicionohen brenda rrethit që e kanë formuar ata që mbahen për duar. Secili fëmijë mund të inkuadrohet në çfarëdo sallate nëse është pjesë e ndonjë figure. Kur të jepet udhëzimi Spageta!, nga dy tre fëmijë kapen për duar dhe i shtrijnë duart që të bëjnë vijë. Kur të jepet udhëzimi Fasule e pjekur!, të gjithë përkulen në dysHEME. Udhëzimet përsëriten njëra-pas-tjetres, pa ndonjë radhitje, por gjithnjë më shpejt e më shpejt.

Aktiviteti kryesor

Pjesëmarrësit ndahen në katër grupe. Secilit grup i jepet fleta e punës me piramidën e ushqimeve. Po ashtu u jepet edhe fleta e punës me llojet e produkteve ushqimore. Të dyja grupeve u jepet për detyrë që të vendosin se cilat prodhime të listës do t'i përfshijnë që të bëjnë sallatë të mirë sipas piramidës së ushqimeve, ndërsa dy grupeve të tjera u jepet për detyrë ta mendojnë sandviçin. Pas 15 minutave grupet e prezantojnë atë që e kanë punuar.



Diskutim

1. Si bëhet sandviçi?
2. Si bëhet sallata?
3. Cilat prodhime i futët në sallatë? Cilat jo? Pse?
4. Cilat prodhime i futët në sandviç? Cilat jo? Pse?
5. A kishte produkte që nuk i futët askund? Pse?
6. A mund të bëhen kombinime të tjera të sallatave? (pritet që nxënësit t'u përmbahen varianteve tradicionale të sallatës, vetëm në perimet më të hershme vjetore. Nxiten të mendojnë për kombinime të ndryshme: sallata peshku me brumëra dhe perime; sallatë me djathë/kaçkavall, fasule ose sojë; sallatë me spinaq dhe gjera të tjera; sallatë me fruta deti me shtojca të ndryshme; sallatë me mish pule etj.).
7. A mund të bëhen lloje të tjera të sandviçëve? (nxënësit po ashtu nxiten të mendojnë për kombinime të ndryshme, sandviç peshku, sandviç me sojë, me fruta deti, me vezë, gjalpë me kikirikë, me xhem, me mjaltë etj.)
8. Çka na flet piramida e ushqimit të shëndetshëm?
9. A mund të vlerësoni se a i përmbaheni ju kësaj?
10. A bëni ndonjëherë sandviç të shëndetshëm edhe në shtëpi?
11. Çka ju mungon?
12. Sa ujë pini?
13. A duhet të pihet ujë? Pse? Çfarë uji?

Përfundim

Që të funksionojë në mënyrë optimale, organizmit tonë i nevojitet ushqim i ekuilibruar, i rregullt dhe i llojllojshëm. Nëse konsumojmë vetëm një lloj të ushqimit (vetëm brumëra ose vetëm mish), ne e kufizojmë marrjen e elementeve të rëndësishme të ushqimit. Me kalimin e kohës kjo do të vijë në shprehje edhe në shëndetin tonë. Çdoherë më mirë është të zgjedhjet ushqim sa më pak i përgatitur dhe ushqim sa më natyral (mishi është më i shëndetshëm të hahet i zier sesa si i fërguar; sallatat janë më të shëndetshme në formë të thatë sesa të konservuara; ushqimi që blihet i gatshëm ose gjysmë i gatshëm shpesh i ka humbur përbërësit e rëndësishëm dhe zakonisht ka shtojca që nuk janë shumë të pëlqyeshme për konsumim).

Çipsat dhe gjërat për përthypje thuajse fare nuk rekomandohen si zgjedhje të shëndetshme, si edhe konsumimi i tepërt i hamburgerëve dhe të a.q. virshlla.

Për organizimin tonë është shumë e rëndësishme të pimë ujë. Uji (nëse është i pijshëm) çdoherë është zgjedhja më e shëndetshme nga secili lëng tjetër.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë shëtisin lirshëm në rreth. Kur të thotë arsimtarja TOSTER 1, 2, 3, 4, 5!, fëmijët më të afërt duhet të formojnë tresha, ashtu që me një fëmijë do të kapen për duart, të shtrira në lartësi të shpatullave, ndërsa një fëmijë që është në mes (buka) kërcen në toster tri herë. Nëse ka fëmijë që nuk arrijnë të formojnë tresha derisa arsimtarja numëron deri në pesë, atëherë vetë arsimtarja i fton ata me emër që ta gjejnë momentin dhe të numërojnë deri në pesë. Fakti që disa nxënës nuk arrijnë të formojnë tresha, duhet të trajtohet me mjaft butësi (si argëtim, e jo si gabim).



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-1.5 Ushqime të thjeshta



Materialet:

- » pajisje për të shkruar
- » fleta letre
- » gërrshërë

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Ndahen në tresha. Në këto tresha secili fëmijë duhet t'i thotë disa ushqime të dëshiruara. Pastaj për ushqimet që i kanë numëruar duhet të gjejnë ndonjë ushqim që do të jetë i përbashkët për të gjithë. Nëse arrijnë të gjejnë, e thonë atë para të gjithëve, e nëse nuk gjejnë, e thonë nga një ushqim të dëshiruar të secilit fëmijë në tresh.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe të vogla. Në secilin grup duhet të merren vesh dhe ta përshkruajnë se si përgatitet një ushqim i thjeshtë të cilin dinë dhe mund ta përgatitin vetë. Nxiten të flasën për ushqime sa më të thjeshta, si tosti, vezët e fërguara, sallata dhe ushqime të tjera për të cilat është mundur të pritët se mund t'i bëjnë në atë moshë. Është me rëndësi që mos të fokusohen në ushqime të gatshme, si për shembull konflekjs.

Pasi të merren vesh se çka do të bëjnë, ata duhet t'i vizatojnë në mënyrë të thjeshtë produktet nga të cilat janë të përbëra ushqime, t'i presin dhe t'i vendosin në një fletë tjetër, e cila paraqet enë e ushqimit që e kanë menduar. Pastaj grupet e prezantojnë punën e tyre. Përmendet një ushqim që e kanë menduar dhe tregohet se si e kanë përgatitur atë.



Diskutim

1. Kush ka marrë pjesë deri tash prej jush në përgatitjen e ushqimit?
Në çfarë ushqimi?
2. A ka përgatitur dikush deri tash ndonjë ushqim vetë?
3. A ka ndonjë fëmijë që vetë e përgatitë ushqimin për në shkollë?
4. A duhet të bëjmë vetë ushqime? Pse?
5. Në çka duhet të kemi kujdes kur përgatitim ushqim?
6. A mund të na tregojë ndonjë fëmijë si bëhet ndonjë ushqim tjetër
– nëse duhet, të gjithë do të ndihmojmë në atë shpjegim.

Përfundim

Fëmijët qysh në moshë më të re, kuptohet me ndihmë e të rriturve, mund të marrin pjesë në përgatitjen e ushqimit, madje më vonë mund të përgatitin ushqime të thjeshta edhe vetë. Që të mund ta bëjnë këtë, atyre duhet t'u jepen informacionet më themelore dhe t'u tregohet kjo shkathtësi. Që të mund të gatuajnë vetë ushqim dhe ta ndërmarrin këtë përgjegjësi mbi vete, ata do të duhet ta dinë se si bëhet kjo dhe të dinë se çka mund e çka nuk mund të bëjnë vetë.

Aktiviteti përmbyllës

Kërkohen dy fëmijë vullnetarë-prerës. Të tjerët ndahen në katër grupe të vogla sipas produkteve të caktuara ushqimore. Grupet e kanë detyrën e njëjtë – të shëtitin nëpër klasë si grup duke u mbajtur për duar. Fëmijët-prerës mund të lëvizin më ngadalë. Kur të arrijnë ata në ndonjë grup, duke e prekur me dorë, ata mund ta presin grupin në atë vend. Atëherë grupi nuk mund të lëvizë më. Fëmija-prerës mund ta ndajë edhe një vend ku fëmijët mbahen për duar dhe kështu fëmija që mbetet me dy duar të lira po ashtu bëhet prerës si ky. Ndërkaq fëmija që më parë ishte prerës e merr vendin e tij në grup.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-1.6 Lënda djegëse organike



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Piramida e ushqimeve 2

Aktiviteti hyrës

Të gjithë lëvizin lirshëm nëpër klasë. Të gjithë janë peshq që notojnë në oqean. Në një moment arsimtarja u thotë se ata janë shumë të uritur. Peshqit e mëdhenj i hanë peshqit më të vegjël. Pas dhjetë sekondave qysh prej fillimit të aktivitetit arsimtarja i prek 3-4 fëmijë në supe dhe ata bëhen PESHQ TË MËDHENJ. Ata fillojnë të lëvizin me krahë të hapur e të shtrirë para vetes. Ata përpiqen të hanë ndonjë peshk të vogël. Ndërkaq peshqit e vegjël përpiqen të ikin. Kur ta prekin ndonjë nga peshqit e vegjël (ndonjë fëmijë), ai fëmijë konsiderohet i gjuajtur/i ngrënë. Fëmija i ngrënë pastaj ndalet pas PESHKUT TË MADH, sikur të jetë tren. Ata vazhdojnë më tej të gjuajnë peshq të vegjël dhe kështu treni rritet. Nëse bëhen më shumë, ata mund të gjuajnë edhe PESHQ TË TJERË TË MËDHENJ, ndërsa nëse janë më pak në numër, do të duhet të ikin. Aktiviteti mbaron kur të renditen të gjithë fëmijët në një peshk të madh (rend).

Aktiviteti kryesor

Arsimtarja e prezanton piramidën e ushqimeve dhe i prezanton grupet e ushqimeve, me karakteristikat e tyre gjegjëse dhe nevojat e organizmit.

Këtu potencohet rëndësia e konsumimit të ujit dhe shmangia e sheqernave dhe yndyrave, si dhe i ushqimit të shpejtë.

I fton nxënësit që bashkërisht t'i paramendojnë nga tre ushqime në ditë, për shtatë ditë, duke i respektuar rekomandimet e piramidës së ushqimeve.



Diskutim

Arsimtarja parashtrohet pyetje para gjithë grupit.

1. Me çka punon vetura? (E synon përgjigjen – lënda djegëse)
2. Çka do të ndodhë nëse shohim se nuk kemi sa duhet lëndë djegëse në veturë? A mund t'i fusim veturës pak ujë apo pak vaj në rezervar? (nëse i hedhim ujë, motori nuk do të punojë, ndërsa nëse i qesim vetëm pak ujë, atëherë mbase do të punojë pak, por nuk do të punojë mirë, do të shuhet, do të bëjë zhurmë, do të shkojë ngadalë)
3. A u duhet të gjitha veturave sasia e njëjtë dhe lloji i njëjtë i lëndës djegëse? Veturave më të mëdha u duhet më shumë lëndë djegëse, disa punojnë me dizel, disa me biodizel kamionët e autobusët harxhojnë shumë më tepër)
4. Çka e lëviz biçikletën? (muskujt tanë)
5. Çka u duhet muskujve tanë që ta lëvizin biçikletën?
6. Çfarë lloje të ushqimeve ka? (pemë, perime, qumësht dhe prodhime të qumështit, peshk dhe mish)

Përfundim

Lënda djegëse/energji e trupi tonë është ushqimi që ne e konsumojmë. Për dallim nga veturat, trupat tanë janë sisteme shumë më të komplikuara. Prandaj është me rëndësi që ushqimin që e konsumojmë të jetë i ekuilibruar dhe i shpërndarë mirë.

Termi “njësi” që haset në fletën e punës së arsimtarit/ arsimtares “Piramida e ushqimeve” u referohet pjesëve dhe proporcioneve të përfaqësimit të llojeve të ndryshme të ushqimit në një kohë të caktuar (ditë, javë). Grupe të ndryshme të ushqimit përmbushin nevojat të ndryshme të organizmit. Ashtu si te veturat, edhe njerëzve të moshave të ndryshme u duhen sasi të ndryshme dhe lloje të ndryshme të ushqimit. Fëmijëve u duhen më shumë proteina që të rriten, ndërsa më të rriturve u duhen më pak.

Aktiviteti përmbyllës

Fëmijët ndahen në tresha. Ata duhet ta mendojnë një ushqim të shëndetshëm të cilin me pantomimë duhet t'ua përshkruajnë të tjerëve. Secili fëmijë në grup e shpjegon nga një fjalë. Rekomandohet të mendohen ushqimet që i kanë së paku tre fjalë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

SASIA E REKOMANDUAR E USHQIMIT TË SHËNDETSHËM
DHE TË EKUILIBRUAR, SIPAS ORGANIZATËS BOTËRORE
TË SHËNDETËSISË, E SHPREHUR NË NJËSI TË KONSUMIMIT
TË PËRBËRJEVE TË NDRYSHME USHQIMORE.



Punëtorja IV-1.7: Shprehitë e shëndosha



Materialet:

- » fletë pune për nxënës IV-1.7a: Shprehitë e shëndosha
- » fletë pune për nxënës IV-1.7b: Për pesë vite
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Për pesë vite

Aktiviteti hyrës

Të gjithë ulen në rreth. Arsimitarja i jep këto udhëzime:

- » Të gjithë që duan të shëtisin në natyrë, le të ngrihen.
- » Të gjithë që dëshirojnë të luajnë në kompjuter, le t'i ngrenë duart.
- » Të gjithë që hanë shumë çipsa dhe gjëra për përtypje, le t'i shkundojnë barqet.
- » Le të ngrihen të gjithë ata që dëshirojnë të pinë lëngje të gazuara.
- » Le të ngrihen të gjithë që dëshirojnë të hanë çokollatë.
- » Le të zgjaten të gjithë ata që qëndrojnë në këmbë.
- » Të gjithë që duan të hanë gjëra të ëmbla, le të vrapojnë në vend.
- » Të gjithë që dëshirojnë të hanë perime, le të ulen të pushojnë.
- » Të gjithë që dëshirojnë pemë, le t'u bashkëngjiten atyre.
- » Të gjithë që nuk mund të durojnë të dëgjojnë se çka do të bëjmë në vijim, le të ulen.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në katër grupe. Për shembull: në banane, portokaj, kivi dhe mandarina. Secilit grup i jepet nga një fletë e punës "Shprehitë" dhe një fletë pune "Për pesë vite". Secili grup duhet t'i lidhë fëmijët e fletës së punës "Shprehitë" me fëmijët e fletës së punës "Për pesë vite". Kjo bëhet ashtu që në një vend të zbrazët në fletën e punës "Për pesë vite" shkruhet emri i fëmijës për të cilin mendohet se i shkon fëmijës së fletës së punës "Shprehitë". Një grup e prezanton vetëm një situatë.



Diskutim

1. Çfarë shprehish ka Dritoni? A është e mundur që ajo t'i ndodhë për pesë vite?
2. Çka bën Dritoni që kjo t'i ndodhë për pesë vite?
3. Cilat janë shprehitë e Artës? A është e mundur që ajo t'i ndodhë për pesë vite? Pse?
4. Çka bën Arta që kjo t'i ndodhë për pesë vite?
5. Me çka dallohen shprehitë e Dritonit dhe të Artës nga ato të Arbenit dhe të Zdravkës?
6. Çka është problematike me ushqimin që e ha Dritoni dhe Arta?
7. Çfarë ushqimi hanë Arbeni dhe Zdravka?
8. A mund të konsumohet vetëm një lloj i ushqimit?
9. Pse është e rëndësishme të hahet ushqim i llojllojshëm?
10. Çka mendoni për lëngjet e gazuara? A janë të dobishme? (janë shumë të dëmshme, pa marrë parasysh cilët. Janë të mbushur me sheqer: në dy litra koka-kolë ka 48 lugë kafeje me sheqer. Ato lëngje të gazuara në vend të sheqerit përmbajnë ndonjë zëvendësim, janë edhe më të dëmshme – e shokojnë organizmin, e përgatitin të konsumojë sasi të mëdha të ushqimit. Pjesa më e madhe e zëvendësuesve të sheqerit janë kancerogjenë.
11. A mund të bëhet vetëm një gjë në kohën e lirë?
12. Pse është i rëndësishëm aktiviteti fizik?
13. A mund t'i kthejë Dritoni dhembët e prishur?
14. E Arta a mund ta përmirësojë shikimin?
15. Si dhe sa shpesh duhet të hahet?
16. A është e shëndoshë mënyra e të ushqyerit para televizorit? Pse? (është shumë me rëndësi që kur të hamë të jemi të koncentruar vetëm në procesin e ushqimit; ashtu rritet vetëdija dhe ndjenja për sasi. Dhe, më shumë kënaqemi me ushqimin.)

Përfundim

Në kohën tonë fëmijët në masë të madhe hanë ushqim të shpejtë, jo të shëndetshëm dhe në vend të aktivitetit fizik dhe komunikimit të gjallë, kohën e kalojnë para kompjuterit ose televizorit. Nëse kjo teprohet, pasojat mund të jenë shumë serioze. Disa pasoja janë të përhershme.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Për pesë vite

Për pesë vite, ZDRAVKA ishte përgjegjës/e e seksionit të ndihmës së nxënësve të tjerë. Është shumë e përkushtuar dhe shumë rregullisht do t'i vizitojë. Të gjithë do të habiten si ka aq energji për gjithçka dhe përsëri të duket aq i/e shëndoshë dhe i/e mbushur me energji. Të gjithë ia marrin lakmi.

Për pesë vite, ARTA do të ketë probleme me gjumin. Shpesh do të ngrihet natën e frikësuar. Shumë vështirë do të lëvizë nga kolltuku dhe do ta urrejë fizikulturën. Mjeku do t'i japë syze të mëdha. Një mjek tjetër do t'i rekomandojë vitamina dhe minerale që do të duhet t'i marrë si tableta, sepse do të ketë aq shumë mungesë që nuk mund të kompensohet dot nga burime natyrore. Ai fëmijë do të jetë gjithnjë e më i dobët. Asnjë ftohje ose grip nuk do t'i ikë.

Për pesë vite DRITONI do të ketë seriozisht më shumë kilogramë se fëmijët e tjerë në klasë. Ky edhe nuk do të jetë ndonjë problem nëse mund të vrapojë në orët e edukatës fizike së paku sa gjysma e asaj që ka mundur të vrapojë para pesë viteve. Dhëmbët do t'i prishen dhe lëkura do t'i zbehet. Shumë shpesh pa asnjë shkak do të jetë nervoz. Do të shpërthejë dhe do të bërtasë. Po ashtu shumë shpesh nuk do të mund të kuptojë se për çka flasin fëmijët e tjerë. Mjekët i rekomandojnë vitamina, minerale dhe aktivitet fizik.

Për pesë vite për ARBENIN do të dijë gjithë shkolla. Do të jetë njëri nga fëmijët më simpatikë dhe më të qetë. Çdoherë do të jetë i buzëqeshur dhe i gatshëm për të ndihmuar. Në veçanti do të shkëlqejë qetësia dhe kthjelltësia e tij. Të gjithë do ta duan. Do të jetë këtu për të gjithë dhe çdoherë do të duket i pushuar dhe i shëndetshëm. Ai nuk është sëmurë asnjëherë në pesë vitet e fundit.

Përmbajtja IV-2: KUJDESI PËR HIGJINIËN PERSONALE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të dijë çka është higjiena e plotë personale » t'i dijë mjetet e mbajtjes së higjienës së plotë personale » t'i dijë pasojat e mbajtjes së teshave të përlyera dhe të këpucëve për shëndetin dhe pranimin social
Shkathtësi	» të mund ta mbajë rregullisht higjienën e plotë personale (trupin, flokët, veshët, thonjtë) » të mund ta mirëmbajë të pastër veshjen dhe këpucët
Qëndrime/ vlera	» të pranojë se mirëmbajtja e higjienës personale është e rëndësishme për shëndetin dhe pranimin social » ta kuptojë se mirëmbajtja e higjienës personale është përgjegjësi personale » ta kuptojë nevojën e përdorimit të mjeteve personale higjienike » ta kuptojë rëndësinë e veshjes së pastër si pjesë e higjienës personale

Punëtorja IV-2.1: Ndërlidhëse



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit IV-2.1: Ndërlidhëse

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimitarja e zgjedh ndonjë send të thjeshtë i cili është i lehtë për manipulim me duar (top letre, sellotej...). Nxënësve u thuhet se tash do të përcjellin një impuls higjienik. Sendi fillon të kalojë në rreth, ashtu që ai mund të shndërrohet në diçka që na ndihmon në mirëmbajtjen e higjienës (sapun, krehër, pastë dhëmbësh.... nxënësit nxitën të mendojnë gjëra të reja dhe/ose të ndryshme nga ato që do të trajtohen në aktivitetin kryesor). Secili që e merr sendin/impulsin në dorë, duhet t'i japë kuptim (me pantomimë të tregojë se a është sapun, shampun a ngjashëm) dhe "t'ia japë" fëmijës që qëndron pranë tij.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në tresha. Atyre u jepet materialet e punës "Ndërlidhëset". Prej tyre kërkohet t'i ndërlidhin sendet që na ndihmojnë në mirëmbajtjen e higjienës personale të vendeve adekuate të trupit dhe, në bazë të kësaj, duhet të shkruajnë sa shpesh i përdorin ato.



Diskutim

1. Si e kanë mbajtur njerëzit higjienën para një shekulli? Me çfarë mjetesh? Sa shpesh janë larë?
2. Si përdoret shampuni?
3. Si përdoret krehri?
4. Pse është me rëndësi që flokët të krehën me krehër? (përveç shkaqeve estetike, është i rëndësishëm edhe për shkak të masazhit së kokës, për higjienë)
5. Si përdoret makina e thonjve? A i pret dikush nga ju thonjtë vetë?
6. Pse është me rëndësi të priten thonjtë?
7. Pse është me rëndësi sapuni?
8. Pse janë me rëndësi brusha dhe pasta e dhëmbëve?
9. Sa shpesh duhet të lahen dhëmbët? Pse? (rekomandohet së paku dy herë në ditë) Si ruhet e pastër brusha e dhëmbëve? (ka vend të caktuar për mbajtjen e saj, lahet pas përdorimit, ndërrohet pas një periudhe të caktuar të përdorimit)
10. Sa i përdorim shpesh krueset e veshëve? (rekomandohet përdorimi i tyre racional, sepse lëngu që tajitet në vesh ka rol mbrojtës dhe është mirë që kohë pas kohe të pastrohet, në çdo 5-10 ditë)
11. Cilin nga këto sende e përdorim më shpesh? Pse? Cilin nga këto sende e përdorim më rrallë? Pse është me rëndësi të bëjmë dush?
12. Sa shpesh dhe në çfarë situatash? (pas edukatës fizike, nëse ndyhem, më shpesh verës e më rrallë dimrit)
13. Pse duhet të mbajmë higjienën personale?

Përfundim

Në të kaluarën njerëzit nuk kanë pasur kushte bashkëkohore për mirëmbajtjen e higjienës. Ka qenë e vështirë qasja në sasi të mëdha të ujit, nuk ka pasur shampone, sapunë të mirë, kruese për veshë, brusha dhe pastë për dhëmbë. Për shkak të kësaj, shumë shpesh janë sëmurë nga sëmundje dhe infektive të ndryshme. Kjo do të na ndodhte edhe sot nëse nuk kujdesemi për higjienën personale ose nëse i përdorim këto mjete në mënyrë joadekuate. Po ashtu të tjerët t'i shmangen kontaktit me njerëzit që nuk kanë kujdes për higjienën e tyre.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë ulen në rreth. Aty ka saktë karrige sa ka nxënës. Arsimitari qëndron në rreth dhe e fillon aktivitetin. Ai/ajo që qëndron në rreth e përfundon fjalinë: "Le t'i ndryshojnë vendet të gjithë ata që përdorin/kanë përdorë...." dhe fjalja përfundon me ndonjë mjet për mbajtjen e higjienës personale. Fëmija që qëndron në rreth e thotë fjalinë dhe përipiqet që, derisa fëmijët e tjerë i ndërrojnë vendet, ai të ulët në ndonjë vend të lirë. Në atë rast një fëmijë do të mbetet në rreth dhe ai do të duhet ta mbarojë fjalinë, tash me ndonjë mjet tjetër për mbajtjen e higjienës personale.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-2.2: E imja – e jona



Materialet:

- » pajisje për të vizatuar

Aktiviteti hyrës

Fëmijët ndahen në çifte. Nëse janë numër tek, në lojë inkuadrohet edhe arsimtari. Në ato situata rekomandohet që arsimtari me ndjeshmëri të jetë në çift me ndonjë fëmijë që më vështirë vë kontakt me të tjerët. Në çift duhet të këmbëjnë mes vete se çka kanë bërë nga mëngjesi deri në atë moment (kanë qenë në WC, janë larë, i kanë larë dhëmbët, kanë ngrënë mëngjes, janë përgatitur për shkollë, i kanë bërë detyrat etj.). Arsimtari i nxit të këmbëjnë detaje dhe, nëse vlerëson se është e nevojshme, mund t'i përkujtojë.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në katër grupe. Dy grupe duhet t'i vizatojnë pajisjet për mbajtjen e higjienës së trupit, që mund të përdoren vetëm nga një njeri, ndërsa dy grupet e tjera duhet t'i vizatojnë ato gjëra që janë për mbajtjen e higjienës së trupit, por që mund të përdoren nga më shumë anëtarë të familjes. Grupet prezantohen.



Diskutim

1. A mund ta përdorin sapunin për duar më shumë anëtarë të familjes?
2. E xhelin e dushit dhe shamponin?
3. A mund të përdoret sapuni i dushit nga më shumë anëtarë të familjes? Pse?
4. A mund të përdoret pasta e dhëmbëve nga më shumë anëtarë të familjes?
5. E peshqiri i duarve? A vlen kjo edhe për mantelin banjës/peshqirin e trupit? Pse?
6. A mund ta përdorin makinën e thonjve më shumë anëtarë të familjes? E krehrin?

Përfundim

Disa pajisje higjienike mund të përdoren nga më shumë anëtarë të familjes, si shamponi ose makina e thonjve. Disa janë vetëm për përdorim personal, si manteli i banjës ose krehri, kjo nga shkakut e mbrojtjes prej infektimeve e sëmundjeve ngjitëse.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari i nxit nxënësit që të fusin entuziazëm në aktivitet, duke u inkuadruar edhe vetë në të. Pas secilës duartrokitje, lihet kohë që fëmijët të duartrokasin.

- » T'u japim një duartrokitje të madhe atyre që sot i kanë larë duart pas secilës ndryje dhe pas secilit ushqim!
- » T'u japim një duartrokitje të madhe të gjithë atyre që javën e kaluar i kanë prerë thonjtë!
- » T'u japim një duartrokitje të jashtëzakonshme të gjithë atyre që në dhjetë ditët e kaluara nuk janë ulur të hanë pa i larë duart!
- » T'u japim një duartrokitje atyre që nuk i kanë ngrënë thonjtë këtë muaj!
- » T'ua japim duartrokitje më të madhe atyre që kanë vendosur që sot tutje të kujdesen edhe më shumë për duart e tyre!



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-2.3 Përralla për Kalën



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Përralla për Kalën
- » fletë pune për nxënësit IV-2.3: Si lahen dhëmbët?

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë të ulur në rreth. Pasi t'i shqiptojë arsimtari fjalët e poshtëshënuara (udhëzimet), ata pritët t'i bëjnë këto lëvizje:

- » pastrimi lart-poshtë – të gjithë ngrihen e ulen (ulja bëhet deri në gjunjë të mbledhur, pra jo deri në fund)
- » pastrimi majtas-djathtas – të gjithë marrin hov në anë të majtë dhe të djathtë të mesit të sipërm të trupit
- » pastrimi në rreth – të gjithë i mbajnë duart në bel dhe bëjnë lëvizje rrethore me kërdhokulla;
- » gargara – të gjithë i ngrenë duart lart dhe me gojë të përgatitur prodhojnë tingull sikur e shpëllajnë gojën dhe fytin pas pastrimit të dhëmbëve – gërrrrrrrr.

Tre udhëzimet e para përsëriten pa ndonjë radhitje të veçantë nga disa herë, e pastaj vijon udhëzimi i fundit.

Aktiviteti kryesor

Nxënësve u lexohet teksti i fletës së punës për arsimtarin:



Diskutim

1. Pse Kala ishte e pikëlluar?
2. Si silleshin njerëzit në atë qytet?
3. Nga çka frikësohej brusha?
4. Pse Kala nuk dëshironte ta harrojnë apo ta përdorin rrallë?
5. Pse Kala nuk dëshironte që atë ta përdorin më shumë njerëz?
6. Pse është me rëndësi që secili ta ketë brushën e tij për dhëmbë?
7. Pse është me rëndësi të lahen dhëmbët?
8. A e di dikush ndonjë ushqim që ndihmon në ruajtjen e dhëmbëve? E cili ushqim i prish dhëmbët?
9. Sa shpesh duhet të lahen dhëmbët? A e di dikush si duhet të bëhet kjo më së miri?
10. Cilat pajisje të higjienës personale mund të përdoren nga më shumë njerëz e cilat jo? Pse?

Përfundim

Dhëmbëve tanë u duhet mirëmbajtje. Nëse nuk i mirëmbajmë dhëmbët të pastër dhe shëndoshë, ato shpejt na prishen. Nëse kemi mbeturina të ushqimit në gojë, atëherë në gojën tonë qëndrojnë miliona baktere që e zbërthejnë ushqimin, por edhe i prishin dhëmbët. Prandaj është me rëndësi që dhëmbët të lahen së paku dy herë në ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje. Aq më mirë do të ishte të lahen pas çdo ushqimi. Sa është me rëndësi që dhëmbët të lahen rregullisht, po aq me rëndësi është që edhe të lahen si duhet dhe mjaft gjatë. Çokollatat, biskotat dhe gjërat e tjera të ëmbla janë materiet më të dëmshme për dhëmbët. Kjo vlen edhe për pjesën më të madhe të çam-çakëzave dhe lëngjeve artificiale. Disa pajisje, si për shembull shamponët, mund të përdoren nga më shumë anëtarë të familjes e disa jo, si sfungjeri i larjes ose brusha e dhëmbëve.

Aktiviteti përmbyllës

Si lahen dhëmbët Të gjithë qëndrojnë në rreth. Në njërin dorë e mbajnë fletën e punës "Si pastrohen dhëmbët". Secila fotografi e fletës së punës shpjegohet më detajisht. Pastaj, sipas udhëzimeve të arsimtarit, bëhen lëvizje që janë paraqitur në fotografi (udhëzimet në fakt janë ajo që është në fotografi, por kihet kujdes radhitja). Kjo përsëritet disa herë dhe mund t'u rekomandohet fëmijëve që atë t'ua prezantojnë edhe familjarëve të tyre në shtëpi.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përralla për Kalën, brusha e pikëlluar e dhëmbëve

Ishte njëherë një brushë dhëmbësh. Ajo quhej Kala. Kishte dorezë të portokalltë, fije të bardha e të kaltra dhe sipërfaqe të mbështjellë. Qysh kur doli nga fabrika, ashtu e paketuar, ajo filloi të mendojë me vete se ku do ta kalojë kohën e saj. Bashkë me brushat e tjera dridhej nga shqetësimi. Në gjithë atë rrëmujë, nëse mund të dëgjoje me kujdes, mund të dëgjohej edhe një zë i frikësuar. “Vetëm jo dymbëdhjetë, vetëm jo dymbëdhjetë... vetëm jo dymbëdhjetë. Kjo ishte një brushë e larme me fytyrë të frikësuar.

- Çka je duke përsëritur gjithë kohën? – e pyeti Kala.

- Po, a nuk e di? – u përgjigj brusha e vogël.

- Jo, çka është puna?

- Ufffff!!!! – tha brusha e vogël. – Tash kur do të arrijmë në magazinë, neve do të na ndajnë në kuti të ndryshme që do të udhëtojnë në qytetet të ndryshme. Kam dëgjuar se kutia me numër dymbëdhjetë udhëton në një qytet ku shumica e njerëzve thuaja asnjëherë në jetë nuk i pastrojnë dhëmbët. Madje edhe ata që i lajnë, këtë e bëjnë shumë rrallë – një deri në dy herë në javë. Bile, flitet, paramendo, ka familje që e përdorin një brushë për gjithë familjen. Thuhet se ato brusha kalojnë jetë shumë të zymtë. Jo vetëm që janë të pikëlluara, por janë të mbushura edhe me plot baktere nga gojët e ndryshme që i përdorin. Ti do të thuash se ndoshta ata njerëz nuk kanë para dhe nuk kujdesen për dhëmbët e tyre, por nuk është kështu. Flitet se në atë qytet të gjithë njerëzit janë shumë të pasur, por të gjitha paratë i përdorin për bonbone e çokollata.

Kala u tmerrua nga ajo që e dëgjoji. E kapi frika se mos pikërisht ajo do ta ketë fatin të bie në atë qytet. Dhe, paramendoni kjo ndodhi. Një dorë e madhe roboti e kapi dhe thjesht e vendosi në një kuti të madhe me numër dymbëdhjetë. Kot bërtiti ajo me zërin e saj. As që i vari dikush. Ata ishin vetëm ca robotë të mëdhenj dhe pa ndjenja. Kalës iu rrëqethën fijet nga frika dhe pikëllimi. Nuk do të mund të jetë ajo për çka është bërë. Ta mbajë të pastër ndonjë gojë. Gjatë kohë udhëtoi deri në qytetin e panjohur. Po ashtu gjatë kohë qëndroi edhe në raftin e një shitoreje të madhe. Dhe, vërtet, njerëzit që kalonin pranë saj, në shitore, të gjithë vraponin kah banaku me bonbone dhe as që i shikonin brushat e dhëmbëve. Megjithatë gjatë gjithë kohës sa qëndroi në shitore ajo nuk e pa asnjë njeri që s’kishte dhëmbë të zinj. Ishte e rrethuar me brusha të tjera që edhe më gjatë kishin pritur t’i blejë dikush dhe të gjitha ishin të dëshpëruara. Tashmë thuaja as nuk flisnin mes vete.

Kështu po i kalonte ditët e gjata. Një pas dite Kala e pa një djalosh të bukur, me flokë ngjyrë ari, që hyri në shitore. “Sa djalë i bukur! Fatkeqësisht që për një kohë të shkurtër nuk do të jetë ashtu i bukur, sepse do t’i shkatërrojë dhëmbët. Si gjithë të tjerët në këtë qytet”, mendoi ajo.

Hejj... shiko, shiko...., fëmija po i afrohej pikërisht asaj. Dhe, thjesht, e zgjati

dorën dhe, e pabesueshme, e mori pikërisht atë – Kalën. Dhe, pasi e shikoi, buzëqeshi dhe shkoi ta paguajë. Kala ende nuk e dinte a të gëzohet apo të dëshpërohet edhe më shumë.

Çka nëse shkon diku dhe e harrojnë ose, edhe më keq, e përdorin disa njerëz dhe e mbushin me baktere të ndryshme?!?! Por, nuk ndodhi kjo. Sapo arriti në shtëpi, fëmija e hoqi nga paketimi, e lau me ujë të ngrohtë, e vendosni në të një pastë aromatike, të butë dhe të bukur dhe filloi t'i pastrojë dhëmbët me shumë kujdes. Nga fytyra e tij mund të shihej se ai po kënaqej. Gëzimi i Kalës nuk mund të përshkruhej me fjalë.

Pas një muaji, prej kur e bleu Kalën, fëmija fitoi në festivalin e fëmijëve. Ishte mysafir edhe në televizion. Kur e pyetën se çka mendon, pse pikërisht atë e ka zgjedhur publiku, për shkak të tekstit, të zërit, të melodisë apo për diçka tjetër, ai u përgjigj: “Melodia e këngës është shumë e mirë, edhe teksti po ashtu, por mendoj se më meritore ishte buzëqeshja ime!”. Pastaj e nxori Kalën nga xhepi. Para aq shumë shikuesve. Ai fëmijë vërtet kishte dhëmbë të mrekullueshëm të bardhë. Ndërsa Kala ishte në TELEVISION!!! Nuk kaloi shumë kohë pas kësaj dhe në qytet rrallëkush harronte më t'i lajë dhëmbët së paku nga dy herë në ditë.

Punëtorja IV-2.4: Veshja adekuatë



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit IV-2.4a: Vishni fëmijët
- » fletë pune për nxënësit IV-2.4b: Veshja adekuatë 1
- » fletë pune për nxënësit IV-2.4c: Veshja adekuatë 2
- » fletë pune për nxënësit IV-2.4ç: Veshja adekuatë 3
- » fletë pune për nxënësit IV-2.4d: Veshja adekuatë 4
- » fletë pune për nxënësit IV-2.4dh: Veshja adekuatë 5
- » Pajisje për prerje dhe ngjitës

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari u thotë të përpiqen që me gjeste “të aktrojnë” sesi vishen pjesë të ndryshme të veshjeve. Të gjithë duhet të kenë kujdes dhe të përpiqen që me lëvizjet e tyre të tregojnë sesi i veshin pjesët e ndryshme të veshjeve. Gjatë aktivitetit askush nuk thotë asnjë fjalë. Arsimtari i lexon këto udhëzime:

- » Të veshim tash të gjithë maica.
- » Të veshim tash të gjithë pantallona.
- » Të veshim tash të gjithë çorape.
- » Të veshim tash të gjithë bluza.
- » Të veshim tash të gjithë kapela.
- » Të veshim tash të gjithë pallto.
- » T’i mbërthejmë tash të gjithë pullat e palltos.
- » Të veshim tash të gjithë atlete.
- » T’i heqim tash të gjithë atletet.
- » T’i heqim tash të gjithë çorapet.
- » Të veshim tash të gjithë kostum për not.
- » Të veshim tash të gjithë sandale.
- » Të veshim tash të gjithë doreza.
- » Të duartrokasim tash të gjithë me doreza.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Secili grup e merr nga një fletë të punës “Veshja adekuatë” dhe nga fleta e punës “Vishni fëmijët”. Secilit grupi i jepet për detyrë që ta zgjedhë, ta presë dhe ta ngjisë (veçmas për djalë dhe për vajzë – nëse dallohen) atë veshje me të cilën do të duhej të vishen fëmijët në këto situata:

- » Kur luajnë
- » Kur duhet të shkojnë në teatër ose në shfaqje tjetër
- » Kur shkojnë në plazh
- » Kur shkojnë në shkollë
- » Kur dalin të luajnë në borë

Secili grup duhet të punojë në situatë të ndryshme. Në fund, grupet e prezantojnë atë që e kanë punuar, duke shpjeguar se si i kanë veshur dhe pse?



Diskutim

1. A janë të gjithë fëmijët të veshur njësoj? Me çka dallohen? Pse?
2. Në çfarë gjërash duhet të kemi kujdes kur zgjidhet veshja?
3. A ka zgjedhur dikush veshje të përllyer? Pse?
4. Për çfarë situatash të tjera mund t’i vishnim fëmijët me veshjen që është ofruar në fletat e punës?

Përfundim

Në raste të ndryshme mbahet edhe veshje tjetër. Ashtu siç nuk e veshin bluzën e re për lojë, po ashtu edhe për në shkollë është mirë të zgjidhet një veshje komode. Për solemnitete, siç janë ditëlindjet ose opera, teatri etj., sigurisht kihet kujdes më shumë për rregullimin e veshjes. Fëmijët e kësaj moshe në masë të madhe janë mjaft të pjekur që vetë ta zgjedhin veshjen. Veshja e përllyer, përveç për në mal dhe në fushë sporti, shpesh bëhet shkak që fëmija të duket i shëmtuar.

5. Çfarë përshtypje fitohet për atë që vesh një veshje të përlyer?
6. A ekzistojnë vende ku është normale të përlyhemi? (fushë sporti, mal, natyrë).

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë lëvizin lirshëm nëpër hapësirë. Kur të takohen dy fëmijë, ata mund ta tejkalojnë njëri-tjetrin, por mund edhe të shikohen dhe ta thonë ndonjërin prej këtyre frazave:

- » “Mirëmbërëma, sa kapelë të bukur paskeni!”
- » “Mirëdita, më pëlqen shumë bluza jote e re.”
- » “Mirëmëngjesi, sandalet u rrinë shumë bukur.”
- » “Mirëdita, sot jeni veshur shumë bukur.”

Përgjigjja jepet me buzëqeshje ose me ndonjërin nga frazat e dhëna.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-2.5: Veshja ime – brenga ime



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit IV-2.5a: Veshja 1
- » fletë pune për nxënësit IV-2.5b: Veshja 2
- » fletë pune për nxënësit IV-2.5c: Veshja 3
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çifte. Nëse ka nevojë (nëse nxënësit janë në numër tek), në aktivitet merr pjesë edhe arsimtarja. Të gjithë mblidhen në një pjesë të caktuar të klasës. Arsimtarja u jep udhëzim se secili çift duhet të kalojë një pjesë të caktuar të klasës (të shënuar paraprakisht, rreth 2-3 metra), me lidhëset e lidhura të atleteve/këpucëve. Nëse ndonjëri nga fëmijët në çift ka këpucë pa lidhëse, lidhëset e njërit anëtar të çiftit lidhen për gjurin e anëtarit tjetër të çiftit. Nëse të dy kanë këpucë pa lidhëse, atëherë përzihen me çift që ka lidhëse. Arsimtarja thotë se lidhëset lidhen në “vijën fillestare” dhe atë nga këmba e majtë e njërit fëmijë në këmbën e djathtë të fëmijës tjetër të çiftit. Me rëndësi është që ata të merren vesh dhe të kenë kujdes mos të lëndohen. Shpejtësia e kalimit nuk është aspak me rëndësi, për dallim nga siguria që është shumë e rëndësishme në këtë lojë. Arsimtarja u thotë se do të kenë shumë përfitim nëse merren vesh dhe nëse lidhëset i lidhin në majat e tyre (të kenë sa më shumë hapësirë ndërmjet të dyja këmbëve), ajo ndihmon gjatë lidhjes dhe, nëse ka nevojë, thekson se duhet të bëhet nje e pastaj mund të zgjidhet lehtë. Kur të jepet shenjë, njëri çift fillon, ndërsa fëmijët e tjerë e inkurajojnë. Aktiviteti kryhet kur të gjitha çiftet ta kalojnë radhën.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në gjashtë grupe. Secilit grup i jepet nga një version i fletës së punës “Veshja 1, 2 dhe 3” me detyrë që ndërmjet vete të diskutojnë SI dhe SA SHPESH i pastron/lan veshjet/këpucët e paraqitura në fletën e tyre. Grupet nuk prezantohen, por u përgjigjen pyetjeve në lidhje me atë që ka qenë tema/detyra e tyre.



Diskutim

1. Si mbahen këpucët të pastra? A duhet të lahen ato? A ka këpucë që nuk lahen? Si mirëmbahen ato?
2. Si mbahen të pastra palltot dhe jaknet? Sa shpesh lahen ato? Çka mund t'i dëmtojë ato lehtë? Në çfarë situatash ato përlayhen më lehtë?
3. Sa shpesh lahen bluzat? Pse?
4. Si mbahen të pastra çorapet? Sa shpesh lahen ato? Sa kohë mund të mbahen një palë çorape? Pse? Çka ndodhë nëse një palë çorapësh mbahen pesëmbëdhjetë ditë? (era, bakteret, do të përlayhen këpucët, infektim kërpuhash)
5. E dorezat, shallet dhe kapelat?
6. Si na përlayhen maicat më shpesh? Sa kohë mund të mbahen ato pa u larë?
7. E sa kohë mund të mbahen pa u larë pantallonat/trenerkat/fundi? A është njësoj gjendja si verës ashtu edhe dimrit? Pse?
8. A mund të lahen të gjitha këto gjëra përnjëherë? Pse?
9. A mund të më thotë dikush si lahen disa prej tyre?
10. Çka nëse na ndodhë që të na përlayhen pantallonat, palltoja ose bluza derisa jemi në shkollë? Çka mund të bëhet në ato situata?

Përfundim

Në të shumtën e rasteve fëmijët vetë zgjedhin se çka do të veshin. Përgjegjësia e veshjes është te ai që e mban atë. Veshja duhet të ruhet jo vetëm nga dëmtimi fizik, por edhe duhet të mbahet e pastër. Me rëndësi është që të krijohen shprehje higjienike, siç janë ndërrimi i veshjeve të përlayera. Mbjtja e veshjeve të përlayera mund të ketë pasoja të ndryshme.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Ndahen në dy grupe me përafërsisht numër të njëjtë të fëmijëve. Duke u mbajtur për duar i formojnë dy rrathë koncentrikë. Ata që janë në rrethin e brendshëm janë të kthyer me fytyrë kah rrethi jashtë, ndërsa fëmijët që janë nga rrethi i jashtëm janë të kthyer me fytyra kah rrethi i brendshëm. Me rëndësi është që rrathët të kenë distancë së paku 50 centimetra. Arsimtarja u thotë se tash janë veshje në lavatriçe, ndërsa ajo është motori që e rrotullon lavatriçen. Ajo do ta rrotullojë makinën me atë që do t'i udhëzojë ata si të sillen në rrathë (paraprakisht i emërton cili është rrethi i brendshëm, e cili rrethi i jashtëm). Të gjithë duhet të kenë kujdes të mos lëndohen. Udhëzimet janë këto. Nëse arsimtarja vlerëson se është e mundur, mund të bëhen dy, tre ose katër rrathë koncentrikë. Në fillim udhëzimet lexohen ngadalë, pastaj gradualisht më shpejt, deri në atë tempo në të cilën nuk është e rrezikuar siguria e nxënësve nga lëndimi.

- » Rrethi i jashtëm sillet në anën e majtë (tuajën).
- » Rrethi i brendshëm sillet në anën e majtë (tuajën).
- » Rrethi i brendshëm sillet në anën e majtë (tuajën).
- » Rrethi i brendshëm sillet në anën e djathtë (tuajën).
- » Rrethi i jashtëm sillet në anën e djathtë (tuajën).
- » Rrethi i brendshëm sillet në anën e majtë (tuajën).
- » Rrethi i brendshëm sillet në anën e djathtë (tuajën).
- »
- » THARJA (arsimtarja bën me gjeste – të gjithë i lëshojnë duart dhe i shkundin si kur i thajnë nga uji).



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-2.6: Përralla e varës



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Përralla e varës

Aktiviteti hyrës

Të gjithë enden lirshëm nëpër klasë. Arsimitarja u thotë se derisa lëvizin do të duhet të aktrojnë sipas udhëzimeve që do t'ua japë ajo:

- » Tash lëvizim sikur të kemi xhinse shumë të ngushta.
- » Tash lëvizim sikur të kemi këpucë shumë të mëdha.
- » Tash lëvizim sikur të na vijë ftohtë dhe mblidhemi në tesha.
- » Tash lëvizim sikur të kemi pantallona shumë të gjera që na bien.
- » Tash lëvizim sikur të kemi këpucë shumë të ngushta
- » Tash lëvizim sikur të kemi një vrimë në pjesën e prapme të pantallonave dhe nuk ndjehemi mirë.
- » Tash lëvizim sikur të kemi taka të gjata.
- » Tash lëvizim sikur të kemi njollë në maicë, të cilën dëshirojmë ta fshehim.

Aktiviteti kryesor

Arsimitarja e lexon tekstin nga pajisja e arsimtarit për të shkruar “Përralla e varës”.



Diskutim

1. A mund të bëjnë diçka jaknet, dorezat dhe palltot diçka për jaknën e gjelbër?
2. Kush mund t'i ndihmojë? (synojmë të marrim përgjigjen “Fëmija që e mban atë”)
3. Si?
4. Të numërojmë gjithçka që është e rëndësishme të dihet ose të bëhet që jakna të jetë e pastër, e plotë dhe e bukur!
5. Si mirëmbahen këpucët? Shpjegojeni procedurën e pastrimit të këpucëve?
6. Ku mbahen këpucët? Si?
7. A është patjetër të lahen atletet?
8. Sa kohë mund të mbahet një maicë pa u larë? Pse?
9. Cila veshje duket më bukur – e pastra apo e papastra?

Përfundim

Secili është përgjegjës për higjienën e tij dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë së veshjes dhe këpucëve të tij. Papastërtia shpie drejt alergjive, sëmundjeve, por edhe nuk duket bukur. Çdoherë njerëz më të dashur janë atë që duken më të pastër dhe më të rregulluar.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë në rreth me zë e thonë se cila pjesë e veshjes është për ta më e dashur, sa kohë e kanë atë dhe pse e duan aq shumë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përralla e varës

Ajo ishte një varëse e zakonshme. Gjendej në një klasë, në një qytet të vogël. Kishte trup të drunjtë dhe fije të metalta. Si çdo varëse tjetër shkollë, edhe ajo në mbrëmje, të shtunave dhe të dielave mbetej e vetmuar. Veçanërisht gjatë kohës së pushimit veror. Atëherë plaste nga mërzia. Klasa ishte e zbrazët dhe normalisht nuk kishte asgjë në të. Më vështirë e kishte gjatë kohës së dimrit. Atëherë e kishte patjetër të ushtrisë dhe të mundohet t'i mbajë të gjitha jaknet, kapelat, dorezat, shallet e palltot. Por, atëherë për të ishte më interesant. Kishte aq shumë veshje me të cilat mund të bisedonte. Çdoherë kërkonte t'i rrëfejnë për botën jashtë klasës, të cilën ajo nuk mund ta shihte, ndërsa si kompensim për këtë i mbante mbi supe të gjitha. Nuk gyxoj t'i them të gjitha sekretet e saj, por mendoj se për këtë ajo nuk do të më hidhërohet.

Një ditë vjeshtë, varësja pyeti për motin jashtë.

- Ufff! – tha një pallto e verdhë – mos pyet, mjegull, ftohtë, baltë dhe lagështi.

- Ditë e vërtetë për një jakne – foli jakna e kuqe me krenari.

- Lehtë e ke ti, ti je bërë nga materiali që nuk lëshon ftohtë dhe lagështi – tha një bluzë e leshtë.

- Ashtu është – tha jakna plot krenari – tash ka ardhur koha ime. Paramendoni si më vinte mua gjithë verën e palosur në raft. Do të çmendesha nga asgjëja. Mirë që në raft kishte edhe barishte kundër molëzës që kundërmonin erë të mirë dhe mua më vinte sikur gjithë kohën po flija e po ëndërroja livadhe me lule. Tash përfundimisht fëmija më veshi, andaj mund të bisedoj me ju. Po, si je ti mik? U bënë gjashtë muaj që nuk jemi parë? – iu drejtua shallit të leshtë.

- Mirë – tha shalli i leshtë. Më lanë dhe më vendosën në zbutës. Jam krejt i butë e aromatik.

- E ju fqinje? – i pyeti jakna dorezat që ishin pranë saj. (Nëse nuk e vërejtët, kjo jakne ishte shumë llafazane)

- Super jemi! Neve as verës nuk jemi të mërzitura. Ne vazhdimisht jemi bashkë.... hihihih. – u qeshën të dyja përnjëherë. – Mezi presim të bie borë, e të bëjmë topa dhe dordolecë.

- E ti kushërirë?!... Eeej! Nuk jemi parë që nga vitrina e shitores kur na shitën. Të kujtohet? Çka ke, pse hesht? Pse je ashtu e dëshpëruar? – iu drejtua një jaknes së njëjtë si ajo, por e gjelbër.

- Hesht! – ia tha ajo. – Fëmija që më bleu më frikëson shumë. Më fut gjithkund, andaj jam krejt pluhur. Në mëngjes më vari në një gardh – mendova se gjithë penjtë do të më shqyhen. Më lë gjithkund. Edhe në dysHEME, edhe në tokë. As që më shkundë e as që më ka larë ndonjëherë. Jam krejt pluhur dhe nuk ngaj në asgjë... Por, kur shoh se çka u bën këpucëve, them 'Hesht dhe gëzohu që së paku fytyrën nuk e ke vazhdimisht në baltë'. Ai fëmijë i ka këpucët më të përlyera në shkollë. T'jua them të drejtën, aspak nuk krenohem me atë. Madje nuk ndjehem hiç mirë nëse mund të them ashtu. Prandaj heshti.

- Ufff! – thanë disa pallto dhe jakne përnjëherë, ndërsa një dorezë filloi të kruhet, sikur po mendonte diçka...

- E shohim që nuk e ke lehtë, por a mund të bëjmë diçka...

Përmbajtja IV-3: PREVENTIVA NDAJ SËMUNDJEVE DHE SËMURJEVE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë rreziqet sëmundjeve dhe sëmurjeve të ndryshme » t'i dijë shkaqet e paraqitjes së sëmurjeve dhe sëmundjeve të ndryshme » t'i dijë infektimet më të shpeshta dhe më aktuale, si dhe mënyrën e përcjelljes së tyre » ta dijë se me cilat mjete dhe procedura mund ta parandalojë përhapjen e sëmundjeve infektuese (higjienën personale dhe higjienën e hapësirës, izolimi, pajisjet mbrojtëse...)
Shkathtësi	» të mund t'i njohë simptomat e sëmundjeve dhe sëmurjeve më të shpeshta » të mund të kërkojë ndihmë kur të shohë simptoma të sëmundjes në vetvete » të mund ta përshtatë sjelljen e tij ndaj situatave të tjera, që mos të sëmuret (të vishet si duhet, të mos laget...)
Qëndrime/vlera	» të pranojë këshilla nga të rriturit për mbrojtje nga sëmundjet dhe sëmurjet (veshje adekuate, ajër i pastër, konsumim i vitaminave) » të pranojë se është patjetër të ndiqen këshillat e parandalimit të sëmundjeve (këshilla gjatë epidemive, higjiena e mirë...) » të pranojë këshilla nga të rriturit për shërimin e sëmundjeve (të marrë tableta, të pijë lëngje...)

Punëtorja IV-3.1: Sëmundjet



Materialët:

- » dy fleta letre, mjaft të mëdha, që në to të mund të shkruhet “Saktë” dhe “Gabim”, gjë që shihet nga një distancë më e madhe
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Saktë-gabim

Aktiviteti kryesor

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari i ngjet fletat në të cilat shkruan “Saktë” dhe “Gabim”, në dy skaje të kundërta të klasës. Hapësira ndërmjet është e zbrazët, që fëmijët të mund të lëvizin lirisht.

Arsimtari u shpjegon fëmijëve se do t’i lexojë disa pohime dhe prej atyre do të kërkojë të ndalen në njërin ose në skajin tjetër, sipas asaj se a mendojnë se pohimi është i saktë ose është gabim.

Lexohen pohimet e fletës së punës së arsimtarit/arsimtares: Saktë-gabim.



Diskutim

1. Cilat gjëra janë më të rëndësishme për mbrojtje nga sëmundjet më të shpeshta infektive, si për shembull gripi? (rregullisht dhe shpesh duhet larë duart me ujë të ngrohtë dhe me sapun, të mos kemi në kontakt me personat e infektuar).
2. Pse vihen duart në gojë kur kollitemi/teshtijmë?
3. Si mund t’i përcjellim kafshët sëmundjet?
4. Cilat mënyra të tjera të infektimit ekzistojnë?
5. A duhet të shkohet në shkollë ose në ditëlindje nëse jemi të sëmurë nga gripi apo nga ndonjë sëmundje tjetër infektive?

Përfundim

Që të mund të mbrohemi me efikasitet nga sëmundjet, me rëndësi është t’i kemi informacionet e vërteta ku, si dhe çka mund të jetë e rrezikshme nga ndonjë sëmundje infektive.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

➤ **Larja e duarve na ndihmon të mbrohemi nga gripi.**

- SAKTË – madje disa mendojnë se kjo është mbrojtja më e rëndësishme.

➤ **Kur jemi të sigurt se jemi të ftohur, nuk e kemi patjetër të shkojmë te mjeku.**

- GABIM – disa sëmundje më serioze në fillim mund të duken si ftohje e thjeshtë dhe\ose grip.

➤ **Është mirë që kur ndonjë fëmijë të ketë fruth të shkohet të vizitohet që ai mos të ndjehet i vetmuar.**

- GABIM – fruthi është sëmundje shumë ngjitëse; në 95% të rasteve ajo përcillet; mund të shkohet në vizitë vetëm nëse jemi të sigurt se e kemi kaluar atë lloj fruthi.

➤ **Nëse e njohim fëmijën, nuk është ndonjë gabim nëse pimë ujë ose lëng nga shishja e njëjtë.**

- GABIM – mund të përcillen viruse të ndryshme, gripi, herpesi (nëse ka nevojë shpjegohet se çka është herpesi).

➤ **Nëse i lajmë duart rregullisht, s'ka nevojë të përdorim ujë të ngrohtë dhe sapun.**

- GABIM – është shumë me rëndësi që si mbrojtje efektive të përdoret uji i ngrohtë dhe sapuni.

➤ **Verdhëza zakonisht vjen nga duart e papastra.**

- SAKTË – verdhëza zakonisht vjen nga duart e papastra.

➤ **Nëse e përkëdhelim ndonjë qen a ndonjë mace për të cilët e dimë se të kujt janë dhe e dimë se janë të pastër, s'ka nevojë t'i lajmë duart pas përkëdheljes .**

- GABIM – ledhatakët, siç janë qentë, macet, lepujt e kështu me radhë, mund të bartin infektive të shumta.

➤ **Pasi të sëmuremi, nuk është më e rëndësishme se a do të pimë lëngje apo jo.**

- GABIM – gjatë ftohjes, gripit dhe temperaturës së lartë konsumimi i lëngjeve dhe vitaminave, si portokaj, limonë, grejpfrute etj., ndihmon mjaft.

➤ **Kur kemi grip, me rëndësi është të mos dalim prej shtëpie.**

- GABIM - me rëndësi është të dilet në ajër të pastër, në mal etj.

➤ **Nga përdorimi i tualeteve publike të papastra mund të marrim ndonjë infektim.**

- SAKTË – nëse nuk lahen duart pas përdorimi të tualetit.

➤ **Nëse mjeku na thotë se kemi grip, më mirë është të mos shkojmë në vende ku ka shumë njerëz.**

- SAKTË – nëse dikush ka grip dhe vjen në kontakt me njerëz të tjerë, është shumë e mundur që t'i infektojë edhe ata.

➤ **Nëse na kërkohet, është korrekte që ndonjë shoku a shoqeje të mirë t'ia japim bal samën e buzëve .**

- GABIM – mund të përcillen viruse të ndryshme, grip, herpes etj. (nëse ka nevojë, duhet të shpjegohet se çka është herpesi).

➤ **Nga papagajtë, kanarinat dhe pëllumbat nuk mund të merret kurrfarë sëmundjeje .**

- GABIM – ledhatakët, veçanërisht zogjtë, janë nikoqirë të viruseve që i sulmojnë njerëzit.

Punëtorja IV-3.2: Visheni Zdravkën



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Pranvera
- » fletë pune për nxënësit IV-3.2: Visheni Zdravkën
- » gërrshërë, aq sa ka grupe (4-6)
- » ngjytës (sellotej ose ndonjë ngjytës tjetër, për letër)
- » pajisje për të vizatuar

Aktiviteti hyrës

Pranvera, vera, vjeshta, dimri, pranvera.

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari e lexon tekstin e fletës së punës arsimtarit/arsimtares “Pranvera”, ndërsa nxënësit me mimika mundohen ta shfaqin atë që ndodhë në përrallë. Arsimtari lexon ngadalë, duke i theksuar fjalët elementare. Fëmijëve u jepen disa sekonda që ta bëjnë gjestin/lëvizjen/mimikën përkatëse. Nuk është aspak e rëndësishme që të gjithë të bëjnë diçka, por me rëndësi është të nxiten prezantime të ndryshme.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në katër grupe. Secilit grup i jepet fleta e punës “Visheni Zdravkën”. Po ashtu secilit grup i jepet për detyrë që ta veshë Zdravkën me veshjen e saj adekuate për stinën gjegjëse. Secilit grup i jepet nga një stinë e ndryshme (pranverë, verë, vjeshtë, dimër). Në fletën e punës priten ato veshje që nxënësit i konsiderojnë së janë të nevojshme dhe i ngjisin në siluetën e Zdravkës. Nëse u mbetet kohë, ato veshje edhe mund t’i ngjyrosin. Pas 10-15 minutave grupet e prezantojnë punën e tyre.



Diskutim

1. Si e veshët Zdravkën? Pse?
2. Si e veshët në verë? Pse?
3. Cilat veshje i mbante ajo në vjeshtë? Pse?
4. E cilat në dimër? Pse?
5. Çka do të ndodhë nëse Zdravka vesh shall në verë?
6. E çka do të ndodhë nëse në dimër shkohet në shkollë me pantallona të shkurta dhe me maica?

Përfundim

Veshja zgjidhet varësisht nga kushtet kohore. Është me rëndësi të dihet se veshja adekuate kontribuon shumë për mirëqenien afatshkurtre dhe afatgjate të organizmit..

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Duhet të sigurohet hapësirë që nxënësit të mund të lëvizin brenda rrethit. Arsimtari u thotë se disa prej nesh më shumë dëshirojnë dimër se verë, disa më shumë e duan pranverën, e disa vjeshtën. Të gjithë ata që e duan verën, kur të jepet shenjë për fillim, ata duhet të bëjnë lëvizje me duar sikur po notojnë dhe ashtu të lëvizin nëpër klasë. Të gjithë që dëshirojnë dimër, duhet të rrëshqasin me këmbë (bëjnë sikur skijojnë ose rrëshqasin në akull) nëpër vijën e jashtme të rrethit duke lëvizur njëri pas tjetrit. Të gjithë që e duan pranverën, në vijën e jashtme të rrethit duhet të ndalen si lule dhe të ulen e ngrihen sikur të lulëzojnë (fëmijët që rrëshqasin duhet t’i anashkalojnë me kujdes). Ndërkaq të gjithë ata që dëshirojnë vjeshtë, duhet të fluturojnë si zogj shtegtarë në brendësi të rrethit, por duke pasur kujdes të mos ndeshen me notuesit.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Është kohë pranvere. Gjithçka në natyrë po zgjohet. Arushat dhe lulebora zgjohen nga gjumi i tyre dimëror. Gjithë livadhi është i lulëzuar. Bletët zukasin në të gjitha anët. Gjithkund mbretëron gëzimi dhe buzëqeshja. Natyra është e mbushur plot me aroma të bukura.

Erdhi një verë e gjatë dhe e nxehtë. Nga vapa të gjithë janë disi të mërzhitur. Të gjithë mbajnë syze për diell. Të gjithë lyhen me krem për diell. Për shumicën noti është shpëtim nga vapa. Ndërkaq disave u ndihmojnë akulloret. Por, të gjithë freskohen, me erashkë....

Më në fund erdhi vjeshta. Nxënësit i përgatisin çantat për shkollë. Shumë shpezë fluturojnë në jug. Gjethet bien, ndërsa frutat më të mira vilen. Bëhet gjithnjë e më ftohtë.

Erdhi dimri. Ra borë. Të gjithë fëmijët rrëshqasin. Bëjnë dordolecë. Pastaj i ngrohijn duart. Bora nuk zgjat shumë, së paku jo aq sa dëshirojnë fëmijë. Ajo shkrihet shpejt. Shkrihen të gjithë dordolecët. U bien hundët. Nga të gjitha pullazet pikon uji.

Përsëri erdhi pranvera. Ashtu si kthehen shpezët në çerdhet e tyre, ashtu edhe nxënësit ulen në karriget e tyre.

Punëtorja IV-3.3: Lëndimet



Materialët:

- » pajisje për të shkruar
- » fletë pune për nxënësit IV-3.3a: Sëmundjet/Fatkeqësitë 1
- » fletë pune për nxënësit IV-3.3b: Sëmundjet/Fatkeqësitë 2
- » fletë pune për nxënësit IV-3.3c: Sëmundjet/Fatkeqësitë 3

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Nxënësit ndahen në çifte me sugjerim që secili fëmijë të formojë një çift me një fëmijë me të cilin mendon se kohën e fundit po kontakton pak. Në këtë çift duhet të ndahet mes vete në bazë të asaj se cila ka qenë sëmundja ose lëndimi më serioz që e kemi pasur gjatë vitit të fundit.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në tre deri në gjashtë grupe të vogla, ndërsa secilit grup i jepet nga një version i fletës së punës. Po ashtu secilit grup i shpjegohet ajo që shkuan në fletën e punës (sëmundjet ngjitëse, lëndimet trupore, gripi/ftohja). Kjo fletë kërkon të jepen përgjigje në këto pyetje:

- » Çka e ka shkaktuar atë gjendje?
 - » Si ndjehet secili fëmijë kur është në gjendje të tillë?
 - » Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur? (shtrirja në krevat, rënkimet, lëvizja e kufizuar)
 - » Si është trajtuar ajo situatë? (terapia, mjekimet, ushqimi, sjellja)
- Grupet prezantohen.



Diskutim

1. Cilat sëmundje ngjitëse i dini?
2. Kush janë shkaktarët e tyre?
3. Si përcillen?
4. Çka mund të bëjmë që të mbrohemi prej tyre?
5. Cilat lëndime i përmendët? (thyerjet, tërheqjet, prerjet, djegiet...)
6. Si shkaktohen thyerjet? Cilat janë situatat më të rrezikshme? (sporti, verimi, lojërat)
7. Çka duhet të bëhet nëse na ndodhë kjo? (Për të gjitha lëndimet, së pari duhet të vizitohet mjeku, të respektohet ajo që e thotë mjeku)
8. Si shkaktohen tërheqjet?
9. Çka duhet të bëjmë nëse na ndodhë diçka e tillë neve?
10. Si ndodhin prerjet? Cilat situata janë më të rrezikshme?
11. Çka duhet të bëhet që mos të ndodhin ato?
12. Si shkaktohen djegiet? Çka duhet të bëhet nëse na ndodhë diçka e tillë?
13. Nëse janë dhënë edhe lëndime të tjera, edhe për ato duhet të parashtrohen pyetjet e njëjta.

Përfundim

Ne nuk mund të mbrohemi plotësisht nga sëmundjet ngjitëse, por sigurisht mund të bëjmë shumë që ta zvogëlojmë rrezikun e infektimit. Në situata të rrezikshme duhet të kemi kujdes, gjegjësisht duhet t'i përshtatemi sjelljes, që kështu të zvogëlohet rreziku i lëndimit. Për sëmundjet ngjitëse, siç janë fruthi, verdhëza, gripi etj., shkaktarë janë bakteret ose/dhe viruset që përcillen në forma të ndryshme, por me rëndësi është të dihet se ato më shpesh përcillen me frymëmarrje direkte në fytyrë, pastaj përmes ajrit, veçanërisht në hapësira të mbyllura, por gjithashtu edhe gjatë përshëndetjes me dorë; po ashtu edhe filterët e klimës mund të jenë çerdhe e mirë e viruseve dhe baktereve të ndryshme, që pastaj përmes ajrit të kondicionerit përcillen në gjithë hapësirën. Prandaj është me rëndësi t'i lajmë duart dhe të ajrosim hapësirën. Lëndimet dhe djegiet e ndryshme shumë shpesh mund të ndodhin edhe në kuzhinë, në punëtori ose gjatë përdorimit të aparateve të amvisërisë. Në ato situata është e rëndësishme të vizitohet mjeku.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë lëvizin lirshëm nëpër hapësirë. Kur dy fëmijë do të shikohen në sy, ata nuk guxojnë të vazhdojnë më tej të lëvizin derisa nuk dalin njëri përballë tjetrit, me ç'rast njëri fëmijë do të thotë: "Mirëdita, doktor, si jeni?", ndërsa fëmija tjetër do t'ia kthejë: "Mirë, faleminderit, po ju si jeni?". Megjithatë gjatë kësaj kohe ata nuk guxojnë të përshëndeten me dorë e as ta prekin njëri-tjetrin në ndonjë mënyrë. Loja vazhdon disa minuta, derisa ka kohë dhe elan për lojë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja IV-4: ZHVILLIMI I VETËDIJES PËR SHËNDETIN SEKSUAL

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë ndryshimet trupore që ndodhin si rezultat i pjekurisë seksuale » ta dijë se çka është shqetësim seksual (prekjet e paqëllimta, fjalët me konotacion seksual...) » t'i dijë procedurat që mund të ndërmerren që të kundërshtohet shqetësimi seksual » ta dijë se çka është pedofilia (keqpërdorimi seksual i fëmijëve nga të rriturit) » ta dijë kujt dhe ku mund t'i drejtohet në rast të shqetësimit seksual dhe keqpërdorimit seksual
Shkathtësi	» të mund t'i dallojë/të reagojë/ta kundërshtojë shqetësimin seksual në situatat e përditshme » të mund të kërkojë ndihmë në rast të keqpërdorimit seksual
Qëndrime/vlera	» ta pranojë seksualitetin si pjesë natyrore të zhvillimit të njeriut » ta pranojë se një pjesë e seksualitetit është vetëkënaqësia » ta kuptojë se askush nuk ka të drejtë t'i shqetësojë dhe keqpërdorë seksualisht të tjerët

Punëtorja IV-4.1 Përralla për Ingën



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Përralla për Ingën

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Nxënësve u thuhet se duhet ta përcjellin ndonjë impuls telefonik, gjegjësisht se arsimtarja do t'i pëshpëritë fëmijës së parë një fjali, ndërsa ai atë ashtu si e ka dëgjuar, ndonëse mund t'i duket e çuditshme, do të duhet t'ia pëshpëritë fëmijës tjetër që gjendet pranë tij. Fjalja do të duhet të kalojë prej fëmijës në fëmijë derisa të kthehet përsëri te arsimtarja e cila do ta shkruajë atë në tabelë. Fëmijët nuk kanë të drejtë të pyesin në lidhje me atë që e kanë dëgjuar dhe si e kanë dëgjuar.

Fjalja është kjo:

Sot do të njoftohemi me Ingën, vajza me flokë të kuqe kaçurrela dhe me njolla në hundë.
Nën fjalinë e përcjellë arsimtarja e shkruan fjalinë origjinale.



Diskutim

1. Çka ndodhi?
2. Pse këto dy fjali janë të ndryshme?
3. A mund t'i besohet telefonit të këtillë?

Përfundim

Është normale dhe pritet që kur nuk kemi kushte të mira për të dëgjuar, e as mundësi për nënpyetje që ne të dëgjojmë "sipas nesh".

Aktiviteti kryesor

Arsimtarëve u lexohet teksti i fletës së punës së arsimtari/arsimtares "Përralla për Ingën". Pastaj nxënësit ndahen në grupe me nga 4-5 nxënës që u përgjigjen këtyre pyetjeve:

- » Si do të ndjeheshit ju në vendin e Ingës?
- » Si do të ndjeheshit ju në vendin e Jamezdinit?



Diskutim

1. Çka mendoni, si është ndjerë Inga në momentin kur të gjithë fëmijët e kanë përqeshur?
2. Si do të ndjeheshit ju në vendin e saj?
3. E si është ndjerë Jamezdini? E ju në vendin e tij?
4. A është e arsyeshme të veprohet ashtu nëse Inga dhe Jamezdini vërtet kanë ndjenja të fuqishme për njëri-tjetrin?
5. E nëse nuk kanë? A ka dallim?
6. A kanë bërë Inga dhe Jamezdini diçka të keqe, të ndaluar apo të turpshme?
7. A është kjo diçka që nuk duhet të bëhet apo është diçka normale për moshën e tyre?
8. A ndodhin këso gjëra në shkollë apo në ndonjë vend tjetër?
9. Çka mendoni, çka është ajo që e ka lënduar/shqetësuar Ingën? (intimitetit dhe privatësia e saj)
10. Si do të ndjeheshit ju nëse të tjerët marrin vesh ndonjë gjë të cilën ju nuk dëshironi ta dinë?
11. A e di dikush se si mund të quhet kjo sjellje e moshatarëve të Ingës? (shqetësim seksual)
Cilat gjëra të tjera që i bëjnë moshatarët mes vete mund të konsiderohen si shqetësim seksual? (shaka në llogari të karakteristikave fizike – gjoksit, këmbëve, qimeve, zërit, lartësisë, prekjeve të padëshiruara, përfaljeve dhe zërave të ndryshëm etj.)
12. Çka mund të bëhet në ato situata?

Përfundim

Shakatë që kanë të bëjnë me diçka intime, shumë shpesh i lëndojnë njerëzit. Nëse ajo bëhet para një grupi më të madh të njerëzve, ajo mund ta lëndojë shumë dikë, pa marrë parasysh se a është kjo e vërtetë apo jo. Të gjithë njerëzit kanë gjëra intime që jo çdoherë dëshirojnë t'i ndajnë me të tjerët. Këto gjëra, kur shkaktohen nga moshatarët, quhet shqetësim seksual.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Nxënësve u thuhet se ata përsëri do ta bëjnë aktivitetin e përcjelljes së impulsit telefonik, por tash do të kenë të drejtë të pyesin sa të duan, derisa të binden se ajo që e kanë dëgjuar është e saktë. Ndërsa fjalitë është: Inga, si të gjithë fëmijët e tjerë, ka sekrete që nuk dëshiron t'i ndajë me të gjithë.

Në fund, për përcjelljen e saktë të fjalisë, fitohet një duartrokitje.



Diskutim

1. Çka ndodhi?
2. A janë këto dy fjali të ndryshme?
3. Pse?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Kur kemi mundësi për kontroll, është shumë më e sigurt që informacionet të përcillen në mënyrë më burimore.

Përralla për Ingën, vajzën me flokë të kuqe kaçurrela dhe me njolla në hundë

Inga ishte një fëmijë punëtor dhe i mençur që mësonte në klasën e katërt të shkollës së gjelbër. Ajo i kishte të gjitha pesëshe. Ajo ishte shumë më tepër e qetë se lazdrake. Edhe pse kishte shokë, për dallim prej tyre, ajo ndonjëherë dëshironte të ulet ose të shëtitet vetë. Në klasë e llogaritnin si njërin nga fëmijët me sukses më të mirë.

Një ditë nëntori, në orën e parë të mësimit erdhi një fëmijë tjetër. Meqë Inga kishte sukses të mirë, por edhe ishte shoqe e mirë, arsimtarja vendosi që për fillim fëmija të ulet me Ingën, ndërsa atë e luti t'i ndihmojë atij derisa të adaptohet. Fëmija quhej Jazmedin. Ai ishte një fëmijë krejt i zakonshëm, por edhe shumë punëtor. Në fakt dukej pak i humbur dhe i shqetësuar në mjedisin e ri, por kjo nuk ishte shumë problem, apo?

Ingës i vinte mirë që mund t'i ndihmonte atij të përshtatet. Kështu u miqësuan. Shoqëroheshin edhe gjatë pushimit, madje ndonjëherë ajo shkonte te ai në shtëpi që t'ia tregojë detyrat e matematikës. Ai ishte shumë i mirë për gjuhë frënge, por thuajse s'kishte lidhje në matematikë.

Një ditë të shtune u morën vesh që Inga t'ia tregojë atij kopshtin zoologjik, parkun e lodrave dhe fushën e lojës së saj. Të hënën, pra pas asaj të shtune, kur Inga hyri në klasë, u habit se pse disa fëmijë e shikonin me aq habi.

Kur u ul në karrige dhe shikoi në tabelë, ajo pa aty një zemër të madhe në të cilën shkruante INGA DHE JAZMEDINI. Një pjesë e madhe e fëmijëve filluan të qeshen. Inga e ndjeu sesi iu skuqën faqet. Nuk dinte çka të bëjë...

Punëtorja IV-4.2: Ndryshimet



Materialet:

- » fletë letre për të shkruar pyetje
- » kuti këpucësh
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në çifte. Nëse ka nevojë, në aktivitet mund të marrë pjesë edhe arsimtarja. Udhëzimi i përgjithshëm, përveç nëse është theksuar diku ndryshe, është se çiftet duhet të formohen me fëmijë që më pak kanë komunikuar mes vete në kohë të fundit. Nuk mund të bëhet çift me ndonjë fëmijë me të cilin një herë gjatë kësaj ore kemi qenë në çift.

- » Cilat ndryshime trupore i keni vërejtur në vetvete që nga momenti kur për herë të parë keni shkruar në shkollë e deri tash?
- » A u janë zhvilluar të gjitha pjesët e trupit njësoj deri tash dhe cilat pjesë të trupit tuaj kanë ndryshuar më shumë?
- » Si mendoni se do të duket trupi juaj pas 5 viteve? Çfarë ndryshimesh të tjera do të ndodhin?

Me çka do të dallohen dhe me çka do të jenë të ngjashëm djemtë dhe vajzat pas dhjetë viteve? Për këso gjëra deri tash shumë rrallë është folur dhe është shumë e mundur që për disa gjëra ju të mos keni informacione. Andaj nëse keni diçka që në veçanti ju intereson, pyeteni fëmijën në çift.



Diskutim

1. Çka është puberteti?
2. Kur fillon përafërsisht ai?
3. A fillon te të gjithë fëmijët në të njëjtën kohë?
4. Cilat ndryshime gjatë pubertetit ndodhin te djemtë e cilat te vajzat? (djemve u trashet zëri, rriten shpejt, u rriten organet gjenitale, pak më vonë u dalin qime në fytyrë dhe në trup. Vajzave u rritet gjinjtë, u vjen cikli mujor. Të dyja gjinitë kanë shpesh puçrra)
5. Çka është ajo që i bën trupat e fëmijëve të rriten aq shpejt gjatë pubertetit? (hormonet – substanca që e përcaktojnë se cilat pjesë të trupit do të zhvillohen).

Përfundim

Deri në pubertet zhvillimi i djemve dhe vajzave është thuaja i njëjtë. Deri në atë moshë trupat tanë nuk tajiin sasi të konsiderueshme të hormoneve mashkullore dhe femërore. Kur ndodhë puberteti përnjëherë, por në mënyrë natyrore, trupat tanë tajiin sasi të mëdha të hormoneve. Por, hormone tjera tajiin te meshkujt e hormone të tjera te femrat. Hormonet e orientojnë rritjen dhe zhvillimin. Janë këto dallimet e ndërtimit të trupit dhe puçrrat, si dhe ciklet mujore te vajzat dhe zëri i trashë te djemtë.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë enden lirshëm në hapësirë. Arsimtarja thotë se në një moment ajo do t'i prekë disa fëmijë dhe ata do të shndërrohen në "Ajo diçka". "Ajo diçka" duhet të lëvizë ngadalë me njërin dorë të ngritur përpjetë, por ajo nuk është patjetër të jetë e drejtuar. "Ajo diçka" nuk është e rrezikshme dhe e imponueshme. Vetëm shëtitet përreth. Nëse e prek ndonjë fëmijë, edhe ai bëhet "Ajo diçka", ndërsa fëmija paraprak përsëri shndërrohet në fëmijë. Arsimtarja nxit zbavitje naive dhe mënyra të ndryshme të lëvizjes së ngadalshme dhe të mbajtjes së dorës dhe të trupit.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-4.3: Puberteti – kuiz



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit IV-4.3: Puberteti – kuiz (arsimtari paraprakisht i ka prerë të gjitha kartelat)
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Përgjigjet (arsimtari paraprakisht i ka prerë të gjitha kartelat)

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Secili fëmijë do të duhet ta mendojë një pyetje të lehtë, që ka lidhje me rritje dhe pubertetin, të dalë nga rrethi dhe “ta pyesë publikun” si në një kuiz të njohur. Nxënësit e tjerë përgjigjen në kor.

Aktiviteti kryesor

Varësisht nga madhësia e klasës, nxënësit ndahen në tre ose gjashtë grupe. Numri i nxënësve në grup nuk duhet të jetë më i vogël se tre dhe më i madh se pesë fëmijë. Grupet ulen të ndara nga njëri-tjetri. Atyre u thuhet se do të marrin pjesë në një kuiz i cili i referohet rritjes dhe zhvillimit të tyre. Secili grup së pari e tërheq një kartelë dhe pastaj ka një minutë kohë që të merret vesh se cilën përgjigje e konsideron të saktë. Nëse nuk janë të sigurt, mund ta pyesin publikun, gjegjësisht grupet. Pasi ta japin përgjigjen e saktë, arsimtari ua jep përgjigjen nga fleta e tij punës dhe u jep shpjegim plotësues. Pastaj kalohet në zgjedhjen e grupit që do të fillojë.

Aktiviteti përmbyllës

Djemtë renditen në njërin skaj të klasës, ndërsa vajzat në skajin tjetër. Ato duhet të lëvizin kah njëri-tjetri në kolonë njëri pas tjetrit, duke e imituar ecjen tipike të meshkujve dhe ecjen tipike të femrave.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Përgjigjet (arsimtari paraprakisht i ka prerë të gjitha kartelat)



1. Kur fillon puberteti?

B) te vajzat më herët se te djemtë

Është e natyrshme që së pari të fillojë te vajzat. Por, kjo nuk do të thotë se të gjitha vajzat do të hynë në pubertet para të gjithë djemve. Kjo megjithatë është shumë individuale

2. Çka NUK është karakteristike për djemtë dhe për vajzat në pubertet?

Ç) t'u rriten "dhëmbët e mendjes"

Karakteristike është të fillojnë të taitin hormone seksuale; të paraqiten ndryshime të shpeshta në disponimin e tyre dhe të fillojnë të shfaqin simpati.

3. Kur shfaqet ndjenja e joshjes seksuale?

B) në pubertet

Për shkak të taitjes së hormoneve seksuale fillon të paraqitet joshja seksuale; kjo është gjë shumë normale në pubertet.

4. Si quhet cikli mujor që paraqitet te vajzat në pubertet?

Ç) menstruacion – është gjakrrjedhje mujore që shkaktohet si pasojë ovulimit.

5. Sa shpesh kanë vajzat cikël mujor gjatë kohës së pubertetit?

Ç) jorregullisht, por kryesisht një herë në muaj – procesit i ovulimit ka nevojë të stabilizohet; cikël relativisht të rregullt mujor kanë vajzat në fund të pubertetit.

6. Si quhet dukuria e shqetësimit spontan seksual te djemtë, e cila mund të paraqitet kohë pas kohe?

C) ereksion – mund të paraqitet kurdo qoftë dhe nuk mund të kontrollohet me vetëdije

7. Çka është masturbimi?

Ç) vetëkënaqësi e pasionit seksual. Është dukuri natyrore në zhvillimin seksual. Ashtu si masturbojnë fëmijët, masturbojnë edhe të rriturit.

8. Për masturbimin është e saktë se:

A) Shfaqet edhe të meshkujt edhe te femrat; vlen njësoj si për djemtë, ashtu edhe për vajzat, pa marrë parasysh moshën dhe lidhjen e tyre – a janë të martuar/a apo jo.

9. Heteroseksualiteti është joshje seksuale

A) për personat e gjinisë së kundërt. Është lloji më i shpeshtë i orientimit seksual, por jo edhe i vetmi.



10. Për homoseksualitetin është e saktë se është:

Ç) orientim i veçantë seksual – si edhe heteroseksualiteti, pos që llogaritet se numri i njerëzve me orientin homoseksual/lezbejgor është më i vogël.

11. Çka NUK është E SAKTË për lojërat seksuale ndërmjet moshatarëve në pubertet?

B) i bëjnë vetëm djemtë; i bëjnë edhe vajzat edhe djemtë; me edhe fëmijë të gjinisë së njëjtë edhe/ose të gjinisë së kundërt.

12. Si quhet dukuria kur njerëzit e moshuar i mashtrojnë fëmijët për aktivitete seksuale?

A) pedofili – përpjekje e një të rrituri që të krijojë lidhje me një person të mitur; pedofilia është vepër që dënohet sipas ligjit dhe për të zbatohen dënime të mëdha.

13. Kur ndonjë vajzë ka cikël mujor?

C) assesi nuk mund të dallohet prej anash. Disa njerëz kanë mendim të gabuar se mund të vërehet nëse një vajzë ka cikël mujor. Kjo është plotësisht gabim, nuk ka kurrfarë mënyre që të shihet kjo?

14. Për vajzat është e shëndetshme të kenë marrëdhënie seksuale:

C) kur të ndjehen të gatshme. Para se të ndjehen të gatshme, kjo mund të jetë shumë e dëmshme për jetën e saj seksuale. Duhet të respektohet zhvillimi individual dhe natyror, pa marrë parasysh se çka bëjnë ose nuk bëjnë moshatarët/moshataret.

15. Për djemtë është e shëndetshme të kenë marrëdhënie seksuale :

C) kur të ndjehen të gatshëm për këtë. Para se të ndjehen të gatshëm kjo mund të jetë shumë e dëmshme për zhvillimin e tyre seksual. Duhet të respektohet zhvillimi individual dhe natyror, pa marrë parasysh se çka bëjnë ose nuk bëjnë moshatarët/moshataret.

16. Vajzat mund ta prekin organin e tyre seksual vetëm:

A) me duar të pastra. Gjithsesi se mund ta prekin si secilën pjesë të trupit. Asgjë nuk e dallon atë. Me rëndësi është që duart të jenë të pastra, si edhe te djemtë, që mos të merret ndonjë infektim.

17. Djemtë mund t'i shfaqin ndjenjat e tyre haptazi vetëm:

C) nëse dëshirojnë. Djemtë kanë ndjenja njësoj si vajzat. Në vend që të përqeshen, ata duhet të mbështeten nëse i shfaqin ndjenjat e tyre. Djemtë që nuk e bëjnë këtë për shkak të paragjytimeve, vetëm e dëmtojnë veten e tyre dhe ia kufizojnë vetvetes shumë përvoja të bukura.

18. Është në rregull t'ia mbushësh mendjen dikujt të bëjë diçka që nuk dëshiron vetëm nëse:

C) në asnjë rast nuk është në rregull. Ajo quhet dhunë, e cila nëse është serioze, përveç që është e dënueshme me ligj, mund të sjellë edhe lëndime serioze emocionale.

Punëtorja IV-4.4 Mbrojtja nga keqpërdorimi seksual¹



Materialet:

- » pajisje për të shkruar
- » ngjyra: të kuqe, ngjyrë portokalli dhe ngjyrë të gjelbër

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çifte dhe dy anëtarë të çiftit këmbëjnë me partnerin fjali të tipit “nuk dua/nuk më pëlqen kur të rriturit më...”. Ajo që e thonë ata duhet të mbetet sekret.

Aktiviteti kryesor

Secili fëmijë e vizaton një siluetë të trupit të fëmijës. Pastaj do të duhet të mendojë mirë dhe t'i ngjyrosë me ngjyra të ndryshme pjesët e trupit:

- » Me ngjyrë të kuqe ngjyrosen pjesët e trupit që nuk na vjen mirë të na prekin të tjerët
- » Me ngjyrë të portokalltë do të ngjyrosen pjesët e trupit që nuk na vjen shumë keq të na prekin të tjerët
- » Me ngjyrë të gjelbër ngjyrosen ato pjesë të trupit që aspak nuk na vjen keq nëse të tjerët na prekin

Me këtë rast gjithë silueta duhet të jetë e ngjyrosur me ndonjë ngjyrë. Pas përfundimit të ngjyrosjes, kërkohet nga fëmijët ta shikojë shkurtimisht vizatimin e tyre dhe të mendojnë se çka do të bënin. Pastaj të gjitha vizatimet ngjiten në një vend të dukshëm në klasë. Kërkohet nga nxënësit që t'i këmbëjnë vizatimet mes vete.



Diskutim

1. Të përpiqen ta vërejnë se a kanë përkime me fëmijët e tjerë po jo?
2. Cilat gjëra në masë më të madhe përkohen në vizatime?
3. A duhet të durojnë fëmijët prekje dhe lëndime të padëshiruara në vendet e përcaktuara?
4. Prej kujt mund të përjetojnë lëndime ose prekje të padëshiruara në ato vende?
5. A guxojnë të rriturit të sillen pa dinjitet me fëmijët?
6. A mund të jetë fajtor fëmija kur ndonjë i rritur e keqpërdor seksualisht?
7. Cili është dallimi ndërmjet shqetësimit seksual dhe keqpërdorimit seksual?
8. Çka është keqpërdorimi seksual?
9. Si duhet të reagohet ndaj sjelljes së padinjitetshme të ndonjë të rrituri?
10. Çka duhet të bëhet nëse ndodhë që dikush të na prekë në atë mënyrë që neve nuk na pëlqen.
11. A e di dikush se si quhet vepra kur ndonjë i rritur pa dinjitet e prek ndonjë fëmijë?

Përfundim

Çka duhet të bëjnë fëmijët dhe të moshuarit kundër keqpërdorimit seksual? KEQPËRDORIMI SEKSUAL i fëmijëve ende paraqet tabu-temë në shoqërinë tonë. Shumë shpesh keqpërdorimi seksual ndodhë në kuadër të familjes (që për fëmijën është më vështirë dhe është më së rëndi të dëshmohet dhe procedohet). Fëmijët duhet të bëhen të vetëdijshëm se kanë të drejtë t'i kundërshtojnë këto forma të dhunës, sepse dhuna çdoherë është në anën e të rriturit dhe se ata nuk duhet të turpërohen të flasin për ngjarjen, me qëllim që shkaktoi i aktit të dhunshëm të dënohet.

FËMIJA NË ASNJË RAST NUK MUND TË JETË I SHPALLUR FAJTOR, MADJE AS NË RASTET KUR FËMIJË “VETË OFROHET”, FAJI ËSHTË I TË RRITURIT. Fëmija në asnjë rast nuk ka faj. Sipas ligjit dhe sipas Konventës për të drejtat e fëmijës, e cila te ne, si anëtare nënshkruese e Konventës fëmija është “mbi ligjin”. Keqpërdorimi seksual i mund të përbëhet nga prekje e pjesëve të trupit të fëmijës ose detyrimi i fëmijës që të prekë pjesë të trupit të të rriturit; fotografimi i fëmijës ose incizimi i filmave në të cilët fëmija është lakuriq; detyrimi i fëmijës të bëjë dashuri me një të rritur. Kur ndonjë i rritur sillet pa dinjitet, atij duhet t'i thuhet JO, kjo të përsëritet disa herë, të largohet prej tij – nëse ka nevojë, edhe më me rreptësi. Fëmija nuk duhet të turpërohet, sepse sjellja e padinjitetshme është faj i të rriturit, e jo faj i fëmijës. Prandaj ai menjëherë duhet lajmërojnë prindin ose ndonjë tjetër të rritur në të cilin ka besim. Situata e tillë sa më shpejt duhet të paraqitet: nëse është fjala për arsimtarin, duhet të njoftohet shërbimi pedagogjiko-psikologjik, drejtori dhe arsimtarët e tjerë, nëse është ndonjë i rritur, duhet të informohet prindi ose të rriturit e tjerë në të cilët fëmija ka besim. Shqetësim seksual është ai që bëhet nga moshatarët, ndërsa keqpërdorim seksual është cilado prekje në cilëndo pjesë të trupit, pa marrë parasysh gjininë, nga ndonjë i rritur. Në asnjë mënyrë nuk lejohet përqaqimi ose dhënia “e komplimenteve” për pamjen fizike – kjo është pedofili. Dënimet në R. e Maqedonisë janë të rrepta, ndërsa është trend botëror që këto dënime të jenë edhe më të rrepta.

Dukuri shoqëruar e keqpërdorimit seksual është edhe TREGTIA ME FËMIJË. Më së shpeshti tregtia është prostituim i fëmijëve dhe inkuadrim i tyre në industrinë pornografike. Njohja, vetëdija për pasojat e mundshme dhe mundësia efektive e fëmijëve që t'i kundërshtojnë këto forma të dhunës, paraqesin armë të fuqishme në luftën kundër tyre.

¹ Ideja është marrë nga doracaku për arsimtarë “KAM TË DREJTË” – program për implementimin Konventës mbi të drejtat e fëmijës në klasën III dhe IV të shkollës fillore; UNICEF-SHKUP; 2004

12. Çka është tregtia me fëmijë?
13. A janë të dënueshme ato vepra?narekuva deloto koga vozrasen nepristojno dopira dete?
14. [to e trgovija so deca?
15. Dali takvite dela se kaznivi?

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë, përfshirë edhe arsimtarin, shëtisin nëpër klasë, por nuk guxojnë të preken mes vete në asnjë mënyrë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-4.5: Shqetësimi seksual



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit IV-4.5a: Saktë-Pasaktë 1
- » fletë pune për nxënësit IV-4.5b: Saktë-Pasaktë 2
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Saktë- Pasaktë 1 dhe 2

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe me nga 4-5 fëmijë. Secilit grup duhet t'i jepet nga një version i fletës së punës "Saktë-Pasaktë 1 dhe 2". Nxënësit duhet ta shënojnë "S" për ato pohime që i konsiderojnë se janë të sakta dhe "P" për ato pohime të cilat i konsiderojnë se janë të pasakta. Pas mbarimit të punës në grupe të vogla, arsimtari i lexon së pari pyetjet, ndërsa grupet përgjigjen një pas një. Pasi të përgjigjet secili grup, kërkohet nga fëmijët e grupeve dhe fëmijët e tjerë që të shpjegojnë nëse ndjehen mirë, të thonë pse mendojnë ashtu, e pastaj arsimtari i lexon përgjigjet e fletës së tij të punës.



Diskutim

1. A ndjeheshit keq kur flisnim në këtë temë? Pse? A duhet ta flitet për seksualitetin, shqetësimin seksual dhe keqpërdorimin seksual? Pse?
2. Çka duhet të bëhet në ato situata të shqetësimit seksual? A është turp të tregohet? Për kë është akt i turpshëm? Kujt duhet t'i drejtohen nxënësit?
3. A ka dallim ndërmjet shqetësimit seksual nga të rriturit dhe nga fëmijët?
4. A mund të jenë të rriturit të shqetësuar seksualisht nga fëmijët?
5. A mund të lejohet një sjellje e këtilla e moshatarëve ose të rriturve dhe deri në ç'masë lejohet kjo?

Përfundim !

Në kulturat tona rrallë ose aspak nuk flitet për seksualitetin. Njëra nga pasojat më negative nga kjo është se një numër i madh i fëmijëve janë viktimë e shqetësimeve seksuale dhe/ose keqpërdorimit seksual. Kjo në masë të madhe është kështu edhe për shkak se një spektër i gjerë i sjelljeve të të rriturve zakonisht nuk llogaritet si problematike. Po ashtu për shkak të tabuve që kanë të bëjnë me seksualitetin një numër i madh i viktimave frikësohen ose as që mendojnë t'i tregojnë dikujt ose të kërkojnë ndihmë, edhe pse "turpi" është i dhunuesit, e jo viktimës. Kjo u shkon në favor vetëm atyre që i keqpërdorin fëmijët. Sa më shumë dhe sa më hapur që flitet për këtë dukuri, aq më i vogël do të jetë rreziku që fëmijët të bëhen viktimë. Sa më shumë dhe sa më hapur që flitet, aq më lehtë do ta kenë fëmijët që qysh në fillim të kundërshtojnë ndaj sjelljeve problematike të të rriturve, përfshirë edhe numrin jo të vogël të punonjësve në arsim. Keqpërdorimi i fëmijë është çështje komplekse dhe problematike. FËMIJA NË ASNJË SITUATË NUK MUND TA SHQETËSOJË SEKSUALISHT NJË TË RRIKUR! Askush nuk ka të drejtë që ta shqetësojë ose keqpërdorë seksualisht askënd, pa marrë parasysh se kjo mund të duket "e parrezikshme" ose "si lojë"!

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Fëmijët një nga një dalin një hap para brenda në rreth dhe e përfundojnë këtë fjali në mënyrë kreative: "Kur të rritem, dëshiroj të bëhem....." përpjetet ta mendojë ndonjë profesion të çuditshëm ose qesharak. Pasi ta tregojë profesionin, fëmijët e tjerë duhet të bëjnë gjeste/lëvizje/tingull që asocojnë në atë profesion, por pa u koordinuar mes vete. Pra, thjesht e lirshëm, ashtu si do t'u vijë në atë moment. Për shembull, nëse fëmija ka thënë "Makinist", fëmijët bëjnë "tu-tuf, tu-tuf" ose "çu-çuuuu"! Secili profesion mund të përmendet vetëm një herë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Saktë-Pasaktë 1

Shqetësim seksual kemi kur arsimtari/arsimtarja...

1.	... me celularin e vet i fotografon nxënësit derisa ata përgjigjen në tabelë ose bëjnë diçka tjetër.	S
2.	... para nxënësve tregon barsoleta me përmbajtje seksuale.	S
3.	... i jep vërejtje ndonjë nxënësit pse është shumë i gjatë.	P
4.	... nxënësve ua lexon porositë e telefonave të tyre, ku mund të ketë edhe porosi nga simpatitë	S
5.	... në orët e biologjisë u ligjëron nxënësve për atë se si bëhet bebet.	P
6.	...i lexon mesazhet nëpër letra, që nxënësit ia dërgojnë njëri-tjetrit në lidhje me simpatitë e tyre.	S
7.	...gjatë orës së edukatës fizike i prek nxënësit në organet e tyre seksuale ose në gjok derisa u ndihmon të bëjnë ndonjë ushtrim.	S
8.	... komenton për pamjen fizike të ndonjë nxënësi/nxënëseje, veçanërisht për ato pjesë të trupit që zhvillohen në pubertet.	S
9.	... në orët e edukatës fizike i kap nxënësit për dore që t'u tregojë se si hidhet topi.	P
10.	... bën komplimente për pamjen fizike të trupit të disa nxënësve.	S
11.	... i lavdëron nxënësit që mësojnë mirë.	P
12.	... hy në gardërobat (të meshkujve ose të femrave) pa paralajmërim (pa trokitur se pa marrë leje).	S
13.	... i përqafon nxënësit, pa marrë parasysh a janë të gjinisë së njëjtë ose të kundërt më të.	S
14.	... i detyron nxënësit të mbeten pas orëve me qëllim që t'u ndihmojë të mësojnë.	P
15.	... u tregon nxënësve materiale me përmbajtje seksuale që nuk kanë lidhje me mësimin	S
16.	... i mban në krah nxënësit kur lëndohen ose kur nuk mund të ecin.	P
17.	... jep këshilla për tema seksuale jashtë përmbajtjeve mësimore.	S
18.	... i fton nxënësit në takime të veçantë, pa pasur nevojë për këtë.	S

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Saktë-Pasaktë 2

Shqetësim seksual kemi kur një nxënës/nxënëse ose një grup nxënësish....

1. ... me telefonin e tyre fotografojnë nxënës të tjerë pa marrë leje për këtë.	S
4. ... para nxënësve të tjerë tregojnë mahi ose ngjarje me përmbajtje seksuale dhe atëherë kur të tjerët nuk dëshirojnë të dëgjojnë.	S
2. ... këmbëjnë porosi SMS mes vete për simpatitë e tyre.	P
4. ... nxënësve të tjerë u dërgojnë porosi SMS të pakëndshme me përmbajtje seksuale.	S
5. ... diskutojnë mes vete për atë se si bëhen bebet.	P
6. ... i lexojnë para të tjerëve fletat me porosi që nxënësit ia dërgojnë njëri-tjetrit në lidhje me simpatitë e tyre, pa marrë leje nga ata që janë përmendur në porosi.	S
7. ... përpiqen ta zhveshin ndonjë nxënës/nxënëse pa dëshirën e tij/saj.	S
8. ... bëjnë komente për pamjen fizike të ndonjë nxënësi/nxënëseje, veçanërisht për ato pjesë të trupit që zhvillohet në pubertet.	S
9. ... e puthin ndonjë nxënës/nxënëse që e dëshiron atë.	S
10. ... flasin për pamjen e ndonjë nxënësi/nxënëseje në atë mënyrë që ai/ajo ndjehet jo mirë.	S
11. ... flasin me të tjerët për anët e mira të ndonjë nxënësi/nxënëseje.	P
12. ... qëllimisht e lënë të hapur derën e tualetit derisa ndonjë nxënës është aty brenda.	S
13. ... e prekin ndonjë nxënës/nxënëse në kundërshtim me vullnetin tij në mënyrë që ai/ajo të ndjehen keq.	S
14. ... i ftojnë simpatitë e veta të bëjnë diçka bashkërisht.	P
15. ... në kundërshtim me vullnetin e tyre, nxënësve të tjerë u tregojnë fotografi ose filma me përmbajtje seksuale.	S
16. ... e vizitojnë në shtëpi ndonjë nxënës/nxënëse që t'i ndihmojnë për detyrat e shtëpisë.	P
17. ... përhapin gënjeshtër për atë se kush kë e ka simpati.	S
18. ... nxënësve të tjerë u shfaqin gjeste të padëshiruar dhe të pakëndshme me përmbajtje seksuale.	S

Punëtorja IV-4.6: Situatat

Përgatitja paraprake

Arsimtari duhet t'i marr vesh numrat e telefonit SOS që janë të dedikuar për fëmijët që janë viktimë dhunës – numrat lokalë dhe nacionalë. Është mirë që arsimtari të ketë edhe informacione nga organizata që e ofron ndihmën SOS, me qëllim që fëmijët të drejtohen te ajo, nëse kanë nevojë. Nëse është e mundur, është mirë të ftohet ndonjë nga njerëzit që punojnë në ndihmën SOS, që të jetë i pranishëm në orë në një pjesë të orës (ose ndonjë ditë tjetër). Të gjitha këto gjëra do t'i forcojnë dhe inkurajojnë fëmijët.



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Situatat
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çifte. Së pari njëri nga çifti thotë: "E ke patjetër ta bësh atë!", ndërsa tjetri përgjigjet: "Nuk do ta bëj!". Kjo përsëritet 4-5 herë dhe secilën herë të ardhshme toni i të dyve në çift rritet. Pastaj rolet ndërrohen.

Aktiviteti kryesor

Arsimtarja u thotë nxënësve se do t'ua lexojë disa situata të caktuara, të cilat te ata mund të shkaktojnë ndjenja të pakëndshme, por që do të duhet të dëgjohen me kujdes. Pas secilës situatë do të kërkohen vullnetarë që ta aktrojnë përgjigjen e pyetjes që do të parashtrohet në lidhje me situatën e paraqitur – nuk duhet të aktrohet gjithë situata, por vetëm reagimi i fëmijëve që janë viktimë potenciale të dhunës së paraqitur. Nëse ka nevojë, mund të kërkojnë edhe prej dikujt tjetër që ta luajë rolin dhunuesve në situatat e dhëna. Rekomandohet të ndiqen së paku 2-3 "aktrime" të reagimeve të mundshme të fëmijëve. Pastaj nxënësve u lexohen të gjithë situatat nga fleta e punës. Një pas një. Ndërkaq nga fëmijët kërkohet ta mendojnë dhe ta aktrojnë reagimin. Pas disa minutave, atyre përsëri u lexohet situata dhe kërkohen prej tyre ndonjë vullnetar. Pas përfundimit të aktrimit të secilës situatë, të gjithë nxënësve u parashtrohen këto pyetje:



Diskutim

1. Cili është rreziku i mundshëm në këtë situatë?
2. Çka duhet të bëhet në këtë situatë? (Më e sigurt është të thuhet "Faleminderit!" dhe më mirësjellje të refuzohet.)
3. Çka nëse njeriu insiston, vardiset apo bëhet i dhunshëm?
4. A e dini se çka është telefoni SOS?

Përfundim

Për fat të keq fëmijët shumë shpesh janë viktimë të dhunës seksuale. Kjo në masë të madhe është nga shkakut se dhunuesit, duke luajtur në letrën e tabusë, lehtë dhe pa u hetuar shpëtojnë, sepse viktimat shumë rrallë i paraqesin rastet. Viktimat shumë shpesh ndjehen fajtoresh dhe përgjegjëse ose sikur disi vetë ato ta kishin nxitur situatën, gjë që është krejt gabim. Ajo është njëra ndër mënyrat më të cilën manipulohen dhunuesit. NË ASNJË RAST një person i mitur nuk mund të jetë përgjegjës për akt seksual ose vepër seksuale – përgjegjës është i rrituri. Fëmijët në masë të madhe vuajnë edhe ngase nuk dinë si të reagojnë në situata të tilla. Nëse atyre u ofrohen mekanizma të shëndoshë, rreziku zvogëlohet. Nëse duket se dikush i vardiset ndonjë fëmijë pse duket se mund të bëhet i dhunshëm dhe i rreptë, më së miri është kërkohet ndihmë nga ndonjë i rritur, mundësisht ndonjë i njohur, që të kërcënohet se do ta paraqitni te prindërit/policia. Mund të bëhet zhurmë, të bërtitet me zë të lartë – NDIHMË! Telefonat SOS ekzistojnë për t'i ndihmuar fëmijët që janë viktimë e dhunës. Ato telefona janë falas, ndërsa fëmijët mund të paraqitet edhe në mënyrë anonime.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në grupe me nga 7 veta. Secili grup duhet të mendojë mënyrë sesi do ta kalojë një hapësirë të caktuar 2-3 metra e gjatë kësaj të lëvizin gjithë së bashku si grup, por në asnjë moment të mos ketë në tokë më shumë se nëntë këmbë. Atyre u jepen disa minuta që të merren vesh. Arsimitarja i nxit për zgjidhje të ndryshme kreative dhe njëherazi kujdeset nëse paraqiten qasje të rrezikshme.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Situata 1

Vllatkoja dhe Safeti janë dhjetëvjeçarë. Rugës prej shkollë për në shtëpi ata i ndal një i panjohur i cili u ofron t'i vozitë deri në shtëpi.

Çka duhet të bëhet në situatë të tillë?

Situata 2

Një njeri i panjohur në park i ofron Verës dhe Sarës çokollata. Ato refuzojnë, por ai fillon të bëhet i dhunshëm – e kap Sarën për krahu dhe e tërheq kah vetja e tij.

Çka duhet të bëjnë që të mbrohen?

Situata 3

Arsimtari i edukatës fizike e fton Ninën në kabinetin e tij që të bisedojë “në katër sy”. Ajo nuk dëshiron të shkojë, nuk ndjehet mirë, madje dhe frikësohet, por ka drojë ta refuzojë arsimtarin se pastaj mund t'i hakmerret ose, po të ketë qëllime të liga, mund ta lëndojë.

Çka duhet të bëjë që të mbrohet?

Situata 4

Një djalosh, jo shumë i njohur për Miën, i ofron asaj ta përcjellë deri në shtëpi. Ajo pranon, se edhe ashtu nuk i shkohet në shtëpi vetë. Pas dhjetë hapave ai e përqafton. Ajo refuzon, e shqetësuar, ndërsa ai përpiket përsëri. Mia përsëri e refuzon, ndërsa ai thotë: “Mos aktro tash, pse atëherë pranove të të përcjell në shtëpi!?” Ndërkaq Mia e frikësuar i përgjigjet se nuk e ka pasur atë qëllim, ndërsa ai përpiket që me zor ta puthë.

Çka duhet të bëjë që të mbrohet?

Përmbajtja IV-5: PARANDALIMI I ALKOOLIT DHE DUHANIT

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë pasojat e duhanit ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve (pirja aktive dhe pasive) » t'i dijë pasojat e konsumimit të alkoolit për veten e tij dhe për të tjerët
Shkathtësi	» të mund ta kundërshtojë thyerjen e ndalimit për pirjen e duhanit » të mund ta kundërshtojë trysinë e të tjerëve për ta pirë duhanin dhe konsumimin e alkoolit
Qëndrime/vlera	» ta kuptojë dëmin e pirjes së duhanit dhe alkoolit për shëndetin. » ta kuptojë se është mirë ta kundërshtojë trysinë e të tjerëve që promovojnë dhe/ose konsumojnë cigare ose alkool.

Punëtorja IV-5.1: Mbrojtja nga pirja e duhanit



Materiallet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Frymëmarrja e mirë
- » fletë pune për nxënësit IV-5.1a: Dua ajër
- » fletë pune për nxënësit IV-5.1b: Kur të...
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtarja e hap derën drejtë, e pastaj i hap edhe dritaret. Pas 1-3 minutave (varësisht sa është ftohtë jashtë) fëmijët ftohen ta ndjejnë ndryshimin dhe të marrin frymë me gjoks të mbushur. Nxënësve u lexohet udhëzimi i fletës së punës së arsimtarit/arsimtares "Frymëmarrja e mirë"



Diskutim

1. A ndjeni ndryshim? Çfarë?
2. A u freskuat pak?
3. Pse është me rëndësi të thithim ajër të pastër?

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Secilit grup i jepet nga një situatë e fletës së punës. Pasi ta kryejnë detyrën, të gjitha grupet prezantohen, ashtu që së pari lexohet situata, e pastaj grupi i prezanton zgjidhjet e ofruara.



Diskutim

1. Çka nënkuptohet me pirje aktive dhe pasive të duhanit?
2. Pse nuk është e sigurt hapësira në të cilën pihet duhan? Cilat janë efektet e dëmshme të tymit të cigareve?
3. A është njësoj e dëmshme pirja e duhanit si për të rriturit, ashtu edhe për fëmijët? Pse?
4. Pse disa fëmijë fillojnë të pinë duhan?
5. Çka mund të bëhet nëse dikush të ofron cigare?

Përfundim

Pirja e duhanit është njëra nga sëmundjet më të dëmshme të varësisë, e cila çrrënjëson shumë vështirë. Pirja e duhanit ndikon dëmshëm në të gjitha organet dhe në përgjithësi në shëndet. Pirja aktive e duhanit është kur dikush vetë konsumon duhan. Ndërsa pirja pasive e duhanit është thithja pa dëshirë e tymit të cigareve që i pi dikush tjetër. Pirja e duhanit askënd nuk e bën më të pjekur/më të rritur. Përkundrazi, ajo është shprehje se dikush nuk di të bëjë zgjedhje të pjekur. Secilit që na ofron cigare mund t'i përmenden pasojat negative të pirjes së duhanit.

Aktiviteti përmbyllës

Ta gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtarja u thotë se të gjithë ne kemi një dozë përgjegjësie në luftën kundër pirjes së duhanit dhe se këtu mund të ushtrojmë se si mund të reagojmë në situatat të ndryshme dhe të përfitojmë ide nga fëmijët e tjerë. Rekomandohet që në lojë të inkuadrohet edhe arsimtarja. Loja fillon nga një fëmijë e pastaj përfshihet secili fëmijë. Fëmijët do të duhet ta përfundojnë fjalinë nga fleta e punës "Kur të..."



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Të përpiqemi të marrim ajër të pastër, por këtë ta bëjmë drejt e mirë. Ju lutem qëndroni në drejt dhe lëshoni duart pranë trupit. Merrni frymë ngadalë me hundë. Së pari filloni ta mbushni pjesën e sipërme të gjoksit, që do të mund të bëni duke e çliruar së pari barkun, pastaj pjesën e mesme të krahavorit, e pastaj pjesën e sipërme të krahavorit. (Pas dhjetë sekondash.) Tash marrim frymë me radhitje të kundërt. Së pari pjesën e sipërme, e pastaj pjesën e mesme dhe, në fund, e tërheqim barkun. Merrni frymë ngadalë.

Procedura përsëritet së paku 5-6 herë që të mos jetë e mundimshme. Disa fëmijëve mund t'u duke e mundimshme nëse kjo bëhet disa herë. Arsimtarja i këshillon që ata të përpiqen të ushtrojnë frymëmarrje të mirë në të gjitha situatat, por më pak se kjo – derisa t'u shkaktojë mundim. Nëse ushtrojnë shumë, kjo do t'u bëhet shprehi dhe do të jenë shumë më të shëndetshëm.

Punëtorja IV-5.2: Shëndet apo jo?



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit IV-5.2: Pesë personazhet
- » pajisje për të shkruar
- » fletë letre

Aktiviteti hyrës

Fëmijët ndahen në çifte. Në situatën e parë një fëmijë është aktor, ndërsa fëmija tjetër është pasqyrë. Aktori me pjesën e sipërme të trupit të tij (pa lëvizur nga vendi) bën lëvizje të ngadalshme, duke e imituar njeriun e dehur, ndërsa pasqyra i përsërit ato. Pas 2 minutave rolet ndërrohen.

Në situatën e dytë aktori, duke bërë lëvizje të ngadalshme, e imiton dikë që pi duhan dhe me këtë rast bëhet i dikush vlefshëm, ndërsa pasqyra reagon me habi dhe gërdi (nga era e keqe i zihet fryma...). Pas 2 minutave përsëri rolet ndërrohen.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe te vogla me nga 3-5 fëmijë. Grupeve u jepet nga një ekzemplar i fletës së punës për nxënësit "Pesë personazhet". Duke u nisur nga karakteristikat e dhëna në fletën e punës, nxënësit në fleta të veçanta duhet t'i vizatojnë pesë figura njerëzish. Pasi të përfundojnë, prej tyre do të kërkohet t'i prezantojnë vizatimet e tyre dhe t'i shpjegojnë ato.



Diskutim

1. A ishte vështirë të vizatohen personazhet? Pse? A kishit dyshime rreth disa karakteristikave?
2. A keni të shtoni diçka që nuk keni pasur mundësi ta vizatoni?
3. Për cilat personazhe presim që të jenë më të prekur nga sëmundjet, infektimet dhe sëmundjet e tjera të ndryshme?
4. Cilat sëmundje mund të merret nga pirja e duhanit? Pse?
5. A dini ndonjë dëmtim të shëndetit i cili buron nga konsumimi i tepërt i alkoolit?
6. Çka ndodhë nëse konsumojnë alkool fëmijët që ende rriten?
7. Çka është duhanpirës? Çka është alkoolist?
8. Si mund të heqin dorë njerëzit më lehtë nga duhanpirja pasi të jenë bërë duhanpirës? Pse?
9. Si mund të heqin dorë njerëzit më lehtë nga alkooli pasi të jenë bërë alkoolistë? Pse?
10. Çka është varësia fizike dhe varësia psikike? Cili është dallimi?
11. A guxon personi i mitur të blejë alkool ose cigare në Republikën e Maqedonisë?
12. A lejohet t'i shërbehet alkool në Republikën e Maqedonisë personit të mitur?

Përfundim

Konsumimi i duhanit dhe alkoolit në masë të madhe është i dëmshëm për shëndetin e njerëzve. Njerëzit që aktivisht merren me ndonjë lloj të aktivitetit fizik dhe njerëzit që konsumojnë alkool dhe cigare një kohë më të gjatë dhe në sasi të mëdha, dukshëm dallohen mes vete. Duhanpirja dhe alkooli mund të shkaktojnë edhe varësi. Kjo do të thotë se ata që i përdorin, edhe pse e dinë se janë materie të dëmshme, nuk mund të heqin dorë lehtë nga këto vese. Varësia fizike është varësi e organizmit nga materia toksike (nikotina/alkooli), ndërsa varësia psikike është varësi nga shprehja e bërjes së atij vesi. Duhani dhe alkooli ndikojnë seriozisht ndaj shëndetit të përgjithshëm dhe imunitetit, por gjithashtu janë faktorë seriozë për paraqitjen e sëmundjeve kancerogjene. Në Republikën e Maqedonisë është e ndaluar t'u shitet cigare dhe pije alkoolike personave të mitur njësoj si edhe shërbimi i alkoolit.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Një fëmijë fillon me këtë fjali: "Në vend të cigareve/alkoolit (e thotë njërin prej tyre), unë do të zgjedh.... (ndonjë sport ose ndonjë hobi që nënkupton qëndrim në qiell të hapur)". Të gjithë fëmijët, një nga një vazhdojnë me procedurën e njëjtë. Pjesa e parë e fjalisë është e njëjtë për të gjithë, ndërsa pjesa e dytë patjetër duhet të dallojë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-5.3: Anti-reklamat

Ky aktivitet duhet të bëhet pasi të kalojnë aktivitetet e tjera të kësaj njësie tematike, kur nxënësit do t'i kenë fituar disa dituri dhe shkathtësi të caktuara.



Materialet:

- » fleta të mëdha të letrës
- » kolazh letre, gërshtë, ngjithës, revista të vjetra, ngjyra

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen nga katër deri në gjashtë grupe. Secili grup përgatit diçka që do të jetë e kuptueshme për nxënësit dhe kështu do të vazhdojë në luftën kundër duhanpirjes/alkoolit ndërmjet moshatarëve. Grupet mund të bëjnë pllakat, të përgatitin një skeç të shkurtër ose të shkruajnë vargje për spot anti-reklamues. Gjysma e grupeve punojnë në propagandën kundër duhanit, ndërsa gjysma tjetër në propagandën kundër konsumimit të alkoolit. Arsimtari i nxit fëmijët për qasje të ndryshme, me ç'rast ata mund të fokusohen në mesazhe të përgjithshme, në aspekt shëndetësor ose ligjor.

Nxënësit i prezantojnë produktet e tyre dhe atë që e kanë punuar në atë temë, mundësisht duke i bashkuar në diçka të përbashkët.

Aktiviteti përmbyllës

Ekspozitë. Pllakatet e përgatitura vendosen në një vend të dukshëm që të mund të shihen, ndërsa arsimtari i fton fëmijët në ekspozitë. Në fund jepet një duartrokitje.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Tema V: UNË DHE MJEDISI – RAPORTI ME MJEDISIN E JASHTËM

Përmbajtja V-1: SJELLJA E SIGURT NË MJEDIS

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» të dijë për gjërat e rrezikshme (kimikate, armë) kafshët (e egra) dhe për bimët (helmuese, rrëshinore) të mjedisit më të afërt që mund ta lëndojnë » të dijë për procedurat e rrezikshme (vetë në shtëpi) dhe situatat (masë njerëzish, komunikacion) me të cilat mund të përballohet në vende të caktuara (stadium, koncert, fushë sporti) dhe në kohë të caktuar (vonë natën) » t'i dijë rregullat e sjelljes në situata konkrete (në ditëlindje, në rrugë, në oborr, në fushë sporti, në ekskursion) » t'i dijë shenjat e rrezikut dhe parandalimit » t'i dijë pasojat e sjelljes personale ndaj sigurisë së të tjerëve
Shkathtësi	» të mund t'i dallojë sendet/situatat/kafshët/bimët që janë të rrezikshme për sigurinë e tij » të mund t'i vërejë pasojat e sjelljes personale mbi sigurinë personale dhe sigurinë e të tjerëve » të mund ta përshtatë sjelljen e tij ndaj vendit/situatës konkret(e) » të mund t'i respektojë rregullat e sjelljes së sigurt që janë të parashikuara për vende/situata të caktuara
Qëndrime/vlera	» të pranojë se ka situata të caktuara në vende konkrete dhe në situata konkrete që mund të jenë të rrezikshme » ta kuptojë nevojën e ekzistimit të rregullave dhe ndalesave për shkak të sigurisë » ta pranojë nevojën e përshtatjes së sjelljes personale për shkak të sigurisë personale dhe sigurisë së të tjerëve

Punëtorja V-1.1: Rreziqet



Materialet:

- » tre deri në pesë topa letre me madhësi sa një top tenisi
- » fletë pune për nxënësit V-1.1a: Sende, situata, kafshë dhe bimë të rrezikshme 1
- » fletë pune për nxënësit V-1.1b: Sende, situata, kafshë dhe bimë të rrezikshme 2
- » fletë pune për nxënësit V-1.1c: Sende, situata, kafshë dhe bimë të rrezikshme 3
- » fletë pune për nxënësit V-1.1ç: Sende, situata, kafshë dhe bimë të rrezikshme 4
- » fletë pune për nxënësit V-1.1d: Sende, situata, kafshë dhe bimë të rrezikshme 5
- » pajisje për të shkruar.
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Rreziqet

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në një skaj të klasës. Gjashtë vullnetarë ndahen në tre çifte. Çiftet shpërndahen duke qëndruar njëri përballë tjetrit në distancë prej 1-2 metrash (si kordon) Po aq distancë ka edhe ndërmjet partnerëve në çifte.

Secilit çift i jepet nga një top letre që do të duhet ta përcjellë më tej sipas ritmit që e dikton arsimtari duke i rrahur duart (rreth 67 rënie për 10 sekonda). Detyra e fëmijëve të tjerë është që të kalojnë “të palënduar” nëpër “kordonin” e atyre që përcjellin topin. Fëmijët që e përcjellin topin nuk duhet të përpiqen t’i qëllojnë – nga ata kërkohet ta mbajnë ritmin e dhënies së topit. Pas një kohe të caktuar çiftet “hedhëse” ndërrohen me fëmijë të tjerë që tashmë kanë kaluar, që të mund të kalojnë edhe ata.

Aktiviteti kryesor 1

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Secilit grup i jepet nga një fletë pune “Sende, situata, kafshë dhe bimë të rrezikshme 1, 2, 3, 4 dhe 5”. Në anën e secilës fotografi duhet t’i shkruajnë rreziqet e atyre gjërave e pastaj në vijat e shënuara t’i shtojnë edhe tre deri në pesë sende të ngjajshme. Grupet i prezantojnë sukseset që i kanë arritur dhe sukseset që i kanë shtuar.



Diskutim 1

1. Cilat gjëra ose situata të mjedisit tonë janë të rrezikshme?
2. Kur janë të rrezikshme ato? Pse?
3. A mund t’i eliminojmë ne ato gjëra apo të asgjësohen ato nga mjedisi jonë? Pse?
4. Çka mund të bëjmë që të mbrohemi?

Përfundim

Në jetën e përditshme ne ballafaqohemi me situata/sende të panumërta që janë të rrezikshme. Për një pjesë të tyre e dimë se janë të rrezikshme, për një pjesë nuk jemi të sigurt, ndërsa për një pjesë nuk e dimë. Sa më shumë informacione që kemi, aq më e përshtatshme është sjellja jonë, ndërsa potenciali për rrezik është vënë në minimum. Nuk duhet të ulemi nën zile të qelqit, por duhet të jemi të vetëdijshëm për rreziqet e mundshme në situatën konkrete. Pajisjet ose makinat e amvisërisë shumë shpesh mund të jenë të rrezikshme nëse përdoret në mënyrë joadekuate, njësoj si kimikatet dhe pajisjet mjekësore që mund të gjenden nëpër shtëpi. Njohja e rreziqeve të mundshme vlen edhe në situata konkrete në jetë, si një fushë sporti ose si udhëkryq i kafshëve dhe bimëve..

Aktiviteti kryesor 2

Në dyshemenë e klasës vizatohet një vijë (me shkurtesë ose ngjitet një sellotej pa ngjyrë) dhe po ashtu shënohet se ku është gjysma e vijës. Arsimtari e jep këtë udhëzim: “Do t’i vendos disa fotografi në vijën e dyshemesë. Të gjitha fotografitë i kam në dy kopje. Ato do t’i vendos njëherë në një anë, e tjetrën në anën tjetër të vijës. Secili fëmijë një nga një do të kalojë nëpër këtë vijë, por deri në vijën e parë nuk do të shikojë fare se ku do të shkelë. Kur të arrijë deri në gjysmën vijës, unë do t’i tregoj dhe ai pastaj do të mund të shikojë.”

Pasi të kalojë nxënësi deri në fund, arsimtari me ndihmën e një nxënësi të përcaktuar më parë do t’i tregojë se në çka ka shkelur.

Kjo përsëritet së paku edhe me 3-4 fëmijë, vullnetarë, varësisht nga koha e mbetur, por çdoherë me radhitje tjetër të fotografive.



Diskutim 2

1. Kur shkelët në më shumë situata të rrezikshme? Pse?
2. Çka na ndihmon që t'u shmangemi situatave të rrezikshme?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim !

Sjellja jonë është më e sigurt në situata kur kemi më shumë informacione/dituri ose vetëdije për atë që na rrethon, gjegjësisht kur në aktivitetin tonë i kemi sytë e hapur dhe se është më e rrezikshme kur nuk kemi informacione, në rastin tonë kur i kemi sytë e mbyllur.



H₂SO₄
HCL

Punëtorja V-1.2: Rruga ime deri në shkollë



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit V-1.2a: Rreziku për të huajt
- » fletë pune për nxënësit V-1.2b: Rruga ime deri në shkollë
- » pajisje për të shkruar/vizatuar

Aktiviteti kryesor 1

Fëmijët ndahen në grupe me nga katër-pesë nxënës. Ata duhet të merren vesh e pastaj të aktrojnë me pantomima sesi ndonjë të huaji (që nuk e di gjuhën tonë) do t'i tregojnë se duhet të ketë kujdes nga diçka e rrezikshme, për çka ai nuk e di ose nuk e sheh. Secili grup duhet të zgjedhë nga një fletëz të fletës të punës në të cilën është përshkruar një situatë potencialisht e rrezikshme. Pasi të merren vesh, ata do të duhet ta shfaqin pantomimën para fëmijëve të tjerë.



Diskutim 1

Secili grup, pasi të përfundojë me pantomimën, duhet të përgjigjet se pse e ka zgjedhur pikërisht atë situatë që t'ia tërheqin vëmendjen të huajt të paramenduar; pasi të përfundojnë të gjitha grupet, para gjithë klasës parashtrihen këto pyetje:

1. A ka situata të këtilla të rrezikshme në mjedisin tonë?
2. Si silleni në ato situata?
3. Çka mund të ndodhë nëse nuk i dimë rreziqet që shfaqet në situatat që nuk i njohim? Si duhet të sillemi atëherë?

Përfundim

Situatat potencialisht të rrezikshme asnjëherë nuk janë të dukshme. Nëse nuk i dimë, shumë lehtë mund ta pësojmë. Prandaj çdoherë kur të gjendemi në ndonjë situatë të re e cila mund të jetë potencialisht e rrezikshme, së pari duhet ta vërtetojmë a është vërtet e tillë para se të ndërmarrim ndonjë aktivitet që mund të na rrezikojë.

Aktiviteti kryesor 2

Nxënësit ndahen në grupe të vogla (4-6) dhe u jepet fleta e punës "Rruga ime deri në shkollë". Në fletë të punës duhet t'i vizatojnë situatat që janë potencialisht të rrezikshme, me të cilat së paku një fëmijë i grupit të tyre ndeshet në rrugën për në shkollë dhe t'i shkruajë se cilat janë rreziqet e mundshme në ato situata kur një fëmijë shkon vetë në shkollë. Grupet prezantohen.



Diskutim 2

Diskutohen të gjitha gjërat/situatat e dhëna me pyetje për refleksion ose parafrzim dhe/ose me kërkesë për ide dhe shpjegime plotësuese të secilës situatë së dhënë. Për shembull (nëse është dhënë udhëkryqi):

1. Cilat janë rreziqet kur gjendemi në udhëkryq të madh? Çka është me rëndësi të dihet? A mund të kalohet rruga nëse ka vetura, ndërsa semafori për këmbësorë është i kuq? Pse?
2. Përshkruani udhëkryqet që i kaloni derisa arrini në shkollë! (a ka pamje të mirë?; a ka semaforë?; a është rrugë frekuentuese? etj.)
3. Cila është mënyra më e sigurt e sjelljes në ato situata?

Përfundim

Çdo ditë dhe në çdo moment thuaja në të gjitha situatat jetësore ndeshemi me një dozë të caktuar të rrezikut. Prandaj është me rëndësi të dihen situatat e rrezikut të lartë, si dhe skenarët e mundshëm të rrezikut, që ashtu sjellja jonë të mund të përshtatet që rreziku të thjeshtësohet në minimum. Me rëndësi të veçantë të kemi kujdes ndaj udhëkryqeve të mëdha, të respektohen shenjat dhe sinjalet ndriçuese në komunikacion. Në asnjë rast nuk lejohet kalimi në të kuqe, sado që të duket se nuk ka makina.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në çifte. Në një pjesë të klasës janë vendosur tre karrige në vijë të njëjtë, në distancë prej një metër e gjysmë deri në dy metra. Çiftet duhet të kalojnë një nga një nga njëri skaj i klasës në skajin tjetër, duke i anashkaluar pengesat, njëjtë si në sllallom, por gjatë kësaj njëri fëmijë duhet të jetë i kthyer me shpinë kah karriget dhe të shkojë së prapthi, ndërsa fëmija tjetër duhet t'i japë atij udhëzime për orientim. Pastaj ndërrohen rolet.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja V-1.3: Siguria në komunikacion



Materiallet:

- » fletë pune për nxënësit V-1.3a: Siguria në komunikacion 1
- » fletë pune për nxënësit V-1.3b: Siguria në komunikacion 2
- » fletë pune për nxënësit V-1.3c: Siguria në komunikacion 3
- » fletë pune për nxënësit V-1.3ç: Siguria në komunikacion 4
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Nxënësit qëndrojnë në një skaj të klasës. Qëllimi i këtij aktiviteti është që fëmijët të ndahen në 4 grupe të vogla. Arsimitarja qëndron në anën e kundërt dhe i fton të vijnë pranë saj nxënësit që e duan atë për të cilën ajo i fton. Gjatë kësaj i inkurajon të garojnë deri te ajo (sigurt dhe pa e lënduar njëri-tjetrin, që mos të diskualifikohen), sepse ajo do t'i ndajë vetëm të parët që do të arrijnë, ndërsa ky numër do të jetë rreth një e katërta e numrit të përgjithshëm të fëmijëve të pranishëm.

Arsimitarja i fton në këtë mënyrë

- » I ftoj fëmijët që kanë shumë dëshirë të voziten me veturë.
- » I ftoj fëmijët që kanë shumë dëshirë të voziten në autobus.
- » I ftoj fëmijët që kanë shumë dëshirë të vozisin biçikletë.
- » I ftoj fëmijët që kanë shumë dëshirë të ecin në këmbë.

Fëmijët e tjerë do të ndahen dhe do të ftohen t'i bashkohen ndonjërit grup, por gjatë kësaj duhet të mbahet llogari që të kemi numër përafërsisht të njëjtë të pjesëmarrësve në grupet e vogla.

Aktiviteti kryesor

Grupeve të formuara nga aktiviteti paraprak, në bazë të preferencave të tyre të shprehura, u ndahen fleta të punës "Siguria në komunikacion 1, 2, 3 dhe 4". Pyetjet për punën e tyre janë këto:

Pas pesëmbëdhjetë minutash grupet e prezantojnë zgjedhjen e bërë dhe e shpjegojnë atë.



Diskutim

1. Cilat gjëra janë të rëndësishme për sigurinë tonë kur ecim në këmbë për në shkollë?
2. Cilat gjëra janë të rëndësishme për sigurinë tonë kur udhëtojmë me autobus?
3. Cilat gjëra janë të rëndësishme për sigurinë tonë kur vozisim biçikletë?
4. Cilat gjëra janë të rëndësishme për sigurinë tonë kur vozitemi me veturë?
5. Cilat gjëra janë të rëndësishme për sigurinë tonë kur dëshirojmë të shëtisim nëpër qytet me rolerka? Ku duhet të shëtisim kështu?
6. A ka udhëtuar dikush nga ju me tren? Cilat janë gjërat e rëndësishme në atë situatë?
7. E me anije a ka udhëtuar? Çka është me rëndësi të dihet kur udhëtojmë me anije apo me avion?

Përfundim

Komunikacioni mund të jetë i rrezikshëm për fëmijët veçanërisht nëse ata nuk i respektojnë masat dhe rregullat e sigurisë, siç janë: bartja e helmetës, e mburojave, lidhja me rrip, lëvizja vetëm në shtigje të përcaktuara etj. Nëse respektohen rregullat, rreziku i fatkeqësive zvogëlohet shumë.



Reflektim

1. Çka bëme sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja V-1.4: Siguria në komunikacion II

Aktiviteti kryesor

Arsimtari u thotë nxënësve se do të bëjnë një hulumtim të vogël të mjedisit të shkollës dhe të komunikacionit të rrugëve pranë shkollës.

Nxënësit paralajmërohen se prej tyre pritet ta vëzhgojnë lëvizjen e veturave, të këmbësorëve, të biçikletave dhe të mjeteve të tjera të transportit. Ata duhet të përpiqen t'i vërejnë pjesët e sigurta të rrugëve, si dhe pikat më të rrezikshme.

Arsimtari qysh më parë duhet të bëjë një plan të lëvizjes, i cili do t'i përfshijë rrugët kryesore prej nga vijnë më shumë fëmijë në shkollë. Kur të bëhet marrëveshja se si të lëvizin së bashku në mënyrën më të sigurt, atëherë dilet jashtë dhe kryhet vëzhgimi. Ky vëzhgim duhet të fokusohet në rrugët me frekuentuesë, në semaforë, në udhëkryqe, në faktin se a ka shtigje për këmbësorë dhe për biçikleta, si dhe ku dhe si kalohet rruga më shpesh. Në pikat themelore arsimtari, që ta tërheqë vëmendjen e nxënësve, parashtrohet pyetje të këtij tipi:

- » A kalon dikush këtu?
- » Në çka duhet të kemi kujdes në këtë vend?
- » Cila është sjellja e drejtë/më e sigurt në këtë vend?
- » Çka është rrezik në këtë vend?



Diskutim

Zhvillohet në klasë.

1. Në çka duhet të kemi kujdes kur kalohet rruga?
2. A është e sigurt të kalohet rruga në dritë të kuqe kur nuk ka makina në rrugë?
3. Ku mund e ku nuk mund të kalohet rruga?
4. Cilat janë vendet më të rrezikshme në afërsi të shkollës? (kësaj duhet t'i kushtohet vëmendje; arsimtari përpaket t'i orientojë fëmijët që vetë t'i zbulojnë ato pika që vërtet janë më të rrezikshme dhe kështu ato të theksohen qartë)
5. Si duhet të sillemi në ato vende që rrezikun e tyre ta thjeshtësojmë deri në minimum?
6. Pse ekzistojnë rregullat dhe parimet e komunikacionit?
7. A mund ta rrezikojnë sigurinë e dikujt fëmijët që ngasin biçikletë, rolerka etj?

Përfundim

Çdo ditë dhe në çdo moment thuaja në të gjitha situatat jetësore ndeshemi me një dozë të caktuar të rrezikut. Prandaj duhet të njihen situatat me rrezik të lartë, si dhe situatat e mundshme të rrezikut, që kështu sjellja të mund të përshtatet në atë mënyrë që rreziku të jetë në minimum. Shumë shpesh fëmijët vuajnë në fatkeqësi komunikacioni nga pakujdesia ose mosrespektimi i rregullave të komunikacionit. Shumë shpesh ato rregulla na duken pa lidhje dhe naive, por megjithatë ato janë vendimtare për sigurinë tonë, sepse janë miratuar për të qenë ne më të sigurt.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë ulen ose qëndrojnë në këmbë duke e formuar një rreth. Nxënësve u thuhet se arsimtari do të fillojë me një fjalë e pastaj secili fëmijë me radhë do të thotë nga dy deri në tre fjalë që logjikisht e plotësojnë atë që është thënë më parë dhe që gjithë kjo të ketë lidhje me atë që është mësuar në atë orë. (Nëse ndonjë fëmijë nuk mund të kujtohet, mund të kërkojë ndihmë.) Kështu bëhet një fjalë e pafund për sigurinë në komunikacion. Arsimtari fillon me fjalën: "Që ta arrij i sigurt në shkollë, unë duhet...." Në fund arsimtari nxit duartrokkitje.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja V-1.5: Është me rëndësi të dihet



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit V-1.5a: Është me rëndësi të dihet
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimitarja u thotë se tash do të aktrojnë lloje të ndryshme të publikut:

- Publiku në koncerte të rokut – të gjithë kërcëjnë me një dorë të ngritur mbi kokë dhe me këmbë të ngjitura
- Publik në teatër – qetësi maksimale; të gjithë vetëm shikojnë me interesim
- Publik në stadium – të gjithë bërtasin “Maqedonia, Maqedonia!”
- Publik në kupën e skijimit – të gjithë bërtasin “OP-OP-OP-OP-OP!”
- Publik në turneun e shkollës – të gjithë e thërrasin emrin e paraleles (për shembull: “E 3-ta A” – sipas emrit të vërtetë të paraleles).
- Publik në kuiz – të gjithë duartrokin

Udhëzimet përsëriten dhe fëmijët i kanë disa minuta që t’i ushtrojnë. Pastaj arsimtarja u thotë se ata duhet të reagojnë shpejt, ndërsa ajo do t’ua japë udhëzimet shkurtimisht dhe me radhitje të përziera. Për shembull:

- » Stadium
- » Teatër
- » Koncert
- » Turne
- » Teatër
- » Skijim
- » Kuiz
- » Stadium
- » Skijim
- » Koncert
- » Skijim
- » Teatër
- » Koncert
- » Turne
- » Kuiz
- » Turne
- » Kuiz
- »

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në gjashtë grupe. Secilit grup i jepet nga një situatë e fletës së punës “Është me rëndësi të dihet”. Fëmijët i kanë dhjetë minuta për punë. Pas përfundimit, grupet i lexojnë situatat që i kanë marrë, e pastaj e shpjegojnë atë që e kanë punuar.



Diskutim

1. Në çka duhet të kihet kujdes kur fëmija është vetëm në shtëpi? Pse?
2. Në çka duhet të kihet kujdes kur jemi në një masë të madhe njerëzish si në koncert të rokut ose në stadium?
3. E kur kthehemi në shtëpi në mbrëmje?
4. Çka është me rëndësi të dihet para se të shkohet në ekskursion? Çfarë përgjegjësie keni derisa jeni në ekskursion?
5. E çka janë ahengjet e ditëlindjes? A ekzistojnë situata të rrezikshme në ato rrethana?
6. Në çfarë gjërash duhet të kemi kujdes kur jemi në fushë të sportit?
7. Në çfarë rregullash duhet të kemi kujdes kur jemi në shkollë – në oborr dhe brenda në ndërtesën shkollore?

Përfundim

Situata të ndryshme jetësore kërkojnë edhe përshtatje specifike të sjelljes. Është me rëndësi të dihen rreziqet potenciale në situata të ndryshme, që kështu të përshtatet si duhet ndaj sjelljes. Në shtëpi ekzistojnë rreziqe nga kimikate të ndryshme, nga rryma, si dhe nga përdorimi i aparateve të caktuara të amvisërisë. Nëse përdoret shporet, pas përdorimit duhet të shkyçet. Duhet të kihet kujdes që të mbyllen të gjitha dyert dhe dritaret, të mos luhet me gjëra që prindërit i konsiderojnë të rrezikshme për fëmijët. Në koncert dhe në stadium duhet të kihet kujdes me lëvizjen, veçanërisht nëse shkohet në grup. Kur ka koncentrim të madh të njerëzve, pritet që në ato raste të ketë edhe njerëz të tillë që kanë më pak kujdes në sigurinë e njerëzve. Atëherë edhe mundësia që të ketë njerëz të dehur ose agresivë është gjithnjë më e madhe. Derisa jemi në ekskursion ne jemi në përgjegjësi të arsimtarëve, andaj është me rëndësi të dëgjohen rekomandimet e tyre dhe të respektohen rregullat e vendosura, që kështu mos të shkaktohet problem me banorët lokalë dhe të mos komunikohet me njerëz të panjohur që kanë kërkesa të dyshimta. Në ahengjet e ditëlindjeve duhet të jemi të kujdesshëm ndaj mobilieve dhe ndaj gjërave të shtëpisë. Derisa jemi mysafirë te dikush dhe derisa jemi në ndonjë aheng në ndonjë vend publik, duhet të kihet kujdes që mos të shqetësohen mysafirët e tjerë ose të kihet kujdes ndaj njerëzve që janë të dehur ose që janë agresivë. Në fushë të sportit po ashtu është me rëndësi të kihet kujdes ndaj fëmijëve më të vegjël, si dhe ndaj sigurisë personale nga gjërat e ndryshme që gjenden në fushë. Aty nuk duhet të qëndrohet kur bën shumë vapë ose kur është shumë ftohtë. Është me rëndësi të kihet sjellje e qetë ndaj fëmijëve që tallen me shpoti. Në shkollë duhet të respektohen rregullat e shkollës.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Kërkohet një fëmijë vullnetar që do të bëjë tinguj që na përkujtojnë në ndonjë melodi bashkëkohore, ndërsa të tjerët do të vallëzojnë sipas asaj melodie, duke bërë lëvizje të shumta të trupit. Pas një kohe kërkohet zëvendësim për fëmijën që e krijon atë muzikë.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja V-1.6: Labirinti



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit V-1.6: Labirinti
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Udhëzime për Labirintin
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth, ndërsa arsimtari u thotë nxënësve se do t'ua tregojë disa udhëzime të shkurtra, e ata do të duhet të reagojnë shpejt dhe në mënyrë adekuate në ato. Kur thotë arsimtari "EC!", fëmijët duhet t'i rrahin këmbët në vend me ritëm të shpejtë. Kur ai të thotë "QËNDRO!", fëmijët duhet të qëndrojnë drejt e qetë. Loja fillon kur arsimtari fillon të flasë shpejt: "ec, ec, ec, ec, ec, ec, QËNDRO, ec, ec, ec, ec, ec, ec, QËNDRO!"

Këtë e përsërit disa herë. Kur të ketë përshtypje se fëmijët tashmë janë gjendur vetë dhe se i kuptojnë udhëzimet, përsëri u thotë nxënësve se rishtazi do të fillojë, por në momentin kur ndonjë fëmijë do të gabojë, ai do të duhet ta marrë rolin e arsimtarit – të japë udhëzime dhe ta diktojë tempon. Kjo përsëritet disa herë.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe me nga tre deri në pesë fëmijë. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit "Labirinti". Si hyrje në aktivitet nxënësve u tregohet legjenda për Dedalin dhe labirintin.

"Pasi që konstruktori gjenial antik Dedal e kishte bërë labirintin më të njohur në kohën antike (në ishullin Kreta), për pak do të mbetej edhe vetë aty, sepse nuk mund ta gjente daljen. Atëherë u kujtua se kishte lënë shenja që vetëm ai mund t'i kuptonte, që në të ardhmen ta gjejë rrugën më lehtë."

Grupet duhet ta gjejnë daljen nga labirinti, duke pasur kujdes në shenjat që i kalojnë. Me këtë rast në një fletë të veçantë të letërës duhet të shënohen këto gjëra për shenja:

- » Çka nënkupton shenja konkrete? Për çka shërben?
- » Në cilat situata mund të ndeshet ajo shenjë?



Diskutim

1. Më çka u ballafaquat kur e kaloni rrugën nëpër labirint?
2. A kishte rreze? A kishte tërheqje të vërejtjes?
3. Në cilat situata mund të hasim në aso shenjash? Pse shërbejnë këto shenja?
4. A mund t'i përcaktojmë se cilat shenja na e tërheqin vërejtjen, cilat informojnë e cilat ndalojnë diçka?
5. A di dikush shenja të tjera të ngjashme?
6. Ça ndodhë nëse nuk respektohen shenjat?
7. A ekzistojnë edhe në vende të tjera shenja të tillë? Pse?

Përfundim

Shenjat që na e tërheqin vërejtjen dhe ato që informojnë janë për shkak të sigurisë personale të njerëzve. Ato janë bërë në mënyrë të thjeshtë – që të jenë lehtë të dukshme dhe të kuptueshme. Zakonisht në numrin më të madh të vendeve ato janë të njëjta. Është me rëndësi të respektohen ato për shkak të sigurisë sonë personale.

Aktiviteti përfmbyllës

Në mesin e klasës vendosen një deri në dy karrige në "zik-zak" me distancë mes vete deri në një metër deri në një metër e gjysmë. Fëmijët në çifte duhet të kërcejnë në një këmbë nga njëri skaj në tjetrit, duke u mbajtur me duar.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Flitet se kur konstruktori gjenial antik Dedal e ka konstruktuar labirintin më të njohur në antikë, atë në ishullin Kreta, pasi e ka përfunduar, për pak edhe vetë do të mbetej përgjithmonë aty, sepse nuk ka mundur ta gjejë daljen. Atëherë është kujtuar se kishte lënë shenja që vetëm ai mund t'i kuptonte, që në të ardhmen ta gjejë më lehtë rrugën." Duke punuar në grupe, do të duhet të gjendet dalja nga labirinti, duke pasur kujdes në shenjat që i kaloni. Me këtë rast në një fletë të veçantë të letrës duhet të shënohen këto gjëra për shenja:

- » Çka nënkupton shenja konkrete?
- » Në cilat situata mund të ndeshet ajo shenjë?
- » Për çka shërben ajo?

Punëtorja V-1.7: Armët



Materialet:

» fletë pune për nxënësit V-1.7: Armët

Aktiviteti hyrës

Nxënësit ndahen në çifte. Secili në çiftin e tij duhet të rrëfejë se a ka pasur ndonjë përvojë të drejtpërdrejtë me ndonjë armë: thikë, pistoletë etj. Arsimitari u thotë atyre se ai nuk do të kërkojë pastaj nga ata që të tregojnë se për çka kanë folur dhe kështu tërhiqet nga rrethi që fëmijët të mund të flasnin lirshëm. Ai verbalisht, po edhe joverbalisht, dëshmon se nuk e dëgjon atë që e bisedojnë fëmijët.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në gjashtë grupe. Grupeve u jepet nga një situatë e fletës së punës. Ata duhet t'u përgjigjen pyetjeve që u parashtrohen në fund të situatës. Kur të përfundojnë, grupet duhet të prezantohen.



Diskutim

1. A guxojnë fëmijët të kenë qasje në armë?
2. Kush guxon? (vetëm njeriu që ka leje për armë)
3. A konsiderohen edhe thikat armë?
4. E pirunët?
5. A mund të jetë e rrezikshme loja me fishekzjarrë dhe eksplozivë të ngjashme që shiten për vitin e ri?
6. A mund të shihet arma në çfarëdo mënyre si diçka e mirë? (JO)
7. Çka mund të bëjmë dhe çka nuk duhet të bëjmë nëse dikush në shkollë mban armë?
8. E nëse mban armë në rrugë ose në fushën e sportit?
9. Për çka shërben arma? (Për vrasje të kafshëve – armët e gjuetisë dhe për vrasje të njerëzve – armët luftarake)

Përfundim

Fatkeqësisht në disa mjedise ende shumë fëmijë kanë qasje në armë. Atyre ose ua japin drejtpërdrejt të rriturit ose ato armë nuk janë sa duhet të mbrojtura dhe kështu fëmijët kanë qasje në to. Të kesh armë të ftohta, thika dhe pirunë të përgatitur enkas, në shumë familje as që konsiderohen si armë të rrezikshme, ndonëse edhe ato janë njësoj të rrezikshme për fëmijët. Në kulturat tona tradicionalisht kultivohet një qëndrim pozitiv ndaj armës, gjë që është mjaft e rrezikshme, sidomos në plan afatgjatë. Fëmijëve duhet t'u mbillet qëndrimi që është jotolerant ndaj secilës armë dhe/ose përdorimit të tyre.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në një pjesë të klasës. Disa fëmijë (2 ose 3) njëherazi, pavarësisht nga njëri-tjetri, duhet të kalojnë në anën tjetër të klasës, duke aktruar se po shkelin në vezë. Arsimitari nxit atmosferë argëtuese, pa prituri ndonjë lëvizje konkrete. Ai nxit stile të ndryshme të lëvizjes: shpejt, ngadalë, në gishta etj.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja V-2: KRIJIMI I RAPORTI POZITIV NDAJ MJEDISIT (kujdesi për higjienën dhe mirëmbajtja)

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë pajisjet për mirëmbajtjen e higjienës dhe përdorimi i saj. » ta dijë se çka duhet të bëjë që ta mirëmbajë higjienën në shtëpi (ngritja e tryezës, rregullimi i dhomës, fshirja e pluhurit, thithja e pluhurit me makinë, larja e enëve), në klasë (ajrosja, rregullimi i materialeve), në hapësirat publike (pështymja, hedhja e mbeturinave) » t'i dijë pasojat e dëmtimit të mjedisit » të dijë se çka duhet të bëjë që ta mirëmbajë (të mos e dëmtojë) mjedisin (thyerje, shkarravitje, shtrembërim, prishje) » ta dijë se cilat materiale në mjedis mund të riciklohen (letra, plastika, qelqi, kanaqet), e cilat mund të ridedikohen racionalisht
Shkathtësi	» të mund të kontribuojë në mirëmbajtjen e higjienës në shkollë dhe në oborrin e shkollës (të mos përlyejë dhe ta pastrojë papastërtinë) » të mund t'i kundërvihet dëmtimit të mjedisit » të mund t'i klasifikojë gjërat për riciklim » të mund të ndikojë ndaj të tjerëve që mbeturinat t'i hedhin në vende adekuate
Qëndrime/ vlera	» t'i kuptojë pasojat e dëmtimit të mjedisit » ta pranojë përgjegjësinë personale për mirëmbajtjen e higjienës në mjedis » ta pranojë përgjegjësinë personale për kujdesin e mirëmbajtjes së higjienës në mjedis » ta kuptojë se duhet të kufizohet përdorimi i materialeve që nuk riciklohen (shishet e plastikës, qeset...)

Punëtorja V-2.1: Ngremë

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në katër grupe. Grupeve u jepen nga 5 minuta që të merren vesh dhe pas 2-3 minutave të aktrojnë ndonjë situatë të caktuar që do t'u jepet. Në aktrim duhet të marrin pjesë të gjithë në rolin e anëtarëve të familjes.

Situatat e këtyra janë këto:

- » Shtrimi dhe ngritja e tryezës së drekës familjare
- » Larja dhe fshirja e enëve pas drekës familjare
- » Pastrimi me pluhurthithëse dhe fshirja e pluhurit
- » Ajrosja dhe rregullimi i dhomës

Nxënësve u thuhet se ata duhet të kenë më shumë kujdes që sa më mirë të mund ta bëjnë atë që duhet ta bëjnë – biseda ndërmjet anëtarëve të familjes gjatë kësaj kohe nuk është aq e rëndësishme.

Grupet prezantohen dhe secili grup i jepet duartrokitje.



Diskutim

1. Kush është përgjegjës për higjienën dhe rregullimin në shtëpi? A janë vetëm të rriturit?
2. Si mund të ndihmojmë në shtëpi kur shtrohet tryeza? A mund t'i bëjnë të gjitha gjërat fëmijët? Cilat munden, e cilat nuk munden? A duhet të ndihmojmë fëmijët kur shtrohet dreka? Pse?
3. Me çka mund të ndihmojmë fëmijët që të ngrihet tryeza pas drekës? A mund t'i bëjnë fëmijët të gjitha ato gjëra? Cilat munden e cilat nuk munden?
4. Me çka lahen enët? A duhet të lajnë enë fëmijët? Pse?
5. A mund t'i përdorin fëmijët të gjitha pajisjet që përdoren për pastrim në amvisëri? Cilat nuk munden? Pse?
6. A duhet të marrin pjesë fëmijët në pastrimin e shtëpisë? Çka mund të bëjnë ata?
7. Kush është përgjegjës për higjienën dhe rregullimin në shkollë? A janë përgjegjës vetëm të punësuarit?
8. Kush është përgjegjës për klasën dhe për rregullimin e klasës? Kush duhet t'i rregullojë bankat ndërmjet orëve? Pse?
9. A duhet dikush nga jashtë ta ajrosë klasën? Pse është me rëndësi të ajroset hapësira në të cilën kalohet një kohë e gjatë?
10. Çka duhet të bëhet me mbeturinat? Ku duhet të hidhen ato?

Përfundim

Fëmijët e kësaj moshe janë mjaft të pjekur që të mund të fillojnë t'i përvetësojnë dhe integrojnë aktivitetet që i referohen mirëmbajtjes së mikrohapësirës së tyre të pastër dhe të rregullt. Kjo më së miri bëhet kur ata janë të inkuadruar në mënyrë aktive në ato aktivitete. Që të mund të inkuadrohen, atyre u duhen disa parajohuri për atë se si duhet të përdoren pajisjet e pastrimit, aparatet dhe cilat gjëra mund t'i bëjnë ata vetë. Me këtë rast nuk rekomandohet përdorimi i pajisjeve kimike për dezinfektim, liruesve të materieve të dëmshme, politurëve të rëndë etj. Fëmijët janë pjesërisht të përgjegjshëm për rregullin dhe higjienën në hapësirën ku ata qëndrojnë.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Secili grup duhet ta mendojë nga një "skulpturë lëvizëse" e cila paraqet një aparat/ makinë në amvisëri e cila shërben për mirëmbajtjen higjienës. Secili grup duhet ta mendojë dhe ta aktroje makinën/ aparatën që e ka menduar, por pa thënë asnjë fjalë. Të gjithë anëtarët e grupit janë të detyruar të jenë pjesë "e skulpturës lëvizëse". Grupet prezantohen një nga një derisa dikush nga "publiku" nuk ia qëllon se çka paraqesin ata.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja V-2.2: KLASA JONË



Materialet:

- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në çifte. Secilit çift i jepet për detyrë që gjatë pesë minutave të ardhshëm të zbulojë sa më shumë dëmtime të inventarit në klasë dhe të klasës në përgjithësi. Së paku njëri anëtar i çiftit mban shënime për atë që do ta zbulojnë. Pas kalimit të pesë minutave, çiftet bashkohen në grupe me nga gjashtë persona të cilët e bëjnë një listë të përbashkët. Arsimitari i fton që të gjithë së bashku të bëjnë një listë të përbashkët në tabelë.



Diskutim

- » Cilat gjëra janë më të dëmshme në klasën tonë?
- » Çfarë dëmtimesh kemi (thyerje, shkarravitje, mbështjellje...)
- » Pse ndodhë kjo? Kush është përgjegjës për ato dëmtime?
- » E kujt është klasa dhe kujt i shërben ajo më së shumti?
- » Çka mund të bëhet nëse shohim se ndonjë fëmijë i shkarravit bankat me qëllim, ndonëse sigurisht e bën atë pa vetëdije?
- » E çka duhet të bëjmë kur të shohim se ndonjë fëmijë ose fëmijët me vetëdije qëllimisht bëjnë dëm?

Përfundim

Te në është shumë e ulët vetëdija për përgjegjësinë “e të mirave të përbashkëta”. Është me rëndësi që fëmijët ta vërejnë se nëse ata bëjnë dëm në hapësirën ku ata qëndrojnë, kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë do të thotë se ia bëjnë të keqen vetvetes. Është me rëndësi që fëmijët të inkurajohen të reagojnë kur shohin se dikush u bën dëm.

Aktiviteti përmbyllës

Përkufizohet një shteg i caktuar nëpër klasë i cili kalon ndërmjet bankave, karrigeve dhe pranë raftëve dhe inventarit tjetër. Secili fëmijë duhet të kalojë aty me kujdes, por gjatë kësaj të mos prekë asgjë nga inventari.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja V-2.3: Mbeturina? Ndotja? Stolia?



Materialet:

- » pajisje për të shkruar
- » litar/sellotej

Aktiviteti hyrës

Nxënësit i kontrollojnë çantat, fletoret dhe bankat e tyre dhe, nëse gjejnë letra/fleta që janë përdorë, e që nuk u duhen, i marrin dhe prej tyre e bëjnë një top të madh. Është mirë që topi mund të qëndrojë pa u lidhur, por nëse kjo nuk është e mundur, lidhet me litar ose përdoret sellotej. Topi lihet anash.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në grupe me nga 4-6 veta. Secili grup në një fletë të letrës duhet t'i numërojë gjërat më të shpeshta që në shtëpitë e tyre përfundojnë në koshin e mbeturinave. Pasi t'i numërojnë ato, do të duhet t'i mendojnë disa mënyra kreative sesi mund të përdoren ato gjëra në mënyrë të dobishme. Kanaqet mund të përdoren si kuti për lapsa, si brusha, lodra. Nga letra mund të bëhen kolazhe të ndryshme, ajo mund të riciklohet, prej saj mund të bëhen lodra etj. Shishet e plastikës mund të mblidhen për shitje, prej tyre mund të bëhen forma të ndryshme, lodra etj. Nga ushqimi që hidhet mund të ushqehen zogjtë, kafshët etj. Arsimitarja i nxit grupet të mendojnë në drejtime të ndryshme.

Grupet e prezantojnë atë që e kanë menduar.



Diskutim

1. Në çka mund të orientohet mbeturina plastike? Në çka mund të orientohet letra? Në çka mund të orientohen kanaqet dhe ambalazhi tjetër?
2. A e bëjmë këtë? Pse jo?
3. Çka ndodhë me qeset e plastikës? A mund të jetohet pa to?
4. Ku mbarojnë mbeturinat? Çka do të ndodhë me planetin nëse vazhdojmë të mbledhim shumë mbeturina?
5. Çka mund të bëhet që mos të ndodhë kjo?
6. Si mundet secili të kontribuojë që kjo të mos ndodhë?
7. Çka do të thotë fjala riciklim?

Përfundim

Nëse vazhdohet me këtë tempo të përdorimit të materialeve që ndotin në mënyrë të përhershme (si plastika) dhe nuk riciklohen, planeti jonë shpejt do të fillojë të duket si një deponi e madhe. Ndërrimi i mundshëm i qeseve të plastikës me qeset e letrës, por edhe përpunimi i tyre, kërkon të përdoren drurë, andaj më së miri është të përdorem strajca të pëlhurës. Secili është drejtpërdrejt përgjegjës dhe i rrezikuar. Që të ndalet ndotja, secili e ka patjetër ta japë maksimumin e vetë duke pasur kujdes që materialet edhe në këso madhësie t'i përdorë njësoj sikur të reagojë ndaj situatave të sjelljes së palejuar. Nëse mbeturina klasifikohet, është shumë më lehtë që ajo të riciklohet. Me riciklimin e saj kursehet energji, por njëherazi edhe zvogëlohet ndotja. Arsimitarja mund t'ua propozojë nxënësve ta shikojnë filmin për robotin pastrues Voli "WALL-E" në të cilin në plan afatgjatë është paraqitur ndotja e planetit.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimitarja i përkujton se ata në fakt kanë arritur të dëshmojnë se dinë t'i ridedikojnë materialet dhe mbeturinat dhe kështu e merr topin që e kishin bërë në fillim. Një fëmijë fillon me aktivitet duke e mbajtur në dorë topin dhe me këtë rast e thotë një fjali të shkurtër dhe konkrete që ai/ajo do ta bëjë në të ardhmen që ta zvogëlojë sasinë e mbeturinave që bëhet në familjen e tij ose në shkollë. Kur të shprehet, ai me shumë kujdes do ta përcjellë topin dhe pastaj do a thotë mendimin e tij. Secili fëmijë mund ta pranojë/japë topin e tij, gjegjësisht të shprehet vetëm një herë. Në fund jepet një duartrokkitje. Nëse mendohet ndonjë përdorim tjetër i topit, është mirë që ai top të ruhet. Po ashtu ai top mund t'i ofrohet kabinetit të edukatës fizike, për ndonjë ushtrim.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja V-2.4: Dita e planetit Tokë

Ideja themelore e këtij aktiviteti është që të shfrytëzohet dita e ekologjisë, e cila zakonisht në shkolla shfrytëzohet si moment për rregullimin, pastrimin dhe zbukurimin e hapësirës shkollore. Është mirë që arsimtari ta shfrytëzojë atë mundësi dhe pas përfundimit të aksionit të bisedojë me nxënësit, që kështu të fuqizohen qëndrimet që zakonisht “nënkuptohen” gjatë realizimit të këtyre aksioneve. Më së miri është që kjo të bëhet menjëherë pas kryerjes së aksionit ose së paku në mundësinë e parë të ardhshme.

Aktiviteti kryesor

Aksion që zhvillohet sipas planit/traditës së shkollës.

Diskutim

Diskutimi zhvillohet varësisht nga aktiviteti. Nëse janë mbledhur mbeturina nga oborri, bisedohet për atë se kush mund të jetë përgjegjës për ato mbeturina dhe në çfarë mënyrash mund të kontribuohet që mos të hidhen aq shumë mbeturina gjithandej, që ashtu të zvogëlohet përdorimi i materialeve që e ndotin mjedisin përgjithmonë. Flitet për llojet e ndryshme të mbeturinave dhe për çështjen se a ka prej tyre të tilla që mund të riciklohen ose të përdoren për diçka tjetër. Pastaj mund të shkruhet kërkesë në vetëqeverisjen lokale që të sjellë kosha për ndarjen e mbeturinave. Mund të mblidhet ambalazhi plastik (mund të luten fëmijët që të sjellin prej shtëpie), mund të shitet në mënyrë transparente bashkë me fëmijët në një stacion të shitjes dhe me ato mjete të blihet diçka e dobishme për klasën. Ajo mund të jetë diçka shumë e lirë dhe e vogël, mund të jetë një shpuzë e zakonshme e re për fshirjen e tabelës, por për fëmijët do të jetë një shembull i mirë për orientimin e pikëpamjeve të tyre.

Nëse keni mbjellë dru, bisedohet për atë që është e rëndësishme të dihet se çka duhet të bëhet që ato drurë të mos dëmtohen. Mund të bëhet edhe një përgjithësim – pse janë të rëndësishëm drurët në planetin tonë?

Nëse klasa është pastruar, bisedo se a është me rëndësi dhe pse është me rëndësi të mbahet higjiena në hapësirën ku qëndrojmë. Përgjegjësi e kujt është kjo? Çka mund të bëhet që higjiena të mirëmbahet në nivel edhe më të lartë. Kush përfiton nga kjo dhe në dëm të kujt është pakujdesia për rregullimin dhe higjienën e hapësirës në të cilën qëndrojmë...

Përfundim

Fëmijët mund të inkuadrohen shumë mirë në aksione serioze ekologjike. Përveç që do ta vërejnë se si bëhet kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë – që t’u fuqizohen vlerat dhe qëndrimet pozitive/të dëshiruara, është me rëndësi të bisedohet dhe në mënyrë të qartë dhe konkrete të nxirren “poentat” e këtyre aktiviteteve.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja V-2.5: Në klasë

Përgatitja paraprake

Kërkohet nga njerëzit që janë të ngarkuar me detyrën e mbajtjes së higjienës që t'ua japin dosa kova, një xhiger, disa lecka për të fshirë, disa palë dorezash dhe pajisje për pastrim. Rekomandohet që edhe arsimtari të marrë nga shtëpia lecka që do të mund të përdoren (zakonisht nëpër shtëpi gjenden lecka të tilla). Nxënësit nxiten të sjellin lecka të vjetra dhe qese të najlonit, duke e mos e kuptuar këtë si detyrim. Kërkoni nga 2-3 fëmijë të paraqiten vullnetarisht për të sjellë sapun. Është mirë që arsimtari të sjellë më shumë gazeta të vjetra, disa thika jo shumë të mprehtë ose spakëll, sfungjerë për larjen e enëve etj. Mund të kërkohet edhe nga nxënësit që të sjellin nga shtëpia këso gjërash, por me këtë rast duhet të kemi kujdes që kjo mos t'i ngarkojë nxënësit/prindërit. Është mirë që ky aktivitet të bëhet në ndonjë ditë kur mund të zgjatë më shumë se një orë ose ndonjë ditë që është e përcaktuar për higjienë dhe ekologji, që kështu aktiviteti të përdoret edhe për qëllime të tjera.



Materialet:

- » pajisje për pastrim, lecka për të fshirë, doreza të gomës, kova, xhiger, letra të vjetra

Aktiviteti kryesor

Arsimtari u tregon nxënësve se sot do të përpiqen ta zbukurojnë edhe më shumë klasën, duke i fshirë dritaret, shkrimet nëpër mure, muret, tabelën etj. Ata do ta pastrojnë deri në shkëlqim derën e klasës, pajisjet mbikëqyrëse, raftet, varëset... Do t'i heqin çam-çakëzat e ngjitur etj.

Arsimtari së pari i shpjegon pajisjet që do të përdoren, veçanërisht ato që janë të rrezikshme, si për shembull kimikatet për pastrim. Qeset e najlonit përdoren si zëvendësim për dorezat e gomës – për të kapur gjëra të papastrta. Fëmijët ndahen në grupe me detyra të veçanta. Ata i kanë në disponim tridhjetë minuta për këtë aktivitet. Grupet ndahen sipas asaj që do ta bëjnë. Secilit grup i thuhet se në çka duhet të ketë kujdes nga aspekti i lëndimeve. Po ashtu u shpjegohet se si të kenë kujdes që mos të përlyhen. Ja disa shembuj:

- » Grupi që me spakëll ose me thikë jo të mprehtë do t'i heqë çam-çakëzat nga bankat (1-2 fëmijë i heqin çam-çakëzat, ndërsa 1-2 fëmijë i mbledhin me duar (të mbështjella me doreza/qese) dhe i hedhin në mbeturina
- » Grupi që do t'i fshijë dritaret mund të pastroje me pajisje të thjeshtë për larjen e enëve, me ujë e pastaj me letër të vjetër t'i bëjë të shkëlqejnë.
- » Grupi që do t'i pastrojë bankat nga shkarravinat.
- » Grupi që do të heqë çam-çakëza nga dyshemeja.
- » Varësisht nga infrastruktura e klasës dhe nevojat specifike, formohen edhe grupe të tjera.



Diskutim

1. Si ju duket tash klasa? Pse?
2. Si ndjeheni tash? Pse?
3. A është tash më mirë të qëndrohet në klasë?
4. Si ta mbajmë klasën të pastër dhe të bukur edhe më tej? (mund të bëhet një marrëveshje që nxënësve dhe arsimtares së ndërrimit tjetër (nëse ka) t'i lihet një porosi se ju e keni bërë atë pastrim dhe se prisni që ata ta çmojnë punën tuaj, se ndoshta do të duan edhe ata të pastrojnë muajin e ardhshëm, që kështu t'i ndërroni rolet etj.)
5. Kush do të jetë i shëmtuar nëse e çrregullojmë/përlyejmë/shkarravisim klasën ose ngjimis çam-çakëza?

Përfundim

Shumë shpesh hapësirat e përbashkët ose publike nuk përjetohen si "tonat". Kjo veçanërisht është dukuri e kulturave tona, prandaj edhe aq lehtë ia lejojmë vetes ta dëmtojmë ose të mos kujdesemi për inventarin dhe higjienën. Nëse fëmijët fusin energji në rregullimin e klasës dhe menjëherë i shohin rezultatet e punës së tyre, edhe mundësia e destruktivitetit të tyre do të jetë më e vogël. Po ashtu ata do ta vërejnë se qëndrimi në klasë të rregulluar është me i këndshëm për vetë ata.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari thotë se sot kanë kryer punë të madhe. Ai thotë se vepra e tyre meriton lëvdata dhe mirënjohje të veçanta. Kjo bëhet në këtë mënyrë: fillohet nga ndonjë fëmijë që do të paraqitet si vullnetar, i cili do të duhet të dalë një hap më para në rreth. Fëmija që është në të djathtën e tij i drejtohet me "Të faleminderit ... (emri i fëmijës) që ndihmove në zbukurimin e klasës sonë". Pastaj vijon një duartrokitje nga të gjithë. Pastaj e ka radhën fëmija që foli, ndërsa aktiviteti zgjat derisa të kalojnë të gjithë me radhë, përfshirë edhe arsimtarin. Në fund arsimtari u thotë: "Ju falënderoj të gjithëve që e zbukuruat klasën, unë KRENOHEM ME JU!".



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja V-3: KRIJIMI I RAPORTIT POZITIV NDAJ KAFSHËVE DHE BIMËVE

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë vendin e bimëve dhe kafshëve në ciklin e jetës së gjallë » t'i dijë disa pasoja të zhdukjes së drurëve nga pyjet » ta dijë se si mund t'u ndihmojë kafshëve që u duhet ushqim
Shkathtësi	» të mund të mbjellë dhe kultivojë bimë » të mund të sillet në mënyrë adekuate ndaj bimëve (të mos i dëmtojë) » të mund t'u ndihmojë kafshëve kur nuk ka sa duhet ushqim
Qëndrime/ vlera	» ta kuptojë se bimët janë të nevojshme për mirëmbajtjen e botës së gjallë » ta pranojë se bimët kanë nevojë për sjellje të veçantë ndaj tyre » ta pranojë se ndaj kafshëve duhet të sillemi me humanitet, si ndaj gjithë qenieve të tjera të gjalla » të shfaqë interes për mirëqenien e kafshëve

Punëtorja V-3.1: Origamet



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Ndarja në 5 grupe
- » fletë pune për nxënësit V-3.1a: Origame 1
- » fletë pune për nxënësit V-3.1b: Origame 2
- » fletë pune për nxënësit V-3.1c: Origame 3
- » fletë pune për nxënësit V-3.1ç: Origame 4
- » fletë pune për nxënësit V-3.1d: Origame 5
- » fleta të letrës së vjetër (që më parë është përdorë për diçka tjetër)

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari qysh më parë përgatit numër të barabartë të fletëve të punës “Ndarja në 5 grupe” dhe ua jep nxënësve që të tërheqin prej tyre. Ai u thotë nxënësve se ata do të duhet të veprojnë sipas udhëzimeve. Arsimtari thekson se është shumë me rëndësi që të mos flitet asgjë mes vete, pos fjalëve që janë dhënë në fletëzat e tërhequra.

Arsimtari jep shenjë për fillimin e aktivitetit. Nëse ka nevojë, edhe ai ndihmon në formimin e grupeve.

Pas kryerjes së aktivitetit, secili grup e thotë atë që e ka shkruar në letër dhe shpërblehet me duartrokitje. Grupet e formuara përdoren edhe për aktivitetin kryesor.

Aktiviteti kryesor

Sipas rolit që e kanë aktruar në aktivitetin paraprak, grupeve u jepet nga një fletë pune “Origami” (macja, tulipani, bretkosa, dardha, zogu). Atyre u jepen më shumë fleta të letrës së vjetër që të mund të përpiqen disa herë. Atyre u lihet kohë 15 minuta që ta zgjidhin origamin. Grupet i prezantojnë figurat e tyre.



Diskutim

1. Çka i duhet një maces së vogël që të jetë e gëzuar dhe e shëndoshë? A mund ta paramendoni botën pa mace? Si do të dukej ajo botë? Cilat do të ishin pasojat e saj?
2. Çka i duhet një tulipani që të rritet? Si do të ishte bota pa tulipane dhe pa disa lule të tjera?
3. Si do të ishte bota pa bimë? Çka mundësojnë bimët?
4. Çka i duhet një bretkose që të jetë e gëzuar dhe e shëndoshë? Cilat mund të jenë pasojat nëse përnjëherë zhduken të gjitha bretkosat?
5. Çka i duhet një peme, si dardha, që të rritet? (nëse përmendet se i duhet spërkatje për mbrojtje, parashtrohet pyetja se “A i duhet spërkatje edhe dardhës që rritet në natyrë?”) Cilat mund të jenë pasojat nëse përnjëherë zhduken pemët?
6. Si do të dukej bota pa peshq? Cilat do të ishin pasojat nëse përnjëherë zhduken peshqit?
7. Çka i duhet një zogu që të jetë i shëndoshë dhe i gëzuar? A mund ta paramendoni botën pa zogj? Cilat do të ishin pasojat nëse verën që vjen nuk na vijën dallëndyshet?
8. Çka mendoni, pse përdorëm letër të vjetër?

Përfundim !

Të gjitha qeniet e gjalla e kanë rolin e tyre në natyrë. Para kohës kur njeriu ka qenë në gjendje ta ndryshojë natyrën dhe të kultivojë e zhdukë bimë e kafshë në masë të madhe, baraspesha dhe harmonia natyrore ka qenë e pranishme gjithkund. Ajo baraspeshë ndërmjet llojeve është e rëndësishme për të gjithë, edhe për bimët edhe për kafshët edhe për njeriun. Nëse ndërpritet një hallkë e zinxhirit ushqimor, këto pasoja shfaqen në të gjitha llojet përreth. Prandaj njeriu që mendon për vete se ai është kafsha më e përsosur, ai e ka përgjegjësinë të kujdeset për baraspeshën në mjedis. Nëse zhduken të gjitha macet në botë, pos që nuk do të kemi mace si ledhatakë, por do ta shohim se macet (të egra, macet e rrugës dhe ato shtëpiake) janë një hallkë e rëndësishme në zinxhirin ushqimor: ato hanë zogj të sëmurë, minj etj., por edhe e mirëmbajnë mjedisin të shëndoshë – në baraspeshë. Ndonëse njeriu disa bimë i konsideron se janë vetëm për dekorim, ato përveç bukurisë, të gjitha kanë edhe rol tjetër në natyrë – insekte të caktuara ushqehen vetëm me bimë të caktuara, ashtu që nëse zhduken bimët, do të zhduken edhe insektet. Bretkosat janë shumë të ndjeshme ndaj ndryshimeve. Edhe një ndotje e vogël e ujit mund t'i shkatërrojë ato. Bretkosat dhe peshqit ushqehen me kërcë, me larva të insekteve të tjera e me krimba, ndërsa janë ushqim për shumë peshq dhe zogj, të cilët pa bretkosa po ashtu do të rrezikoheshin. Zogjtë hanë insekte të shumta, kërcë, miza dhe mushkonja, që nëse nuk do të ishin dallëndyshet, do të shumoheshin shumë.

Aktiviteti përmbyllës

Secili grup i aktivitetit kryesor me trupat e tyre duhet të bëjnë skulpturë të figurës së tyre të origamit – duhet të bëjnë “origami të gjallë”. Është me rëndësi të thuhet se të gjithë anëtarët e grupit duhet të marrin pjesë në skulpturën e krijuar.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Lëviz lirshëm nëpër klasë, vetëm bën “MJAU-MJAU” dhe asgjë tjetër! Aktron se je mace. Përpiqu t’i gjesh ata që janë të ngjashëm me ty. Bashkë me ata krijoni një grup në një pjesë të klasës.

Lëviz lirshëm nëpër klasë, vetëm bën “KRE-KRE” dhe asgjë tjetër! Mund edhe të kërcesh. Aktron se je bretkosë. Përpiqu t’i gjesh ata që janë të ngjashëm me ty. Bashkë me ata krijoni një grup në një pjesë të klasës.

Lëviz lirshëm nëpër klasë, vetëm bën “BLUP-BLUP” dhe asgjë tjetër! Pëllëmbët i ke në qafë, me gishtat e mëdhenj të duarve përjashta, të cilët i lëviz me një ritëm të rregullt Aktron se je peshk. Përpiqu t’i gjesh ata që janë të ngjashëm me ty. Bashkë me ata krijoni një grup në një pjesë të klasës.

Lëviz lirshëm nëpër klasë, vetëm bën “FLET-FLET” dhe asgjë tjetër! Lëviz me duar sikur të fluturosh. Aktron se je zog. Përpiqu t’i gjesh ata që janë të ngjashëm me ty. Bashkë me ata krijoni një grup në një pjesë të klasës.

Lëviz lirshëm nëpër klasë me duart të ngritura mbi kokë, vetëm bën “MMMMMMM” (sikur mahnitesh) dhe asgjë tjetër! Aktron se je tulipan të cilës i mahniten të gjithë. Përpiqu t’i gjesh ata që janë të ngjashëm me ty. Bashkë me ata krijoni një grup në një pjesë të klasës.

Punëtorja V-3.2: Fjalëkryqi



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit V-3.2: Fjalëkryqi
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Fjalëkryqi

Aktiviteti hyrës

Të gjithë qëndrojnë ulur në rreth. Fëmijët e paramendojnë kafshën e tyre ledhatake dhe, kur jepet shenjë, ata fillojnë të shëtisin nëpër rreth, duke imituar sjellje të kafshës së tyre ledhatake. Por, nuk guxojnë të preken mes vete me qëllim. Pas një kohë të caktuar përsëri mbledhen në rreth dhe tregojnë se cilën kafshë e kanë aktruar dhe pse e kanë aq për zemër atë.

Aktiviteti kryesor

Fëmijët ndahen në grupe me 3-4 anëtarë. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Fjalëkryqi”, të cilin ata duhet ta zgjidhin.



Diskutim

Diskutimi zhvillohet në atë mënyrë që arsimtari kërkon përgjigje nga grupe të ndryshme duke i parashtruar pyetjet një pas një. Pasi të përgjigjen fëmijët, ai parashtron edhe nënpyetje për të gjithë. Pyetjet kanë për qëllim të shpjegojnë ose të japin informacione plotësuese për kafshët e paraqitura në fjalëkryq (A janë të reja disa të dhëna të fjalëkryqit? Pse janë të dobishme ato kafshë? Pse njerëzit ende i zhdukin ato? etj.) Me këtë rast nuk guxojmë të shprehim qëndrime negative ose qëndrime që janë në kundërshtim me ato që janë shprehur në fjalëkryq, si për shembull, se ujqit nuk janë të dobishëm, por janë të dëmshëm – që është një paragjykim shumë i përhapur. Ujqit kanë rëndësi shumë të madhe në natyrë, madje jo vetëm për njerëzit dhe disa lloje të tjera të kafshëve, por edhe për shumë bimë. Me një fjalë për gjithë ekosistemin. Ujqit nuk janë fajtorë që njerëzit ua dërgojnë atyre prenë në territorin e tyre dhe ua shkatërrojnë prenë e tyre natyrore.

Përfundim

Për shumë kafshë që i shohim çdo ditë në fakt ne dimë shumë pak. Që të mund të ndikojmë në mënyrë aktive në ruajtjen e jetës së gjallë, së pari duhet të njoftohemi me disa informacione themelore dhe të krijojmë qëndrim pozitiv.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në 5 grupe. Secili grup me trupin e tyre duhet t'i shkruajë këto fjalë:

- » TULIP
- » BUF
- » IRIQI
- » URITH
- » BLI

Një shkronjë mund ta bëjnë më shumë fëmijë. Grupeve u jepet kohë që të merren vesh e pastaj një nga një t'i prezantojnë fjalët. Të gjithëve u jepet duartrokitje.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: FJALËKRYQI

¹ L			² M			³ K	O	R	B
E			E			E			
J		⁴ T	R	O	F	T	A		⁵ DH
L			I			R			E
E			M			I			L
K			A						P
			N						R
	⁶ TH	⁷ N	E	G	L	A		⁸ P	A
		E		A				Ë	
⁹ A		P						LL	¹⁰ M
R		Ë						U	J
I		R						M	E
¹¹ U	J	K		¹² RR	Ë	¹³ Q	E	B	U
		A				E		I	M
						N			A
	¹⁴ S	O	K	O	L	I			

Horizontalisht:

- 3- njëri nga zogjtë më inteligjentë, i zi, shumë i dobishëm dhe me çerdhe nëpër drurë
- 4- peshku më i njohur Liqenit të Ohrit – i ndaluar për peshkim
- 6- krijesa shume të vogla, të vyeshe dhe të dashura (në shumës)
- 11- kafshë shumë e dobishme që njerëzit e mbysin pa mëshirë – këndon shumë mirë në hënë dhe jeton në tufë
- 12 - një mace e bukur, e egër, që mund të shihet shumë rrallë
- 14 - një shpend i bukur grabitqar, me shikim shumë të mprehtë (më i vogël se shqiponja) dhe me ngjyrë kafeje

Vertikalisht:

- 1- shpend që e bën çerdhen nëpër shtylla dhe oxhaqe, ndërsa në vjeshtë shkon në jug, në Afrikë
- 2 – endësja më e mirë ndërmjet insekteve, prej së cilës fëmijët frikësohen pa arsye
- 3- një kafshë e shkathtë dhe e bukur që i pëlqen shumë lajthitë
- 5- kafshë që është shumë e dobishme, ndërsa njerëzit e konsiderojnë për të dëmshme dhe dinake
- 7- një gjarpër helmues
- 8- postieri më i mirë ndërmjet zogjve
- 9- një kafshë e madhe dhe e dashur – ha shumë mjaltë dhe miza
- 10 - shpendi më i madh që jeton te ne – është i bardhë dhe jeton pranë ujërave
- 13 - kafshë e zbutur prej njeriut në fillim të historisë

Punëtorja V-3.3: Vesna e madhe e vogël



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Përralla për Vesnën e vogël të madhe
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Lejleku i bardhë

Aktiviteti hyrës

Të gjithë lëvizin lirshëm nëpër klasë. Në një moment të dhënë fillojnë të bëjnë KRE-KRE (bëhen bretkosa). Derisa bëjnë kështu, arsimtarja i thotë një nxënësit që ai të bëhet lejleku. Lejleku ecën ngadalë dhe me krahë të shtrirë përpara duke bërë titur KLLAP-KLLAP dhe duke i ndjekur bretkosat. Çdoherë që ai do ta kapë ndonjë bretkosë, edhe ajo shndërrohet në lejlek, i ndjek bretkosat e tjera. Kur të shndërrohen të gjithë në lejlekë, arsimtarja ua parashtron pyetjen: “Çka bëjmë tash kur nuk ka më ushqim? Të fluturojmë në jug!” dhe kështu me gjeste i fton nxënësit të ulen në karrige.

Aktiviteti kryesor

Arsimtarja e lexon përrallën për Vesnën e vogël të madhe ngadalë, të përgatitur, me zë dhe me dramatizim. Nëse arsimtarja vlerëson se është e nevojshme, përralla mund të lexohet edhe një herë, por më shpejt.



Diskutim

1. A mund ta shpjegojmë shkurtimisht përrallën?
2. Pse përralla quhet “Përralla për Vesnën e vogël të madhe”? Pse quhet “e vogël e madhe”?
3. Çka do të ndodhte me lejlekun nëse Vesna nuk e dërgonte në veteriner?
4. Çka do të bënit ju? Pse?
5. A vlen kjo vetëm për zogjtë?
6. Nëse hasni ju në ndonjë qen të lënduar, a duhet të veproni edhe ju ashtu?
7. Kujt do t’i drejtoheshit ju nëse e shihni ndonjë kafshë të lënduar dhe nëse nuk jeni të sigurt se mund të ballafaqoheni me situatën?

Pas përfundimit të diskutimit, fëmijëve u lexohet teksti i fletës së punës për arsimtarin “Lejleku u bardhë”.

Përfundim

Njerëzit janë lloji i vetëm i kafshëve që në masë aq të madhe ndikon në të gjitha qeniet e tjera të gjalla. Zakonisht ai ndikon në mënyrë negative. Prandaj, çdoherë kur kemi mundësi ta shpëtojmë ndonjë qenie të gjallë që nuk arrin të mbijetojë vetë, është mirë që ne të ndihmojmë aq sa mundemi që të mbahet në jetë bota e gjallë përreth nesh. Që të mund të ndihmohet, megjithatë duhet t’i kemi disa paranjohuri.

Aktiviteti përmbyllës

Nxënësit ndahen në tresha. Në secilin tresh ekzistojnë nga dy ndihmës, ndërsa një fëmijë e ka të lënduar këmbën. Secili tresh do të duhet të kalojë bashkërisht nga njëri në skajin tjetër të klasës ashtu që ndihmësit do t’i ndihmojnë fëmijës së lënduar, që mund të shkelë vetëm në një këmbë, që të arrijë në skajin tjetër të klasës. Arsimtarja siguron atmosferë të sigurt dhe qasje të ndryshme të ndihmës. Nëse ka kohë, rekomandohet që fëmijët t’i provojnë të dyja rolet.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Kjo është përrallë për shoqen time të madhe-të vogël Vesna. Ajo jeton në fshat dhe ka shumë dëshirë të shëtitet nëpër natyrë. Një pasdite nëntori Vesna po shëtitej nëpër fushat e orizit dhe çka të shohë – një LEJLEK! Prej nga doli tash ky lejlek? Vesna i donte shumë kafshët dhe dinte shumë gjëra për to. Ajo e dinte se në këtë rast diçka nuk është në rregull. Atë do ta dinte secili. Në këtë kohë lejlekët janë në Afrikë.

Ajo filloi t'i afrohet lejlekut. Kur i erdhi afër vetëm dhjetë metra, lejleku filloi të ikë nga ajo. Si afrohej Vesna afër tij, edhe lejleku e shpejtonte hapin, por nuk fluturoi as kur ajo iu afrua vetëm dy metra. Atëherë filloi të përpëlitet me flatra. Atëherë Vesna e kuptoi se çka është puna. Njëri krah i lejlekut ishte i lënduar. Prandaj Vesna vrapoi me guxim drejt tij, por besoni se iu deshën katër-pesë rrathë rreth drurit të madh që të lodhen mirë. Fatmirësisht që lejleku u lodh i pari.

Kur e kapi ajo, lejleku filloi ta lëkundë sqepin dhe të bëjë kllap-kllap-kllap – e dini më si bëjnë lejlekët. Vesna u frikësua të mos mbetet pa hundë. Por, Vesna jonë është e gjindshme dhe e ndjeshme. Këtë e ka mësuar nga shëtitjet në natyrë. E nxori shpejt shtrënguesin nga flokët dhe ia lidhi sqepin lejlekut. Pastaj e kapi nën sqetulla dhe u nis drejt ambulancës më afërt të veterinarisë. Të gjithë e shikonin me habi.

Veterinerët i thanë se ai lejlek e kishte të lënduar njërin krah dhe plagën e kishte të infektuar. Pastaj ia pastruan plagën, ia lidhën krahun dhe ia dhanë Vesnës një sprej që lejlekun ta shërojë në kushte shtëpiake. Atë lejlek pastaj të gjithë e ushqenin së bashku. Edhe të rriturit, edhe shokët e saj, edhe fqinjët, edhe fëmijët e shkollës. I jepni peshq nga shitorja e peshqe.

Pastaj u kujtuan të paraqiten në kopshtin zoologjik. Atje u thanë se kanë shumë dëshirë ta kenë një lejlek. Dhe, kështu lejleku arriti në kopshtin zoologjik, ku kishte mjaft hapësirë për të shëtitur dhe shoqëri nga disa lejlekë të tjerë të lënduar, që ishin vendosur në kafaze se edhe ashtu nuk të fluturonin më. Por, edhe nuk e kishin fort keq. Sikur të ishin në natyrë, mbase do ta pësonin më keq. Ju ndoshta edhe e keni parë lejlekun e Vesnës atje.

Prej atëherë Vesna është shumë krenare. Për veprën e bërë ata të kopshtit zoologjik ia dhanë një mirënjohje të madhe të gjelbër. Një mirënjohje e tillë e shkruar me shkronja të mëdha është vendosur edhe në hyrje të kopshtit zoologjik, aty ku shiten biletat. “Mirënjohje për meritat e veçanta për kujdesin e shfaqur ndaj botës së gjallë.” – shkruan aty. Ajo u lavdërua edhe para të gjithë nxënësve. Ndërsa kur ishte në televizion dhe e pyetën se çka e kishte shtyrë ta shpëtojë lejlekun, ajo u përgjigj thjesht: “Po çka mund të bëja tjetër? Çka do të bënit ju në vendin tim?”

(përralla bazohet në ngjarje të vërtetë, ndërsa është marrë nga një forum interneti)

Lejleku i bardhë është një zog të cilin fatkeqësisht gjithnjë e më pak e shohim në hapësirat tona. Lejleku i bardhë ka qenë gjithmonë i pranishëm në Maqedoni, por sot numri i lejlekëve është gjithnjë e më i vogël. Kështu nga 2550 çerdhet e evidentuara në vitin 1959, nga të cilat gjysma kanë qenë me lejlekë të rinj, sot kemi një rënie të jashtëzakonshme – më shumë se gjysma janë zhdukur. Deri në vitin 1958 në Maqedoni lejlekët e bardhë i rrisnin mbi 3500 lejlekë të vegjël në vit, ndërsa sot numri i tyre është 3-4 herë më i vogël. Ky shpend është jashtëzakonisht i lidhur me njerëzit dhe zakonisht jetën në afërsi të tyre. Për dallim prej shpezëve të tjera të egra, lejleku i bardhë nuk frikësohet nga njeriu, që e rrit edhe më shumë përgjegjësinë për sjelljen tonë ndaj tyre. Shumohet në trevat tona, kah fundi i marsit, pas kthimit nga Afrika. Lejleku zakonisht kthehet në çerdhen e vet të vjetër.

Zvogëlimi i popullatës së lejlekëve bazohet në shkaqet e shumta, siç janë: zhdukja e moçaleve të vjetra, rrënimi i shtëpive të vjetra nëpër fshatra dhe lagje ku lejlekët më së shpeshti i ndërtojnë çerdhet e tyre, zvogëlimi i ushqimit, por edhe ndotja e burimeve të mbetura.

Që të mbrohet lejleku i bardhë, duhet të ndërmerren masa urgjente, si për shembull, të mos lejohet rrënimi i objekteve ose prerja e drurëve me çerdhe lejlekësh ose, së paku, çerdhja e tyre të zhvendoset në një shtrat sa më të afërt të fortë.

Punëtorja V-3.4: Bondrithja dhe Barishti



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Bondrithja dhe Barishti, hap pas hapi
- » farë bari
- » grurë, elb, thekër, tërshërë
- » disa palë çorapësh/hulahopkash të vjetra të grave
- » pluhuri i sharrës së drurëve
- » rërë (sa dy filxhanë)
- » dhe (sa dy filxhanë)
- » një enë, një legen, një kuti këpucësh ose një kovë
- » kapakë të shisheve të plastikës
- » ngjitës
- » gërrshërë
- » ngjyra (markerë, flomasterë ose kolazh letre)
- » litar i hollë, tërkuzë e trashë ose diçka të ngjashme
- » kuti plastike e thellë rreth 4-6 cm dhe me diametër prej së paku 10 cm

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në 4-5 grupe. Ato grupe bëjnë “kukulla” të gjalla që do t’i quajnë Barishti dhe Bondrithja – bëhen duke vendosur fara në bazën në të cilën ata do të mbijnë shpejt dhe do t’u rriten flokët si të kukullave që ata i bëjnë.

“Kukullat” do të bëhen hap pas hapi, sipas udhëzimeve që i jep arsimtari nga fleta e punës së arsimtarit/arsimtares Bondrithja dhe Barishti:



Diskutim

1. Si do ta sigurojmë rritje të Barishtëve dhe Bodritheve tona? Kush do të kujdeset për to?
2. Nëse nuk i ujisim ose i largojmë nga dielli, çka do të ndodhë me ato?
3. A do të kenë jetë të gjatë njësoj Barishtët dhe Bondrithet tona si ato që janë mbjellë drejt në tokë? Pse? (jo, do të mbijetojnë 1-2 javë, nuk kanë sa duhet dhe)
4. Pse janë të rëndësishme bimët për ne? (ajri i pastër, ushqimi...)
5. Si do të dukej bota pa bimë?
6. Ku do të përfundonin këto materiale nëse nuk do t’i përdornim ne? (çorapet, kapakët, saksitë)

Përfundim

Bimët kanë nevojë për tokë, për dritë dhe për ujë që të mund të rriten. Bimëve në ambientin që na rrethon, në veçanti atyre bimëve që i mbikëqyrë njeriu, u duhet kujdes dhe trajtim i veçantë nga njerëzit. Baza e gjithë jetës së gjallë në tokë janë bimët. Vetëm bimët mund të krijojnë nga materia e vdekur – mineralet, të prodhojnë diçka që të tjerët mund ta përdorin si energji/ushqim. Vetëm bimë janë përgjegjëse për sasinë e oksigjenit në atmosferë. Pa bimë nuk ka jetë.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Nxënësve u thuhet se në laboratorë të ndryshëm eksperimentalë është dëshmuar se nëse në ndonjë bimë shprehen mendime dhe ndjenja të mira, bima rritet më shpejt dhe më bukur sesa ndonjë bimë mbi të cilën janë shprehur mendime dhe emocione negative, bërtitje dhe ofendime. Nxënësit ftohen që në grupe në afat prej tre minutash kukullave të tyre Bondrithja/Barishti t’u shprehin komplimente pozitive dhe t’u tregojnë se si do të rriten me stoli të bukura.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

1. Merren disa grushte pluhur sharre.
2. Mbetja e pluhurit të sharrës, rëra dhe dheu përzihen në një kuti.
3. Secilit grup i jepet nga një copë nga najloni i çorapeve. Njëri skaj i çorapeve duhet të jetë i mbyllur (ose është pjesa e thembrës, që është e mbyllur vetë ose e mbyllim me të lidhur në njërin skaj që është i hapur). Kështu çorapen e përgatitur e shtrijmë në tavolinë.
4. Merret një grusht nga një lloj i farave (fara të barit, të grurit etj.) me zgjedhje të lirë dhe vendoset në çorap dhe aty shpërndahet mirë.
5. Nëpër fara me shumë kujdes, pa u derdhur renditja e tyre, vendosen disa grushte nga pluhuri i pastër i sharrës.
6. Pastaj shtohet përzierja e rërës së dheut dhe pluhurit të sharrës derisa të mbushet copa e çorapit – aq sa të mbetet një pjesë që mund të lidhet. Gjatë kësaj duhet të kemi kujdes të mbahet mend se në cilën anë është vendosur fara.
7. Nga kapakët mund të bëhen sy dhe hundë ose veshë në mënyra të ndryshme. Është me rëndësi të futen nën çorapin e mbushur. Megjithatë duhet të kihet kujdes që çorapi mos të shqyhet.
8. Lidhet ana e hapur e çorapit. Është me rëndësi që lidhja të jetë e sigurt dhe e fortë.
9. Secila figurë vendoset në një kuti plastike që është parashikuar të jetë si bazë. Nëse ka kohë, edhe ato mund të stolisen.
10. Në atë bazë derdhet ujë. Në fakt ujë duhet t'i qesim sa herë që shihet se niveli i ujit në bazë ka rënë për një centimetër.
11. Barishtët dhe Bondrithjet vendosen në vend të sigurt, të ngrohtë dhe të ndritshëm.
12. Nëse gjithçka ka qenë në rregull, pritet që ato për disa ditë të mbijnë.

Punëtorja V-3.5: Ushqimoret e fluturave



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Ushqimore për flutura.
- » gota plastike të përdorura të jogurtit, kosit etj.
- » litar i hollë ose tërkuzë më e trashë
- » pambuk
- » gota plastike të përdorura me ngjyra themelore intensive, ambalazh tjetër me ngjyra themelore, i cili mund të pritët me gërshtë
- » ngjitës për plastikë
- » gërshtë
- » sheqer (së paku 200-300 gramë)
- » ujë
- » një shishe plastike prej 1,5 litrash

Aktiviteti kryesor

Fëmijët bëjnë ushqimore për flutura (më së miri është të bëhet në pranverën e vonshme, në maj ose në qershor). Arsimtarja u jep udhëzime nga fleta e punës dhe u ndihmon t'i zbatojnë aktivitetet e kërkuara.



Diskutim

1. Në cilin lloj të kafshëve bëjnë pjesë fluturat?
2. A e dini se si ushqehen ato dhe me çka? (me nektarin e bimëve, me përzierje të sheqerit dhe ujit).
3. A keni ditur deri tash se njerëzit mund t'i ushqejnë fluturat?
4. Cilat insekte të tjera mund t'i tërheqin këto ushqimore?
5. Si ndjeheni kur mund t'u ndihmoni qenieve të tjera?
6. Pse është me rëndësi kjo?
7. Cilave kafshë të tjera mund t'u ndihmohet në ushqim? Si?
8. A është me rëndësi që njerëzit t'u ndihmojnë kafshëve në ushqim? Pse?
9. Ku do të përfundonin këto materiale nëse nuk bënim diçka të dobishme prej tyre, nëse nuk i përdornim?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Me mënyrën e tij të jetës njeriu çdo ditë dhe vazhdimisht ua merr resurset themelore shumë llojeve të bimëve dhe të kafshëve. Si pjesë e zinxhirit ushqimor, edhe pse edhe ai është i varur nga llojet bimore dhe shtazore, njeriu patjetër duhet të mbajë llogari dhe t'u ndihmojë kafshëve dhe bimëve në çdo rast të mundshëm. Veçanërisht është me rëndësi të ridedikohen materialet, që nëse nuk ua zbulojmë ndonjë funksion, do të përfundojnë si mbeturina dhe do ta ndotin mjedisin.

1. Në një gotë plastikë bëhen pesë vrima. Katër prej tyre vihen në pjesën e sipërme, afër hapjes, në distancë thuaja të njëjtë, që aty të mund të futen penjtë e ushqimeve që do të varen aty. Vrima e pestë bëhet në mesin e bazës së gotës. Është me rëndësi që vrima në bazë të jetë me madhësi 3-4 milimetra.
2. Në vrimat e sipërme futen katër pjesët e penjve, ndërsa pjesët që mbeten në gotë lidhen nyjë, që të mos mund të tërhiqen lidhëset. Mbi gotë, lidhëset bashkohen në një vend, në një nyje, që ushqimorja të mund të varet në diçka.
3. Nga qeset e larme priten disa forma që duken si lule dhe ngjiten në pjesët e poshtme të gotës. Duhet të kemi kujdes që vrima të mos mbulohet.
4. Nëpër vrimën e bazës së gotës, në pjesën e brendshme, futet pambuku. Ky pambuk duhet të dalë jashtë vrimës, përafërsisht sa një thonj i gishtit të madh të njeriut të rritur. Brenda duhet të mbetet së paku 3-4 herë më shumë vëllim i pambukut.
5. Në një shishe plastike sheqeri tretet në ujë. Mund të përdoret ujë i ngrohtë dhe shishja e mbyllur të shkundet mirë.
6. Ushqimoret vendosen në ndonjë degë druri ose në diçka ku mund të varen.
7. Në to derdhet pak ujë prej sheqerit të tretur, në lartësi prej 2-3 cm.
8. Pritet të vijnë fluturat.

Nëse është e mundur të kombinohet që ushqimoret të vendosen në oborrin e shkollës në atë mënyrë që të shihet efekti i tyre aty, kjo do të ishte mënyra më efikase. Nëse ka kushte, fëmijët bëjnë ushqimore që do t'i marrin në shtëpi.

Punëtorja V-3.6: Ushqimore për shpezë

Përgatitja paraprake

Kërkoni nga fëmijët që dikush prej tyre të ndihmojë në furnizimin me këto materiale dhe ato t'i sjellë në orë, përveç skalpelit ose thikës që i sjell arsimtari dhe ai i përdor ato. Është me rëndësi të thuhet se fëmijët asgjë nuk duhet të blejnë, por duhet të sjellin vetëm çka kanë në shtëpi.



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Ushqimore për shpezë
- » shishe plastike, sa më të mëdha
- » litar i hollë dhe tërkuzë e trashë
- » skalpel ose thikë që pret mirë
- » fara të ndryshme (grurë, elb, thekër, luledielli, mel, fara kungulli.... ushqim special për shpezë)
- » pemë të ndryshme: molla, dardha, kumbulla të thata, fiq të thatë etj.
- » bukë të moçme, yndyrë gjedhi, margarinë (nëse mund të gjendet)
- » një enë ku mund të përzihet farat dhe pemët.

Aktiviteti kryesor

Fëmijët bëjnë ushqimore për shpezë (më së miri është të bëhet në vjeshtën e vonë ose në dimër). Arsimtari ua jep udhëzimet e fletës së punës dhe u ndihmon në zbatimin e aktiviteteve të kërkuara.



Diskutim

1. Si dhe me çka ushqehet shpezët që mbeten te ne edhe dimrit?
2. A është njësoj lehtë të gjendet ushqim edhe në dimër?
3. A do të ishte e dobishme ndihma jonë që ato të gjejnë ushqim?
4. A e keni ditur deri tash se njerëzit mund t'i ushqejnë shpezët?
5. Çka mendoni, si do të na falënderohen shpezët? Pse?
6. A duhet t'u ndihmojnë njerëzit kafshëve kur ato janë të rrezikuara? Pse?
7. Cilave kafshë të tjera mund t'u ndihmojmë? Si?
8. Çka do të ndodhte me këto materiale nëse nuk ua gjenim vendin e ri për përdorim?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

Me mënyrën e tij të jetës njeriu çdo ditë dhe vazhdimisht ua merr resurset themelore shumë llojeve të bimëve dhe të kafshëve. Si pjesë e zinxhirit ushqimor, edhe pse edhe ai është i varur nga llojet bimore dhe shtazore, njeriu patjetër duhet të mbajë llogari dhe t'u ndihmojë kafshëve dhe bimëve në çdo rast të mundshëm. Një numër i madh i shpezëve në dimër shumë vështirë gjejnë ushqim ose së paku nuk gjejnë ushqim cilësor. Shumë zogj që verës ushqehen me ushqime bimore, do t'u vinte shumë mirë nëse që dimrit të ushqehen me ushqim proteinik/yndyror me burim shtazor. Yndyrat u ndihmojnë në ruajtjen e temperaturës së trupit.

1. Kërkohen dy fëmijë vullnetarë që do të bëjnë diçka të ndryshme nga të tjerët. Arsimtari ua tregon para të gjithëve të gjitha gjërat që duhet t'i bëjnë ata fëmijë, që ata të kenë qasje më të mirë.
2. Dy fëmijët në enën për përzierje do t'i përziejnë të gjitha farat bashkë me yndyrën. Nëse përdoret bukë e moçme, së pari duhet të pastrohet tuli i bukës dhe të copëtohet në copëza të vogla, të përziehet me pak ujë dhe të bëhet si brumë. Pastaj shtohet korja e bukës, e imtësuar sa më shumë. Vihen edhe farat dhe bashkë përziehen në një masë kompakte. Kur të përfundojë kjo, fëmijët i lajnë duart dhe u bashkohen grupeve të tjera që tashmë janë duke punuar.
3. Fëmijët e tjerë ndahen në disa grupe. Ashtu grup pas grupi ata vijnë te arsimtari, ndërsa ai me skalpel i pret dy copa të shishes nga mesi i saj. Në pjesën e mesme të shishes mbeten vetëm dy "vija" që e mbajnë bazën e shishes të mos bie, ndërsa gjithçka tjetër pritet që shpezët të mund të vijnë. (të gjitha ngjitëset dhe aplikacionet e shisheve mënjanohej.)
4. Peri me gjatësi prej së paku 70 centimetrash deri në një metër futet nëpër fytin e shishes, lëshohet në bazën e saj derisa nuk mblidhet pak pe në bazën e saj.
5. Shishja mbyllet mirë me kapak përmes perit – kapaku e luan rolin e mbajtësit të perit. Kështu fitohet diçka që ushqimorja të mund të varet.
6. Në pjesën e perit që e prek bazën e shishes bëhet disa nyje, që s'është patjetër të forcohen, por është me rëndësi të jenë të mëdha.
7. Përreth nyjave vihet ushqimi i përzier për shpezë.
8. Ushqimoret vendosen në degë druri, në një vend që nuk mund të arrihen lehtë për macet ose njerëzit, por që arrihen lehtë për shpezët.
9. Pritet të vijnë shpezët dhe të falënderohen për ushqimin.

Përmbajtja V-4: PËRMIRËSIMI, MIRËMBAJTJA DHE STOLISJA E MJEDISIT

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» ta dijë rëndësinë e mjedisit që mirëmbahet mirë » ta dijë çka duhet të bëhet që të krijohet, të përmirësohet, të mirëmbahet dhe stoliset mjedisi jonë (dhoma, banesa, klasa, shkolla, oborri...)
Shkathtësi	» të mund të përdorë sende dhe pajisje të ndryshme për zbukurimin e hapësirës » të mund të marrë pjesë në formësimin estetik dhe organizimin e hapësirës së shkollës
Qëndrime/vlera	» të pranojë se secili duhet të kontribuojë në mirëmbajtjen dhe zbukurimin e hapësirës në mjedisin e tij (mjedisin kolektiv dhe imazhin personal) » të pranojë se njerëzit kanë shije të ndryshme për rregullimin dhe zbukurimin e hapësirës

Punëtorja V-4.1: Klasa jonë



Materialet:

- » fletë pune për nxënësit V-4.1a: Dhoma ime
- » fletë pune për nxënësit V-4.1b: Klasa jonë
- » pajisje për të shkruar

Aktiviteti hyrës

Të gjithë fëmijët, përveç dy vullnetarëve, qëndrojnë në rreth. Në rrethin e parë të prezantimit secili fëmijë duhet të dalë një hap para dhe të tregojë se cila ngjyrë i pëlqen më shumë. Të dy vullnetarët e kanë për detyrë të shkruajnë se sa herë është përmendur secila ngjyrë (njëri shkruan, ndërsa tjetri kujdeset që mos të ikë diçka). Në rrethin e dytë të prezantimit po ashtu përsëritet kjo procedurë, por kësaj radhe tregohet ngjyra që më së paku u pëlqen, ndërsa vullnetarët përsëri mbajnë evidencë.

Aktiviteti kryesor 1

Fëmijët ndahen në grupe me 4-6 vetë. Gjysmës së grupeve u jepen kartela të njërës fletë të punës, ndërsa gjysmës tjetër i jepen kartela nga fleta tjetër e punës. Grupet që e kanë për detyrë ta rregullojnë dhomën e tyre, duhet të përgjigjen në pyetjen “Sikur të keni dhomë tuajën, si do ta rregullonit?”, ndërsa të tjerët duhet të përgjigjen në pyetjen “Si është më mirë të jetë e rregulluar klasa jonë?”.

Grupet e kanë për detyrë t’i radhitin kartelat sipas rëndësisë në formë diamanti:

1. Rendi i parë – një kartelë që është më e rëndësishme
2. Rendi i dytë – dy kartela shumë rëndësishme
3. Rendi i tretë – tre kartela mesatarisht të rëndësishme
4. Rendi i katërt – dy kartela më pak të rëndësishme
5. Rendi i pestë – një kartelë më pak e rëndësishme

Grupeve u jepen nga tre kartela të zbrazëta në të cilat ata mund të shkruajnë gjëra plotësuese dhe t’i vendosin në diamantin e dëshiruar.

Pas 5-10 minutave secili grup tregon se cilën kartelë e kanë vendosur si më të rëndësishme, e cilën si më pak të rëndësishme, duke dhënë edhe shpjegime për atë zgjedhje. Pastaj i prezantojnë gjërat që i kanë shënuar në kartelat e zbrazëta dhe tregojnë se ku i kanë vendosur. Me këtë rast nuk është aspak me rëndësi se si i kanë radhitur kartelat – nuk ka përgjigje të saktë.



Diskutim 1

1. A e kishit lehtë të vendosnit se çka është më e rëndësishme, e çka është më pak e rëndësishme për rregullimin hapësirës që konsiderohet si e juaja?
2. Çka është ajo që më shumti kontribuon për rregullimin dhe bukurinë e hapësirës në të cilën e kaloni kohën?
3. Si ndjeheni në hapësirë të rregulluar, e si ndjeheni në hapësirë të parregulluar? Pse?
4. Ku është më mirë të luhet? Ku mësohet më lehtë?
5. Çka mund të bëjnë fëmijët e moshës suaj që këndi i tyre të jetë i rregulluar dhe i bukur? Si?

Aktiviteti kryesor 2

Arsimtarja i fton fëmijët, e pastaj edhe vetë inkuadrohet, që ta shikojnë klasën mirë dhe në 5-10 minutat e ardhshme të përpiqen ta bëjnë edhe më të rregulluar. Mund t’i rregullojnë fletoret, librat, jaknet, mund t’i mbledhin mbeturinat, t’i drejtojnë fotografitë e shtrembëruara, pastaj aplikacionet, kartelat, mjetet mbikëqyrëse etj., t’i ngjisin kolazhet e rena, pllakatet etj.

Përfundim

Vetë ne jemi përgjegjës për rregullimin dhe pastrimin e hapësirës në të cilën qëndrojmë. Shumë shpesh mjafton të bëhet një rregullim i vogël i gjërave në hapësirë që kështu të shihet dallimi. Në një hapësirë në të cilën gjithçka është e rregulluar dhe në vendin vet, njerëzit zakonisht ndjehen më mirë dhe janë më efikas. Fëmijët mund propozojnë zgjidhje ose afinitete, të ndihmojnë dhe ta rregullojnë hapësirën në të cilën e kalojnë kohën e tyre.



Diskutim 2

1. A duket tash klasa më ndryshe? Si?
2. A është më e bukur më e shëmtuar? Pse?
3. Kush është përgjegjës për rregullimin e klasës?

Përfundim

Për shumë njerëz hapësira e rregulluar është më e mirë për të qëndruar aty. Zakonisht vlerësohet si “e bukur” për arsye praktike (e dimë ku i kemi gjërat), por edhe për arsye subjektive. Ajo është përgjegjësi e të gjithëve që e kalojnë kohën aty.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Nxënësit ndahen në tresha. Secili anëtar i treshit duhet t’ua tregojë dy anëtarëve të tjerë të treshit së paku nga një gjë që do të fillojë ta bëjë prej sot që ashtu të kontribuojë për zbulimin e hapësirës në të cilën qëndron: në shtëpi, në këndin personal ose në klasë. Kur të mbarojnë të gjithë, jepet një duartrokitje e fuqishme.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja V-5: MBROJTJA E PLANETIT TOKË

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	» t'i dijë ndotësit më të shpeshtë të ajrit, të ujit dhe të tokës » t'i dijë pasojat më të shpeshta nga ndotja e ujit, ajrit dhe tokës nga njerëzit dhe qeniet e tjera të gjalla. » t'i dijë mënyrat e ndryshme për racionalizimin e përdorimit të ujit dhe të energjisë elektrike.
Shkathtësi	» të mund të tërheqë vërejtjen ndaj përdorimit joracional të ujit dhe të energjisë elektrike. » të mund t'i identifikojë prodhimet me shenjë ekologjike që nuk janë të dëmshme për natyrën.
Qëndrime/vlera	» ta dijë se uji i pijshëm dhe resurset e tjera natyrore nuk janë burim i pashtershëm. » ta kuptojë përgjegjësinë e njeriut për mbrojtjen e mjedisit jetësor. » ta kuptojë se duhet të kufizohet përdorimi i teknologjive ndotëse (sprejet, freonet...).

Punëtorja V-5.1: Shëtitja e gjelbër-ndotësmetri



Materialet:

- » dy fleta të punës në të cilët me shkronja të mëdha shkruan “SAKTË” dhe “GABIM”.
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Barometri i gjelbër

Aktiviteti kryesor

Në dy skajet e kundërta të klasës ngjiten fletat në të cilat shkruan “SAKTË” dhe “GABIM”. Pastaj nxënësve u thuhet se arsimtari do t’i lexojë disa pohime, ndërsa ata sipas asaj që e mendojnë se është pohimi (saktë/gabim) do të duhet të pozicionohen në një pjesë të caktuar të klasës.

Pasi të pozicionohen, do të duhet të shpjegojnë se pse mendojnë ashtu. Të gjithë lexojnë pyetje nga fleta e punës së arsimtarit “Barometri i gjelbër”.



Diskutim

1. Cilat gjëra e ndotin tokën?
2. E kush janë ndotësit e ajrit?
3. Cilat ndotës të ujit i njihni?
4. Çka nënkuptoni me nocionin “ndotja e dritës”?
5. E çka është “ndotja e zërit”? Çka nënkuptoni me të?
6. Kush i pëson pasojat e ndotjes?
7. Si mund të kontribuojë secili prej nesh në zvogëlimin e ndotjes?



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përfundim

“Përparimi” teknologjik i qytetërimit të sotëm në fakt është maksimalisht destruktiv për mjedisin dhe për ardhmërinë e gjithë planetit, i cili ngadalë po shndërrohet në një deponi të madhe. Ne gjithkund jemi të rrethuar nga plastika dhe ambalazh që është për një përdorim dhe i cili pastaj si mbeturinë që nuk shkatërrohet vetvetiu ndikon keq për mjedisin dhe për shëndetin e jetës së gjallë. Veturat, fabrikat dhe aparatet e amvisërisë janë ndotësit kryesorë të ajrit. Toka ndotet nga kimikatet që “gjoja” ndihmojnë për zhvillimin më të mirë të kulturave, ndërsa ujërat ndoten si nga fabrikat, po ashtu edhe nga mbeturinat organike dhe nga pajisjet për “higjienë”. Ekzistojnë disa lloje të ndotjes për të cilat ende flitet shumë pak, siç janë ndotja e dritës dhe ndotja e zërit, që kanë efekte të dëmshme ndaj jetës së gjallë dhe shëndetit të njerëzve. Ndriçimi në mjediset urbane, si dritat e rrugëve, reklamat dhe veturat edhe natën e shndërrojnë në ditë. Kjo e pamundëson mënyrën natyrore të jetës së disa qenieve të natës, por edhe njerëzve ua shkurton shikimin kah qielli me plot yje. Ndotja e zërit e nënkupton gjendjen e mjediseve urbane që janë shumë më të zhurmshme se të gjitha makinat që përdoren. Këto zhurma të fuqishme më së paku ndikojnë për shqetësimin e njeriut, ndërsa disa shkencëtarë konsiderojnë se kanë ndikim të madh edhe në zhvillimin e sëmundjeve. Secili prej nesh mund të bëjë një ndryshim, duke pasur kujdes se a janë ndotëse gjërat që ai i përdor dhe deri në çfarë mase ndotin ato.

- **Përdorimi i dezodoranseve dhe sprejeve të tjera nuk ndikon ndaj mjedisit jetësor**

GABIM – shumë shpesh të gjitha enët nën trysni në freonëve – gazra që e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit.

- **Makinat që punojnë me gaz e ndotin më pak ajrin se makinat që punojnë me naftë dhe me benzinë.**

SAKTË - kur digjet, gazi ka emetim më të paktë të materieve të dëmshme.

- **Aparatet e klimës nuk janë të dëmshme për mjedisin.**

GABIM – përdorin freone në sasi të mëdha dhe harxhojnë shumë energjie elektrike, e cila fitohet në procese “të ndyta”, gjegjësisht në mënyrë që e ndot ambientin.

- **Përdorimi i detergjenteve për larje ndikon dëmshëm ndaj mjedisit.**

SAKTË – i ndot ujërat; nuk ekziston pajisje për larje që nuk ndot.

- **Përdorimi i plehut artificial në ara nuk e ndot tokën.**

GABIM – disa plehra artificialë mbeten në tokë deri në 50 vite.

- **Futja në tokë e materialit plastik është mënyra më e mirë që ai të shkatërrohet.**

GABIM – plastika edhe ashtu shumë ngadalë, me disa mijëra vite, shkatërrohet vetëm nga ndikimi i rrezeve ultravjollce dhe diellit; nëse është nën tokë, praktikisht kurrë nuk do të shkatërrohet.

- **Vozitja në autobus kontribuon për ndotjen më të vogël të ajrit se vozitja me veturë.**

SAKTË – autobusët njëherazi transportojë udhëtarë dhe nuk është patjetër të përdoren aq shumë edhe veturat, sepse ato edhe ashtu mund të transportojnë më pak udhëtarë.

- **Spërkatja kundër mushkonjave ndikon keq jo vetëm ndaj insekteve të tjera, por edhe ndaj bimëve, njerëzve, ujit dhe tokës.**

SAKTË – i vret shumë insekte të tjera, i helmon bimët dhe ujin dhe mbetet në tokë.

- **Derdhja e ujërave të kanalizimeve në lumenj dhe liqene është e dëmshme për peshqit dhe qeniet e tjera të gjalla që jetojnë aty.**

SAKTË – bashkë me ujërat e zeza, në lumenj dhe liqene derdhen edhe kimikate që e ndryshojnë strukturën biologjike dhe kimike të atyre ujërave.

- **Tymi i fabrikave e ndot ajrin, por edhe tokën.**

GABIM – ajri i ndotur i fabrikave që mblidhet në atmosferë pastaj kthehet në formë të shirave acidikë dhe e ndot tokën.

- **Përdorimi i energjisë diellore është i dëmshëm për mjedisin.**

GABIM – deri tash nuk dihet ndonjë efekt i dëmshëm nga përdorimi i energjisë diellore.

- **Kur stërpiken pemët që të mbrohen nga insektet kështu shkaktohen dëme edhe për njerëzit.**

SAKTË – të gjitha pajisjet artificiale që përdoren në bujqësi thithen nga pemët dhe perimet dhe nga njeriu përmes ushqimit. Disa prej tyre janë shumë të dëmshme.

- **Një pjesë e madhe e njerëzve shkaktojnë ndotje nga mosdija.**

SAKTË – shumë njerëz edhe nuk e dinë për shumë burime të ndotjes.

- **Mbrojtja e mjedisit është detyrim i secilit prej nesh.**

SAKTË – secili prej nesh më shumë ose më pak ndikon ndaj mjedisit jetësor; secili mund të bëjë një ndryshim nëse i përdor me vetëdije ose nëse i shmang gjërat që ndikojnë negativisht ndaj mjedisit.

Punëtorja V-5.2: Teknologjia = ndotja?



Materialet:

- » fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Ndotësit
- » revista të vjetra
- » gërshërë
- » ngjithës
- » fleta të mëdha/hamerë

Aktiviteti hyrës

Secili fëmijë duhet të kalojë rreth dy metra me revistë/gazetë mbi kokë, pa mos e mbajtur me dorë dhe pa i rënë fare.

Aktiviteti kryesor

Nxënësit ndahen në tre grupe. Ata do të duhet t'i ndajnë nga revistat së paku dhjetë burime të ndotjes të dhe të bëjnë ndonjë pllakat/kolazh me të cilin do të përcjellin ndonjë porosi. Secilit grup i jepet detyrë tjetër. Këto detyra i marrin nga fleta e punës për arsimtarin/arsimtaren "Ndotësit".

Pastaj grupet prezantohen.



Diskutim

1. Cilat janë ndotësit kryesorë të ajrit?
2. Cilët janë ndotësit më të mëdhenj të ujit?
3. Cilët janë ndotësit kryesorë të tokës?
4. A është në dobi apo në dëm të njeriut përdorimi i këtyre teknologjive dhe pajisjeve? Si dhe pse?
5. Çka mund të bëhet?
6. Çka mund të bëjë secili prej nesh në jetën e përditshme?

Përfundim

Në kapitalizmin bashkëkohor me orientim drejt konsumit njerëzit shumë rrallë i dinë/i ndejnë pasojat negative të produkteve që i përdorin. Janë këtu pasojat e tmerrshme dhe të drejtpërdrejta ndaj shëndetit të njeriut, që nga pesticidet e deri te dëmi ndaj mjedisit nga pajisjet klimatike. Që të mund të ndikohet ndaj shkatërrimit të gjithë eko-sistemit të planetit, është me rëndësi thelbësore të kihen sa më shumë informacione. Secili mund të kontribuojë edhe me ndryshimet më të vogla të sjelljes së tij që ashtu ta mbrojë planetin. Ndotësit më të mëdhenj të ajrit janë veturat, industria dhe, kohëve të fundit, gjithnjë e më shumë po flitet edhe për kafshët që mbahen në ferma, si dhe për gazet që lirohen prej tyre. Shumë të rëndësishëm e pak të përmendur janë edhe gazet që përdoren në dezoderanse, në pajisjet klimatike – freonet etj. Uji ndotet nga fabrikat, por edhe nga secila amvisëri përmes pluhurit të ndryshëm, detergjenteve, pajisjeve për pastrim, mbeturinave që hidhen në lumenj e liqene etj. Toka ndotet nga pesticidet, nga plehrat e ndryshëm, por edhe nga kulturat e njëlllojta të bimëve që vetëm përdoren, ndërsa nuk e ripërtërijnë cilësinë e tokës, të gjitha kimikatet që përdoren në amvisëri, që gjenden nëpër deponi etj.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë lëvizin lirshëm nëpër rreth. Secili fëmijë do të duhet të ecë rreth dy metra sikur ka mbi kokë një libër dhe ai përpiqet që të mos i bie.



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Ndotësit



- » Zbuloni dhe përmendni ndotësit kryesorë të ajrit!
Shkruani se si e ndotin ata ajrin!

-
- » Zbuloni dhe përmendni ndotësit kryesorë të ujit!
Shkruani se si e ndotin ata ujin!

-
- » Zbuloni dhe përmendni ndotësit kryesorë të tokës!
Shkruani se si e ndotin ata tokën!

Punëtorja V-5.3: Uji



Materialet:

- » letër, stilolapsa, lapsa
- » fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Një mëngjes i pakëndshëm
- » fletë pune për nxënësit V-5.3: Këshilla për përdorimin më racional të ujit

Aktiviteti hyrës

Fëmijët radhiten në dy vija paralele të kthyer me fytyrë kah njëri-tjetri, duke formuar kështu një shtrat lumi. Një fëmijë nga njëri skaj fillon të lëvizë nëpër “shtrat” në fillim më ngadalë, e më pas gjithnjë e më shpejt e më shpejt, suke e simuluar rrjedhjen e ujit. Kur të arrijë në fund, ndalet në radhë, ndërsa fëmija tjetër përballë tij e përsërit këtë veprim. Kjo përsëritet derisa të gjithë fëmijët nuk kalojnë nëpër “shtratin e lumit”.

Aktiviteti kryesor¹

Nxënësve u lexohet teksti i pajisjes së punës për arsimtarin “Një mëngjes i pakëndshëm”

Fëmijët ndahen në grupe të vogla. Në ato grupe ata do të duhet të paramendojnë se ata janë fshatarë që duhet të marrin vendim se a do të shpërngulen në ndonjë vend tjetër. Vendimin duhet ta marrin pasi të zbulojnë dhe të ofrojnë mënyra sesi të kursehet uji, që fshati të mund të jetojë dhe të mbijetojë me sasi të kufizuara të ujit.

Pas dhjetë minutash punë grupet e prezantojnë atë që e kanë punuar.



Diskutim

1. Cili ishte problemi kryesor i njerëzve në përrallë?
2. A mund të kujtoheni në pasuritë e tjera natyrore që mund të zhduken?
3. Si do të dukej bota nëse përnjëherë zhduket karboni? E nëse zhduket nafta?
4. Çka mund të bëhet që të vazhdohet afati i përdorimit të burimeve të përpërtëritshme të energjisë?
5. Cilat janë burimet e ripërtëritshme të energjisë?

Përfundim

Njerëzit janë të varur nga resurset natyrore, të cilat janë të kufizuara. Pa ujë të mjaftueshëm nuk mund të mbijetojmë. Ne mund të kontribuojmë për kursimin e ujit nëse e ndryshojmë sjelljen tonë dhe kemi më shumë kujdes. Këtë mund t’ua themi ta bëjnë edhe të tjerët.

Shënim

Orientimi themelor i diskutimeve duhet të jetë që nxënësit të shprehin se uji, si edhe resurset e tjera natyrore, nuk është i pakufizuar. Me këtë rast duhet të thuhet se në përgjithësi në kulturat tona nuk ka vetëdije për atë, veçanërisht nga shkak se ne i takojmë një nënqielli që është më i pasur me ujë më shumë se pjesa më e madhe e botës. Në një moment diskutimi duhet të përgjithësohet edhe në resurset e tjera: nafta, drunjtë, karboni, energjia elektrike. Kështu do të arrihet në përfundim se njeriu është përgjegjës për përdorimin dhe harxhimin e tyre.

Aktiviteti përmbyllës

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Ndahen në çifte. Secilit fëmijë i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Këshilla për përdorimin më racional të ujit”. Fëmijët duhet t’i lexojnë gjërat e shkruara dhe për ato të bisedojnë në çiftin e tyre së paku për tre gjëra, prej të cilave njëën do të mundohen ta zbatojnë vetë, njëën do ta këshillojnë ta zbatojë një fëmijë tjetër dhe njëën do të këshillojnë ta zbatojë një i rritur – të gjitha për përdorimin më racional të ujit. Në fund mund të propozohet që tekstin gjegjës ta dërgojnë si porosi elektronike nëpër njerëz të ndryshëm.

¹ Ideja është marrë nga: The Green Pack-A multi-media educational resource pack, Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe (REC)



Reflektim

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Një mëngjes i pakëndshëm

Një mëngjes, kur u zgjuan njerëzit e një fshati, ata u ballafaquan me një lajm të tmerrshëm. Burimi i vetëm që mundësonte jetë në fshat ishte tharë. Banorët më të moçëm të fshatit ishin mbledhur dhe po bisedonin e mendoheshin gjerë e gjatë. Ata e shihnin se zgjidhja e vetme nga situata është ta braktisin fshatin që kishte qenë shtëpia e tyre për shumë shekuj. Por, tash do të duhej të shpërnguleshin në ndonjë vend tjetër. Kështu shpallën se do t'i dërgojnë tre kasnecë që të gjejnë ndonjë vend të ri për fshatin e tyre të ardhshëm.

Pas një hulumtimi të gjatë, kasnecët u kthyen dhe thanë se e kanë gjetur një vend të përshtatshëm ku mund ta ngrenë fshatin e tyre të ri. Vendi ishte i qetë dhe toka ishte pjellore, por burimi i vetëm në afërsi ishte i vogël dhe mund të jepte vetëm 50 litra ujë në ditë për njeri. Fshatarët më të moshuar përsëri u mbledhën që të bisedojnë dhe të merren vesh se çka të bëjnë.

Çka mendoni, çka duhet të bëjnë? Si do të durojnë me aq pak ujë?

